RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Mbi
"Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë"

BASHKIA KRUJË

Tiranë 2022

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **4**

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit **4**

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve **5**

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit **7**

II. HYRJA **10**

1. Objektivat e auditimit **10**

2. Qëllimi i auditimit **10**

3. Identifikimi i çështjes **10**

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese **11**

5. Përgjegjësitë e audituesve **11**

6. Kriteret e vlerësimit **11**

7. Standardet e auditimit **12**

8. Metodologjia e auditimit **12**

9. Dokumentimi i auditimit **14**

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT **14**

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Krujë **14**

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit **14**

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm. 14

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për periudhën 2020 – 2021. . 30

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitet 2020-2021. 72

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2020-31.12.2021. 95

2.5 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme 155

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME **157**

V. ANEKSET **174**

Lista e shkurtimeve	
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për aktivitetin ekonomik dhe financiar të periudhës nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2021. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të KLSH-së, Rregulloren e procedurave të auditimit të KLSH-së, Kodin e etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Krujë si planifikimi, hartimi dhe realizimi i buxheteve; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore; auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore; mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Nuk janë zbatuar plotësisht kërkesat e komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Nuk është hartuar dhe miratuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e ushtruara nga NjAB;
- Nuk ka të dhëna mbi numrin e familjeve që ngarkohen me detyrime për taksat dhe tarifat vendore;
- Detyrimet e pa arkëtuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet janë me vlerë **63,639,060 lekë;**
- Borxhi tatimor i Bashkisë Krujë më datë 31.12.2021 është në total **614,535,969 lekë,** për subjektet530,511,820 lekë dhe 84,024,149 lekë për taksat dhe tarifat familjare;
- Në procedurat e prokurimit publik janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve jo në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik si dhe ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të dokumenteve të tenderit;
- Në zbatimin e punimeve të kontratave kanë rezultuar diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **957,860 lekë** pa TVSH.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Krujë, KLSH ka dhënë ñ*Opinion të kualifikuar*ò për pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative, rekomandime për shpërblim të dëmit apo rekomandime mbi përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Krujë si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Krujë 15 akt konstatime dhe 1 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt

verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi projekt raportin e auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Krujë të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së procedurave të auditimit të KLSH.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Rekomandimi
1	Llogaria 4342 ñTë tjera operacione me shtetin (të drejta)ò në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 73,799,447 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 4,097,464 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit në vlerën 77,896,911 lekë, e cila përbëhet nga shuma e: llog.401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò për vlerën 2,839,600 lekë, llog.42 ñDetyrime ndaj personelitò për vlerën 21,714,400 lekë, llog.431 ñDetyrime ndaj shtetit për tatim taksaò për vlerën 1,351,493 lekë, llog.435 ñSigurime shoqëroreò për vlerën 6,446,778 lekë, llog.436 ñSigurime shëndetësoreò për vlerën 888,460 lekë, llog.466 ñMjete në ruajtjeô në vlerën 44,656,180 lekë. Gjithashtu kjo llogari nuk rakordon dhe me llog.7206 ñFinancim të pritshëm nga buxhetiò në Formatin e Performancës së PF, gjendja e së cilës në fund të vitit 2021 është në vlerën 763,937,770 lekë. *(faqe 72-95 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël e gjendjes së llogarisë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ò në fund vitit 2021 të paraqitur gabim, duke përfshirë në mënyrë të saktë vlerat e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 ñFinancim i pritshëm nga buxhetiò. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuara.
2	Gjendja e Llogarisë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë neto 1,423,340,263 lekë, dhe me kosto historike në vlerën 1,823,791,496 lekë. Në gjendjen e llogarisë *212"Ndërtesa Konstruksione",* sipas inventarit kontabël përfshihen dhe aktivet ñNdërtesa e konstruksioneò të NJA Thumanë, me vlerë 104,595,727 lekë dhe aktivi me emërtim ñNdërtime para vitit 2001ò me vlerë 27,146,269 lekë, që i përket NJA Fushë Krujë, të cilat nuk janë të analizuara si në kontabilitet ashtu dhe në inventar fizik, situatë e trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Krujë të këtyre vlerave të aktiveve të pa analizuara në mbyllje të bilancit të vitit 2015 të këtyre njësive të qeverisjes vendore, problematikë së cilës nuk i është dhënë zgjidhje. *(faqe 72-95 të RPA)*	E lartë	Strukturat drejtuese, Bashkia Krujë të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialistë të fushës dhe të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. *212"Ndërtesa Konstruksione".* Për aktivetñNdërtesa e konstruksione NJA Thumanëò në vlerën 104,595,727 lekë dhe për aktivet ñNdërtime para vitit 2001 NjA Fushë Krujëò në vlerën 27,146,269 lekë nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-komuna Thumanë dhe ish-Bashkia Fushë Krujë për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite dhe për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilanc e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.
3	Nga auditimi i PF rezultoi se, gjendja e llogarisë *26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur prej 500,000 lekë në bazë të 25% së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqërinë Aksionare ñKlubi Sportiv Kastriotiò dhe vlerën e kapitalit të derdhur prej 3,500,000 lekë në bazë të 25% së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqërinë Aksionare ñIliria (klubi i futbollit Fushe-Kruje)ò. Mos evidentimi në llogarinë e aktiveve afatgjata llog.26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe në llogarinë kundërparti të saj në pasiv të bilancit llog 1011, ñShtesa të fondit bazëò ka sjellë mos pasqyrim të këtyre investimeve eventuale të kryera nga Bashkia Krujë në vlerën 4,000,000 lekë, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere. *(faqe 72-95 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa që në në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të kryejë veprimet kontabël përkatëse për pasqyrimin në PF të investimeve në vlerën 4,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në SH.A ñKlubi Sportiv Kastriotiò për vlerën 500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 25% të aksioneve dhe SH.A ñIliria (Klubi i Futbollit Fushë-Krujë)ò për vlerën 3,500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve.

4	Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 89 raste faturash me vlerë 220,833,627 lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Krujë, *e ndarë 57* raste në vlerën 25,633,208 lekë janë kryer pagesa të vonuara në vitin 2020 dhe 32 raste në vlerën 195,200,419 lekë në vitin 2021, ku në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh (mos realizim të ardhurash). *(faqe 72-95 të RPA)*	E lartë	Bashkia Krujë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.
5	Nga auditimi i të ardhurave nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi se,për periudhën 2020-2021 janë debitorë 25 qytetarë me vlerë totale 699,615 lekë, ndërsa vlera e detyrimit nga legalizimet e kryera për herët deri më datë 31.12.2020 është 62,939,445 lekë. Në total të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet janë në vlerën **63,639,060 lekë.**Gjithashtu, gjatë vitit 2020 ASHK nuk ka dërguar informacion pranë Bashkisë Krujë lidhur me legalizimet e kryera dhe bashkia nga ana e saj nuk ka dërguar asnjë kërkesë për informacion drejtuar ASHK-së. *(faqe 30-72 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për ñTaksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimetò dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me **vlerë 63,639,060 lekë**. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Krujë të bashkëpunojnë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
6	Rezulton se, në Bashkinë Krujë në fund të vitit 2021 të jenë 2251 subjekte debitorë me vlerë totale të detyrimit 530,511,820 lekë. Gjithashtu, bashkia nuk ka të dhëna lidhur me numrin total të familjeve që kanë detyrim të paguajnë taksat dhe tarifat vendore dhe si rrjedhojë, nuk është e mundur të identifikohet saktë as numri i familjeve debitore. Në total vlera progresive e detyrimit për familjet debitore e regjistruar është 84,024,149 lekë. Në përfundim, borxhi tatimor i Bashkisë Krujë më datë 31.12.2021 është në vlerën **614,535,969 lekë**. Nga ana e Bashkisë Krujë nuk janë marrë të gjitha masat për të bërë të mundur përmirësimin e gjendjes së debitorëve progresiv. *(faqe 30-72 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **614,535,969 lekë** nga taksapaguesit privat dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatës për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitorë. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgojë listën e subjekteve debitorë të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë së Financës.
7	Në territorin eBashkisë Krujë për periudhën nën auditim ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit me pakicë të lëndëve djegëse 31 subjekte që rezultojnë të pa pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit duke sjellë një efekt financiar me vlerë totale **7,166,460 lekë** të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë. *(faqe 30-72 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **7,166,460 lekë** ndaj Bashkisë Krujë.
8	Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Krujë u konstatua se, për vitin 2020, janë marrë 28 masa administrative ñGjobëò nga të cilat nuk janë paguar 22 gjoba me vlerë 9,200,000 lekë. Për vitin 2021 janë marrë 25 masa administrative ñGjobëò me vlerë totale 16,202,600 lekë nga të cilat nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë gjobë. Në përfundim për periudhën 2020-2021të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale **25,402,600 lekë.** *(faqe 30-72 të RPA)*	E lartë	Drejtoria Juridike dhe IMTV në Bashkinë Krujë të ndjekin të gjitha hapat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **25,402,600 lekë**.
9	Nga auditimi i zbatimit të kontratave në **4** raste,u konstatuan punime/blerje mallrash të pakryera dhe të paguara në shumën **957,860 lekë** pa TVSH *(faqe 95-156 të RPA)*	E lartë	Bashkia Krujë të marrë masa për arkëtimin e vlerës: **1. 289,224 lekë** për shërbimin e pakryer të ndërrimit të rrotave të kontenierëve, nga BOE ñR... 96ò dhe ñL... 2007ò. **2. 385,632** lekë për amortizimin e kontenierëve nga BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2007ò.

			3. **42,332 lekë** nga BOE ñD...ò SHPK dhe ñF.ò, për shërbimin e pakryer në rrugën ñLekë Zahariaò. **4. 240,672 lekë** nga OE ñE...ò SHPK për zërin e punime të preventivit të nr. 5 ñ*Rrafshim skarpate në gërmim, ekskavator 0.25m³*ò për sasinë 10,464 m³ në objektin ñ*Rehabilitim e pritës lumore Murqinë".*
10	Nga auditimin e 13 procedurave të prokurimit për vitin 2020-2021 me vlerë të fondit limit 1,185,431 mijë lekë pa TVSH, ka rezultuar se në DT janë aplikuar kritere të ekzagjeruara dhe të paargumentuara në rastin e 5 procedurave me vlerë të fondit limit 1,055,650 mijë lekë pa TVSH ose 89%. Gjithashtu, nga auditimi i këtyre 13 procedurave me vlerë kontrate 1,160,112 mijë lekë pa TVSH, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike 6 procedura me vlerë kontrate 1,007,391 mijë lekë pa TVSH ose 87 % e vlerës së kontratave të lidhura. Në këto 6 procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të dokumenteve të tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave në vlerën **1,007,391mijë lekë** me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik. *(faqe 95-156 të RPA)*	E lartë	**1 -** Njësia e Prokurimit në çdo rast të përcaktimit të kritereve kualifikuese, duhet të analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim. Gjithashtu, nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë më përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT. **2 -** Bashkia Krujë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

1. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2021:

Grupi i auditimit të KLSH, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Krujë të periudhave ushtrimore 01.01.2021 ï 31.12.2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të kualifikuar**[1]për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Krujë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021ò.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimi (Kap I, faqe 6).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve

[1] ***Një opinion i kualifikuar*** *jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.*

monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin disa gabime materiale por jo të përhapura, (materialiteti i llogaritur është në vlerën 37,773,170 lekë), të cilat sipas mendimit tonë kanë efekt në pozicionin financiar të llogarive të bashkisë. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e Raportit Përfundimtar të Auditimit, konkretisht:

- Llogaria 4342 ñTë tjera operacione me shtetin (të drejta)ò në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 73,799,447 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 4,097,464 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit

-Vlera prej 44,192,686 lekë pjesë e gjendjes së llogarisë 202*"Studime dhe Kërkime"* që i përket 60 projekt-studimeve e mbartur që nga viti 2018 e më përpara*,* nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Gjithashtu nuk është llogaritur amortizim në masën 15% të vlerës së mbetur.

- Në gjendjen e llogarisë *212"Ndërtesa Konstruksione",* sipas inventarit kontabël përfshihen dhe aktivet ñNdërtesa e konstruksioneò të NJA Thumanë, me vlerë 104,595,727 lekë dhe aktivi me emërtim ñNdërtime para vitit 2001ò me vlerë 27,146,269 lekë, që i përket NJA Fushë Krujë, të cilat nuk janë të analizuara si në kontabilitet ashtu dhe në inventar fizik.

- Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë *214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune",* konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 63 artikuj aktive materiale në vlerën 47,358,283 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël.

- Në gjendjen e llogarisë*215"Mjete Transporti"* janë përfshirë vlera e 4 automjeteve prej 7,986,465 lekë, të cilët nuk ekzistojnë fizikisht, pasi 2 automjete janë dhe nuk ka kaluar pronësia tek blerësi (Bashkisë) dhe 2 automjete kanë humbur, aktive të cilat vazhdojnë të jenë të evidentura në kontabilitet.

- Gjendja e llogarisë *26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur prej 500,000 lekë në bazë të 25% së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqërinë Aksionare ñKlubi Sportiv Kastriotiò dhe vlerën e kapitalit të derdhur prej 3,500,000 lekë në bazë të 25% së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqërinë Aksionare ñIliria (Klubi i Futbollit Fushë-Krujë)ò.

2. Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Krujë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e ñBazës për Opinioninò, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar[2] të përputhshmërisë.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

- Nga auditimi i **13** procedurave të prokurimit për vitin 2020-2021 me vlerë të fondit limit 1,185,431 mijë lekë pa TVSh, ka rezultuar se në DT janë aplikuar kritere të ekzagjeruara dhe të paargumentuara në rastin e **5** procedurave me vlerë të fondit limit 1,055,650 mijë lekë pa TVSh ose 89%.

[2]*Sipas* ***Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë*** *të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020,* ***Opinion i kualifikuar*** *jepet nëse rastet e mospërputhjeve janë materiale por jo të përhapura, fq. 107.*

-Nga auditimi i **13** procedurave të prokurimit për vitin 2020-2021 me vlerë kontrate 1,160,112 mijë lekë pa TVSh, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike **6** procedura me vlerë kontrate 1,007,391 mijë lekë pa TVSh ose 87 % e vlerës së kontratave të lidhura. Në këto 6 procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të dokumenteve të tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave në vlerën **1,007,391mijë lekë** me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

- Në **4** raste,u konstatuan punime/blerje mallrash të pakryera dhe të paguara në shumën **957,860 lekë** pa TVSh.

- Detyrime të pa arkëtuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet me vlerë **63,639,060 lekë.**

- Detyrime të pa arkëtuara nga gjobat e IMTV-së në vlerën **25,402,600 lekë.**

- Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve konstatohet se detyrimet që subjekteve fizikë/juridikë dhe familjet kanë deri më 31.12.2021 (debitorët progresiv), janë, në vlerën totale **614,535,969lekë,** për subjektet 530,511,820 lekë dhe 84,024,149 lekë për taksat dhe tarifat familjare.

- Detyrime të pa arkëtuara nga mos pagesa e vlerës për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse në vlerën **7,166,460 lekë.**

- Detyrime të pa arkëtuara nga kontratat e qirasë me vlerë **68,400 lekë.**

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë

Stafi drejtues Bashkia Krujë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator lidhur me raportimin financiar, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet.

Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[3]. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin, të cilat i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

[3] ***ISSAI 300,*** *Parimet bazë të auditimit në lidhje me përputhshmërinë pohojnë se auditim duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimtarive të paligjshme që mund të cenojnë ndjeshëm objektin e auditimit.*

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 259/1 Prot, datë 09.03.2022,miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 09.03.2022 deri në datë 06.05.2022, në subjektin Bashkia Krujë u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2020 ï 31.12.2021.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E. V. ï *Përgjegjës Grupi*
2. I. Sh. ï *Anëtare*
3. E. K. ï *Anëtare*
4. K. P. ï *Anëtare*

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Krujë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[4];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Krujë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2020 - 2021, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Krujë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

Pika 1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.

Pika 2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit,burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

[4] *Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.*

Pika 3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitet 2020-2021.
Pika 4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2020-31.12.2021.
Pika 5. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese
Strukturat drejtuese të Bashkisë Krujë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve
Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit
Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Krujë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Krujë. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 ñPër buxhetin e vitit 2021ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 ñPër unifikimin e procedurave tëkontrollit të territorit ngaInspektorati Kombëtar iMbrojtjes së Territorit dhe ai iNjësisë Vendoreò;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò;

- Udhëzimi plotësues nr. 2 datë 19.1.2019 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò;
- Udhëzimi MFE nr. 2 datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2020ò;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 ñPër nëpunësit zbatues të të gjitha niveleveò;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò, etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Krujë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 ñParimet themelore të auditimit të sektorit publikò;
- ISSAI 400 ñParimet themelore të auditimit të përputhshmërisëò, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 ñPrezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëò; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për tôju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Krujë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[5].

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tôu audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[6].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*;*

[5] ISSAI 1315

[6] *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

dhe së fundi kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Krujë

Bashkia e Krujës gjendet në pjesën veriore të Shqipërisë së mesme. Shtrihet midis kodrave të Ishmit, fushave të Kamzës, malit të Dajtit, zonës së Mnerit, Qafë-Shtamës, malit Skënderbej dhe zonës së Kurbinit. Ajo kufizohet me Bashkitë Laç, Durrës, Vorë, Kamëz, Tiranë edhe Mat dhe shtrihet në një sipërfaqje prej 339.02 km2. Relievi i zonës paraqet një mozaik formash dhe tipologjish me lartësira që zbresin gradualisht në drejtimin lindje-perëndim. Zona fushore shtrihet në perëndim midis kodrave të Ishmit ï Prezë, Tapizë, Krastë Krujë. Zona kodrinore ka një lartësi 100-300 m mbi nivelin e detit. Zona malore përbëhet nga dy vargje paralele me drejtim veri-perendim dhe jug-lindje. Vargu Krujë-Dajt dhe vargu Skënderbej. Bashkia ka si qendër qytetin e Krujës që shtrihet në faqen perëndimore të malit të Krujës me një lartësi 600 m mbi nivelin e detit.

Bashkia Krujë përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Krujë, Fushë-Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë dhe Cudhi. Sipas Censusit të vitit 2011 Bashkia Krujë ka 59.814 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrit të Gjendjes Civile numëron një popullsi prej 79.608 banorësh. Kruja ka një sipërfaqe prej 339.02 km^2. Sipas Censusit, densiteti i popullsisë është 176.43 banorë/km^2 ndërsa sipas Regjistrit Civil dendësia është 234.81 banorë/km^2. Referuar të dhënave nga Regjistri i Gjendjes Civile, Njësia më e madhe administrative është Fushë Kruja, me 27,076 banorë dhe 7,704 familje e ndjekur nga Thumanë me 16.563 banorë dhe 2.929 familje, Kruja me 16,345 banorë dhe 5,129 familje, Nikël me 10,563 banorë dhe 2,929 familje, Bubq me 8,805 banorë dhe 2,495 familje dhe Njësia Cudhi me 2,988 banorë dhe 987 familje.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së

1. Mjedisi i kontrollit

(Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010)

Bashkia Krujë funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Krujë, referuar në Vendim Nr. 09, datë 28.02.2018, nr. 1034 Prot., për miratimin e rregullores ñMbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrativeò. Gjithashtu ekziston edhe një Vendim Nr. 10, datë 11.01.2021, nr. 182 Prot., për miratimin e rregullores ñMbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrativeò, por nuk vihen re ndryshime në përmbajtje të rregullores edhe pse ka dalë vendimi në vitin 2021.

Grupi i punës ngarkuar për zbatimin e këtyre vendimeve është Nën-kryetari, sekretari i përgjithshëm, drejtoritë, sektorët përkatës dhe administratorët. Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përsa i përket pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njësisë Publike, vihet re se përgjithësisht është hartuar bazuar në këtë manual dhe mbështetet në legjislacionin përkatës, duke përmbajtur disa nga elementët thelbësore, që çdo rregullore duhet të ketë.

Kodi i Etikës

Bashkia Krujë në vitin 2020 ka funksionuar me Kodin e Etikës referuar shkresës nr. Ext Prot., datë 22.01.2020. Kodi i Etikëspër vitin 2021 është po i njejti në përmbajtje me atë të një viti më parë edhe psë i referohet shkresës nr. 3918 Prot., datë 10.06.2021. Kodi është i bazuar në legjislacionin përkatës, ku mbështetet Njësia Publike për hartimin dhe përpilimin e tij.

Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:

Për vitin 2020, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Krujë, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2020, VKB Nr. 100, datë 26.12.2019, vendosi se numri i përgjithshëm i punonjësve organik të Bashkisë dhe Njësive Administrative të saj të jetë **366 punonjës,** sipas kësaj ndarje: Bashkia Krujë 147 punonjës, NA Fushë Krujë 73 punonjës, NA Thumanë 66 punonjës, NA Nikël 36 punonjës, NA Bubq 30 punonjës, NA Cudhi 14 punonjës. Numri i punonjësve me funksione të deleguara (arsimi parashkollor ï kopshtet + QKF, shërbimet mbështetëse arsimi parashkollor + 9 ï vjeçar, arsimi i mesëm, administrimi i pyjeve, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, rrugët rurale, QKB, punonjës sezonale) është **168 punonjës.** Bashkangjitur Vendim Nr. 4, datë 10.01.2020, nr. 99 Prot., ñPër miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative të saj për periudhën 01.02.2020 deri në 01.02.2021ò. Gjithsej 538 punonjës organik, përfshirë këtu edhe punonjësit me funksione të deleguara edhe ata të Njësive Administrative.

Referuar shkresës nr. 1810 Prot., datë 01.04.2022, për pozicionet e punës trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin Civilò, në muajin janar 2020 janë 118 punonjës me status, 416 punonjës me kontratë pune dhe 0 vakanca. Ndërsa në muajin dhjetor 2020 janë 115 punonjës me status, 412 punonjës me kontratë pune dhe 7 vakanca.

Për vitin 2021, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Krujë, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2021, Vendim Nr. 278, datë 24.12.2020, nr. 8831 Prot., ñPër miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative të saj për periudhën 01.02.2021 deri në 01.02.2022ò, bazuar në VKB Nr. 100, datë 26.12.2019, vendosi se numri i përgjithshëm i punonjësve organik të Bashkisë dhe Njësive Administrative të saj të jetë **366 punonjës**. Për vitin 2021,numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Krujë, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2021, funksionon me po të të njejtën VKB si në vitin 2020.

Referuar shkresës nr. 1810 Prot., datë 01.04.2022, për pozicionet e punës trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin Civilò, në muajin janar 2021 janë 115 punonjës me status, 412 punonjës me kontratë pune dhe 7 vakanca. Ndërsa në dhjetor 2021 janë 114 punonjës me status, 419 punonjës me kontratë pune dhe 1 vakancë.

Tabela nr.1: Mbi rekrutimin e punonjësve në Bashkinë Krujë

Nr.	Viti 2020 dhe 2021	Np. Civil	Kontratë Pune	Nr. Përgjithshëm	Vakanca
1.	Janar 2020	118	416	534	0
2.	Dhjetor 2020	115	412	527	7
3.	Janar 2021	115	412	527	7
4.	Dhjetor 2021	114	419	533	1

Burimi: Bashkia Krujë

2. Menaxhimi i riskut

(Në zbatim të kërkesave të nenin 21, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010)

Regjistri i Riskut për vitin 2020, shkresa nr. Ex Prot., datë 13.02.2020, dhe regjistri i riskut për vitin 2021, shkresa nr. 950 Prot., datë 10.02.2021, në Bashkinë Krujë është hartuar sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Në përgjithësi, është i plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një regjistër risku. Në këtë regjistër janë përshkruar disa nga risqet kryesore për vitin përkatës duke krijuar një pamje më analitike të situatave dhe përcaktuar nivelin e secilit prej risqeve para dhe pas kontrollit. Gjithashtu janë përcaktuar nevojat për kontrollet e mëtejshme, veprimet për të adresuar boshllëqet, duke identifikuar në të njejtën kohë edhe zotëruesit e riskut.

Disa nga risqet e identifikuara janë, ndryshimet e shpeshta të bazës ligjore dhe rregullatore, profesionalizmi i specialistëve të Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve, njësitë mund të mos kuptojnë qasjen dhe rolin që kërkon të ketë juristi, mosmbledhja e të ardhurave të planifikuara në bazë të përllogaritjes sipas legjislacionit në fuqi për taksat dhe tarifat vendore, ndryshimet e vazhdueshme të gjendjes së subjekteve tregtare mund të shkaktojnë probleme dhe vonesa në përditësimin e të dhënave të tyre, mungesa e sistemit të kompjuterizuar IT për kontabilizimet financiare, ndryshimet e shpeshta të bazës ligjore dhe rregullatore të njësive që auditohen, gjetjet dhe rekomandimet e përgjithshme të paadresuara për personat që duhet të marrin masa për përmirësime të mëvonshme, profesionalizmi i audituesve, auditi i brendshëm shikohet si kontroll që është i përqëndruar në zbulimin e shkeljeve dhe jo si partner që është atje për të ndihmuar njësitë që auditohen të përmirësojnë punën e tyre, njësitë që janë objekt auditimi mund të mos kuptojnë qasjen dhe rolin e ri që kërkon të marrë auditi i brendshëm etj.

Risqet e identifikuara në vitin 2021 janë të njejta me ato të identifikuara edhe në vitin 2020, ndërsa vlerësimet e nivelit të riskut para dhe pas kontrollit ndryshojnë, referuar niveleve të riskut të vlerësuara një vit më parë, pra në 2020. Në disa nga risqet vihet re se niveli është rritur, ndërsa në disa të tjera niveli i riskut paraqitet më i ulët, ashtu siç ka dhe raste që kanë të njejtin nivel risku. Të dhëna këto, që merren në shqyrtim krahasuar me vitin paraardhës, në mënyrë që të ketë një bazë krahasimi të qëndrueshme dhe sa më reale.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut për vitin 2020 dhe 2021 është hartuar për të dyja vitet duke qenë e mbështetur në bazën ligjore specifike dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë. Në përmbajtje të saj përshkruhen pikat kryesore mbi të cilat është menduar të organizohet i gjithë procesi i menaxhimit të riskut, bazuar në hartimin e planit vjetor të punës së Bashkisë, evidentimin e fushave themelore të funksionimit dhe evidentimin e zonave të riskut në kuadër të fushave të përcaktuara, përkufizimi dhe përshkrimi i risqeve, vlerësimi i impaktit të një risku të caktuar, përkufizimi i probabilitetit që një risk i caktuar të ndodhë, caktimi i detyrave konkrete që lidhen me kundërveprimin e një lloji të caktuar risku, hartimi i regjistrit të riskut, hartimi i kodit të etikës dhe rregullores.

Nga Bashkia Krujë janë ndjekur hapat për implementimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, duke u bazuar edhe në UMF nr. 28, datë 15.12.2011 ñ*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm një njësitë publike".*

3. Veprimtaria e kontrollit

(Në zbatim të kërkesave të nenin 22, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010)

Referuar shkresës, Urdhër Nr. 209, nr. 1969 Prot., datë 21.04.2020, ñPër ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut dhe krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjikò në Bashkinë Krujë, të përbërë nga 17 anëtarë.

Referuar shkresës, Urdhër Nr. 103, nr. 942 Prot., datë 10.02.2021, ñPër ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut dhe krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjikò në Bashkinë Krujë, të përbërë nga 17 anëtarë.

Koordinatori i riskut për vitin 2020 dhe 2021, është znj. O. L., caktuar në pozicionin e Koordinatores së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, bazuar në Vendim nr. 1961/1 Prot., datë 21.04.2020 dhe Vendim Nr. 37, nr. 943 Prot., datë 10.02.2021, vazhdon të jetë po e njejta punonjëse.
Referuar shkresës, Urdhër Nr. 225, datë 29.04.2020, nr. 2094 Prot., ñPër ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021 ï 2023 dhe buxhetit vjetor 2021ò të Bashkisë Krujë, bashkangjitur me kalendarin e shpenzimeve buxhetore dhe përgatitijen e PBA 2021 - 2023.
Ekipet e Menaxhimit të Programeve në Bashkinë Krujë janë për fusha si, Funksioni i Shërbimeve të Përgjithshmë Publike, Rendi dhe Siguria Publike, Çështjet Ekonomike; Funksioni i Shërbimeve Bujqësore, Inspektimi, Ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit, Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit; Funksioni i Shërbimeve Publike Vendore, Rrjeti Rrugor Rural, Menaxhimi i ujrave të zeza, Furnizimi me ujë; Funksioni i Planifikimit Urban Vendor; Funksioni i Argëtim, Kultura, Feja dhe Sporti; dhe Funksioni i Mbrojtjes Sociale.
Referuar shkresës, Urdhër Nr. 466, nr. 7280 Prot., datë 27.10.2020, ñPër ngritjen e grupit të punës për hartimin dhe miratimin e buxhetit të vitit 2021ò, të përbërë nga 3 (tre) anëtarë të grupit koordinues dhe 10 (dhjetë) anëtarë për grupin e punës që do e hartojë.
Deklarata e Cilësisë për vitin 2020 në Bashkinë Krujë, është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE me shkresën nr. 23/2 Prot., datë 25.02.2021. Deklarata e Cilësisë për vitin 2021 në Bashkinë Krujë është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE me shkresën nr. 1114/1 Prot., datë 25.02.2022.
Shkresa nr. 23 Prot., datë 25.02.2021, **Pyetësori i Vetëvlerësimit** për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për Bashkinë Krujë, është hartuar dhe miratuar sipas formatit standard të manualit MFK. Për vitin 2021, shkresa nr. 1114 Prot., datë 25.02.2022, Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për Bashkinë Krujë, është hartuar dhe miratuar sipas formatit standard të manualit MFK.
Përgjithësisht pyetësori është realizuar duke u mbështetur në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò. Vlerësimi i riskut është bërë sipas katër seksioneve, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi. Në çdo seksion janë analizuar parimet në të cilat mbështetet njësia publike, duke dhënë edhe përgjigjet e arsyetuara për secilën prej tyre. Disa nga parimet janë angazhimi për integritet dhe vlerat etike; demostrimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje; krijimi i strukturave organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë; demostrimi i angazhimit në realizimin e kompetencave; veprimi në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale; specifikimi i objektivave si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve lidhur me këto objektiva; identifikimi dhe analiza e risqeve për arritjen e objektivave; vlerësimi i mundësive të riskut për mashtrime; identifikimi dhe analiza e ndryshimeve që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm; përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit; zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë; vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave; marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit cilësor; përdorimi i komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm; përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm; dhe vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.
Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2020, është hartuar dhe përpiluar sipas manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, bazuar në nenin 18, Ligji nr.10 296, datë 8.7.2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò.

referuar shkresës nr. 23/1 Prot., datë 25.02.2021 dhe për vitin 2021 referuar shkresës nr. 1114/2 Prot., datë 25.02.2022. Raportet për të dyja vitet janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE dhe përmbajnë të gjitha rubrikat kryesore si përmbledhja ekzekutive, vlerësimi i sistemit të MFK-së, gjetjet dhe rekomandimet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm, masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen.
Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë, për vitin 2020 ka hartuar **hartën e proceseve të punës** referuar shkresës nr. ï Prot., datë 06.01.2020 dhe për vitin 2021 ka hartuar hartën e proceseve të punës referuar shkresës nr. ï Prot., datë 05.01.2021, e cila është e njejtë me atë të hartuar një vit më parë, pra në 2020, duke përfshirë të njejtat procese dhe nënprocese. Hartat e proceseve të punës, për të dyja vitet, janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë.
Ky dokument është hartuar sipas formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin duke iu referuar gjithashtu edhe bazës ligjore përkatëse. Nëpërmjet hartës së proceseve të punës, garantohet uniformiteti në kryerjen e proceseve të punës, identifikohen aktivitetet e kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen, së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij. Proceset që përfshin harta e punës për vitin 2020 janë përgatitja e dokumentacionit në kuadër të hartimit të Projekt ï Buxhetit Afatmesëm 3-vjeçar dhe Projekt ï Buxhetit vjetor për Bashkinë Krujë, monitorimi periodik dhe vlerësimi i treguesve buxhetorë, përgatitja e raportit javor/mujor për investimet me financim të huaj dhe mujor për investimet me financim të brendshëm, kryerja e pagesave në përputhje me Buxhetin e miratuar dhe akte të tjera normative, monitorimi dhe raportimi për ekzekutimin e NA, rakordimi i të dhënave/ shifrave me thesarin, mbajtja e kontabilitetit: shpenzime. Nënproceset e punës si krijimi i Ekipeve të Menaxhimit sipas programeve buxhetore; marrja e tavaneve nga MF, ndarja e tyre sipas programeve buxhetore; mbledhja dhe përpunimi i kërkesave buxhetore; përgatitja e PBA dhe projekt-buxhetit vjetor. Te kategoria afati është specifikuar faza I - 30 prill dhe faza II - 30 gusht. Procesi tjetër është rakordimi i të dhënave/shifrave me thesarin, ku nënproceset janë mbledhja e të dhënave, regjistrimi i tyre dhe raportimi. Te kategoria afati është specifikuar data 1-10 çdo muaj.
Përsa i takon vendimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik, në Bashkinë Krujë nuk janë të dokumentuara në formë shkresore minutat e takimit për mbledhjet që ka kryer GMS, për vitet 2020 dhe 2021. I vetmi takim i dokumentuar është rasti kur GMS është mbledhur për ñCaktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022ò, bazuar në Vendim nr. 106, datë 28.12.2021. Si rrjedhim i kësaj, nuk ka të evidentuar as vendime, që vijnë si rezultat i çështjeve që janë diskutuar në këto mbledhje. Nisur nga ky fenomen, vihet re edhe mospërgatitja e disa dokumentave si plani për kontrollin e brendshëm, plani i veprimit për arritjen e objektivave, të cilat janë rezultat i mbledhjeve që realizon GMS dhe vendimeve që merren në to.
Plani për Kontrollin e Brendshëm për vitin 2020 dhe 2021, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Krujë. Referuar në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3. ku theksohet se Plani për Kontrollin e Brendshëm, është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit, me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.
Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për periudhën objekt auditimi, është i hartuar dhe miratuar për vitin 2020, me shkresën nr. - Prot., datë 25.02.2020 dhe për vitin 2021, me shkresën me nr. - Prot., datë 25.02.2021. Hartimi i tyre është relizuar sipas formatit që ka manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kapitulli IV i tij, duke

përfshirë një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të planifikuara për periudhat e përmendura më lart.

Plani i veprimit për arritjen e objektivave për vitet 2020 dhe 2021, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Krujë. Veprim i cili është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, Neni 8, pika a.

Në Bashkinë Krujë nuk ka një urdhër për hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditit. Të vetmet gjurmë që janë hartuar specifikohen si vijon duke marrë në konsideratë ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, por pa u bazuar në një urdhër konkret.

Gjurma standarde e auditit për zbatimin e buxhetit është hartuar për vitin 2020 referuar shkresës, nr. - Prot., datë 07.01.2020, ndërsa hartimi i saj për vitin 2021 i referohet shkresës, nr. - Prot., datë 06.01.2021. Gjurmët për të dyja vitet janë të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Krujë.

Ky dokument është i mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të paraqitet procesi i ekzekutimit të pagesave në SIFQ, duke përfshirë në mënyrë skematike të gjitha fazat dhe etapat nëpër të cilat kalon ky proces duke adresuar edhe strukturat përgjegjëse që angazhohen me secilin nga proceset.

Procedura Standarde e Veprimit për Prokurimet Publikembi kufirin monetar të blerjes me vlerë të vogël, janë përgatitur për të dyja vitet 2020 dhe 2021. Në intervistën e realizuar me përgjegjësin e Prokurimeve Publike, z. G. H. bëhet me dije se përsa i përket prokurimeve, nuk është hartuar një gjurmë e mirfilltë për realizimin e këtij procesi, por në vend të saj të gjitha fazat dhe stadet nëpër të cilat kalon procesi i standardizuar i prokurimit, janë të paraqitura në mënyrë analitike në shkresën e datës 07.01.2020 dhe në shkresën e datës 06.01.2021, ñPSV për Prokurimet Publike mbi kufirin monetar të blerjes më vlerë të vogëlò, të cilat janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë. Në përmbajtje përshkruhen në mënyrë analitike etapat e procesit duke filluar nga përgatitja e dosjes së prokurimit dhe inicimi i procedurës përkatëse deri te monitorimi i kontratës dhe zbatimi i saj. Bashkangjitur paraqitet edhe diagrama ilustruese e procedurës standarde të veprimit, me të gjitha hapat që ndiqen nga fillimi deri në përfundim të kësaj procedure.

Procedura Standarde e Veprimit për Prokurimet Publike, përprocedurat e prokurimit blerje me vlerë të vogël, është përgatitur për vitin 2020 dhe funksionon me të njejtën edhe për vitin 2021.

Në intervistën e realizuar me përgjegjësin e Prokurimeve Publike z. G. H., bëhet me dije se përsa i përket prokurimeve, nuk është hartuar një gjurmë e mirfilltë për realizimin e këtij procesi, por në vend të saj të gjitha fazat dhe stadet nëpër të cilat kalon procesi i standardizuar i prokurimit për blerjet me vlerë të vogël, janë të paraqitura në mënyrë analitike në shkresën e datës 06.01.2020, e miratuar nga titullari i Bashkisë Krujë.

Në përmbajtje të saj përshkruhen në mënyrë analitike etapat e procesit, duke filluar nga përgatitja e dosjes së prokurimit dhe inicimi i procedurës përkatëse deri te monitorimi i kontratës dhe zbatimi i saj. Bashkangjitur paraqitet edhe diagrama ilustruese e procedurës standarde të veprimit, me të gjitha hapat që ndiqen nga fillimi deri në përfundim të kësaj procedure. Për vitin 2021, Bashkia Krujë ka funksionuar me të njejtën Procedurë Standarde të Veprimit për procedurat e prokurimit blerje me vlerë të vogël, si në vitin 2020.

Plani vjetor i punës i Drejtorisë së Financës, për vitin 2020 është hartuar me shkresën nr. - Prot., datë 06.01.2020 dhe plani vjetor i punës, për vitin 2021, është hartuar me shkresën nr. Ex Prot., datë 31.12.2020. Planet për të dyja vitet janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë. Përgjithësisht paraqesin disa nga detyrat kryesore të programuara, që parashikon të kryejë Drejtoria e Financës brenda këtyre viteve. Plani është i hartuar në mënyrë të tillë që, adreson edhe strukturën përgjegjëse për zbatimin e detyrave, strukturën përgjegjëse për

ndjekje dhe raportim, gjithashtu edhe një afat brenda të cilit duhet të zbatohen këto detyra, duke u mbështetur edhe në bazën ligjore përkatëse.

4. Informacioni dhe komunikimi

(Në zbatim të kërkesave të nenin 23, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010)

Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Krujë, nuk ka të specifikuar në asnjë nga nenet e saj, mënyrën e realizmit të komunikimit të brendshëm në Bashkinë Krujë. Por çfarë evidentohet nga praktika, vihet re se komunikimi realizohet në mënyrë shkresore nëpërmjet (raporteve periodike, evidencave, procesverbaleve), verbale dhe nëpërmjet rrjetit të brendshëm elektronik (internetit). Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare brenda Bashkisë apo jashtë saj nga nëpunësit dhe punonjësit, bëhet gjithmonë duke përdorur postën elektronike (e-mail), ndërsa qasja publike përsa i përket publikimeve elektronike bëhet rregullisht në faqen e web-it të Bashkisë Krujë.

5. Monitorimi

(Në zbatim të kërkesave të nenin 24, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010)

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse. Një formë e monitorimit, është pyetësori i vetëvlerësimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Titulli i gjetjes 1:*Mungesa e dokumentacionit që vërteton realizmin e mbledhjeve të GMS dhe marrjen e vendimeve për çështjet kryesore të diskutuara në këto takime.*

Situata: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

Procesi i realizimit të minutave të takimit për mbledhjet që ka kryer GMS, për vitet 2020 dhe 2021, nuk është i dokumentuar në formë shkresore. Si rrjedhim i kësaj, nuk ka të evidentuara as vendime, që vijnë si rezultat i çështjeve që janë diskutuar në këto mbledhje. Takimi i vetëm i dokumentuar është rasti kur GMS është mbledhur për ñCaktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022ò, bazuar në Vendim nr. 106, datë 28.12.2021.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar, Neni 27, pika 1. Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të diskutimit të çështjeve kryesore dhe mangësive serioze që dalin brenda njësisë dhe i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

Shkaku: Mos zbatimi i kuardit ligjor dhe nënligjor për MFK.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat në mënyrë që, temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.

Titulli i gjetjes 2:*Moshartimi i Planit për Kontrollin e Brendshëm për periudhën objekt auditimi.*

Situata: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

Nuk është hartuar Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, i cili referuar në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3. theksohet se është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit, me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar, Neni 22, pika 1. Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë neglizhencën për të mos hartuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të cilat ndihmojnë për të dhënë siguri të arsyeshme, lidhur me risqet që kufizohen brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.
Shkaku: Mos zbatimi i kuardit ligjor dhe nënligjor për MFK.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat që të hartojë në mënyrë periodike Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, i cili ndihmon në organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.
Titulli i gjetjes 3: *Mos hartimi i Planit të Veprimit për arritjen e objektivave për periudhën objekt auditimi.*
Situata: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:
Nuk është hartuar Plani i Veprimit për arritjen e objektivave, i cili paraqet hapat që do të ndërmerren për të arritur objektivat e njësisë publike dhe për minimizimin e risqeve apo mangësive.
Kriteri:
Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar, Neni 8, pika a. Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë neglizhencën për të mos hartuar Planin e Veprimit për arritjen e objektivave për periudhën objekt auditimi, i cili ndihmon në krijimin e një pamje më të qartë të çështjeve të njësisë publike dhe organizimin e punës në mënyrë të tillë që objektivat e paracaktuara të arrihen brenda një afati kohor specifik.
Shkaku: Mos zbatimi i kuardit ligjor dhe nënligjor për MFK.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat që të hartojë në mënyrë periodike Planin e Veprimit për arritjen e objektivave, duke bërë të mundur realizimin dhe përmbushjen e objektivave duke siguruar minimizimin e risqeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Znj. S. S., Drejtor i Financës, nënpunës zbatues.

Vlerësim mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm
Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Krujë, rezultoi se:
Organizimi dhe Funksionimi
Bashkia Krujë ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm. Për vitin 2020 është miratuar me Vendim Nr. 100, datë 26.12.2019, por ka pësuar ndryshime bazuar në shkresën Vendim nr. 4, datë 10.01.2020, nr. 99 Prot., ñPër miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative të sajò, për periudhën 01.02.2020 deri në 01.02.2021. Për vitin 2021 është miratuar me Vendim Nr. 278, datë 24.12.2020, nr. 8831 Prot., datë 24.12.2020 ñPër miratimin e ndryshimeve në strukturën organizative të Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative të sajò, për periudhën 01.02.2021 deri në 01.02.2022.

Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Krujë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.
Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publikò, është krijuar njësia e auditimit të brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.
Kapaciteti auditues i strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Krujë, është në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publikò, i ndryshuar. Njësia e Auditit të Brendshëm që nga viti 2016 që është krijuar, bazuar në Vendim nr. 21, nr. 2082 Prot., datë 31.05.2016 ñPër miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Krujë për periudhën 01.06.2016 deri 31.12.2016ò, ka funksionuar me 1 (një) Përgjegjës njësie dhe 2 (dy) Specialistë, sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë. Bashkangjitur gjithashtu edhe Vendim Nr. 28, datë 31.05.2016 ñPër shtimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Krujë e njësive administrative në varësi të saj për periudhën qershor ï dhjetor 2016ò. Po kështu ka qenë struktura edhe për vitin 2020 dhe 2021. Ku përgjegjës i NjAB është z. E. F., i cili është emëruar në këtë pozicion nga data 31.10.2016 dhe 2 (dy) specialistët janë, z. H. Z. për periudhën (25.10.2016 - 31.05.2021) dhe znj. E. K.
Pas datës 31.05.2021, të largimit të z. H. Z. nga pozicioni i specialistit të njësisë së auditit të brendshëm, referuar Urdhër nr. 345, nr. 3639 Prot., datë 01.06.2021, në pozicionin e specialistit të NjAB, referuar Urdhër nr. 733, nr. 8543 Prot., datë 16.12.2021, është emëruar përkohësisht në pozicionin si specialiste e Auditit të Brendshëm znj. S. D., e pa pajisur me certifikatë të audituesit të brendshëm. Eksperienca e mëparshme e punës së znj. S. D. është 1 vit e 3 muaj, bazuar në librezën e punës së saj, konkretisht nga data 17.09.2020 ï 14.12.2021, në sektorin bankar.
Eksperienca e mëparshme e punës së znj. S. D., nisur nga fakti që nuk ka certifikatën e audituesit të brendshëm, është jo e mjaftueshme për tu punësuar pranë NjAB të Bashkisë Krujë, referuar këtu edhe faktit se ajo nuk ka diplomë universitare të nivelit të dytënë shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera. Ajo ka vetëm diplomë të nivelit të parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi.

Tabela nr. 2: Përbërja e sektorit NJAB, viti 2020

Nr.	Nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	E. F. (emëruar me urdhër nr. 489, datë 31.10.2016)	Përgjegjës	Fakulteti Ekonomise, ñMaster shkencorò	Mbi 20 vite	Mbi 5 vite	Nr.1927, dt.6.7.2018	Trajnuar çdo vit
2	E. K. (emëruar me urdhër nr. 479, datë 25.10.2016)	Specialist	Fakulteti Juridik, ñMaster shekncorò	7 vite	Mbi 5 vite	Nr.1923, dt.6.7.2018	Trajnuar çdo vit
3	H. Z. (emëruar me urdhër nr. 478, datë 25.10.2016)	Specialist	Fakulteti Ekonomise, ñMaster shekncorò	Mbi 25 vite	13 vite	Nr.1927, dt.6.7.2018	Trajnuar çdo vit

Burimi: Bashkia Krujë

Tabela nr. 3: Përbërja e sektorit NJAB, viti 2021

Nr.	Nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	E. F. (emëruar me urdhër nr. 489, datë 31.10.2016)	Përgjegjës	Fakulteti Ekonomise, ñMaster shkencorò	Mbi 20 vite	Mbi 5 vite	Nr.1927, dt.6.7.2018	Trajnuar çdo vit
2	E. K. (emëruar me urdhër nr. 479, datë 25.10.2016)	Specialist	Fakulteti Juridik, ñMaster shekncorò	7 vite	Mbi 5 vite	Nr.1923, dt.6.7.2018	Trajnuar çdo vit

3	H. Z. *(Deri date 31.05.2021)*	Specialist	Fakulteti Ekonomise, ñMaster shekncorò	Mbi 25 vite	13 vite	Nr.0095, dt.11.2007	Trajnuar çdo vit
4	S. D. (emëruar me urdhër nr. 733, datë 16.12.2021)	Specialist	Fakulteti Ekonomik, ñBACHELORò	Mbi 1 vit	-	Jo	Jo

Burimi: Bashkia Krujë

Bazuar në Manualin e Auditit të Brendshëm, planifikimi i nevojave të stafit për trajnim duhet të jetë i përvitshëm dhe është identifikuar se për vitet 2020 dhe 2021, të tre punonjësit e NjAB i kanë ndjekur orët e nevojshme të trajnimet, përveç znj. S. D. që është punësuar në muajin dhjetor 2021.

Karta e Auditimit është përgatitur nga Drejtuesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Krujë, me shkresën nr. 3359 Prot., datë 08.05.2019.

Ky veprim është në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2.6.1, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave. Në Bashkinë Krujë nuk rezulton një shkresë përcjellëse, ku të pasqyrohet dërgesa e Kartës së Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Veprim i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 14, pika b.

Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2020 është përgatitur dhe dërguar brenda afatit të përcaktuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2020 ï 2022, me shkresën nr. 6806 Prot., datë 18.10.2019. Plani strategjik përgjithësisht është përpiluar bazuar në standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3., por nuk ka të specifikuar në përmbajtje të tij qëllimin e planit strategjik, organizimin e NjAB, objektivat strategjikë, kufizimet e auditimit dhe prioritet për tre vite.

Bazuar në pasqyrën nr. 2, për vitin 2020 janë planifikuar 7 (shtatë) angazhime auditimi, ku 7 (shtatë) janë përputhshmërie, shoqëruar me shkresën nr. 178 Prot., datë 16.01.2020.

Shkresa nr. 6912 Prot., datë 16.10.2020, për ndryshime në planin vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2020, ku te kjo e fundit është përcaktuar se do të kryhen gjithsej 4 (katër) angazhime auditimi, nga të cilat 4 (katër) përputhshmërie.

Plani vjetor për vitin 2020 ekziston vetëm në formë tabelare, referuar shkresave të përmendura më sipër, por ama nuk ka një analizë të shkurtër bashkëngjitur në lidhje me realizimin e angazhimeve të programuara në planin e vitit aktual deri në periudhën raportuese, nuk janë përfshirë prioritetet për vitin e ardhshëm të NjAB në lidhje me përmirësimin e punës audituese, nuk specifikohen objektivat e NjAB në funksion të arritjes së objektivave të njësisë publike, nuk ka të specifikuar mënyrën se si planifikohet sigurimi i brendshëm i cilësisë nga drejtuesi i NjAB.

Plani Strategjik dhe vjetor për 2021 është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2021 ï 2023, me shkresën nr. 6913 Prot., datë 16.10.2020. Plani strategjik përgjithësisht është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3., por nuk ka të specifikuar në përmbajtje të tij qëllimin e planit strategjik, organizimin e NjAB, objektivat strategjikë, kufizimet e auditimit dhe prioritet për tre vite.

Bazuar në pasqyrën nr. 2, për vitin 2021 janë planifikuar 7 (shtatë) angazhime auditimi, ku 7 (shtatë) janë përputhshmërie, shoqëruar me shkresën nr. 218 Prot., datë 12.01.2021.

Shkresa nr. 7089/2 Prot., datë 12.10.2021, për ndryshime në planin vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2021, ku te kjo e fundit është përcaktuar se do të kryhen gjithsej 3 (tre) angazhime auditimi, nga të cilat 3 (tre) përputhshmërie.

Plani vjetor për vitin 2021 gjithashtu ekziston vetëm në formë tabelare, referuar shkresave të përmendura më sipër dhe ashtu si një vit më parë, as për këtë vit nuk ka një analizë të shkurtër bashkëngjitur në lidhje me realizimin e angazhimeve të programuara në planin e vitit aktual deri në periudhën raportuese, nuk janë përfshirë prioritetet për vitin e ardhshëm të NjAB në lidhje me përmirësimin e punës audituese, nuk specifikohen objektivat e NjAB në funksion të arritjes së objektivave të njësisë publike, nuk ka të specifikuar mënyrën se si planifikohet sigurimi i brendshëm i cilësisë nga drejtuesi i NjAB.

Programet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Nj.A.B Krujë për vitet 2020 dhe 2021,nuk janë hartuar dhe si rrjedhim nuk figurojnë si dokument në Bashkinë Krujë.

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Nëpërmjet tij, vlerësohet efikasiteti, efektiviteti i veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikohen mundësitë për përmirësim. Veprim i cili është në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 7.1.1.

NjAB e Bashkisë Krujë ka përgatitur **Regjistrin e Riskut për vitin 2020**, shkresa nr. 130/2, datë 14.02.2020, hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë, bazuar në legjislacionin përkatës dhe në funksion të objektivave institucional. Ky regjistër përfshin disa nga pikat kryesore që paraqesin risk si ndryshimet e shpeshta të bazës ligjore dhe rregullatore të njësive që auditohen, gjetjet dhe rekomandimet e përgjithshme të paadresuara për personat që duhet të marrin masa për përmirësime të mëvonshme, profesionalizmi i audituesve, kërkesa për ndryshime në planin strategjik të miratuar, auditi i brendshëm shikohet si një kontroll që është i përqendruar në zbulimin e shkeljeve dhe jo si partner që është atje për tëi ndihmuar njësitë që auditohen të përmirësojnë punën e tyre, njësitë që janë objekt auditimi mund të mos kuptojnë qasjen dhe rolin e ri që kërkon të marrë auditi i brendshëm. Për të gjitha këto risqe të parashikuara janë përshkruar edhe kontrollet ekzistuese, vlerësimi i secilës prej pikave të riskut, nevoja për kontrolle të mëtejshme dhe zotëruesit e riskut.

Regjistri i Riskut 2021, shkresa nr. 218/1, datë 12.01.2021, hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë, bazuar në legjislacionin përkatës dhe në funksion të objektivave institucional. Ky regjistër përfshin disa nga pikat kryesore që paraqesin risk si ndryshimet e shpeshta të bazës ligjore dhe rregullatore të njësive që auditohen, gjetjet dhe rekomandimet e përgjithshme të pa adresuara për personat që duhet të marrin masa për përmirësime të mëvonshme, profesionalizmi i audituesve, kërkesa për ndryshime në planin strategjik të miratuar, auditi i brendshëm shikohet si një kontroll që është i përqendruar në zbulimin e shkeljeve dhe jo si partner që është atje për tëi ndihmuar njësitë që auditohen të përmirësojnë punën e tyre, njësitë që janë objekt auditimi mund të mos kuptojnë qasjen dhe rolin e ri që kërkon të marrë auditi i brendshëm. Për të gjitha këto risqe të parashikuara janë përshkruar edhe kontrollet ekzistuese, vlerësimi i secilës prej pikave të riskut, nevoja për kontrolle të mëtejshme dhe zotëruesit e riskut.

Hartimi i planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara

Sipas Planit Strategjik të periudhës 2020ï 2022, 2021 ï 2023, i nënshtrohen auditimit të plotë:

Për vitin 2020 i janë nënshtruar procesit të auditimit, Ujësjellës Kanalizime Sh.A Krujë; Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike të Bashkisë Krujë (Sektori i Rrugëve Rurale, Sektori i Bordit të Kullimit); Drejtoritë dhe Sektorët e Bashkisë (Zbatimi i rekomandimeve të KLSH); Drejtoria e Financës (Analizimi i situatës lidhur me detyrimet e prapambetura);

Për vitin 2021 i janë nënshtruar procesit të auditimit, Administrata e Bashkisë (Zbatimi i rekomandimeve të KLSH) dhe Drejtoria Juridike e Prokurimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura për vitet 2020 dhe 2021, u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, bazuar edhe te ñManuali i Auditimit të Brendshëmò (MAB).
Nga auditimi i projekt - raportit dhe raportit përfundimtar, rezulton se në procesin e auditimit në përgjithësi, nga audituesit e brendshëm, janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe në formë.
Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, ò*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*ò, në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Gjithashtu referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.
Në dosjet e auditimit të vitit 2020, dokumentacioni në dosje ka qenë specifikisht si vijon:

- Në rastin e auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve të KLSH-së, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, programi i angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve, deklarata e konfliktit të interesit, ndarja e detyrave gjatë angazhimit të auditimit, projekt ï raporti, memo dhe raporti përfundimtar.
- Në rastin e auditimit të Drejtoria e Shërbimeve (Sektori i Rrugëve Rurale; Sektori i Bordit të Kullimit), dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, programi i angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, proces ï verbal takimi fillestar, deklarata e konfliktit të interesit, ndarja e detyrave gjatë angazhimit të auditimit, plani i veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve, proces - verbal për verifikimin në terren të punimeve të kryera në objektet, memo, projekt ï raporti, shkresë përcjellëse e raportit përfundimtar Drejtorisë së Shërbimeve (Sektori i Rrugëve Rurale; Sektori i Bordit të Kullimit), raporti përfundimtar.
- Në rastin e auditimit të Drejtorisë së Financës ï Detyrimet financiare të prapambetura të krijuara ndër vite, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim,programi i angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, proces ï verbal takimi fillestar, ndarja e detyrave gjatë angazhimit të auditimit, deklarata e konfliktit të interesit, plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve, shkresë përcjellëse Drejtorisë së Financës e raportit përfundimtar, memo dhe raporti përfundimtar. **Në dosje nuk ka projekt – raport.**
- Në rastin e auditimit të Ujësjellës Kanalizime Sh.A Krujë, në dosje gjenden autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, ndarja e detyrave gjatë angazhimit të auditimit, proces ï verbal takimi fillestar, analiza e riskut, deklarata e konfliktit të interesit, shkresë përcjellëse e projekt ï raportit, projekt ï raporti, memo, shkresë përcjellëse e raportit përfundimtar dhe raporti përfundimtar. **Në dosje mungon plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve.**

Në dosjet e auditimit të vitit 2021, dokumentacioni në dosje ka qenë specifikisht si vijon.

- Në rastin e auditimit të Zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, në dosje gjenden njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, proces ï verbal takimi fillestar, deklarata e konfliktit të interesit, informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, projekt ï raporti, memo dhe raporti përfundimtar. **Në dosje mungon plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve.**
- Në rastin e auditimit të Sektorit të Prokurimeve të Bashkisë - Blerje automjet zjarrfikëse për Bashkinë Krujë, në dosje gjenden njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit,

programi i angazhimit të auditimit, autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, proces ï verbal takimi fillestar, deklarata e konfliktit të interesit, projekt ï raporti, shkresë përcjellëse e projekt ï raportit Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve, shkresë përcjellëse e raportit përfundimtar (Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve, Drejtorisë së Financës dhe sektorit MZSH), memo dhe raporti përfundimtar. **Në dosje mungon plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve.**

Për auditimet e realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Krujë, në tre prej dosjeve, të përmendura më lart, nuk rezulton të jetë përgatitur dhe miratuar një **plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna**, për secilin nga auditimet e ushtruara nga NjAB, gjatë viteve 2020 dhe 2021. Veprim i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 12, pika d.

Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm, hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për periudhën 2020 ï 2021,është raportuar në mënyrë sistematike Kryetari i Bashkisë Krujë.

Për çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar, nga Përgjegjësi i NjAB, në bazë të Planit Vjetor. Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhrin e ministrit të financave nr. 100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

Tabela nr. 4: Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2020

Viti 2020						
Plan	Fakt	Rekom	Zbat.	Pa zbat.	Në proc.	Përputhsh.
4	4	19	6	-	13	4

Burimi: Bashkia Krujë

Tabela nr. 5: Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2021

Viti 2021						
Plan	Fakt	Rekom	Zbat.	Pa zbat.	Në proc.	Përputhsh.
3	2	4	0	-	4	2

Burimi: Bashkia Krujë

Raporti i Veprimtarisë të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2020 është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020, me shkresën nr. 930 Prot., datë 10.02.2021, në përputhje me Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 i ndryshuar.

Ky raport i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2020 përmban të dhëna për Burimet Njerëzore për vitin 2020 (pasqyra nr. 1); Realizimi i planit të angazhimeve 2020 (pasqyra nr. 2); Përmbledhje e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit 2020 (pasqyra nr. 3); Përmbledhje e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve për vitin 2020 (pasqyra nr. 4); Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2020 (pasqyra n. 5); Çështje të dërguara për investigim për vitin 2020 (pasqyra nr. 6); Pyetësori i vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm; Raport shpjegues.

Bazuar në pasqyrën nr. 2, për vitin 2020 janë realizuar 4 (katër) angazhime auditimi, nga të cilat 4 (katër) përputhshmërie, referuar shkresës nr. 6912 Prot., datë 16.10.2020, për ndryshime në planin vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2020.
Referuar pasqyrës nr. 3, nuk ka gjetje me dëm ekonomik.
Referuar pasqyrës nr. 4, gjetjet sipas fushës ose sistemeve janë, 3 (tre) te Sistemi i prokurimeve, blerjeve dhe investimeve; 2 (dy) te Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione; 5 (pesë) te Sistemet e Administrimit të Pronës dhe Pasurisë; dhe 9 (nëntë) te kategoria Të tjera. Gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) gjetje të parregullsive, të konstatuara gjatë auditimit të brendshëm të vitit 2020.
Referuar pasqyrës nr. 5, rekomandime 19 (nëntëmbëdhjetë) gjithsej, 6 (gjashtë) të zbatuara, 13 (trembëdhjetë) në proces zbatimi.
Referuar pasqyrës nr. 6, çështje të dërguara për investigim për vitin 2020 nuk ka.
Raporti i Veprimtarisë të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021**,** me shkresën nr.721 Prot., datë 09.02.2022, në përputhje me Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 i ndryshuar.
Ky raport i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 përmban, të dhëna për Burimet Njerëzore të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 (pasqyra nr.1); Realizimi i planit të angazhimeve 2021 (pasqyra nr.2); Përmbledhje e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit 2021 (pasqyra nr.3); Përmbledhje e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve për vitin 2021 (pasqyra nr.4); Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2021 (pasqyra n. 5); Çështje të dërguara për investigim për vitin 2021 (pasqyra nr. 6); Pyetësori i vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm; Raport shpjegues.
Bazuar në pasqyrën nr.2, për vitin 2021 janë realizuar 2 (dy) angazhime auditimi, nga të cilat 2 (dy) përputhshmërie, ndërkohë që ishin planifikuar të kryheshin 3 (tre) angazhime auditimi, ku 3 (tre) ishin përputhshmërie, referuar shkresës nr. 7089/2 Prot., datë 12.10.2021, për ndryshime në planin vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2021.
Referuar pasqyrës nr. 3, nuk ka gjetje me dëm ekonomik.
Referuar pasqyrës nr. 4, gjetjet sipas fushës ose sistemeve janë, 1 (një) gjithsej, e cila i përket kategorisë Të tjera. Gjithsej 1 (një) gjetje të parregullsive, e konstatuar gjatë auditimit të brendshëm të vitit 2021.
Referuar pasqyrës nr. 5, rekomandime 4 (katër) gjithsej, 0 (zero) të zbatuara dhe 4 (katër) në proces zbatimi.
Referuar pasqyrës nr. 6, çështje të dërguara për investigim për vitin 2021 nuk ka.
Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Krujë, rezulton se:

a) Z. E. F., me arsim të lartë, dega financë, Fakulteti i Ekonomisë, MSC, me status Auditues i Brendshëm 06.07.2018, nr.regjistri 1927, është emëruar në detyrën e përgjegjësit të auditit të brendshëm në NJAB, në periudhën 31.10.2016 në Bashkinë Krujë me Urdhër nr. 489, nr. 4570 Prot., datë 31.10.2016, duke qenë i pajisur me certifikatën e audituesit.
b) Znj. E. K., me arsim të lartë juridik, Fakulteti i Drejtësisë, MSC, me status Auditues i Brendshëm 06.07.2018, nr.regjistri 1923, është emëruar në detyrën e specialist auditi të NJAB 25.10.2016 në Bashkinë Krujë, me Urdhër nr. 479, datë 25.10.2016, nr. 4492 Prot., duke qenë e pajisur me certifikatën e audituesit.
c) Z. H. Z., me arsim të lartë ekonomik, Fakulteti i Ekonomisë, MSC, me status Auditues i Brendshëm 30.11.2007, nr.regjistri 0095 është emëruar në detyrën e specialist auditi të NJAB 25.10.2016, në Bashkinë Krujë me Urdhër nr. 478, datë 25.10.2016, nr. 4491 Prot., duke qenë i pajisur me certifikatën e audituesit.

d) Znj. S. D., me arsim të lartë, Bachelor në Menaxhim Biznesi, është emëruar në detyrën e specialist auditi të NJAB 16.12.2021, në Bashkinë Krujë me Urdhër nr. 733, datë 16.12.2021, nr. 8543 Prot., e pa pajisur me certifikatën e audituesit.

Referuar përbërjes së grupit të NjAB për vitin 2021, pas largimit nga pozicioni i Specialistit të NjAB, të z. H. Z., referuar Urdhër nr. 345, nr. 3639 Prot., datë 01.06.2021 dhe pas emërimit të znj. S. D., në pozicionin Specialist, Urdhër nr. 733, datë 16.12.2021, nr. 8543 Prot., grupi i NjAB funksionon me 3 (tre) anëtarë, ku 1 (një) në pozicionin Përgjegjës, konkretisht z. E. F. dhe 2 (dy) janë në pozicionin Specialist, konkretisht znj. E. K. dhe znj. S. D.

Titulli i Gjetjes 4:*Mungesa e eksperiencës së nevojshme të punës për tu punësuar në Njësinë e Auditit të Brendshëm për aq kohë sa punonjësi nuk e zotëron certifikatën e audituesit të brendshëm dhe nuk ka diplomë të nivelit të dytë.*

Situata: Referuar Urdhër nr. 733, nr. 8543 Prot., datë 16.12.2021, është emëruar përkohësisht e pa pajisur me certifikatë të audituesit të brendshëm. Eksperienca e mëparshme e punës së znj. S. D. është 1 vit e 3 muaj, bazuar në librezën e punës së saj, konkretisht nga data 17.09.2020 ï 14.12.2021, në sektorin bankar. Eksperienca e mëparshme e punës së znj. S. D., nisur nga fakti që nuk ka certifikatën e audituesit të brendshëm, është jo e mjaftueshme për tu punësuar pranë NjAB të Bashkisë Krujë, referuar këtu edhe faktit se ajo nuk ka diplomë universitare të nivelit të dytënë shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera. Ajo ka vetëm diplomë të nivelit të parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, Neni 11, pika 2 a) dhe 2 ç). Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò.

Ndikimi: Mungesa e profesionalizmit dhe eksperiencës së punës për një audites të brendshëm krijon vështirësi në kryerjen e detyrave specifike që duhet të kryejë specialisti që është pjesë e Njësisë së Auditit të Brendshëm të Njësisë Publike. Kjo pasi një audites i brendshëm profesionist jo vetëm që duhet të dijë mirë përkufizimin, por edhe duhet të jetë në gjendje t'ia shpjegojë atë palëve të tjera të interesuara, edhe atyre që nuk janë audites të brendshëm. Ata duhet të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuara, të auditimit të brendshëm, të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm.

Shkaku: Nuk është zbatuar kuadri ligjor ku theksohet se për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme si, të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet; dhe punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si "Audites i brendshëm", por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa që në pozicionin e specialistit të NjAB, të punësohet një person që përmbush kriteret për të qenë pjesë e kësaj strukture dhe mundëson funksionimin e auditit të brendshëm në mënyrë efektive.

Titulli i Gjetjes 5:*Mos dërgimi i Kartës së Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.*

Situata: Pavarësisht se Karta e Auditimit është përgatitur nga Drejtuesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe miratuar te titullari i Bashkisë Krujë, me shkresën nr. 3359 Prot., datë 08.05.2019, ajo nuk është dërguar për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, siç parashikohet në kuadrin ligjor përkatës.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, Neni 14, pika b) dhe Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò.

Ndikimi: Duke qenë se Karta e Auditimit është një akt administrativ që përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm, duhet të dërgohet me shkresë përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në mënyrë që aktiviteti dhe statusi organizativ i njësisë së auditimit të brendshëm të bëhet i njohur dhe të jetë i identifikueshëm nga MFE.

Shkaku: Neglizhenca për të mos dërguar Kartën e Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe mos zbatimi i kuadrit ligjor.

Rëndësia:E mesme

Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa qëKarta e Auditimit si një akt administrativ që përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm, duhet të dërgohet me shkresë përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në mënyrë që aktiviteti dhe statusi organizativ i njësisë së auditimit të brendshëm të bëhet i njohur dhe të jetë i identifikueshëm nga MFE.

Titulli i Gjetjes 6:*Mos hartimi i Programit të Sigurimit të Cilësisë të NjAB për vitet objekt auditimi.*

Situata: Në Bashkinë Krujë nuk është hartuar dhe miratuar një program për sigurimin e cilësisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, për vitet 2020 dhe 2021.

Kriteri: Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik pika 7.1.1.

Ndikimi: Programi i siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë duhet të përfshijë si vlerësime të brendshme ashtu dhe të jashtme. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm. Duke qenë se ai shërben përpërmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm duke filluar me vlerësimet e brendshme të cilësisë dhe me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës, është e rëndësishme përgatitja e tij në mënyrë periodike. Kjo pasi në këtë mënyrë bëhet i mundur reduktimi i mangësive dhe përmirësimi i veprimtarisë së NjAB.

Shkaku: Neglizhenca për të mos hartuar Programin e Sigurimit të Cilësisë së NjAB duke u bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi: Bashkia Krujë duhet të hartojë në mënyrë periodike Programin e Sigurimit të Cilësisë të NjAB, për aq kohë sa ai shërben si një mjet apo tregues përpërmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm të njësisë publike.

Titulli i Gjetjes 7:*Mungesa e një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna, për secilin nga auditimet e ushtruara nga NjAB, gjatë viteve 2020 dhe 2021.*

Situata: Në Bashkinë Krujë nuk është realizuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, për secilin nga auditimet e ushtruara nga NjAB për periudhën objekt auditimi.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 12, pika d) dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Ndikimi: Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit, plotësohet nga njësia publike e audituar sipas formatit të rekomanduar dhe pasi miratohet nga titullari i njësisë së audituar, i dërgohet zyrtarisht NjAB që ka kryer angazhimin e auditimit. Mungesa e tij në dosjen përkatëse të auditimit, krijon vështirësi për

procesin e monitorimit dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga NjAB, për auditimin e radhës të kësaj njësie.

Shkaku: Mos zbatimi i bazës ligjore ku specifikohet procesi i hartimit, miratimit dhe ndjekjes së planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga NjAB për njësinë publike të audituar.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi: Pas përfundimit të angazhimit të auditimit, NjAB të marrë masat që dosja që përmban gjithë dokumentacionin e auditimit duhet të pajiset edhe me një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Kjo ndihmon në monitorimin dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve në auditimin e radhës nga NjAB, për të parë se si dhe deri në çfarë mase janë zbatuar ato.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. E. F., Përgjegjës i NjAB në Bashkinë Krujë.

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për periudhën 2020 – 2021.

Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxheteve vjetore

Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2020-2022 dhe 2021-2023

Nga auditimi i procedurave rezultoi se:

Në **vitin 2020** për përgatitjen PBA-së 2020-2022 ka dalë Urdhri i Titullarit nr. 650, datë 04.10.2019 për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe ñPër ngritjen e ekipeve te menaxhimit te programit (EMP) për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023ò

Në **vitin 2021** për përgatitjen PBA dhe 2021-2023 rezultoi se për realizimin e fazave të përgatitjes kanë dalë Urdhrat e Titullarit nr. 209, date 21.04.2020 për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe nr. 225, date 29.04.2020 ñPër ngritjen e ekipeve te menaxhimit te programit (EMP) për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023ò.

Buxhetet e dy viteve janë miratuar ne Këshillin Bashkiak , konkretisht :

a- PBA 2020 -2022 bashkë me buxhetin vjetor koherent 2020 miratuar me VKB nr 105 datë 28.12.2020

b- PBA 2021-2023 bashkë me buxhetin vjetor koherent 2021, miratuar me VKB nr. 101, datë 26.10.2021

Kërkesat buxhetore për PBA-ve janë dërguar në MFE me shkresat përkatëse.

PBA 2022-2024 me shkresën nr. 6250 Prot, datë 15.09.2021

PBA 2021-2023 me shkresën nr. 5691 Prot, datë 15.09.2020

Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, duke respektuar tavanet buxhetore të miratuara nga Këshilli Bashkiak në fazën e parë të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat.

Hartimi i PBA-së dhe Buxhetit Vjetor i përgatitur është miratuar në këshillin bashkiak në tre faza, faza e parë në muajin Qershor, faza e dytë në muajin shtator dhe faza e tretë në muajin dhjetor.

Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA-ve 2020-2022 dhe 2021-2022 rezultoi se, ishin respektuar kërkesat e Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022òdhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.20, datë 10.07.2019 ñPër përgatitjen e buxhetit vendorò.

Në këtë program risi është futja e Instrumentit të planifikimit financiar i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e

financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).
Në dokumentin e PBA janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si dhe nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit në tre vite dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin kjo PBA 2020-2021-2022.
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të ñBuxhetimit me pjesëmarrjeò, pasi mungojnë dokumentet e evidentimit të kryerjes së këtyre konsultimeve. Buxhetet nuk janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative, Drejtoritë e Shkollave, Sektorët e Bashkisë, Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Ujësjellës Kanalizime sha, etj, gjë që vërteton se prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, ku mbi bazën e tyre të hartohej buxheti.

Hartimi dhe programimi i buxheteve vjetore 2020 dhe 2021

Buxhetet vjetore të 2 viteve janë miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe janë konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarku Durrës, konkretisht:
Për vitin 2020, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 101, datë 26/12/2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 1277/2 date 31.12.2019
Për vitin 2021, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 105, datë 28/12/2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 1121/2 date 06.01.2021, konkretisht pasqyra:

Tabela nr. 6: Të ardhura dhe shpenzimet për vitin 2020-2021 *Në 000/lekë*

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2020		Plani i vitit 2021	
		Të Ardhurat	Shpenzime	Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	118,521.27		161,700.95	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	54,350.51		98,331.01	
3	Trashëguar nga Transferta specifike	15,500.26		27,599.59	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	332,800.00		330,000.00	
5	Granti	283,848.00		299,524.65	
6	Transferta specifike	139,887.00		156,689.04	
7	Rindertimi			516,852.16	
8	Paga (600)		340,600.60		360,518.04
9	Sigurime shoqërore (601)		73,691.81		64,120.56
10	Shpenzime operative (602)		257,222.01		282,908.40
11	Shpenzime operative (602) rindertimi				132,990.61
12	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		43,847.78		51,709.53
13	Transferta (604 - 609) Rindertimi				159,100.00
14	Inv (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez		229,544.84		314,588.71
15	Inv (230 +231) nga rindertimi				224,761.55
16	Investime nga FZHSH e M. Linjës				
17	Te tjera (166, 651, 603, 604, 606)				

		944,907	**944,907**	**1,590,697**	**1,590,697**

Burimi: Bashkia Krujë

Sipas tabelës së mësipërme buxhetet e viteve 2020 dhe 2021 janë miratuar të balancuara dhe pa defiçite. Kështu **për vitin 2020** të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 944,907 lekë**, për vitin 2021** të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 1,590,697 lekë.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

Tabela nr. 7: PBA 2020-2022 me planin buxhetor 2020 *Në 000/lekë*

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2020	Sipas PBA 2020-2022	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	404,570.00	404,570.00	0
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	217,314.00	217,314.00	0
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	134,651.00	141,851.00	-7,200
4	Investime nga FZHSH	0	0	0
	Total I planit fillestar	**756,535.00**	**763,735.00**	**- 7,200**
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar	0	0	0
6	Shpenzime për pagat (600+601)	0	0	0
7	Shpenzime (602.604.609)	0	0	0
	Grant i kushtëzuar (230-231)			*0*
	Gjithsej	**756,535.00**	**763,735.00**	**- 7,200**

Burimi: Bashkia Krujë

Në planin faktik të buxhetit 2020 në krahasim me PBA 2020-2022, ka diferencë në shumën -7,200 mijë lekë, të cilat janë fonde të planifikuara ne PBA por është pakësuar plani i të ardhurave në Buxhetin 2020 konkretisht duke pakësuar investimet per këtë vlerë.
Në zërin e planifikimit të planit vjetor: ñInvestime Bashkia ñështë më i vogël se viti i parë i PBA (2020-2022) për këtë vlerë .

Tabela nr. 8: Zëri investime *Në 000/lekë*

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2021	Sipas PBA 2021-2023	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	399,872.00	399,872.00	-
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	269,308.00	224,523.00	44,785.00
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	109,667.00	114,667.00	-5,000.00
4	Investime nga FZHSH	0	0	-
	Total I planit fillestar	**778,847.00**	**739,062.00**	39,785.00
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar	0	0	0
6	Shpenzime për pagat (600+601)	0	0	0
7	Shpenzime (llog.602,llog.604,llog.609)	0	0	0
	Grant i kushtëzuar (230-231)			*0*
	Gjithsej	**778,847.00**	**739,062.00**	**39,785.00**

Burimi: Bashkia Krujë

Në planin faktik të buxhetit 2021 në krahasim me PBA 2021-2023, ka diferencë në shumën -39,785 mijë lekë, të cilat janë fonde që nuk janë të planifikuara ne PBA pasi kanë ardhur shtesë si fonde sektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve urbane 38,000 lekë dhe trasnfertë për mbrojtjen civile 6,785 lekë . Ndërsa në planin e fondeve për investime kemi një diferencë -5,000 lekë në planin fillestar 2021 në raport me PBA 2021-2023 si pasojë e pakësimit të transfertës krahasuar me planifikimin në PBA 2021-2023.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.
- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Krujë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.
Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Krujë dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxhetet vjetore gjatë viteve kanë pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Krujë.
Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.
Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Tabela nr. 9: Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2021 *në lekë*

	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate vitit		Pakësuar/shtuar artikulli (me emër)			
Periudha buxhetore	Nr./datë	Përshkrimi	Nr./datë	Vlera	Shtesa art.	shuma	Paksime art.	Shuma
Viti 2021	Nr. 105, dt 28.12.2020	Ndryshim Buxheti	Nr.42, dt 28.06.2021	22,901,133	231 investime	22,901,133	231, investime	22,901,133
Miratimi I shtesës se Buxhetit 2021	Nr.06 dt 05.02.2021	Shtese fondi për pagat e arsimit parashkollor	Nr 18 dt 26.02.2021	7,366,467	600,601 shpenzime	7,366,467		
		Shtese fondi për shlyerje detyrime prapambetura	Nr 116 dt 28.12.2021	2,569,926				
					231 investime	2,569,926		

Burimi: Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga Bashkia Krujë

Referuar tabelës së ndryshimeve për shtesa dhe pakësime gjatë vitit buxhetor rezulton se ka patur lëvizje të pakta, gjë që tregon se planifikimi i buxheteve 2020-2021 është i qëndrueshëm dhe efektiv, por duhet theksuar se vëmendja kryesore ka qenë puna dhe menaxhimi i fondeve për rindërtimin nga dëmtimet e tërmetit në këtë zonë, ku dhe financimet për kryerjen e investimeve dhe rindërtimet kanë ardhur nga pushteti qendror e destinacion të përcaktuar.

Mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Krujë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Krujë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuara nga Transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Tabela nr. 10: Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	2020			2021		
		Plan	Fakt	Real.%	Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	348,217	311,032	89.3	371,212	320,694	86.4
2	Sigurime shoqërore 601	74,898	53,882	71.9	65,328	52,986	81.1
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	461,480	179,558	38.9	422,319	264,441	62.6
4	Subvencion Ujësjellësi, etj. 603	-	-	0	-	-	0
4	K. Q Emergj Civile 604	816,335	707,315	86.7	211,734	120,469	56.9
	a.Fonde Rindërti transferta te familjet për riparimet e termet DS1,2,3	779,772	688,850		159,100	100,500	
	b.Fonde për mbrojtjen civile dhe transfrta për Klubin sportiv	36,553	18,465		52,634	19,969	
5	Transferta te individët 606	774,737	754,480	97.3	703,236	701,561	99.8
	a.Bonus i qerasë për familjet e dëmtuara nga tërmeti	372,030	352,425		303,050	302,535	
	b.Nd/Ekonom invalid e lindje	400,947	400,295		399,356	398,195	
6	Mjete ne ruajtje 466	-	-	0	-	-	0
7	Investime 230-231	480,212	365,656	76.1	615,103	384,522	62.5
	a.Investime per rindërtimin						
	b.Investime të tjera						
	Totali	**2,955,879**	**2,371,923**	**80.2**	**2,388,932**	**1,844,674**	**77.2**

Burimi: Bashkia Krujë

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2020** janë realizuar 2,371,923 mijë lekë nga 2,955,879 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 80.24%,
- Për **vitin 2021** janë realizuar 1,844,674 mijë lekë nga 2,388,932 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 77.22%

Në këtë masë realizimi ka ndikuar realizimi në zërat e buxhetit:

a. Shpenzimet për paga dhe sigurime art. 600 në vitin 2020 janë realizuar 364,914 mijë lekë nga 423,115 mijë lekë të planifikuara ose në masën 87% dhe për vitin 2021 janë realizuar 373,681 mijë lekë nga 436,540 mijë lekë ose në masën 84%. Realizimi në këtë nivel për këto zëra shpenzimesh ka ardhur nga mosplotësimi i i plotë i organikës.
b. Shpenzimet operative art.602në vitin 2020 janë realizuar 179,558 mijë lekë nga 461,480 mijë lekë të planifikuara ose në masën 34% dhe për vitin 2021 janë realizuar 264,441 mijë lekë nga 422,319 mijë lekë ose në masën 63%
c. Shpenzimet për investime llog.231 në vitin 2020 janë realizuar 365,656 mije leke nga 480,212 mijë lekë të planifikuara ose në masën 76% dhe për vitin 2021 janë realizuar 384,522 mije lekë nga 615,103 mijë lekë të planifikuara ose në masën prej 63%. Këto mosrealizime kanë ardhur si rezultat i vonesave në prokurime dhe në lidhje kontratash, apo realizime të vogla të të ardhurave të planifikuar, gjë që ka sjellë lënien e likuidimeve në fund të vitit.
d. Shpenzimet për përballimin e pasojat tërmetit (fondet e Rindërtimit) art.604 në vitin 2020 janë realizuar 365,656 mije leke nga 480,212 mijë lekë të planifikuara ose në masën 76% dhe për vitin 2021 janë realizuar 384,522 mije lekë nga 615,103 mijë lekë të planifikuara ose në masën prej 63%.

Konkluzion: Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumetuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale.
Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet për paga, ndjekur nga shpenzimet për investime dhe shpenzimet operative, tregues të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 11: Pesha specifike në buxhet sipas zërave 2020-2021

Nr	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021
1.	Shpenzimet operative	8%	14%
2.	Investime	15%	21%
3.	Shpenzime për paga	15%	20.%
	Fonde rindërtimi për rikonstruksion banesash të dëmtuara nga tërmeti	29	5
	Shpenzime bonus i qirave	15	16

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Miratimi i realizimit faktik të buxheteve
Në fund të periudhave ushtrimore nga Bashkia Krujë janë miratuar buxhetet vjetor, ku për *vitin 2020* është miratuar me Vendim të KB nr. 101, datë 26.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 1277/2 datë 31.12.2019
Për vitin 2021, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 105, datë 28.12.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 1121/2 datë 06.01.2021,

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës
Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku:
P*ër vitin 2020*, është miratuar në vlerën 20,000,000 lekë, fond i cili është pakësuar me VKB nr. 31 datë 03.04.2020 në vlerën prej 3,108,400 lekë për: Përballimin e gjendjes se fatkeqësisë natyrore si pasojë e pandemisë Covid 2019.
Për *vitin 2021* është planifikuar në masën 6,000,000 lekë, përveç fondit rezervë janë planifikuar fonde për mbrojtjen civile në shumën 17,897,032 lekë. Po ashtu nga pushteti qendror janë akorduar fonde në formën e transfertës specifike për mbrojtjen civile në shumën prej 6,785,439 lekë. nga e cila janë përdorur fondet në vlerën 137,445 lekë për dëme të shkaktuara nga djegia e banesave, në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2020 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare".*

Fondet e shpenzuara nga Bashkia Krujë për shkak te situatës COVID 19 miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit ligjor.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Krujë dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, për shkak të situatës COVID-19.

Për vitin 2020 bazuar në VKM nr. 236 datë 19.03.2020ò Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës ne banese ndaj shtetasve ne nevoje, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID- 19ò, shkresës nr. Prot. 1650, datë 24.03.2020 të Ministrisë së Mbrojtjes me lëndë: ñKërkese për marrjen e masave urgjente të përdorimit të fondit të emergjencave civileò, të VKM nr.243, datë 24.03.2020 ñPër shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyroreñ, shkresës nr. Prot.6501, datë 01.04.2020 nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë ñPër situatën e krijuar nga pandemia COVID-19ò në buxhet kanë ndodhur ndryshime si më poshtë:
- Me VKB nr.31,datë 03.04.2020 ñPërdorim i fondit të emergjencaveò, ku është pakësuar fondi i emergjencave art 604 dhe është shtuar art 602 ñShpenzime operativeò në vlerën 3,108,400 lekë e cila është programuar dhe përdorur:

a. Vlera prej 2,477,440 lekë për blerje pako ushqimore për familjet në nevojë si pasoje e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga Covid-19,e cila është shpenzuar në masën 100%.
b. Vlera prej 167,500 lekë për blerje veshje dhe pajisje anti Covid-19, e cila është përdorur në masën 100%
c. Vlera prej 463,500 lekë për blerje e produkteve dezinfektimi anti Covid-19, e cila është përdorur në lerën 456,030 lekë, pra në masën 98%.
d. Vlera prej 424,800 lekë për blerje produkte anti Covid-19 e përballuar nga fondet e art.602 ñshpenzime operativeò

Për vitin 2021 janë blerë produkte dezinfektimi e produkte të tjera anti Covid-19 në vlerën 480,000 lekë, të cilat janë programuar dhe përballuar nga fondet e art.602 ñshpenzime operativeò

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizmit të të ardhurave

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikoje procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës**,** kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikuiduara

Me fondet e vitit buxhetor 2020 dhe vitit 2021, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHSH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.
Nga auditimi i miratimeve të buxheteve vjetore rezultoi se për vitet 2020 detyrimet e prapambetura janë detajuar dhe fondet për likuidimin e tyre janë miratuar me buxhetin shtesë të miratuar VKB nr.12 datë 05.02.2020. Për vitin 2021 fondet për financimin e detyrimeve të prapambetura janë miratuar me VKB nr.6 datë 05.02.2021 me buxhetin shtesë.
Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës ñ*Detyrimet e prapambetura*ò, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Tabela nr. 12: Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2020

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartu 31/12/2019/ Në lekë	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020 (lekë)	Total detyrime/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2020/lekë	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2020 Në lekë
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
INVESTIME	26,376,809		26,376,809	1,861,188	24,515,621
Investime nga FZHSH	11,634,760.00		11,634,760		11,634,760
Mallra dhe shërbime	1,373,708		1,373,708		1,373,708
Vendime gjyqësore	10,365,268		10,365,268	1,000,000	9,365,268
Të tjera...	3,141,007	2,237,586	5,378,593	2,237,586	3,141,007
Totali :	52,891,552	2,237,586	55,129,138	5,098,774	50,030,364

Burimi:Nga të dhënat e subjektit, sipas pasqyrave dhe shkresësnr.Prot.1010 datë 26.02.2021

Tabela nr. 13: Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2021

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartu 31/12/2019/ Në lekë	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021 (lekë)	Total detyrime/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2021/lekë	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2021 Në lekë
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
INVESTIME	24,515,621	35,256,999	59,772,620	44,182,904	15,589,716
Investime nga FZHSH	11,634,760		11,634,760		11,634,760
Mallra dhe shërbime	1,373,708		1,373,708		1,373,708
Vendime gjyqësore	9,365,268		9,365,268	4,195,268	5,170,000
Të tjera...	3,141,007		3,141,007		3,141,007
Totali :	50,030,364	35,256,999	85,287,363	48,378,172	36,909,191

Burimi:Nga të dhënat e subjektit, sipas pasqyravenr. Prot.169/1, datë 10.02.2022

Referuar shkresës nr. Prot. 1010, datë 26.02.2021 dhe shkresës nr. Prot. 169/1, datë 10.02.2022 të Bashkisë Krujë dërguar në MFE të raportimit të detyrimeve të prapambetura për vitin 2020 dhe 2021 paraqitur në tabelën e mësipërme rezulton se detyrimet në mbyllje **të vitit 2020** janë në shumën **50,030,364** lekë dhe në mbyllje **të vitit 2021** janë në shumën **36,909,191** lekë. Detyrimet e prapambetura të raportuar në MFE rakordojnë me detyrimet e paraqitura në bilanc në llogaritë e klasës 4.

Konkluzion: Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhave ushtrimore 2020-2021, Bashkia Krujë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, ku në fundvitin 2020 janë në vlerën 50,030,364 lekë, dhe në fundvitin 2021 janë në vlerën 36,909,191 lekë, por me një trend ulje nga viti në vit.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, të paraqitura në tabelën e A/1 rezultojnë që, në fund të vitit 2021 janë të pa likuiduara gjithsej 111 raste me vlerë 36,909,191 lekë të krijuara dhe të trashëguara që nga vitet 2015 e përpara dhe të trashëguara nga ish-komunat, e ndarë në:

a. 51 fatura për shpenzime për investime në vlerën 27,224,476 lekë (kryesisht mbikëqyrje dhe kolaudim), për të cilat ka patur likuidime pjesore në vite për rastet që kanë patur dokumentacion ligjor.
b. 55 fatura për mallra e shërbime në vlerën 1,373,708 lekë, për të cilat nuk janë kryer likuidime, pasi për to nuk ekziston dokumentacion ligjor.
c. 5 vendime gjyqësore 5,170,000 lekë, për të cilat ka patur likuidime pjesore në vite.
d. 4 raste në vlerën 3,141,007 lekë të detyrimeve të pa derdhura për tatim të ardhurash personale dhe sigurime shoqërore e shëndetësore në DRTT, për të cilat nuk është kryer asnjë likuidim, pasi nuk ka të dhëna dhe dokumentacion ligjor shoqërues.

Analiza dhe shlyerja e detyrimeve për vendimet gjyqësore.

Detyrimet e prapambetura për vendime gjykate sipas vitit të krijimit, objektit të padisë, likuidimet e kryera, gjendjet në fund për vitet 2020-2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 14: Detyrimet e prapambetura për vendime gjykate 2020-2021

Nr	Emërtimi i subjektit	Objekti i vendimit gjyqësor	Nr/ Data		Vlera e mbetur	Likuidimi	Vlera e mbetur	Likuidimi	Vlera e mbetur
				vendimit	31.12.2019	2020	31.12.2020	2021	31.12.2021
1	A. M.	shpronësim	276	23,06,2010	6,670,000.00	1,000,000.00	5,670,000	1,000,000	4,670,000
2	L. Q.	kontratë	541	22,11,2013	963,085.00		963,085	463,085	500,000
3	B. V.	shpronësim	287	04,06,2012	984,300.00		984,300	984,300	-
4	S. G.	paga	3531	02,07,2015	1,647,883.00		1,647,883	1,647,883	-
5	R. LL.	paga	244	16,02,2012	100,000.00		100,000	100,000	-
Totali:					10,365,268.00	1,000,000.00	9,365,268.00	4,195,268.00	5,170,000.00

Burimi: Bashkia Krujë

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, rezulton se për periudhën objekt auditimi, Bashkia Krujë ka trashëguar detyrime të prapambetura që nga vitet para Bashkimit ,dhe vlera e mbetur pa u shlyer në fund të vitit 2020 është 9.365.268 lekë dhe në fund të vitit 2021 në vlerën 5,170,000 lekë. Sipas objektit të analizuara Vendimet Gjyqësore kryesisht janë në lidhje me shpronësimet, për detyrime kontraktuale dhe për dëmshpërblime në formë pagash për largime të padrejta nga puna.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxheteve vjetore janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e veta të Bashkisë Krujë, nga Ministritë e linjës dhe nga donatorë të huaj.

- Për **vitin 2020** janë planifikuar fonde për investime në shumën 600,418,116 lekë për 8 projekte me vlerë kontrate prej 597,510,828 lekë. Nga këto projekte janë financuar plotësisht 7 projekte nga fondet e Bashkisë dhe janë financuar pjesërisht 1 projekt nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, KUK, duke mbetur pa financuar deri në fund të vitit 2021 vlera prej 462,657,805 lekë.
- Për **vitin 2021** janë planifikuar fonde për investime në shumën 197,928,463 lekë për 30 projekte me burim financimi nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar, fonde të rindërtimit të dëmtimeve nga tërmeti në vlerën 698,480,134 lekë për 5 projekte dhe fonde për bashkëfinancim me donatorë për 2 projekte. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2021 është 866,675,586 lekë. Nga këto kontrata kanë mbetur pa u financuar vlera prej 603,738,670 lekë. Vlera e kontratave të pa likuiduara deri në fund të vitit 2021 duke përfshirë dhe kontratat e lidhura para vitit 2020 është 1,259,946,077 lekë.

Në vitin 2020 -2021 për projekte janë përdorur fondet e Bashkisë nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar e buxhetit të shtetit në blerje automjetesh, pajisje për kopshte, shkolla e zyra, në infrastrukturë rurale e rikonstruksion shkollash e zyrash. Ndërsa nga FZHR dhe Ministritë e Linjës janë alokuar fonde për financim të 9 projekteve ndërsa projekte të financuara më donator janë gjithsej 2 projekte.

Nga Ministria e Infrastrukturësjanë financuar 2 projekte:

1. Rehabilitim i puseve ekzistuesedhe ndërtim i linjës se transmetimit dhe shpërndarjes se ujësjellësit Fushë-Krujë me vlerë kontrate 587,214,932 lekë me afat 12 muaj nga data e fillimit të punimeve paguar deri ne fund të vitit 2021 në vlerën 127,773,898 lekë , mbetur pa u likuiduar deri në fund të vitit 2021 vlera prej 459,441,034 lekë.
2. Mbikëqyrje punimesh për objektin:´Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së ujësjellësit Fushë-Krujë me vlerë kontratë 4,502,496 lekë me afat 12 muaj nga data e fillimit të punimeve paguar deri ne fund të vitit 2021 në vlerën 1,285,725 lekë, mbetur pa likuiduar deri në fund të vitit 2021 vlera prej 3,216,771 lekë.
3. Shtim i Sasisë së Furnizimit me Ujë të qytetit Krujë me vlerë kontrate 376,513,869 lekë me afat 12 muaj nga data e fillimit të punimeve paguar deri ne fund të vitit 2021 në vlerën prej 186,633,084 lekë , mbetur pa u likuiduar deri në fund të vitit 2021vlera prej 189,880,785 lekë.
4. Mbikëqyrje punimesh për objektin: Shtim i Sasisë së Furnizimit me Ujë të qytetit Krujë me vlerë kontrate 3,863,858 lekë me afat 12 muaj nga data e fillimit të punimeve, paguar deri në fund të vitit 2021 vlera prej 2,935,033 lekë, mbetur pa likuiduar deri në fund të vitit 2021deri ne fund të vitit 2021 928,825 lekë.

Nga Ministria e Arsimit janë financuar 1 projekt:

1. Rikonstruksion dhe shtesë Anësore e Shkollës së Mesme Lagjia Kastrioti, Fushë Krujë me vlerë kontrate 193,191,496 lekë datë kontratë 12.09.2019 e cila është

financuar nga Ministria e Arsimit në vlerën prej 135,174,097 lekë dhe bashkëfinancim nga Bashkia në vlerën prej 58,017,399 lekë, likuiduar gjatë vitit 2020-2021 vlera prej 79,041,882 lekë dhe vlera e mbetur e kësaj kontrate ne fund të vitit 2021 është 0 lekë.

Nga Ministria e Bujqësisë janë financuar 1 projekt:

1. Rehabilitim i Digës së Ujëmbledhësit Tapizë me vlerë kontrate 204,444,551 lekë datë kontrate 18.07.2019 e cila është financuar nga Ministria e Bujqësisë në vlerën prej, likuiduar gjatë vitit 2020 vlera prej 24,044,902 lekë dhe vlera e mbetur e kësaj kontrate në fund të vitit 2021 është 0 lekë.

Nga Ministria e Rindërtimit janë financuar 5 projekte:

1. Hartimi i Projektit të ndërhyrjes, rehabilitimit për objektet e dëmtuara nga tërmeti me kontratë me vlerë 63,746,100 lekë, likuiduar në masën 100%.
2. Rindërtim i Objektit: ñAtrium Center Thumanaò me vlerë kontrate 220,079,942 me afat punimesh 4 muaj nga data e fillimit të punimeve, likuiduar deri me datë 31.12.2021 35,256,999 lekë dhe vlera e mbetur e kësaj kontrate në fund të vitit 2021 është 184,822,942 lekë.
3. Rindërtim i Objektit: ñPoli i Ri Administrativ i Bubqitò me vlerë kontrate 237,995,994 me afat punimesh 4 muaj nga data e fillimit të punimeve, likuiduar deri me datë 31.12.2021 47,625,968 lekë dhe vlera e mbetur e kësaj kontrate në fund të vitit 2021 është 190,370,026 lekë.
4. Rindërtim i Objektit Arsimor: ñRindërtim i Shkollës 9 vjeçare ñHajdar Zogu, Tapizeò me vlerë kontrate 102,994,662 me afat punimesh 4 muaj nga data e fillimit të punimeve, likuiduar deri me datë 31.12.2021 20,629,500 lekë dhe vlera e mbetur e kësaj kontrate në fund të vitit 2021 është 82,365,162 lekë.
5. Rindërtim i Objektit Arsimor: ñRindërtim i Shkollës Vëllezërit Masha, Nj Ad Bubqò, me vlerë kontrate 72,793,016 me afat punimesh 4 muaj nga data e fillimit të punimeve, likuiduar deri me datë 31.12.2021 14,588,841 lekë dhe vlera e mbetur e kësaj kontrate në fund të vitit 2021 është 58,234,175 lekë.

Nga Donatorët janë financuar 2 projekte:

1. Rehabilitim i Sallës së Koncerteve në Pallatin e Kulturës "Ibrahim Berdaku" Krujë Financuar nga Fondacioni ñPrograma i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri në vlerën prej 25,635,845 lekë dhe me të ardhurat e Bashkisë vlera prej 5,127,169 lekë në total projekti 30,763,014 lekë, likuiduar deri në fund të vitit 2021 vlera totale prej 19,480,018 dhe vlera e mbetur në fund të vitit 2021 është 11,282,996 lekë
2. Blerje Automjeti Zjarrfikës për Bashkinë Krujë financuar nga Ambasada Japoneze në vlerën prej 9,000,000 lekë dhe nga të ardhurat e Bashkisë në vlerën prej 1,800,000 lekë, në total vlerë kontrate 10,800,000 lekë, likuiduar në masën 100%.

Konkluzion: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 37 projekteve të investimeve me fondeve të akorduara nga Ministritë e Linjës dhe FZHR, si dhe fondeve të veta të vëna në dispozicion nga Bashkia Krujë për periudhën 2020-2021, rezultoi se janë ndjekur hapat:

Bashkia për këto investime ka marrë angazhime buxhetore një dhe disavjeçare, të cilat janë regjistruar kundrejt planit vjetor për tre vite në vijim në sistemin Informatikë financiar të Qeverisë nëpërmjet Degës së Thesarit Krujë.

Për çdo procedurë prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Krujë. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Krujë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas planifikimit në PBA. Nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara me qëllim pagesën e saj dhe në rastet, kur fondi nga Ministria ka ardhur i ndarë në afate mujore kontrata është regjistruar e plotë, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të

depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Tabela 15: Realizimi i buxhetit për vitet 2020 dhe 2021 sipas burimit të financimit

Në 000/lekë

	Emërtimi	2020			2021		
Nr		Plan	Fakt	Real.%	Plan	Fakt	Real.%
1	**Paga 600**	**348,217**	**311,032**	**89.32%**	**371,212**	**320,694**	**86.39%**
	grant i kushtezuar	7,616	7,368	96.75%	10,694	10,621	99.32%
a	grant i pakushtezuar + tarsnsferta specifike	245,846	228,684	93.02%	271,781	244,115	89.82%
b	të ardhura	94,754	74,980	79.13%	88,737	65,958	74.33%
2	**Sigurime shoqërore 601**	**74,898**	**53,882**	**71.94%**	**65,328**	**52,986**	**81.11%**
	grant i kushtezuar	1,206	1,206	99.99%	1,207	1,207	100.00%
a	grant i pakushtezuar + tarsnsferta specifike	54,665	39,043	71.42%	49,268	39,968	81.12%
b	të ardhura	19,027	13,632	71.65%	14,852	11,811	79.52%
3	**Shpenz.operative 602+ F.rezerve**	**461,480**	**179,558**	**38.91%**	**422,319**	**264,441**	**62.62%**
	grant i kushtezuar	1,017	675	66.38%	420	180	42.86%
a	grant i pakushtezuar + tarsnsferta specifike	154,049	94,088	61.08%	170,255	120,278	70.65%
b	Fonde rindertimi (grant i pakushtezuar)	197,242	64,600	32.75%	132,991	82,552	62.07%
c	te ardhura	109,173	20,195	18.50%	118,654	61,432	51.77%
4	**K.Qarkut Emergj.civile 604**	**816,335**	**707,315**	**86.65%**	**211,734**	**120,469**	**56.90%**
a	grant i kushtezuar	466	466	100.00%	7,756	-	0.00%
b	grant i pakushtezuar	16,892		0.00%	14,785	2,173	14.70%
c	të ardhura	19,196	18,000	93.77%	30,093	17,796	59.14%
d	Fonde rindertimi (grant I pakushtezuar)	779,782	688,850	88.34%	159,100	100,500	63.17%
5	**Nd eko invalid, Bonus qera , shperb lindje 606**	**774,737**	**754,480**	**97.38%**	**703,236**	**701,561**	**99.76%**
a	grant i kushtezuar	772,977	752,720	97.38%	702,406	700,730	99.76%
	grant i pakushtezuar +transferte specifike	1,607	1,607	100.00%	626	626	100.00%
	Të ardhura	153	153	100.00%	205	205	100.00%
6	**Investime 230-231**	**480,212**	**365,656**	**76.14%**	**615,103**	**384,522**	**62.51%**
I	Buxheti i bashkise Grant +te ardhura)	*229,545*	*129,185*	*56.28%*	*314,589*	*138,828*	*44.13%*
a	Grant i pakushtezuar + trasnsferta specifike	20,527	4,306	20.98%	81,428	21,807	*26.78%*
b	të ardhura	209,018	124,879	59.75%	233,160	117,022	*50.19%*
II	Ministrite e linjes + FZHR	*236,038*	*235,085*	*99.60%*	*75,753*	*51,200*	*67.59%*
III	Fonde rindertimi (grant I pakushtezuar)	*14,630*	*1,386*	*9.47%*	*224,762*	*194,494*	*86.53%*
	Bashkia	***2,955,880***	***2,371,923***	***80.24%***	***2,388,932***	***1,844,673.94***	***77.22%***

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se **me të ardhurat e veta** kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 ñpaga e shpërblimeò për vitin 2020 në masën 24.10 %, dhe për vitin 2021 në masën 20.87% .
- Shpenzimet në artikullin 601 ñkontributin për sigurime shoqërore e shëndetësoreò për vitin 2020 në masën 25.29%, dhe për vitin 2021 në masën 22.29%.
- Shpenzimet në artikullin 602 ñ shpenzime operative për mallra e shërbimeò për vitin 2020 në masën 11.25%, dhe për vitin 2021 në masën 23.23 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 ñinvestimeò për vitin 2020 në masën 34.15 %, dhe për vitin 2021 në masën 30.43%.

Referuar burimit të financimit, shpenzimet buxhetore në total sipas viteve ushtrimore janë përballuar:

Për vitin 2020, nga të ardhurat e veta në shumën 251,840 mijë lekë ose në masën 11%, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 367,728 mijë lekë ose në masën 16 %, nga transferta e kushtëzuar në shumën 762,434.97 mijë lekë ose në masën 32%, nga FZHR dhe Ministritë e Linjës në shumën 235,085 mijë lekë ose në masën 10% dhe nga fondet e rindërtimit ne Shumën 754,835 ose në masën 32%.

Për vitin 2021, nga të ardhurat e veta në shumën 274,224 mijë lekë ose në masën 15%, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 428,967 mijë lekë ose në masën 23 %, nga transferta e kushtëzuar në shumën 712,737.77 mijë lekë ose në masën 39 %, nga

FZHR dhe Ministritë e Linjës në shumën 51,200 mijë lekë ose në masën 3% dhe nga fondet e rindërtimit në shumën 377,545 ose në masën 20%.
Pra duke u nisur nga burimi i financimit rezulton se rolin kryesor në financimin e buxhetit vjetor për funksionet e kësaj njësie vendore, kryesisht përballohen nga fondet e alokuara nga buxheti i shtetit dhe në masë të vogël nga të ardhurat e veta rreth 15%

Raportet e Monitorimit.
Për vitin 2020 dhe 2021 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò neni 65, si dhe me Udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 ñPër Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Qeverisjes vendoreò.
Raportet e monitorimit vjetore janë dërguar pranë MFE, ku për vitin 2020 me shkresën nr. 390 Prot. datë 20.01.2021 dhe për vitin 2021me shkresën nr. 784 Prot.datë 11.02.2022.
Konkluzion: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2020 dhe 2021 *u konstatua se*:
1. Për **vitin 2020** fondet buxhetore janë realizuar 2 në shumën 2,371,923 mijë lekë nga 2,955,879 mijë lekë ose në masën 80.24% dhe për **vitin 2021** fondet buxhetore janë realizuar në shumën 1,844,674 mijë lekë nga 2,388,932 mijë lekë planifikuara ose në masën 77.22%. Pra kemi një realizim jo të kënaqshëm të fondeve të programuara në të dy vitet buxhetore, ku në mosrealizimin e tyre kanë ndikuar realizimi në nivel të ulët sidomos i:
- zërit të shpenzimeve 602 ñshpenzime operativeò, i cili për vitin 2020 është realizuar në masën 38.91% dhe për vitin 2021 në masën 62.62%
-zërit të shpenzimeve 230- 231ñshpenzime për investimeò, ku për vitin 2020 janë realizuar në masën 76.14% dhe për vitin 2021 në masën 77.22%
- zërit të shpenzimeve 600-601ñpaga e sigurimeò të cilat janë realizuar rreth 86%.
- zërit të shpenzimeve 604ò emergjencat civile, ku për vitin 2020 në masën 87% dhe për vitin 2021 në masën 57%.
Mosrealizimi i fondeve në këto zëra shpenzimesh tregon për programime të pa studiuara dhe me rezervë, për të cilat nuk është bërë një analizë faktoriale për përmirësimin e punës për një planifikim mbi baza reale.

2. Në fund të periudhave ushtrimore 2020-2021, Bashkia Krujë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, ku në **fundvitin 2020** janë në vlerën **50,030,364 lekë** dhe në **fundvitin 2021** janë në vlerën **36,909,191 lekë**, por me një trend ulje nga viti në vit.Nga analiza e detyrimeve të prapambetura për fatura të mbërritura për periudhën 01.01.2020 ï 31.12.2021, rezultojnë që, në fund të vitit 2021 janë të pa likuiduara gjithsej 111 raste faturash, kontratash, procese gjyqësorë dhe detyrime ndaj DRTT për TAP me vlerë 36,909,191 lekë të krijuara dhe të trashëguara që nga vitet 2015 e përparanga ish-komunat.
3. Me miratimin e buxheteve vjetore janë miratuar dhe projektet për investime.
- Për **vitin 2020** janë planifikuar fonde për investime në shumën 600,418,116 lekë për 8 projekte me vlerë kontrate prej 597,510,828 lekë. Nga këto projekte janë financuar plotësisht 7 projekte nga fondet e Bashkisë dhe është financuar pjesërisht 1 projekt nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, KUK, duke mbetur pa financuar deri në fund të vitit 2021 vlera prej 462,657,805 lekë
- Për **vitin 2021** janë planifikuar fonde për investime në shumën 197,928,463 lekë për 30 projekte me burim financimi nga të ardhurat dhe transferta e pakushtëzuar, fonde të rindërtimit të dëmtimeve nga tërmeti për 5 projekte në vlerën 698,480,134 lekë dhe për 2 projekte të bashkëfinancuara nga donatorë. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2021 është

866,675,586 lekë. Nga këto kontrata kanë mbetur pa u financuar vlera prej 603,738,670 lekë. Vlera e kontratave të palikuiduara deri në fund të vitit 2021 duke përfshirë dhe kontratat e lidhura para vitit 2020 është 1,259,946,077 lekë.

4.Të ardhurat janë realizuar për *vitin 2020* në masën **91.3**%. dhe për vitin 2021 në masën **94**%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 241,254 mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2021 është bërë në masën më të madhe prej 85% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, transferta specifike, FZHR e Ministritë e Linjës) dhe 15% nga të ardhurat e veta.

Titulli gjetjes 8:*Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi.*

Situata: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2020 u konstatua se:

a. Fondet buxhetore për *vitin 2020* janë realizuar në shumën 2,371,923 mijë lekë nga 2,955,879 mijë lekë të planifikuara ose në masën 80.24% dhe për *vitin 2021* janë realizuar në shumën 1,844,674 mijë lekë nga 2,388,932 mijë lekë të planifikuara ose në masën 77.22%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i:

- llog. 602 ñShpenzime operativeò në masën 39% në *vitin 2020* e 63% në *vitin 2021*;
- llog. 230-231 ñShpenzime për investimeò në masën 76.14% në *vitin 2020* e 77.2% në vitin 2021;
- llog. 600-601ñpaga e sigurimeò në masën 86%;
- llog. 604 ñemergjencat civileò në masën 87% në *vitin 2020* e 57% në *vitin 2021.*

Mosrealizimi i fondeve në këto zëra shpenzimesh tregon për programime të pa studiuara dhe me rezervë mos realizimi i projekteve në vlerë të plotë, për të cilat nuk është bërë një analizë faktoriale për përmirësimin e punës për një planifikim mbi baza reale.

b. Në fund të periudhave ushtrimore 2020-2021, Bashkia Krujë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, ku në **fund të** *vitit 2020* janë në vlerën *50,030,364 lekë*, dhe në fund të*vitit 2021* janë në vlerën *36,909,191lekë*, por me një trend ulje nga viti në vit.Nga analiza e detyrimeve të prapambetura rezultojnë që, në fund të vitit 2021 janë të pa likuiduara gjithsej 111 raste faturash, kontratash, procese gjyqësorë dhe detyrime ndaj DRTT për TAP me vlerë 36,909,191 lekë të krijuara dhe të trashëguara që nga vitet 2015 e përparanga ish-komunat për të cilat mungon dokumentacioni.

c.Të ardhurat janë realizuar për *vitin 2020* në masën 91.3%. dhe për vitin 2021 në masën 94%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 241,254 mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2021 është bërë në masën më të madhe prej 85% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, transferta specifike, FZHR e Ministritë e Linjës) dhe 15% nga të ardhurat e veta.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò neni 40,42.

Udhëzim i MFE nr.09 datë 20.07.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, Kreu ñDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò, pikat 82-91; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar neni 12 pika 3.

Ndikimi: Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti si dhe realizim jo shumë të mirë të të ardhurave si dhe raportim jo i plotë e detyrimeve të papaguara.

Shkaku: Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritetesh dhe nevojash reale dhe ndryshimet e shpeshta e bëjnë të paqëndrueshëm dhe jo efektiv procesin e buxhetimit, ndërsa mos evidentimi i saktë i detyrimeve dhe mos likuidim i tyre sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria Ekonomike të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre dhe borxhi tatimor.

Struktura e Bashkisë Krujë për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Në strukturën e Bashkisë Krujë për vitin 2020-2021 Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka patur në përbërjen e tij 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës. Përkatësisht, 1 (një) Drejtor, 10 (dhjetë) specialistë dhe 4 (katër) inspektor terreni.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2020 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Krujë është miratuar me VKB-në 93, datë 12.12.2019 ñMbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020ò;

Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Krujë është miratuar me VKB-në nr. 104, datë 28.12.2020 ñMbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021ò.

Tabela nr.16: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Krujë, 2020– 2021

Lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	%	PLAN	FAKT	%
I	**TAKSA VENDORE**	**245,964,000**	**222,059,646**	**90%**	**243,167,000**	**234,594,203**	**96%**
1	**Tatim i Thjeshtuar Fitimin**	**4,000,000**	**3,812,403**	**95%**	**4,000,000**	**3,507,325**	**88%**
2	**Taksë Pasurie Paluajtshme**	**105,894,000**	**108,995,250**	**103%**	**87,184,000**	**98,206,256**	**113%**
	a- T. Ndërtese	63,150,000	86,702,865	137%	63,150,000	72,372,412	115%
	b- T. Ndërtese Banesa	1,450,000	667,867	46%	1,450,000	487,647	34%
	c- T. Toke Bujqësore	27,294,000	1,251,659	5%	8,584,000	1,033,423	12%
	d- T. Truallin	14,000,000	20,372,859	146%	14,000,000	24,312,774	174%
3	**T. Fjetjes në Hotel**	**970,000**	**247,958**	**26%**	**670,000**	**556,838**	**83%**
4	**T. Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja**	**58,500,000**	**6,931,427**	**12%**	**56,500,000**	**15,112,484**	**27%**
5	**TAKSA TË NDARA**	**45,800,000**	**40,988,489**	**89%**	**43,300,000**	**58,982,195**	**136%**
	a- T. Kalimit të pronësisë	800,000	880,198	110%	800,000	4,447,565	556%
	b- T. Mjeteve Të Përdorura + T.A.P	42,000,000	37,610,698	90%	40,000,000	47,298,951	118%

	c- Renta minerare	3,000,000	2,497,593	83%	2,500,000	7,235,679	289%
6	**T. Tabele, Reklame**	**8,000,000**	**32,815,032**	**410%**	**10,000,000**	**14,553,850**	**146%**
7	**T. të tjera Taksa**	**800,000**	**-**	**0%**	**800,000**	**-**	**0%**
8	**Debitor**	**22,000,000**	**28,269,087**	**128%**	**40,713,000**	**43,675,255**	**107%**
II	**TARIFA VENDORE**	**86,836,000**	**71,417,366**	**82%**	**86,833,000**	**72,757,296**	**84%**
1	**Qiratë**	**475,000**	**48,000**	**10%**	**472,000**	**24,000**	**5%**
2	**T. zënie e hap. Publike e të tjera**	**2,800,000**	**110,000**	**4%**	**2,800,000**	**2,500,000**	**89%**
	a- T. hapësira publike	100,000	80,000	80%	100,000	-	0%
	b- sipërfaqja zënies së hapësirave para biznesit	2,700,000	30,000	1%	2,700,000	2,500,000	93%
3	**Tarifë Shërbime Publike**	**50,500,000**	**53,910,289**	**107%**	**50,500,000**	**53,358,543**	**106%**
4	**Tarifë Ndriçimi**	**2,800,000**	**4,014,050**	**143%**	**2,800,000**	**3,778,687**	**135%**
5	**Tarifë leje transporti**	**4,000,000**	**4,551,960**	**114%**	**4,000,000**	**4,164,205**	**104%**
6	**Kopshte + Çerdhe**	**4,000,000**	**1,776,299**	**44%**	**4,000,000**	**3,175,428**	**79%**
7	**T. bagëti e therur + certifikata**	**1,500,000**	**541,319**	**36%**	**1,500,000**	**528,898**	**35%**
8	**Tarifa të Ndryshme Bordi Kullimit**	**3,000,000**	**-**	**0%**	**3,000,000**	**-**	**0%**
9	**T. Pyjore**	**3,173,000**	**1,345,736**	**42%**	**3,173,000**	**1,161,530**	**37%**
10	**T. Të tjera shitje M+SH Uji**	**8,050,000**	**2,957,000**	**37%**	**8,050,000**	**3,207,500**	**40%**
11	**Të tjera tarifa**	**6,538,000**	**2,162,713**	**33%**	**6,538,000**	**858,505**	**13%**
	a- T. nga Urbanistika, MZSH	5,000,000	2,153,213	43%	5,000,000	850,005	17%
	b- T. Administrative	1,538,000	9,500	1%	1,538,000	8,500	1%
I+II	**TË ARDHURA VENDORE GJITHSEJ**	**332,800,000**	**293,477,012**	**88%**	**330,000,000**	**307,351,499**	**93%**

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Krujë paraqitet si vijon:

- *Për vitin 2020* të ardhurat janë realizuar në masën 88%, nga 322,800 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 293,477 mijë lekë (diferencë 39,323 mijë lekë).
- *Për vitin 2021* të ardhurat janë realizuar në masën 93%, nga 330,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 307,351 mijë lekë (diferencë 22,649 mijë lekë).

Nga analizimi i mëtejshëm i tabelës, rezulton se:

P**ër vitin 2020**, 9 zëra janë realizuar në masën mbi ose 85%, 3 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%, 6 zëra janë realizuar në masën mbi ose 25% dhe 7 zëra nën masën 25%.

Për vitin 2021, 11 zëra janë realizuar në masën mbi ose 85%, 2 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%, 5 zëra janë realizuar në masën mbi ose 25% dhe 7 zëra nën masën 25%.

*Nga auditimi u konstatua se,*ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzime, për zërat që bashkia mund të parashikojë (siç janë grup zërat taksë për tokën bujqësore, tarifë kopshte dhe çerdhe, etj.), ndërkohë që zërat të cilët janë në vlera mbi 100%, janë të ardhura që bashkia nuk mund ti planifikojë me saktësi për nga specifika e taksave ose tarifave.

Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve

buxhetore pa patur burime financimi reale. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:
- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò;
- Udhëzimit të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendoreò.
- Udhëzimit të MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022".

Titulli i gjetjes 9:*Metodologjia që DTTV përdor për të realizuar planifikimin vjetor të taksave dhe tarifave vendore nuk bën të mundur një parashikim real të të ardhurave të veta të Bashkisë Krujë.*

Situata: Bashkia Krujë rezulton të ketëdiferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzime, për zërat që Bashkia mund të parashikojë (siç janë grup zërat taksë për tokën bujqësore, tarifë kopshte dhe çerdhe, etj.), ndërkohë që zërat të cilët janë në vlera mbi 100%, janë të ardhura që Bashkia nuk mund ti planifikojë me saktësi për nga specifika e taksave ose tarifave.

Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale.

Për vitin 2020, 9 zëra janë realizuar në masën mbi ose 85%, 3 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%, 6 zëra janë realizuar në masën mbi ose 25% dhe 7 zëra nën masën 25%.

Për vitin 2021, 11 zëra janë realizuar në masën mbi ose 85%, 2 zëra janë realizuar në masën mbi ose 50%, 5 zëra janë realizuar në masën mbi ose 25% dhe 7 zëra nën masën 25%.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar;Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò; Udhëzimi të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendoreò; Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022"; VKB-në 93, datë 12.12.2019 ñMbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020ò; VKB-në nr. 104, datë 28.12.2020 ñMbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021ò.

Ndikimi: Niveli i planifikimit të të ardhurave të bashkisë nga taksat dhe tarifat vendore ndikon direkt në hartimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Krujë.

Shkaku: Strukturat brenda Bashkisë Krujë nuk dërgojnë informacionin përkatës pranë DTTV sipas përcaktimeve të VKB-ve për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Krujë. Drejtoria nga ana e saj në mungesë të këtij informacioni si dhe nga mos kryerja e analizave të mirëfillta nuk arrin një planifikim efektiv.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë të bashkëpunojë me strukturat e tjera të Bashkisë si dhe me institucione të tjera vendore përkatëse me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c[7]dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 ñPër përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimittë të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizimò, pika 5[8].

Në Bashkinë Krujë struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Bazuar në shkresat që ASHK dërgon në Bashkinë Krujë, për vitin *2020* janë legalizuar 61 objekte nga 101 objekte të legalizuara faktikisht. Kanë paguar detyrimin 79 qytetarë në shumën 2,705,874 lekë. Janë **debitorë 22 qytetarë nëshumën 592,494 lekë**.

Për vitin *2021* është dërguar asnjë shkresë nga AShK për legalizimet e 24 objekte me detyrim për taksën e ndikimit në infrastrukturë prej 1,285,118 lekë. Kanë paguar detyrimin 21 qytetarë në shumën 1,177,997 lekë. Janë **debitorë 3 qytetarë nëshumën 107,121 lekë** (për më shumë informacion shiko Aneksin nr. 4).

Tabela nr.17:Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2020-2021

lekë

Viti	Numri total i legalizimeve	Detyrimi financiar në lekë	Numri i faturave të paguara	Vlera	Numri i faturave të pa paguara	Vlera
2020	101	3,298,368	79	2,705,874	22	592,494
2021	24	1,285,118	21	1,177,997	3	107,121
SHUMA	**125**	**4,583,486**	**100**	**3,883,871**	**25**	**699,615**

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

*Nga auditimi u konstatua se,*lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se:

Për periudhën 2020-2021 janë debitor 25 qytetarë me vlerë totale 699,615 lekë dhe nga vitet e mëparshme në vlerë totale 62,939,445 lekë, **që përbën në total 63,639,060 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë**.

Gjithashtu, *u konstatua se,* pjesërisht për vitin 2020 nuk janë dërguar shkresa nga AShK për legalizimet e bëra dhe janë paraqitur vullnetarisht qytetarët për pagesat e detyrimeve nga legalizimi. Në këtë rast Bashkia Krujë nuk ka ndërmarrë asnjë hap që AShK të sjellë shkresat përkatëse.

Titulli i gjetjes 10:*Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).*

Situata: Lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë

[7]Ligji nr. 95/2018 ñ për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñPër sistemin e taksavevendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c ñpër ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesiò.

[8]VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: ñTaksavendore e ndikimitnë infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimiò.

rezulton se, për periudhën 2020-2021 janë debitor 25 qytetarë me vlerë totale 699,615 lekë dhe nga vitet e mëparshme në vlerë totale 62,939,445 lekë,që përbën në total 63,639,060 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.
Rezultoi se pjesërisht për vitin 2020 nuk janë dërguar shkresa nga AShK për legalizimet e bëra dhe janë paraqitur vullnetarisht qytetarët për pagesat e detyrimeve nga legalizimi. Në këtë rast Bashkia Krujë nuk ka ndërmarrë asnjë hap që AShK të sjellë shkresat përkatëse.
Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006,ñPër sistemin e taksavevendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr. 95/2018 ñ për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñPër sistemin e taksavevendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c; Ligji nr. 98/2020 ñ për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñPër sistemin e taksavevendoreò, i ndryshuar, neni 1, ñnë nenin 27, pika 3, shkronja ñcò; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ñ Për përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimittë të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizimò pika 5; VKB-në 93, datë 12.12.2019 ñMbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020ò; VKB-në nr. 104, datë 28.12.2020 ñMbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021ò.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë, nga mos arkëtimi i vlerës prej **63,639,060lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.
Shkaku: Mos marrje e masave nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për të bërë të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve nga subjektet që kanë përfituar certifikatën e pronësisë, si dhe mos bashkëpunim me DTTV dhe ASHK-në.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për ñTaksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimetò dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me **vlerë 63,639,060lekë**. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Krujë të bashkëpunojnë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore
Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Krujë kryhet në programin Excel. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Tabela nr.18: Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Krujë 2020-2021

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2020	1083	149	111	1121
		2021	1121	157	76	1202
2	Biznesi Madh	2020	444	33	29	448
		2021	448	28	17	459
	Gjithsej	2020	1527	182	140	**1569**
		2021	1569	185	93	**1661**

Burimi: Bashkia Krujë

Sa më sipër u konstatua se numri total i bizneseve në Bashkinë Krujë ka ardhur në rritje nga viti 2020 që rezultojnë 1569 në vitin 2021 rezultojnë 1661 biznese gjithsej. Për këtë periudhë janë regjistruar 367 biznese të reja ndërkohë që janë mbyllur 233 biznese të tjera.

Mbi realizimit e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit
Për periudhën 2020-2021 IMTV ka patur në strukturën e tij, 1 Kryeinspektor dhe 3 Inspektor emëruar me Urdhër nr. 59, datë 09.02.2016, Urdhër nr. 14, datë 17.01.2020 dhe Urdhër nr. 17, datë 17.01.2020.
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Krujë është ngritur dhe funksionon në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, i ndryshuar, neni 4.
Kryeinspektori në detyrë i IMTV-së është emëruar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 97, datë 29.09.2015 dhe 3 Inspektor emëruar me Urdhër nr. 59, datë 09.02.2016, Urdhër nr. 14, datë 17.01.2020 dhe Urdhër nr. 17, datë 17.01.2020.

Mbi aktivitetin e IMTV-së për periudhën 2020-2021
Titulli i gjetjes 11:*Mos arkëtim i gjobave të vendosura nga IMTV.*
Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Krujë u konstatua se për vitin 2020 janë mbajtur në total 28 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes dhe për të gjithë kundërvajtjet është vendosur ñ*Dënim me gjobë*ò. Janë paguar 3 gjoba në vlerë 400,000 lekë dhe nuk kanë paguar 25 subjekte me vlerë totale të gjobave të vendosura për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 është 9,200,000 lekë.
Bashkia Krujë ka miratuar VKB-në nr. 110, datë 28.12.2020 ñPër miratim falje masash administrative të vendosura nga IMT, Bashkia Krujë, gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19 dhe familjeve të dëmtuara për shkak të fatkeqësisë natyroreò, dhe me këtë VKB ka falur 3 dënime me gjobë për F. Sh. për vlerën 500,000 lekë, B. M. për vlerën 500,000 lekë dhe F. I. R. për vlerën 1,000,000 lekë.
Për vitin 2021 janë mbajtur në total 25 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes dhe për të gjithë kundërvajtjet është vendosur ñ*Dënim me gjobë*ò. Të gjithë gjobat e vendosura nuk janë paguar. Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2021 është 16,202,600 lekë.

Drejtoria e IMTV në Bashkinë Krujë ka njoftuar me shkresat përkatëse për të gjithë dënimet me gjobë Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të Bashkisë Krujë dhe ka ndjekur hapat e nevojshëm për të dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për secilën gjobë të vitit 2020.
Për vitin 2021 Drejtoria e IMTV në Bashkinë Krujë ka ndjekur hapat e nevojshëm për të dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për gjobat e vendosura të këtij viti, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 30, pika 4.
*Nga auditimi u konstatua se,*për periudhën 01.01.2020-31.12.2021 **të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 25,402,600 lekë.**
Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò neni 30 pika 1 pika 3 dhe pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë në vlerën 25,402,600 lekë.
Shkaku: Mos ndjekja e hapave ligjore për arkëtimin e gjobave, nga Drejtoria Juridike dhe IMTV.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Drejtoria Juridike dhe IMTV në Bashkisë Krujë të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **25,402,600 lekë**.

Menaxhimi i borxhit

Subjektet Debitore

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve progres për subjektet fizik/juridik në fund të vitit 2019 rezultojnë, 1563 subjekte në vlerën 291,870,310 lekë, si dhe për vitet 2020-2021 paraqitet si mëposhtë:

Tabela nr. 19: Subjektet debitorë progresiv sipas njësive për vitin 2020

lekë

Lloji biznesit	**DEBITORËT**				
	Njësitë				
	Krujë	**Fushë -Krujë**	**Nikël**	**Bubq**	**Thumanë**
Biznes i Vogël	25,600,804	76,507,508	57,091,841	15,302,054	1,128,905
Biznes i Madh	50,822,249	78,187,695	49,530,235	16,444,996	809,660
Pronar	8,751,819	8,173,867	4,975,591	2,192,404	
Të Tjerë					46,458,633
Shuma	85,174,872	162,869,070	111,597,667	33,939,453	48,397,198
TOTAL	**441,978,261**				

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr. 20: Subjektet debitorë progresiv në numër sipas njësive për vitin 2020

Njësitë	Nr. Biznesesh			
	Biznes i Vogël	Biznes i Madh	Pronar	Shuma
Krujë	354	79	14	447
Fushë - Krujë	808	174	15	997
Nikël	260	60	41	361
Bubq	113	26	5	144
Thumanë	36	116		152
TOTAL	1 571	455	75	**2 101**

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr. 21: Subjektet debitorë progresiv sipas njësive për vitin 2021

lekë

Lloji biznesit	**DEBITORËT**				
	Njësitë				
	Krujë	**Fushë - Krujë**	**Nikël**	**Bubq**	**Thumanë**
Biznes i Vogël	27,733,713	79,686,575	67,706,470	15,219,632	14,161,033
Biznes i Madh	57,837,903	103,096,002	58,621,444	17,821,468	44,236,509
Pronar	13,103,982	11,834,569	7,902,857	7,305,169	4,244,496
Shuma	98,675,598	194,617,145	134,230,771	40,346,269	62,642,037
TOTAL	**530,511,820**				

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr. 22: Subjektet debitorë progresiv në numër sipas njësive për vitin 2021

Njësitë	Nr. Biznesesh			
	Biznes i Vogël	Biznes i Madh	Pronar	Shuma
Krujë	368	79	22	469

Fushë - Krujë	835	203	37	1 075
Nikël	305	70	15	390
Bubq	106	32	9	147
Thumanë	124	43	3	170
TOTAL	1 738	427	86	**2 251**

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Nga të dhënat e Bashkisë Krujë gjendja e debitorëve progres për subjektet fizik/juridik, në fund të vitit 2019 rezultojnë 1563 subjekte në vlerën 291,870,310 lekë.
Në fund të vitit 2020 rezultojnë 2101 subjekte në vlerën 441,978,261 lekë.
Në fund të vitit 2021 rezultojnë 2251 subjekte në vlerën 530,511,820 lekë.
Vërehet se për vitin 2020 vlera e debitorëve në progresiv të jetë rritur përafërsisht me 34% me një vit më parë dhe për vitin 2020 vlera e debitorëve në progresiv të jetë rritur përafërsisht me 17%.
*Nga auditimi u konstatua se,*në fund të vitit 2021 gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik është**530,511,820 lekë, vlerë kjo që sjell të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.**

Taksat dhe Tarifat Familjare
Në Bashkinë Krujë familjarët ngarkohen me taksa dhe tarifa për Tokën, Banesën, Ndriçimin dhe Shërbimet Publike nga Drejtoria e Tatim Taksave Vendore. Rezulton se Bashkia Krujë nuk ka të identifikuar numrin e familjeve që paguajnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe si rrjedhojë nuk ka identifikuar numrin e familjeve debitore, si dhe nuk u paraqitën dokumente analitike për këto debitorë. Në total vlera progresive e detyrimit të paraqitur nga Bashkia Krujë e familjeve debitore është 84,024,149 lekë.
Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Tatim Taksave, vlera totale borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Krujë paraqitet:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 84,024,149 lekë;
2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë 63,639,060 lekë; dhe
3. Biznese Debitore në vlerë 530,511,820 lekë;

Në Total Borxhi tatimor në Bashkinë Krujë rezulton në vlerë 678,175,029 lekë.
*Nga auditimi u konstatua se,*në fund të vitit 2021 borxhi tatimor është në vlerën **678,175,029 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.**
*Gjithashtu u konstatua se,*Bashkia Krujë nuk ka të dhëna për numrin e familjeve debitore për periudhën objekt auditimi si dhe nuk ka dokumente analitike ku të jenë paraqitur zërat sipas taksave dhe tarifave dhe numrit të familjeve për taksat dhe tarifat familjare.

Efekti i masave lehtësuese të marra ndaj bizneseve gjatë situatës së pandemisë Covid-19
Në zbatim të VKM-së 25 datë 27.04.2020 ñPër disa ndryshime në Vendimin nr. 105, datë 22.11.2019 ñPër miratimin e paketës fiskal për vitin 2020ò si rezultat i pandemisë Covid-19, Bashkia Krujë ka shtyrë afatet e pagesave të taksave dhe tarifave vendore për një periudhë 2-9 mujore, për taksën e tokës bujqësore, tarifat e bizneseve, etj., dhe VKB-së nr. 75, datë 30.09.2020 ñPër disa ndryshime në VKB nr. 93, datë 17.12.2019, mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020, ndryshuar me VKB nr. 29, datë 27.03.2020 ñPër disa ndryshime në VKB nr. 93, datë 17.12.2019ò. Përkatësisht janë falur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për 798 subjekte me efekt financiar në të ardhurat e Bashkisë Krujë në vlerën **2,215,334 lekë.**

Masat e marra për uljen e borxhit

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.[9]

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore me shkresën nr. 270-270/87, nr. 271-271/34, nr. 272-272/27, nr. 273-273/16 datë 02.07.2021 dhe shkresën nr. 275-275/71 datë 07.07.2021 , por pas mbarimit të afatit ligjor të këtij njoftimi, nuk ka vazhduar procedurat e mëtejshme për bllokimin e llogarive bankare të subjekteve debitore.

Nga auditimit u konstatua se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2020-2021, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë.

Titulli i gjetjes 12: *Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Krujë dhe masat e marra për uljen e tij.*

Situata: Rezulton se Bashkia Krujë fund të vitit 2021 të jenë 2251 subjekte debitorë në vlerën 530,511,820 lekë dhe vlera e taksës në infrastrukturë e parketuar në shumën 63,639,060 lekë. Gjithashtu, nuk ka të identifikuar numrin e familjeve që paguajnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore dhe si rrjedhojë nuk ka identifikuar numrin e familjeve debitore, si dhe nuk u paraqitën dokumente analitike për këto debitorë. Në total vlera progresive e detyrimit të paraqitur nga Bashkia Krujë e familjeve debitore është 84,024,149 lekë. Duke sjellë që borxhi tatimor i Bashkisë Krujë të jetë 678,175,029 lekë në fund të vitit 2021.

Kriteri: Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga debitorët.

Rëndësia:E lartë

Rekomandim 1: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **678,175,029 lekë** nga taksapaguesit privat dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatës për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitorë. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgojë listën e subjekteve debitorë të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë së Financës.

Rekomandim 2: Bashkia Krujë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masat të ngrejë një grup pune për të identifikuar të gjithë familjarët që paguajnë detyrimet e bashkisë lidhur me taksat dhe tarifat familjare.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Në territorin e Bashkisë Krujë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 35 subjekte. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në

[9]Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 89, 90, 91, 93.

zbatim të legjislacionit në fuqi[10] dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për vitet 2020-2021.

Sa më sipër Bashkia Krujë, ka paraqitur observacion me shkresën nr.3609/1, datë 12.07.2022 protokolluar në KLSH me nr.259/4 datë 12.07.2022, ku citohet:

Pretendimet e subjektit:

Për subjektet "V… P…", "A… G…", "S… G", "B… S…", "G… C…" dhe "I… P… A…", bashkëlidhur janë dokumentacioni vërtetues për pikat e karburanteve të cilat janë pajisur me autorizime.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për këto observacione nuk ka fakte të reja dhe këto pretendime janë të njejtat që janë dërguar në akt-konstatime, dhe për të cilat grupi i auditimit i ka sqaruar në Projekt Raportin e Auditimit.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatuan disa mungesa, përkatësisht:

1. Subjekti ñ***E… O…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 19.05.2020-19.05.2021 dhe 02.07.2021-02.07.2022. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 01.01.2020-18.05.2020 dhe 20.05.2021-01.07.2021, periudha e pambuluar me autorizim 4 muaj e 22 ditë * 16,666 = 78,874 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
2. Subjekti ***"K…"***, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 5 vjeçare për periudhën 2018 ï 2023 për të dy pikat në Bashkinë Krujë;
3. Subjekti ***"V… P…"***, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., ka tre pika karburanti në Bashkinë Krujë:
   a) si dhe është pajisur me licencë 5 vjeçare për periudhën 05.05.2015-05.05.2020 dhe 1 vjeçar për periudhën 05.01.2020-05.01.2021 për njërën nga tre pikat e karburantit në Bashkinë Krujë, por rezulton e pambuluar me licencë për periudhën 06.01.2021-31.12.2021 ose 1 vit = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
   b) për pikën e dytë të karburantit është pajisur me licencë për periudhën 05.01.2020-05.05.2021, por rezulton e pambuluar me licencë për periudhën 06.05.2021-31.12.2021 ose 6 muaj e 24 ditë * 16,666 = 113,316 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
   c) për pikën e tretë të karburantit është pajisur me licencë për periudhën 05.01.2021-05.01.2022, por rezulton e pambuluar me licencë për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 ose 1 vit = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
4. Subjekti ***"P… B…"***, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 5 vjeçare për periudhën 2020 ï 2025;
5. Subjekti ñ***K…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 25.03.2019-25.03.2020 dhe 21.05.2020-21.05.2021 dhe 25.05.2021-25.05.2022. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 26.03.2020-20.05.2020 periudha e pambuluar me autorizim 1 muaj e 15 ditë * 16,666 = 24,991 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
6. Subjekti ñ***A… G…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 01.01.2020-22.02.2021. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 01.01.2021-10.11.2021 periudha e pambuluar me

[10]Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñpër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

autorizim 10 muaj e 22 ditë * 16,666 = 178,870 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;

7. Subjekti ñ***K… D…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 16.12.2021-16.12.2022. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 dhe 01.01.2021-15.12.2021 periudha e pambuluar me autorizim 1 vit 11 muaj e 15 ditë * 16,666 = 391,643 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
8. Subjekti ñ***K…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për periudhën 2020-2021 periudhë e pambuluar me autorizim për 2 vite për të dy pikat e karburantit = 800,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
9. Subjekti ñ***I…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 02.10.2019-02.10.2020 dhe 02.07.2021-02.07.2022. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 03.10.2020-31.12.2020 dhe 01.01.2021-01.07.2021 periudha e pambuluar me autorizim 8 muaj e 28 ditë * 16,666 = 148,868 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
10. Subjekti ñ***B… O…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 25.11.2019-25.11.2020 dhe 13.12.2020-13.12.2021. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 25.12.2020-13.12.2020 periudha e pambuluar me autorizim 19 ditë * 555 = 10,545 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
11. Subjekti ñ***S… G***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., ka tre pika karburanti në Bashkinë Krujë:
    a) Ka autorizim për periudhën 28.04.2015-28.04.2020 por nuk është pajisur me licencë nga Bashkia Krujë për një periudhë të pacaktuar në vazhdimësi, ky subjekt ka paguar në datë 25.05.2021 vlerën 200,000 lekë. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 01.05.2020-24.05.2021 periudha e pambuluar me autorizim 1 vit e 1 muaj * 16,666 = 216,658 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë për njërën pikë karburanti;
    b) dhe për pikën e dytë dhe të tretë ky subjekt nuk është pajisur me licencë për të dy vitet objekt auditimi dhe sjell të ardhura të munguara në Bashkinë për vlerën 800,000 lekë;
12. Subjekti ñ***M… O…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 04.02.2021-04.02.2022. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 01.01.2020-04.02.2021 periudha e pambuluar me autorizim 1 vit e 1 muaj * 16,666 = 216,658 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
13. Subjekti ñ***B… S…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 14.03.2020-14.03.2021 dhe 16.03.2021-16.03.2022. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 01-01.2020-13.03.2020 periudha e pambuluar me autorizim 2 muaj e 14 ditë * 16,666 = 41,102 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
14. Subjekti ñ***G… C…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 01.01.2020-18.11.2020 dhe 19.11.2020-19.11.2021. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 20.11.2021-31.12.2021, pra 1 muaj e 11 ditë * 16,666 = 22,771 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
15. Subjekti ñ***V…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për periudhën 2020-2021 periudhë e pambuluar me autorizim për 24 muaj = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
16. Subjekti ñ***I… P… A…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 10.12.2020-10.12.2021. Rezulton mangësi pajisje

me licencë për 28 ditë * 555 = 15,540 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;

17. Subjekti ñ***E… O…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për periudhën 2020-2021 periudhë e pambuluar me autorizim për 24 muaj = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
18. Subjekti ñ***G. E. P.***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për periudhën 2020-2021 periudhë e pambuluar me autorizim për 24 muaj = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
19. Subjekti ñ***A… ShPK***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 01.01.2020-19.05.2020 dhe 19.05.2021-02.07.2021. Rezulton mangësi pajisje me licencë për 4 muaj e 14 ditë * 16,666 = 74,434 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
20. Subjekti ñ***K… 02***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 01.01.2021-13.12.2021. Rezulton mangësi pajisje me licencë 1 vit * 16,666 = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
21. Subjekti ñ***S… A…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për periudhën 2020-2021 periudhë e pambuluar me autorizim për 24 muaj = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
22. Subjekti ñ***E…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për periudhën 2020-2021 periudhë e pambuluar me autorizim për 24 muaj = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
23. Subjekti ñ***D… O…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., për dy pika karburanti si dhe është pajisur me licencë nga data 27.02.2019-27.02.2021 për të dy pikat e karburantit. Rezulton mangësi pajisje me licencë për 10 muaj * 16,666 = 166,660 * 2 pika = 333,320 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
24. Subjekti ***"V… T…"***, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë 5 vjeçare për periudhën 2018 ï 2023;
25. Subjekti ñ***A… 2…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për periudhën 2020-2021 periudhë e pambuluar me autorizim për 24 muaj = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
26. Subjekti ñ***G…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 16.07.2020-16.07.2021. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 01.01.2020-15.07.2020 dhe 17.07.2021-31.12.202, pra 1 vit = 200,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
27. Subjekti ñ***M… O…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe nuk është pajisur me licencë për periudhën 2020-2021 periudhë e pambuluar me autorizim për 24 muaj = 400,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë;
28. Subjekti ñ***E… O…***ò, ka ushtruar aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, etj., si dhe është pajisur me licencë nga data 01.07.2019-01.07.2020 dhe 21.08.2020-21.08.2021. Rezulton mangësi pajisje me licencë për periudhën 01.07.2020-20.08.2020 dhe 22.08.2021-31.12.2021, pra 5 muaj e 28 ditë *16,666 = 98,870 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë

Nga auditimi u konstatua se, nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 28 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 35 pika karburanti), nga të cilat 3 subjekte për 4 pika karburanti janë të autorizuar dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore dhe 31 janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale **7,166,460lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë.**

*Gjithashtu u konstatua se,*referuar dokumentacionit Bashkia ka hartuar shkresa për njoftim me licencë subjekteve, dhe nga të dhënat në shqyrtimin e dosjeve përkatëse të subjekteve,

rezulton se ka hapësirë në kohë nga përfundimi i afatit të pajisjes me autorizim deri në pajisjen me autorizim të ri për ushtrimin e aktivitetit. Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatuan disa mungesa të dokumenteve në dosje si:

- Mungonin pjesërisht autorizimet nga Bashkia Krujë për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesës së detyrimit ligjor për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesave të detyrimeve tatimore vjetore.

Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte sipas dokumentacionit që bashkia disponon dhe janë të pa pajisur me autorizim, bie në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjinnr. 8450, datë 24.2.1999, ñPër përpunimin,transportimin dhe tregtimin e naftës,gazit dhe nënprodukteve të tyreò, tëndryshuar, neni 4 ñ *Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*ò. Neni 20- Autorizimet pika 2. ñ*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11*[11]*, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*ò.

Titulli i gjetjes 13:*Ushtrimi i aktivitetit në shkelje të dispozitave ligjore nga subjektet që tregtojnë lëndëve djegëse.*

Situata: Rezultojnë 28 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë (në 35 pika karburanti), nga të cilat 3 subjekte për 4 pika karburanti janë të autorizuar dhe kanë paguar detyrimet sipas kërkesave ligjore dhe 31 janë pa autorizim për periudha të ndryshme me një efekt financiar me vlerë totale 7,166,460 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatuan disa mungesa, përkatësisht:

- Mungonin pjesërisht autorizimet nga Bashkia Krujë për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesës së detyrimit ligjor për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesave të detyrimeve tatimore vjetore.

Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte sipas dokumentacionit që bashkia disponon dhe janë të pa pajisur me autorizim.

Kriteri: Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjinnr. 8450, datë 24.2.1999, ñpër përpunimin,transportimin dhe tregtimin e naftës,gazit dhe nënprodukteve të tyreò, tëndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2, pika 11.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Puna jo efektive e drejtuesit dhe specialistëve të Drejtorisë së Tatim Taksave Vendore në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim edhe pse janë njoftuar nga DTTV.

Rëndësia:E lartë

[11]Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorëò.

Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **7,166,460lekë** ndaj Bashkisë Krujë.

Asetet e dhëna me qira

Dhënia e aseteve të bashkisë me qira bëhet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, ñPër Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar;
- VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò.

Bashkia Krujë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi[12] për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 1 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Kjo kontrata është lidhur bazuar në legjislacionin përkatës.

Nga auditimi i pagesave të kontratës nr. 8121 Prot., datë 23.12.2019, me subjektin M. S. me aktivitet noteri, lidhur për një sipërfaqe prej 38 m^2, për vlerën 68,400 lekë, që nuk e ka paguar detyrimin për vlerën totale të detyrimit.

*Nga auditimi u konstatua se,*qiramarrësi M. S. nuk ka paguar detyrimet e kontratës së qirasë në vlerë 68,400 lekë. Detyrimi që subjekti ka ndaj Bashkisë Krujë për vitin 2020 në vlerën totale **68,400 lekë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.**

Titulli i gjetjes 14:*Të ardhura të munguara nga mos pagesa e kontratave të qirasë së aseteve.*

Situata: Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Krujë rezulton se, nga pagesa e kontratës së qirasë qiramarrësi M. S. nuk ka paguar detyrimet e kontratës për vlerën 68,400 lekë.

Kriteri: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, Ligji nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë nga mos arkëtimi i detyrimeve nga dhënia me qira e aseteve.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Krujë nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirasë nga subjektet qiramarrëse.

Rëndësia:E mesme

Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve të marrë masat që subjekti ñM. S.ò të paguajnë detyrimin për vlerën 68,400 lekë dhe të ndiqen më përpikmërikushteve të kontratave se qirasë.

Zbatimi i akt marrëveshjeve

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, DTTV Bashkia Krujë ka lidhur marrëveshje për pagesën me

[12] Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, ñPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò.

këste të detyrimeve të prapambetura me disa subjekte debitore të vitit 2020 që sqarohen më të detajuara në vijim.

- Akt marrëveshja me subjektin A. S. është lidhur më datë 20.01.2020, për një periudhë një vjeçare nga 20.01.2020-20.12.2020 për vlerën 113,000 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 46,000 lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshje për vlerën 67,000 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin K. Gj. është lidhur më datë 04.02.2020, për një periudhë nga 04.02.2020-04.01.2021 për vlerën 55,873 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 20,000 lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 35,873 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin S. D. është lidhur më datë 10.02.2020, për një periudhë nga 10.02.2020-10.12.2020 për vlerën 80,760 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 37,000 lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 43,760 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Lé ShPK është lidhur më datë 12.02.2020, për një periudhë nga 12.02.2020-12.06.2021 për vlerën 4,112,638 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Eé Oé Cé është lidhur më datë 20.02.2020, për një periudhë nga 20.02.2020-20.06.2020 për vlerën 328,167 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 243,375lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 84,792 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Vé Xhé është lidhur më datë 19.02.2020, për një periudhë nga 19.02.2020-30.06.2021 për vlerën 2,190,983 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 650,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 1,540,983 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Aé ShPK është lidhur më datë 06.03.2020, për një periudhë nga 06.03.2020-06.12.2021 për vlerën 694,450 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Fé Xhé është lidhur më datë 04.05.2020, për një periudhë nga 04.05.2020-04.05.2021 për vlerën 116,031 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Qé 2 është lidhur më datë 14.05.2020, për një periudhë nga 14.05.2020-14.12.2020 për vlerën 416,184 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 389,184lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 27,000 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Fé Sé është lidhur më datë 08.06.2020, për një periudhë nga 08.06.2020-10.12.2020 për vlerën 443,234 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Xhé Té është lidhur më datë 16.06.2020, për një periudhë nga 16.06.2020-16.02.2021 për vlerën 224,619 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 90,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 134,619 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Sé Ié është lidhur më datë 29.06.2020, për një periudhë nga 29.06.2020-19.03.2021 për vlerën 549,436 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 499,946lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 49,490 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Té Té Gé është lidhur më datë 01.07.2020, për një periudhë nga 01.07.2020-12.12.2020 për vlerën 294,930 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Çé Aé Ié është lidhur më datë 09.07.2020, për një periudhë nga 09.07.2020-12.12.2021 për vlerën 1,843,614 lekë, rezulton se ka paguar

vlerën 1,473,614lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 370,000 lekë;

- Akt marrëveshja me subjektin Aé ShPK është lidhur më datë 03.07.2020, për një periudhë nga 03.07.2020-12.12.2020 për vlerën 679,732 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Ké Dé është lidhur më datë 01.09.2020, për një periudhë nga 01.09.2020-12.12.2021 për vlerën 626,707 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 200,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 426,707 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Zé Gé është lidhur më datë 14.08.2020, për një periudhë nga 14.08.2020-12.12.2020 për vlerën 716,668 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 629,400lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 87,268 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Ré & Cé është lidhur më datë 02.10.2020, për një periudhë nga 02.10.2020-12.12.2020 për vlerën 58,323 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Aé Çé është lidhur më datë 19.10.2020, për një periudhë nga 19.10.2020-31.01.2021 për vlerën 384,320 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 110,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 274,320 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Bé Sé është lidhur më datë 30.10.2020, për një periudhë nga 30.10.2020-30.02.2021 për vlerën 75,221 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Aé Vé është lidhur më datë 18.11.2020, për një periudhë nga 18.11.2020-18.04.2021 për vlerën 421,851 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Aé Lé është lidhur më datë 17.12.2020, për një periudhë nga 17.12.2020-12.12.2021 për vlerën 1,776,687 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Hé është lidhur më datë 23.12.2020, për një periudhë nga 23.12.2020-23.09.2021 për vlerën 704,254 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 616,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 88,254 lekë.

Tabela nr.23: Akt marrëveshjet e lidhura për vitin 2020

lekë

Nr.	Akt-marrëveshja	Subjekti	Detyrimi	Shuma e paguar	Shuma e mbetur
1.	20.01.2020-20.12.2020	Aé Sé	113,000	46,000	67,000
2.	04.02.2020-04.01.2021	Ké Gjé	55,873	20,000	35,873
3.	10.02.2020-10.12.2020	Sé Dé	80,760	37,000	43,760
4.	12.02.2020-12.06.2021	Lé Shpk	4,112,638	4,112,638	0
5.	20.02.2020-20.06.2020	Eé Oé Cé	328,167	243,375	84,792
6.	19.02.2020-30.06.2021	Vé Xhé	2,190,983	650,000	1,540,983
7.	06.03.2020-06.12.2021	Aé ShPK	694,450	694,450	0
8.	04.05.2020-04.05.2021	Fé Xhé	116,031	116,031	0
9.	14.05.2020-14.12.2020	Qé 2	416,184	389,184	27,000
10.	08.06.2020-10.12.2020	Fé Sé	443,234	443,234	0
11.	16.06.2020-16.02.2021	Xhé Té	224,619	90,000	134,619
12.	29.06.2020-19.03.2021	Sé Ié	549,436	499,946	49,490
13.	01.07.2020-12.12.2020	Té Té Gé	294,930	294,930	0

14.	09.07.2020-12.12.2021	Çé Aé Ié	1,843,614	1,473,614	370,000
15.	03.07.2020-12.12.2020	Aé ShPK	679,732	679,732	0
16.	01.09.2020-12.12.2021	Ké Dé	626,707	200,000	426,707
17.	14.08.2020-12.12.2020	Zé Gé	716,668	629,400	87,268
18.	02.10.2020-12.12.2020	Ré & Cé	58,323	58,323	0
19.	19.10.2020-31.01.2021	Aé Çé	384,320	110,000	274,320
20.	30.10.2020-30.02.2021	Bé Sé	75,221	75,221	0
21.	18.11.2020-18.04.2021	Aé Vé	421,851	421,851	0
22.	17.12.2020-12.12.2021	Aé Lé	1,776,687	1,776,687	0
23.	23.12.2020-23.09.2021	Hé	704,254	616,000	88,254

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

- Akt marrëveshja me subjektin Gé Aé është lidhur më datë 08.02.2021, për një periudhë nga 08.02.2021-12.12.2021 për vlerën 354.111 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 282,820lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 71,291 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Ké Sé është lidhur më datë 12.02.2021, për një periudhë nga 12.02.2021-12.12.2021 për vlerën 253,504 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 111,500lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 142,004 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Xhé Lé është lidhur më datë 16.02.2021, për një periudhë nga 16.02.2021-12.12.2021 për vlerën 54,038 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Vé Ké është lidhur më datë 22.02.2021, për një periudhë nga 22.02.2021-30.06.2021 për vlerën 189,780 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Hé Ké është lidhur më datë 10.05.2021, për një periudhë nga 10.05.2021-10.10.2021 për vlerën 31,000 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Né Hé është lidhur më datë 25.05.2021, për një periudhë nga 25.05.2021-10.12.2021 për vlerën 440,038 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Vé Xhé është lidhur më datë 04.06.2021, për një periudhë nga 04.06.2021-10.12.2021 për vlerën 110,415 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 85,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 25,415 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Gé Té është lidhur më datë 07.06.2021, për një periudhë nga 07.06.2021-10.12.2021 për vlerën 471,560 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Mé Ké është lidhur më datë 10.06.2021, për një periudhë nga 10.06.2021-10.12.2021 për vlerën 382,845 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 295,340lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 87,505 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Ré ShPK është lidhur më datë 22.06.2021, për një periudhë nga 22.06.2021-10.12.2021 për vlerën 379,883 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 284,883lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 95,000 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Eé Ié është lidhur më datë 23.06.2021, për një periudhë nga 23.06.2021-10.12.2021 për vlerën 1,874,553 lekë, rezulton se ka paguar vlerën

1,194,553lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 680,000 lekë;

- Akt marrëveshja me subjektin Ié është lidhur më datë 24.06.2021, për një periudhë nga 24.06.2021-12.12.2021 për vlerën 427,956 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Sé Té është lidhur më datë 01.07.2021, për një periudhë nga 01.07.2021-01.07.2022 për vlerën 232,923 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 107,804lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 125,119 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Ké T... është lidhur më datë 01.07.2021, për një periudhë nga 01.07.2021-27.09.2021 për vlerën 669,777 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Lé ShPK është lidhur më datë 05.07.2021, për një periudhë nga 05.07.2021-05.06.2022 për vlerën 848,372 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 634,186lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 214,186 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Qé 2 është lidhur më datë 07.07.2021, për një periudhë nga 07.07.2021-10.12.2021 për vlerën 682,503 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 482,503 lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 200,000 lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Gé Dé është lidhur më datë 09.07.2021, për një periudhë nga 09.07.2021-10.12.2021 për vlerën 536,105 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Ké Ké është lidhur më datë 09.07.2021, për një periudhë nga 09.07.2021-30.06.2022 për vlerën 494,586 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 335,758lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 158,828lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Lé Pé është lidhur më datë 14.07.2021, për një periudhë nga 14.07.2021-14.07.2022 për vlerën 606,213 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 174,700lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 431,513lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Vé Ké është lidhur më datë 14.07.2021, për një periudhë nga 14.07.2021-14.12.2021 për vlerën 75,000 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Né ShPK është lidhur më datë 15.07.2021, për një periudhë nga 15.07.2021-15.04.2022 për vlerën 1,196,857 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Cé Té është lidhur më datë 16.07.2021, për një periudhë nga 16.07.2021-30.06.2022 për vlerën 940,752 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 600,000lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 340,752lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Hé Cé është lidhur më datë 19.07.2021, për një periudhë nga 19.07.2021-10.12.2022 për vlerën 347,065 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 130,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 217,065lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Jé Cé është lidhur më datë 19.07.2021, për një periudhë nga 19.07.2021-10.12.2022 për vlerën 702,745 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 260,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 442,745lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Eé Gé është lidhur më datë 19.07.2021, për një periudhë nga 19.07.2021-10.12.2022 për vlerën 428,049 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 191,450lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 236,599lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Aé Cé është lidhur më datë 21.07.2021, për një periudhë nga 21.07.2021-30.06.2022 për vlerën 140,039 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 95,000lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 45,039lekë;

- Akt marrëveshja me subjektin Pé Pé është lidhur më datë 21.07.2021, për një periudhë nga 21.07.2021-10.12.2022 për vlerën 635,051 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 300,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 335,051lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Ké 2é është lidhur më datë 23.07.2021, për një periudhë nga 23.07.2021-30.06.2022 për vlerën 1,498,647 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 950,000lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 548,647lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Té Té Gé është lidhur më datë 27.07.2021, për një periudhë nga 27.07.2021-12.12.2021 për vlerën 70,805 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 60,000lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 10,805lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Mé ShPK është lidhur më datë 01.04.2021, për një periudhë nga 01.04.2021-30.07.2022 për vlerën 2,113,058 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 521,055lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 1,592,003lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Lé Mé është lidhur më datë 31.08.2021, për një periudhë nga 31.08.2021-12.12.2021 për vlerën 55,588 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 24,918 lekë dhe nuk ka paguar këstet sipas kushteve të akt marrëveshjes për vlerën 30,670lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Aé Lé është lidhur më datë 23.09.2021, për një periudhë nga 23.09.2021-30.03.2022 për vlerën 598,224 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 384,527 lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 213,697lekë;
- Akt marrëveshja me subjektin Zé Gé është lidhur më datë 28.09.2021, për një periudhë nga 28.09.2021-10.12.2021 për vlerën 588,998 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Sé Zé është lidhur më datë 12.10.2021, për një periudhë nga 12.10.2021-12.03.2022 për vlerën 85,000 lekë, rezulton se ka paguar të gjithë vlerën sipas kushteve të akt marrëveshjes;
- Akt marrëveshja me subjektin Ké ShPK është lidhur më datë 21.10.2021, për një periudhë nga 21.10.2021-10.12.2023 për vlerën 843,222 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 220,000 lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 623,222lekë, si dhe afati i aktmarrëveshjes është lidhur për një periudhë prej 27 muaj;
- Akt marrëveshja me subjektin Eé Mé është lidhur më datë 27.10.2021, për një periudhë nga 27.10.2021-10.12.2022 për vlerën 83,003 lekë, rezulton se ka paguar vlerën 21,000 lekë dhe mbetet për të paguar për vlerën 62,003lekë.

Tabela nr.24: Akt marrëveshjet e lidhura për vitin 2021

lekë

Nr.	Akt-marrëveshja	Subjekti	Detyrimi	Shuma e paguar	Shuma e mbetur
1.	08.02.2021-12.12.2021	Gé Aé	354,111	282,820	71,291
2.	12.02.2021-12.12.2021	Ké Sé	253,504	111,500	142,004
3.	16.02.2021-12.12.2021	Xhé Lé	54,038	54,038	0
4.	22.02.2021-30.06.2021	Vé Ké	189,780	189,780	0
5.	10.05.2021-10.10.2021	Hé Ké	31,000	31,000	0
6.	25.05.2021-10.12.2021	Né Hé	440,038	440,038	0
7.	04.06.2021-10.12.2021	Vé Xhé	110,415	85,000	25,415
8.	07.06.2021-10.12.2021	Gé Té	471,560	471,560	0
9.	10.06.2021-10.12.2021	Mé Ké	382,845	295,340	87,505
10.	22.06.2021-10.12.2021	Ré Shpk	379,883	284,883	95,000
11.	23.06.2021-10.12.2021	Eé Ié	1,874,553	1,194,553	680,000

12.	24.06.2021-12.12.2021	Ié	427,956	427,956	0
13.	01.07.2021-01.07.2022	Sé Té	232,923	107,804	125,119
14.	01.07.2021-27.09.2021	Ké Té	669,777	669,777	0
15.	05.07.2021-05.06.2022	Lé Shpk	848,372	634,186	214,186
16.	07.07.2021-10.12.2021	Qé 2	682,503	482,503	200,000
17.	09.07.2021-10.12.2021	Gé Dé	536,105	536,105	0
18.	09.07.2021-30.06.2022	Ké Ké	494,586	335,758	158,828
19.	14.07.2021-14.07.2022	Lé Pé	606,213	174,700	431,513
20.	14.07.2021-14.12.2021	Vé Ké	75,000	75,000	0
21.	15.07.2021-15.04.2022	Né Shpk	1,196,857	1,196,857	0
22.	16.07.2021-30.06.2022	Cé Té	940,752	600,000	340,752
23.	19.07.2021-10.12.2022	Hé Cé	347,065	130,000	217,065
24.	19.07.2021-10.12.2022	Jé Cé	702,745	260,000	442,745
25.	19.07.2021-10.12.2021	Eé Gé	428,049	191,450	236,599
26.	21.07.2021-30.06.2022	Aé Cé	140,039	95,000	45,039
27.	21.07.2021-21.12.2021	Pé Pé Ké	635,051	300,000	335,051
28.	23.07.2021-30.06.2022	Ké 2013	1,498,647	950,000	548,647
29.	27.07.2021-12.12.2021	Té Té Gé	70,805	60,000	10,805
30.	01.04.2021-30.07.2022	Mé	2,113,058	521,055	1,592,003
31.	31.08.2021-12.12.2021	Lé Mé	55,588	24,918	30,670
32.	23.09.2021-30.03.2022	Aé Lé	598,224	384,527	213,697
33.	28.09.2021-10.12.2021	Zé Gé	588,998	588,998	0
34.	12.10.2021-12.03.2022	Sé Sé	85,000	85,000	0
35.	21.10.2021-10.12.2023	Ké Shpk	843,222	220,000	623,222
36.	27.10.2021-10.12.2022	Eé Mé	83,003	21,000	62,003

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

*Nga auditimi u konstatua se,*Bashkia Krujë ka lidhur:

- 23 akt marrëveshje për të ndihmuar subjektet debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2020;
- 36 akt marrëveshje për të ndihmuar subjektet debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2021.

Për vitin 2020 rezulton se 10 prej tyre i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa 13 subjektet e tjera nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa për vitin 2021, 22 subjekte dhe familje debitore i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes dhe nuk i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes 14 prej tyre.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se ka mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht;

- Të gjitha akt marrëveshjet janë të pa protokolluara;
- Në njërin rast rezulton se, afati i aktmarrëveshjes është lidhur për një periudhë prej 27 muaj[13];
- Pjesërisht nuk kanë kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë më marrëveshje për pagesë me këste[14];

[13]Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, pika 4, Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, pika 77.4 (marrëveshja e pagesës me këste nuk mund të zgjasë më tepër se fundi i vitit kalendarik pasardhës, pas momentit të hartimit të marrëveshjes)

[14]Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, pika 2 ñTatimpaguesi paraqet një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagese me këste. Kërkesa duhet t'i drejtohet drejtorit të drejtorisë rajonale apo drejtuesit të njësive të ngjashme me të dhe duhet të parashtrojë arsyet, që e pengojnë tatimpaguesin për të paguar detyrimet tatimoreò.

- Në asnjë rast nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste[15].

Titulli i gjetjes 15:*Mos hartim i akt marrëveshjeve për pagesën e detyrimeve tatimore ndaj bashkisë në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.*

Situata: Bashkia Krujë ka lidhur:

- 23 akt marrëveshje për të ndihmuar subjektet debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2020;
- 36 akt marrëveshje për të ndihmuar subjektet debitore në likuidimin e detyrimeve me këste për vitin 2021.

Për vitin 2020 rezulton se 10 prej tyre i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa 13 subjektet e tjera nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes, ndërsa për vitin 2021, 22 subjekte dhe familje debitore i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes dhe nuk i kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes 14 prej tyre.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe i akt marrëveshjeve për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se ka mangësi nga ana e DTTV në lidhjen e marrëveshjeve për pagesat me këste, përkatësisht;

- Të gjithë akt marrëveshjet janë të pa protokolluara;
- Në njërin rast rezulton se, afati i aktmarrëveshjes është lidhur për një periudhë prej 27 muaj;
- Pjesërisht nuk kanë kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë më marrëveshje për pagesë me këste;

Në asnjë rast nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, pika 2, 3, 4, 5.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Shkaku: Akt marrëveshjet janë hartuar në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor.

Rëndësia:E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujëgjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë të marrë masat që këto akt marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare si dhe të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. *Zj. L. T., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave*
2. *Z. E. S., me detyrë Drejtor i Planifikimit Zhvillimit të Territorit*
3. *Z. Xh. Xh., me detyrë Administrator i Nj.A. Fushë Krujës*
4. *Zj. G. M., me detyrë Administrator i Nj.A. Thumanë për periudhën nga 01.01.2020*
5. *Zj. Sh. Ç., me detyrë Administrator i Nj.A. Thumanë për periudhën nga 02.08.2021*
6. *Z. B. D., me detyrë Administrator i Nj.A. Nikël*
7. *Z. A. K., me detyrë Administrator i Nj.A. Bubq*
8. *Z. F. A., me detyrë Administrator i Nj.A. Cudhi*

Mbi zbatimin e kritereve të vlerësimit në menaxhimin dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për rikuperimin e pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019.

[15]Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 77, pika 5 ñAdministrata tatimore mund ta refuzojë kërkesën për një marrëveshje pagese me këste ose të kërkojë garanci bankare, para se të hyjë në një marrëveshje të tillëò, ligji nr. 112/2016, neni 30 ñ.....në të njëjtën kohë tatimpaguesi duhet të vërtetojë që është në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, si dhe të tregojë që pavarësisht nga rrethana financiare, ai është në gjendje të përmbushë marrëveshjenò.

Titullari i Bashkisë Krujë ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 756, datë 26.11.2019 ñPër përballimin e situata emergjente të krijuar nga lëkundjet e tërmetit të datës 25.11.2019ò, dalë në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, ñPër dokumentacionin e nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi natyroreò. Nëpërmjet këtij urdhri në Bashkinë Krujë dhe në Njësitë Administrative janë ngritur Shtabet e Emergjencave Civile për të ndjekur situatën e krijuar nga tërmeti.

Në Bashkinë Krujë shtabi është me përbërje:

I. L. ï Kryetar;	L. T. ï Anëtare;
F. C. ï Anëtar;	M. D. ï Anëtar;
E. M. ï Anëtar;	A. H. ï Anëtare;
R. B. ï Anëtar;	H. Z. ï Anëtar;
E. S. ï Anëtar;	A. K. ï Anëtar;
R. D. ï Anëtar;	Administratorët e NJA

1. Mbi aplikimin dhe hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik dhe në aplikacionin "Shtëpia ime"

Në Bashkinë Krujë kanë operuar 23 ekipe të specializuara me nga 3 anëtarë për kryerjen e konstatimeve në terren lidhur me dëmet e shkaktuara nga tërmeti. Këto ekipe kanë konstatuar rreth 100 objekte me kate si dhe rreth 3000 banesa individuale të kategorizuara me nivel dëmi nga DS1 deri ne DS5. Grupet e inspektimit në kryerjen e verifikimeve në terren kanë përdorur platformën *datech* e lidhur me gps me anë të së cilës bëhej identifikimi i menjëhershëm i vendodhjes së banesave duke ulur mundësitë e një vlerësimi fiktiv në distancë. Në përfundim të verifikimeve ekipet kanë mbajtur akt konstatimet elektronike dhe në format të printuar. Pas përfundimit të vlerësimit qytetarit i bëhej e ditur niveli i dëmit dhe njoftohej që të drejtohej në sportelet e bashkisë për të aplikuar në sistemin e rindërtimit "Shtëpia ime". Ky sistem elektronik është miratuar me VKB nr. 14 datë 05.02.2020 ñPër miratimin e platformës online (sistemit elektronik) për regjistrimin dhe përpunimin e aplikimeve për përfitimin nga programet e rindërtimitò. Bashkia Krujë në zbatim të përcaktimeve të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, Kreu II, pika 13, ñ*Njësitë e vetëqeverisjes vendore regjistrojnë aplikimet në një sistem elektronik, i cili jep mundësinë e përpunimit të të dhënave...",* ka kryer regjistrimin e kërkesave (aplikimeve) në sistemin elektronik ñShtëpia imeò referuar edhe të dhënave të hedhura në platformën *datech*.

Nga verifikimet e kryera nga grupi i auditimit rezultoi se është bërë regjistrimi i të gjithë aplikantëve në sistem duke plotësuar modulet e aplikacionit me sa më shumë të dhëna të mundshme. Fushat që janë plotësuar me të dhëna janë:

Numrin e aplikimit dhe datën;

Të dhëna mbi aplikantët (emrin, mbiemrin, adresën);

Përbërjen familjare në momentin e aplikimit*;*

Të dhëna mbi dokumentacionin që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar;

Të dhënat e llogarisë bankare të kërkuesit;

Akt ekspertizë e thelluar mbi pasurinë e dëmtuar ose Akti i konstatimit.

Ndërsa u konstatua se nuk është plotësuar fusha ñ*objekti i kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për të përfituar nga programi i grantit të rindërtimit".*

2. Mbi aplikimin e sistemit të pikëzimit

Në zbatim të përcaktimeve të VKM nr. 904, datë 24.12.2019 ñPër përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimitò, pika

11, germa a) dhe VKM nr. 5, datë 06.01.2020, pika 17, Këshilli Bashkiak Krujë ka miratuar me VKB nr. 13 datë 05.02.2020 sistemin e pikëzimit për aplikimet për përfitimin nga programet e rindërtimit si vijon:

Tabela nr. 25: Kriteret e pikëzimit

Nr.	Kriteret e Pikëzimit	Pikët
I	**Kushtet e strehimit**	**25**
1	Individët/familjet të cilët aktualisht banojnë në çadër	15
2	Individët/familjet të cilët aktualisht banojnë në kontenjer	4
3	Individët/familjet të cilët aktualisht banojnë me qira, përfituar nga bonusi i qirasë, pjesë e programit të rindërtimit	6
II	**Kushtet familjare**	**40**
1	Familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore	12
2	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna	6
3	Familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara	10
4	Familjet me më shumë se tre fëmijë	5
5	Të moshuarit, të cilët kanë mbushur moshën e pensionit	7
III	**Kushtet sociale**	**35**
1	Individ që ka Statusin e Jetimit	10
2	Familjet e punonjësve të rënë në detyrë	5
3	Familjet në skemën e Ndihmës Ekonomike	15
4	Familje/Individë të Komunitet Rom/Egjiptian	5

Referuar sistemit të pikëzimit të mësipërm, të miratuar nga Bashkia Krujë me VKB, rezulton se është krijuar një sistem pikëzimi me 12 kritere përparësie dhe 7 nivele pikësh që varion nga 15 pikë deri në 5 pikë (15-12-10-7-6-5-4). Në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, pika 17, janë parashikuar 6 kritere përparësie për renditjen e fituesve si më poshtë vijon:

a) Familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;
b) Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
c) Familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara;
ç) Të moshuarit, të cilët kanë mbushur moshën e pensionit;
d) Familjet në skemën e ndihmës ekonomike;
dh) Të rënët në krye të detyrës.

Kriteret e përparësisë të shtuara nga Bashkia Krujë janë:

Individët/familjet të cilët aktualisht banojnë në çadër;
Individ që ka statusin e jetimit;
Individët/familjet të cilët aktualisht banojnë me qira, përfituar nga bonusi i qirasë, pjesë e programit të rindërtimit;
Familjet me më shumë se tre fëmijë;
Individët/familjet të cilët aktualisht banojnë në kontenjer;
Familje/Individë të komunitet Rom/Egjiptian;

Konstatohet se nuk është ndjekur radha e kritereve të përparësisë të përcaktuara në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, pika 17, për renditjen e përfituesve. Ndryshimi në sistemin e pikëzimit i bërë nga strukturat e Bashkisë Krujë është bazuar në Manualin e Procedurave për Përfitimin nga Programet e Rindërtimit i hartuar nga Bashkia Tiranë. Ky manual i është përcjellë Bashkisë Krujë nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin. Referuar këtij manuali, Njësitë e Qeverisjes Vendore mund të ndryshojnë sistemin e pikëzimit sipas nevojave.

Bashkia Krujë ka kryer klasifikimin e kërkesave për programet e procesit të rindërtimit të miratuar për 5 nivelet e dëmit, ku kanë rezultuar sa më poshtë:

Tabela nr.26: Niveli i dëmit dhe numri i përfituesve

Nr.	Niveli i dëmit	Nr. i përfituesve
1	DS1	853
2	DS2	958
3	DS3 (Grant)	1079
4	DS3 (Prishje)	96
5	DS4	1511
6	DS5	303
		4800

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstatoi që Bashkia Krujë nuk ka dokumentacion që të argumentojë/vërtetojë se i është referuar sistemit të pikëzimit gjatë procesit të klasifikimit të kërkesave duke mos zbatuar përcaktimet e VKM nr. 904, datë 24.12.2019 ñPër përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimitò, pika 11, *b) njësia e vetëqeverisjes vendore "klasifikon kërkesat për programet e procesit të rindërtimit, sipas sistemit të pikëzimit".*

3. Mbi rregullshmërinë e procesit për pagesën e bonusit të qirasë, për familjet banesat e të cilëve janë klasifikuar të pabanueshme për shkak të dëmtimeve

Në zbatim të përcaktimeve të Aktit Normativ nr. 8, datë 07.12.2019 ñPër përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019ò, ndryshuar me Aktin Normativ nr. 37 datë 24.12.2020, neni 2, ñ*Njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, ngarkohen: - të hartojnë listat e familjeve, banesat e të cilave janë shembur ose janë klasifikuar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit; - të vlerësojnë nivelin mesatar të qirasë për struktura të ndryshme apartamentesh; - të miratojnë, në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, listën e familjeve përfituese...*ò.

Sa më sipër, Bashkia Krujë ka hartuar listat e familjeve, banesat e të cilave janë shembur ose janë klasifikuar si të pabanueshme me akt konstatim nga Instituti i Ndërtimit të cilat janë miratuar me 33 Vendime të Këshillit Bashkiak për trajtim me bonusin e qirasë (paraqitur në mënyrë të detajuar në Aneksin nr. 5). Referuar VKB-ve rezultojnë që familjet që kanë përfituar bonusin e qirasë janë si vijon:

Tabela nr.27: Përmbledhje e përfituesve të bonusit të qirasë

	Ap. 1+1	Ap. 2+1	Ap. 3+1	Totali
Totali përfitues sipas VKB-ve	1232	1526	1436	4194
Vlera mujore e qirasë sipas strukturës së apartamentit	10,000	15,000	20,000	
Vlera totale mujore	12,320,000	22,890,000	28,720,000	63,930,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i listave të përfituesve të bonusit të qirasë vërehet se, në fillim listat janë miratuar për përfitimin e bonusit të qirasë me afat deri një vit, referuar Aktit Normativ nr. 8, datë 07.12.2019 ñPër përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019ò, neni 7 ñ*Subvencionimi i pagesës së qirasë, sipas këtij akti normativ, do të zgjasë për një periudhë deri në një vit. Pas kësaj periudhe, çdo familje përfituese duhet të sigurojë dokumentacionin shtesë sipas ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social*ò. Në vijim Akti Normativ nr. 8, datë 07.12.2019 ka ndryshuar me Aktin Normativ nr. 37 datë 24.12.2020, duke përcaktuar se afati i përfitimit të bonusit të qirasë nga familjet e prekura nga tërmeti do të zgjasë deri në momentit e rindërtimit apo rikonstruksionit të banesave, përkatësisht neni 7 ñ*Subvencionimi i pagesës së qirasë, sipas këtij akti normativ, do të zgjasë deri në momentin që familjeve u rindërtohen apo rikonstruktohen banesat, të cilat, si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, janë shembur ose janë deklaruar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit*ò. Si rezultat i këtij ndryshimi ligjor, Këshilli Bashkiak ka rimiratuar një pjesë të listave të përfituesve pas përfundimit të periudhës 1 vjeçare të përfitimit të bonusit të qirasë.

Vlera e qirasë është miratuar në masën 100% të vlerës së qirasë së tregut sipas strukturave përkatëse të apartamenteve me VKB nr. 94 datë 17.12.2019 ñPërcaktimin e pagesës së qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që kanë mbetur të pastreha nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019ò. Vlera e pagesës së qirasë miratuar me VKB është si vijon:
Qiraja për apartamente 1+1 ï 10,000 lekë;
Qiraja për apartamente 2+1 ï 15,0000 lekë;
Qiraja për apartamente 3+1 ï 20,000 lekë.
Në vijim të zbatimit të përcaktimeve të Aktit Normativ nr. 8, datë 07.12.2019, neni, 2 ñ*NJVV duhet të dërgojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën për mbështetje buxhetore për financimin ose bashkëfinancimin e subvencionit, në mënyrë elektronike dhe shkresore, së bashku me informacionin për numrin e familjeve të ngelura të pastreha, sipas klasifikimit të bërë nga Instituti i Ndërtimit*ò, Bashkia Krujë ka dërguar në MFE kërkesat për financim si vijon:
Shkresa nr. 8205 Prot, datë 27.12.2019 ku i kërkohet MFE mbështetje buxhetore për **551 familje** përfituesish të miratuara me VKB dhe për familje të tjera që janë ende në proces vlerësimi (janë regjistruar 2000 familje). Fondi i nevojshëm i kërkuar në këtë shkresë është 6,000,000 lekë për vitin 2019 dhe 360,000,000 lekë për vitin 2020.
Shkresa nr. 1742 Prot, datë 31.03.2020 i kërkohet MFE mbështetje buxhetore për **90 familje** përfituesish të miratuara me VKB në vlerën 17,220,000 lekë.
Shkresa nr. 831 Prot, datë 05.02.2021 i kërkohet MFE mbështetje buxhetore për **1864 familje** përfituesish që trajtohen me bonus qiraje të miratuara me VKB në vlerën 307,970,000 lekë. Vlera totale e kërkuar nga Bashkia Krujë është 691,190,000 lekë.
Sa më sipër MFE i ka transferuar Bashkisë Krujë fondet për pagesën e qirasë:

Tabela nr. 28: Transferimi i fondeve nga MFE për bonusin e qirasë

Shkresa e MFE	Data	Vlera e Fondit
24249/1	31.12.2019	6,000,000
22388/2	16.01.2020	36,000,000
22388/4	27.01.2020	32,400,000
5589	17.03.2020	43,927,556
6291	06.04.2020	58,782,444
7410/3	26.06.2020	70,630,000
15100/1	15.09.2020	131,340,000
7971/1	25.01.2021	30,010,000
3410	18.02.2021	76,992,500
6362/9	27.04.2021	49,620,000
6362/12	29.04.2021	49,620,000
6362/31	06.07.2021	25,130,000
13526/3	09.08.2021	25,385,000
16728/2	14.10.2021	49,600,000
6362/56	15.11.2021	38,874,897
		724,312,397

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr.29: Pagesat mujore për përfituesit e bonusit të qirasë

Viti 2019	**Vlera**	**Viti 2020**	**Vlera**	**Viti 2021**	**Vlera**
		Janar	22,735,000.00	Janar	28,445,000.00
		Shkurt	29,395,000.00	Shkurt	24,720,000.00
		Mars	30,990,000.00	Mars	24,810,000.00
		Prill	31,730,000.00	Prill	25,085,000.00
		Maj	31,760,000.00	Maj	25,130,000.00
		Qershor	32,215,000.00	Qershor	25,285,000.00
		Korrik	32,315,000.00	Korrik	25,385,000.00
		Gusht	32,010,000.00	Gusht	24,640,000.00
		Shtator	31,830,000.00	Shtator	25,045,000.00

		Tetor	26,990,000.00	Tetor	24,700,000.00
		Nëntor	27,085,000.00	Nëntor	24,805,000.00
Dhjetor	3,415,000.00	Dhjetor	23,370,000.00	Dhjetor	24,485,000.00
	3,415,000.00		**352,425,000.00**		**302,535,000.00**
658,375,000					

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve rezulton se, pagesat mujore që janë bërë nga Bashkia Krujë për bonusin e qirasë për periudhën Dhjetor 2019 - Dhjetor 2021 janë në vlerën 658,375,000 lekë. Nga verifikimi i Urdhër shpenzimeve rezultoi se, plotësimi i tyre është kryer në mënyrë të saktë, si dhe secili prej tyre ka bashkëngjitur listë pagesën (borderonë) me emrat e përfituesve nga fondet e rindërtimit. Shuma totale e urdhër shpenzimeve është e barabartë me faktin e llogarisë 606, të rakorduar me Degën e Thesarit. Shpërndarja e tyre është kryer nëpërmjet shërbimit postar apo në llogaritë bankare të përfituesve. Diferenca e fondit të transferuar në fund të vitit dhe që nuk është përdorur nga bashkia është tërhequr përsëri nga ministria e linjës.
Për vitin 2020 dhe 2021, objekt auditimi, janë dëmshpërblyer nga fondi i rindërtimit 4194 familje, që kanë përfituar bonus qiraje, të vlerën totale **658,375,000** lekë.

Lidhur me listat e familjeve që janë trajtuar me bonusin e qirasë të miratuara me VKB ajo që konstatohet nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur grupit të auditimit është se numri i këtyre familjeve ka ndryshuar rast pas rasti. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i numrit të familje që kanë përfituar bonusin e qirasë për një periudhë të caktuar deri në kalimin e fondeve për rikonstruksion të banesave të tyre. Për vitin 2020-2021 janë hequrnga listat e përfituesve të bonusit të qirasë 468 familje të miratuara me 11 VKB.
Gjithashtu, në listën e përfituesve janë shtuar edhe familje të tjera si rezultat i ndryshimit të klasifikimit të nivelit të dëmit, pra familje banesat e të cilëve janë shpallur të pabanuara pas kryerjes së ekspertizës së thelluar nga Instituti i Ndërtimit. Përkatësisht, referuar dokumentacionit të audituar janë 96 familje banesat apo apartamentet e të cilëve janë klasifikuar të nivelit DS3 për prishje pas kryerjes së ekspertizës së thelluar nga Instituti i Ndërtimit.

4. Alokimi i fondeve për rikonstruksionin apo riparimin e objekteve (niveli i dëmit DS1, DS2 dhe DS3)
Në zbatim të përcaktimeve të Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019, VKM nr. 904, datë 21.12.2019 dhe VKM nr. 5 datë 06.01.2020 ñPër përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelò, e ndryshuar, *pika IV, Grantet për rikonstruksion*, Bashkia Krujë ka dërguar 5 shkresa Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për subjektet që përfitojnë vlerën e masës së grantit sipas nivelit të dëmit.

1. Referuar VKB-ve nr. 45, datë 12.06.2020, nr. 46, datë 16.06.2020 dhe VKB nr. 52, datë 23.06.2020, Bashkia Krujë ka dërguar shkresën nr. 3268 Prot, datë 02.07.2020, Komisionit Shtetëror të Rindërtimit ku kërkohet financim për **2068 subjekte përfituese** me divel dëmi DS1, DS2 dhe DS3 me vlerë totale 660,700,000 lekë. Fondet për rindërtimin janë miratuar me VKM nr. 540, datë 08.07.2020 ñPër përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Durrës, Tiranë, Lezhë, Krujë dhe Kavajèò, pika ç ñ*Bashkisë Krujë i transferohet fondi prej 660,700,000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale*

*dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para*ò.

2. Referuar VKB-ve nr. 45, datë 12.06.2020, nr. 56, datë 06.07.2020 dhe VKB nr. 69, datë 21.08.2020, Bashkia Krujë ka dërguar shkresën nr. 5301 Prot, datë 03.09.2020, Komisionit Shtetëror të Rindërtimit ku kërkohet financim për **328 subjekte përfituese** me nivel dëmi DS1, DS2 dhe DS3 me vlerë totale 86,000,000 lekë. Fondet për rindërtimin janë miratuar me VKM nr. 732, datë 16.09.2020 ñPër përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të banesave individuale, të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Krujë, Shijak, Durrës dhe Tiranëò, pika a ñ*Bashkisë Krujë i transferohet fondi prej 86,000,000 (tetëdhjetë e gjashtë milionë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para*ò.

3. Referuar VKB-ve nr. 45, datë 12.06.2020 dhe VKB nr. 97, datë 29.10.2020, Bashkia Krujë ka dërguar shkresën nr. 7909 Prot, datë 19.11.2020, Komisionit Shtetëror të Rindërtimit ku kërkohet financim për **38 subjekte përfituese** me divel dëmi DS1, DS2 dhe DS3 me vlerë totale 12,150,000 lekë. Fondet për rindërtimin janë miratuar me VKM nr. 1135, datë 24.12.2020 ñPër përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) si dhe mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Krujë dhe Lezhëò, pika a ñ*Bashkisë Krujë i transferohet fondi prej 12,150,000 (dymbëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para*ò.

4. Referuar VKB-ve nr. 45, datë 12.06.2020 dhe VKB nr. 24, datë 09.03.2021, Bashkia Krujë ka dërguar shkresën nr. 1835 Prot, datë 23.03.2021, Komisionit Shtetëror të Rindërtimit ku kërkohet financim për **381 subjekte përfituese** me nivel dëmi DS1, DS2 dhe DS3 me vlerë totale 89,100,000 lekë. Fondet për rindërtimin janë miratuar me VKM nr. 333, datë 02.06.2021 ñPër përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Krujë, Durrës dhe Rrogozhinëò, pika a ñ*Bashkisë Krujë i transferohet fondi në masën 89,100,000 (tetëdhjetë e nëntë milion e njëqind mijë) lekë*ò.

5. Referuar VKB-ve nr. 45, datë 12.06.2020, nr. 10, datë 05.02.2021, nr. 41, datë 31.05.2021, nr. 47, datë 28.06.2021 dhe VKB nr. 69, datë 06.08.2021, Bashkia Krujë ka dërguar shkresën nr. 6224 Prot, datë 14.09.2021, Komisionit Shtetëror të Rindërtimit ku kërkohet financim për **57 subjekte përfituese** me nivel dëmi DS1, DS2 dhe DS3 me vlerë totale 16,350,000 lekë. Fondet për rindërtimin janë miratuar me VKM nr. 144, datë 11.03.2022 ñPër përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Shijak, Krujë, Kavajë, Kamëz dhe Mirditë,ò, pika b ñ*Bashkisë Krujë i transferohet fondi në masën 16,350,000*

*(gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë*ò. Shuma 16,350,000 lekë nuk ka kaluar ende në llogari të Bashkisë Krujë.

Tabela nr.30: Përmbledhëse e numrit të përfituesve sipas nivelit të dëmit DS1-DS2-DS3

Nr.	Niveli i dëmtimit	Masa e vlerës sipas nivelit të dëtimit	Nr. i përfituesve sipas VKB-ve	Vlera totale (mijë lekë)	Likuiduar	Vlera (mijë lekë)	Mbetur	Vlera e mbetur (mijë lekë)
1	DS1	100,000	853	85,300	811	81,100	42	4,200
2	DS2	250,000	958	239,500	913	228,250	45	11,250
3	DS3	500,000	1079	539,500	960	480,000	119	59,500
			2890	864,300	2648	789,350	206	74,950

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Referuar Akt-rakordimit të datës 28.01.2022, të mbajtur midis Bashkisë Krujë dhe Degës së Thesarit Krujë, rezulton se fondet e transferuara me VKM ndaj Bashkisë Krujë për rikonstruksion nuk janë përdorur në masën 100% duke trashëguar për vitin 2022 fonde në vlerën 58,600,000 lekë (informacion më i detajuar gjendet në Aneksin nr.6). Për vitin 2020-2021 janë dëmshpërblyer 2648 familje me vlerë 789,350,000 lekë.

Tabela nr.31: Fondet e rikonstruksionit të transferuara dhe të përdorura sipas akt rakordimeve me Degën e Thesarit Krujë

	Vlera e Financimit viti 2020	Përdorimi i Fondeve 2020	Vlera e trashëguar për vitin 2021	Vlera e financimit viti 2021	Përdorimi i Fondeve 2021	Fonde të disponueshme 31.12.2021
Shuma totale e fondeve të rindërtimit me kap. 01 me Kod Projekti 94902AB	758,850,000	688,850,000	70,000,000	89,100,000	100,500,000	58,600,000

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Për mënyrën dhe saktësinë e pagesave të masës së përfitimit, u verifikuan urdhër shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëngjitur tyre i cili rezultoi të jetë i saktë.

5. Mbi rregullshmërinë e dokumentacionit në dosjet e përfituesve

Titulli i gjetjes 16:*Dokumentacion jo i plotë i dosjeve tëtë përfituesve të granteve të rikonstruksonit DS1/DS2/DS3 dhe përfituesve të bonusit të qirasë.*

Situata: Grupi i auditimit, me qëllim dhënien e një konkluzioni përfaqësues për gjithë popullatën, me përzgjedhje rastësore auditoi 418 dosje nga të cilat 318 dosje nga përfituesit e grantit të rikonstruksionit për nivelin e dëmit DS1/DS2/DS3 dhe 100 dosje nga përfituesit e bonusit të qirasë. Grupi i auditimit verifikoi dokumentacionin në dosjet e aplikuesve që janë kualifikuar për të përfituar të paktën një nga nivelet e grantit apo bonusit të qirasë, në lidhje me rregullshmërinë e dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesit dhe të plotësuar nga Bashkia Krujë, bazuar në përcaktimet e VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 e ndryshuar, Kapitulli II ñProcedura e miratimit të projekteve model, kushtet, kriteret dhe autoritet përgjegjëse për vlerësimin e aplikimeveò pika 14, ku cilësohet: *"Në qoftë se aplikimi paraqet mangësi të të dhënave, sipas parashikimeve të këtij vendimi, struktura/t përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përkatës, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e regjistrimit të aplikimit, i kërkon/jnë me shkrim aplikantit të korrigjojë pasaktësitë, duke përcaktuar edhe afatin e nevojshëm për plotësimin e tyre.* ***Struktura/t përgjegjëse ofron/jnë ndihmë aktive për plotësimin e formularëve të aplikimit për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit për cilindo aplikues, duke u kujdesur që çdo individ/familje të marrë informacionin dhe ndihmën e nevojshme për këtë qëllim****."*

Referuar përcaktimeve të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu II, pika 13, dokumentacioni që duhet të përmbajë dosja duhet të jetë si më poshtë vijon:
a) emrin, atësinë, mbiemrin;
b) numrin e aplikimit;
c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;
ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për të përfituar nga programi i grantit të rindërtimit dhe tipi i projektit model të zgjedhur ose projektin e kryer vetë nga kërkuesi/aplikanti;
d) adresën e kërkuesit;
dh) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit;
e) Aktin e konstatimit/aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa e shpallur si e pabanueshme;
ë) çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar;
f) të dhënat e llogarisë bankare të kërkuesit pranë një banke të nivelit të dytë.
Në pamundësi të dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë nga të gjitha subjektet aplikuese Bashkia Krujë ka miratuar me VKB nr. 50 datë 22.06.2020 ñPër miratimin e vërtetimit të lëshuar nga Kryetari i fshatit dhe Administratori i njësisë administrative si dhe dokumentacionit tjetër plotësues që vërtetojnë posedimin dhe gëzimin e vazhduar të banesave, si dhe vërtetimin e legalizimit dhe formularit të aplikimit si dokumentacion që provojnë pronësinë e objektit për aplikuesit për programin e rindërtimitò, vërtetimin e faktit të posedimit fizik të banesës me dokumentacion plotësues si vërtetim nga Kryetari i fshatit, vërtetim nga Administratori i NjA, vërtetim të lëshuar nga ASHK si dhe dokumentacion tjetër plotësues (deklaratë noteriale, vërtetim banimi, kontratë të lidhjes së energjisë elektrike).
Nga auditimi i 318 dosjeve të përzgjedhura të përfituesve të granteve të rikonstruksonit DS1/DS2/DS3 rezultoi se:
- Dosjet janë të inventarizuara por inventari nuk ka datë;
- Në dosje mungon kërkesa për ndihmë sipas përcaktimeve të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu II, pika 13/ç;
- 12 dosje DS1 nuk kanë nuk ka asnjë dokument që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu II, pika 13/ë;
- Asnjë nga 318 dosjet e audituara DS1/DS2/DS3 nuk ka projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit dhe preventivin e punimeve që kërkohen të financohen nëpërmjet grantit për individët ose familjet që përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu IV. Grantet për Rikonstruksionin, pika 2/b. ñ*Përveç sa parashikohet në pikën 13, të kreut II, të këtij vendimi, aplikimet për grante rikonstruksioni ose riparimi duhet të shoqërohen dhe me projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit dhe preventivin e punimeve që kërkohen të financohen nëpërmjet grantit për individët ose familjet që përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit, sipas pikës 3, të këtij kreu, hartuar nga Instituti i Ndërtimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo projektuesit e licencuar".*

Nga auditimi i 100 dosjeve të përzgjedhura të përfituesve të bonusit të qirasë rezultoi se:
- Në 26 dosje nga 100 nuk ka asnjë dokument që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu II, pika 13/ë;

- Në 2 dosje nuk ka specifikim për nivelin e dëmit DS...;
- Vetëm 6 dosje kanë akt ekspertize të thelluar;
- 11 dosje janë pa inventar;
- Inventari i dosjeve nuk ka datë.

Kriteri: VKM nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu II, pika 13/ç, e, ë, Kreu IV. Grantet për Rikonstruksionin, pika 2/b.
Ndikimi: Dokumentacioni në dosje nuk vërteton se përfituesit janë përfitues në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullativ.
Shkaku: Mosplotësim i dosjeve nga strukturat e bashkisë që kanë administruar dokumentacionin e aplikuesve për grantet e rikonstruksionit apo bonusin e qirasë.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Krujë të ngrejë një grup pune për të verifikuar dokumentacionin në dosjet e përfituesve të granteve të rikonstruksionit DS1/DS2/DS3 dhe përfituesve të bonusit të qirasë si dhe të bëhet plotësimi i këtyre dosjeve kur është e mundur.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. *Z. Xh. Xh., me detyrë Administrator i Nj.A. Fushë Krujës*
2. *Zj. G. M., me detyrë Administrator i Nj.A. Thumanë për periudhën nga 01.01.2020*
3. *Zj. Sh. Ç., me detyrë Administrator i Nj.A. Thumanë për periudhën nga 02.08.2021*
4. *Z. B. D., me detyrë Administrator i Nj.A. Nikël*
5. *Z. A. K., me detyrë Administrator i Nj.A. Bubq*
6. *Z. F. A., me detyrë Administrator i Nj.A. Cudhi*

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitet 2020-2021.

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese ñAparati i Bashkisë Krujeò për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr.25/2018, datë 01.01.2019 datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Kruje për vitin ushtrimor 2021 me shkresë përcjellëse nr. 1776 Prot.31.03.2022 datë. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Kruje dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Ekonomik.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program ñExcelò
- Në përgjithësi janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajturlibri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban tëdhënapër shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu:Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2019 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;
Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël ne llogarinë e 520 ñDisponibilitete në Thesarò dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 ñPasqyrë e lëvizjes në cash viti 2021ò.

Totali i Aktivit për vitin 2021 është në vlerën6,723,000,671lekë dhe për vitin 2020 është 6,634,046,944lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Tabela nr. 32: Formati nr.1- Aktivi i Bilancit 2021 *Në lekë*

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M Ë R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur viti 2021	Ushtrimi Paraardhes viti 2020
1	**A**	**A K T I V E T**	**6,723,000,671**	**6,634,046,944**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**1,422,888,101**	**1,499,293,260**
3		**1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre**	**628,580,883**	**741,921,619**
4	531	Mjrete monetare ne Arke		0
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	628,580,883	741,921,619
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**71,890,148**	**81,558,683**
12	31	Materiale	6,996,294	5,815,176
13	32	Inventar I imet	64,893,854.00	75,743,507
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		**3.Llogari te Arketushme**	**685,507,879**	**625,782,594**
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	611,708,432	507,626,731
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	73,799,447	118,155,863
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**36,909,191**	**50,030,364**
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		

41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	36,909,191	50,030,364
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**5,300,112,570**	**5,134,753,684**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**134,000,204**	**68,204,104**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave	0	
45	202	Studime dhe kerkime	134,000,204	68,204,104
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**4,291,986,973**	**3,845,065,263**
48	210	Toka, T,roje, Terene	37,907,145.00	25,260,855
49	211	Pyje, Plantacione	19,804,270.00	19,804,270
50	212	Ndertesa e Konstruksione	1,423,340,263.00	1,306,445,434
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,710,398,261	2,399,440,931
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	17,468,925	18,149,287
53	215	Mjete Transporti	22,672,572.00	15,740,715
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	57,995,537.00	57,823,771
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	2,400,000.00	2,400,000
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		**4.Investime**	**874,125,393**	**1,221,484,317**
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	874,125,393	1,221,484,317

Burimi: Bashkia Krujë

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 741,921,619 dhe në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 628,580,883 lekë**,** të cilat rakordojnë me rubrikën V ñTeprica ne fillim te vitit ushtrimorò dhe rubrikën VI ñTeprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimorò në Formatin nr.3 ñPasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkteò .

- ***Gjendja e llogarisë 520 "Disponibilitete në Thesar"*** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 741,921,619 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 628,580,883 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në me formatin nr.5 ñPasqyrë e lëvizjes në cash viti 2021ò të paraqitur në Aneksin B/8 të bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në klasën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues" të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 81,558,683 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 71,890,148 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej 9,668,535 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 ñNdryshimi I gjendjeve të inventaritò në formatin nr.2 ñPasqyra e performancës financiareò. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- Gjendja e llogarisë 31 "Materiale" paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 5,815,176 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 6,996,294 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 1,181,118 lekë e cila përfaqëson shtim te gjendjes se mallrave ne fund te vitit 2020. Kjo llogari është e analizuar për gjendjen datë 31.12.2021 në shumën 6,996,294 lekë, duke bërë sondazhe për 4 artikuj në inventarin fizik.

- Gjendja e llogarisë 32 "Inventari i imët" paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 75,743,507 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 64,893,854 lekë me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 10,849,653 lekë, e cila përfaqëson ulje te inventarit te imët për vitin 2021.

Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 625,782,594 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2021 në vlerën 685,507,879 lekë, ku kemi shtim duke

e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se debitorëve krahasuar me vitin paraardhës.

- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 507,626,731 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 611,708,432 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 ka pësuar një rritje prej 104,081,701 lekë, e cila ka ardhur nga rritja e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore si dhe nga vlera e gjobave të vendosura nga IMT të pa arkëtuara. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit. Analiza e gjendjes së llog. ñDebitorë të ndryshëm ñdhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.33: Gjendja e llogarisë 468 "Debitore te ndryshëm" më datë 31.12.2021

Nr	Përshkrimi	Dokumentacioni	Gjendje 31.12.2020	Shtesa 2021	Pagesa 2021	Gjendje 31.12.2021
1	Debitore nga klsh 2011-2012	Raport KLSH	24,593,227		4,459	24,588,768
2	Debitore Prefektura	Prefektura	347,314			347,314
3	Debitore nga IMT	Gjoba nga IMT	39,260,000	15,702,600	150,000	54,812,600
4	Debitore nga tatim taksat	Tatim taksa	441,978,260	88,533,560		530,511,820
5	Ismet Mavriqi	Kontrate shit-blej nr 323|2 DT 23.10.2010	647,930			647,930
6	Myrteza veseli	Urdher arketim nr 623 date 08.08.2017	800,000			800,000
						-
	Totali		**507,626,731**	**104,236,160**	**154,459**	**611,708,432**

Burimi: Bashkia Krujë

- ***Llogaria 4342*** ñTë tjera operacione me shtetin (të drejta)ò në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 73,799,447 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 4,097,464 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit në vlerën 77,896,911 lekë, e cila përbëhet nga shuma e: llog.401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò për vlerën 2,839,600 lekë, llog.42 ñDetyrime ndaj personelitò për vlerën 21,714,400 lekë, llog.431 ñDetyrime ndaj shtetit për tatim taksaò për vlerën 1,351,493 lekë, llog.435 ñSigurime shoqëroreò për vlerën 6,446,778 lekë, llog.436 ñSigurime shëndetësoreò për vlerën 888,460 lekë, llog.466 ñMjete në ruajtjeô në vlerën 44,656,180 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu II ñParimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò pika 15/b,59 /a, Kreu III. pika 32, Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik ñpika 3.3ñ Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të tretëve (klasa 4) nënpika 8.

Titulli gjetjes 17:*Mbi kontabilizimet e gabuara, të llogarive të arkëtueshme në aktiv të bilancit dhe të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit.*

Situata: Llogaria 4342 ñTë tjera operacione me shtetin (të drejta)ò në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarije në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 73,799,447 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 4,097,464 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit në vlerën 77,896,911 lekë, e cila përbëhet nga shuma e : llog.401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò për vlerën 2,839,600 lekë, llog.42 ñDetyrime ndaj personelitò për vlerën 21,714,400 lekë, llog.431 ñDetyrime ndaj shtetit për tatim taksaò për vlerën 1,351,493 lekë, llog.435 ñSigurime shoqëroreò për vlerën 6,446,778

lekë, llog.436 ñSigurime shëndetësoreò për vlerën 888,460 lekë, llog.466 ñMjete në ruajtjeô në vlerën 44,656,180 lekë. Gjithashtu kjo llogari nuk rakordon dhe me llog.7206 ñFinancim të pritshëm nga buxhetiònë Formatin e Performancës së PF, gjendja e së cilës në fund të vitit 2021 është në vlerën 763,937,770 lekë.

Kriteri: Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu II ñParimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeòpika 15/b,59 /a,Kreu III. **pika 32,** Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik ñpika 3.3ñ Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të tretëve (klasa 4) nënpika 8.

Ndikimi: Pozicionimi dhe veprimet e gabuara kontabël në llogaritë e arkëtueshme në aktiv të bilancit dhe të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit kanë sjellë një ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e njësive shpenzuese në marrëdhënie me shtetin, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia: I lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël e gjendjes së llogarisë 4342 ñOperacione me shtetin (të drejta)ònë fund vitit 2021 të paraqitur gabim, duke përfshirë në mënyrë të saktë vlerat e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 ñFinancim i pritshëm nga buxhetiò. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuara.

Klasa 4 "Të tjera aktive afatshkurtra" e cila përbëhet nga :

Gjendja e llogarisë **486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 50,030,364 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 36,909,191 lekë.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave te UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I ñInvestimeò). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 5,300,112,570 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,134,753,684 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)òparaqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 4,879,238,302 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,597,446,034 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga**:**

- **Gjendja e llogarisë 202** ***"Studime dhe kërkime"*** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën prej 68,204,104 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 134,000,204 lekë, diferenca është vlera e shtuar e tre projekteve, ku njeri prej te cilëve është donacion. Ndërsa sipas Formatit 7/b ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 68,204,104 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 134,000,204 lekë, ku diferenca në rritje prej 65,796,100 lekë i përket 3 projekteve të shtuara gjatë vitit 2021. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon.

Tabela nr. 34: Inventari i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime"

NR	EMERTIME	Gjendja 31.12.2017	Gjendja 31.12.2018	NR	EMERTIME	GJ.ME .31.12.2020	SHTESA 2021	GJ.ME, 31.12.2021
					Te mbartura	25072534		25072534
1	Projekt (Trefast)	60.000	60.000	34	Projekti Rruges Brret	480000		480000
2	Studim Urbanistik Qender F.Kruje	145.000	145.000	35	Projekti Rrug Ne Lagje Kasme	468000		468000
3	Stud Urban Lagja E Re Fush Kruje	522.000	522.000	36	Proj Rr Lidhes Qender - Qen, Kult	420000		420000
4	Proj. Rik E Shk9-Vjec N.1.F.Kruj	216.000	216.000	37	Projekti Shkolles Nr 4	2157600		2157600
5	Projekt Rruga Luz	783.000	783.000	38	Projekti Elektrik I Gjimnazit	100000		100000
6	Projekt Ujesjellesi Halil	324.000	324.000	39	Projek Trotua Afer Stadiumit	366000		366000
7	Sistemi Adresave Fushe Kruje	985.000	985.000	40	Proj Siste Trotua Derede - Subash	114000		114000
8	Projektim Studim	426.000	426.000	41	Proj " Ura Gjatush Fsha Shqeze	193200		193200
9	Projektim Unaza Veriore	300.000	300.000	42	Projekt " Rruga E Fshatit Bruz '	141600		141600
10	Studim Projektim Lumi Zeze	99.000	99.000	43	Proj " Rrethim I Zyra Te Komun "	141600		141600
11	Projekt Lagja Grumbullimit	495.000	495.000	44	Proj " Ndertim Ura Nuaj Katund "	142320		142320
12	Projekt Rruga Halil	797.700	797.700	45	Proj " Ndert Ujes Cudhi Kamp "	34.800		34800
13	Projekt Rruga E Dibraneve	397.000	397.000	46	Proj " Ndert Ujesjel Cudhi Zalle "	112800		112800
14	Projekt Rruga Durresit	397.000	397.000	47	Proj " Pa Adrese "	147500		147500
15	Projekt Rruga Magaze	1.045.063	1.045.063	48	Proj " Qendra Shendets Nuaje "	149450		149450
16	Projekt Blloku 6	397.000	397.000	49	Proj " Shkolla Shkrete "	149450		149450
17	Projekt Rruga Sabri Cela	700.000	700.000	50	Projekt " Pa Adrese "	148500		148500

18	Projekt Rr. Larush Poshte	1.992.000	1.992.000	51	Proj Per Ujsjell Bilaj,Mazhe Vogel	146.376		1469376
19	Detyre Projektimi	1.784.000	1.784.000	52	Projekt I Rruges Budull	478080		478080
20	Plani Rregullues	295.200	295.200	53	Proj I Rr Budull-Koder-Budul Fush	47.000		474000
21	Projekt Fasadat E Qytetit	395.595	395.595	54	Projekt Rruga Bubq	128000		128000
22	Projekt Gjimnazi Vjeter	214.560	214.560	55	Projekte Rrugesh	632300		632300
23	Proj Studim Lagja Grumbullim	345.600	345.600	56	Harta E Komunes Bubq	174000		174000
24	Projekt Studim	378.262	378.262	57	Projekte Rrugesh Komuna Bubq	109200		109200
25	Projekt Blloku 6	111.600	111.600	58	Projekte Ish Komuna Thumane	3.664114		3664114
26	Projekt Rruga Sabri Cela	99.000	99.000	59	Hart Proj Prev Rr.Hyre Shes M.Merl	3967920		3967920
27	Proj Rruga Larush Poshtem	284.310	284.310	60	Hart Proj Prev Linja Ujesj Thumane	117600		117600
28	Detyre Projektimi	468.000	468.000	61	Stud Projekt Unaza Fushe-Kruje	8080800		8080800
29	Plani Rregullues	9.579.000	9.579.000	62	Stud Proj Mbrojt Lumo Fush Kruje	6000000	2000000	8000000
30	Projekt Fasadat E Qytetit	450.000	450.000	63	Stud Proj Objek Ujitje Bashk Kruje	948000		948000
31	Projekt Gjimnazi Vjeter	372.000	372.000	64	Stud Proj Infras Rrug Bashkia Kruje	1846800		1846800
32	Proj.Stud Lagja Grumbullim	106.784	106.784	65	Stud Projektim Uji Pijeshem Kruje	4787280		4787280
				65	Stud Projektim Uji Pijeshem Kruje	4787280		4787280
33	Projekt Studim	107.860	107.860	66	Studim projektim per godinat e demtuara nga termeti		63746100	63746100
				68	Studim Hidrologjik Perroi I madh Donacion		50000	50000
	Shuma	**25.072.534**	**25.072.534**			**62562046**	**65796100**	**134000204**

Titulli gjetjes 18: *Mbi kontabilizimet e gabuara, të llogarive aktiveve jo materiale dhe mos llogaritjen e amortizimit për to.*

Situata: **Gjendja e llogarisë 202 *"Studime dhe Kërkime"*** në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto 134,000,204 lekë dhe me kosto historike në vlerën prej 134,000,204 lekë, e cila përfaqëson vlerën e 68 projekt-studimeve për investime. Nga këto vlera prej 44,192,686 lekë e 60 projekt-studimeve e mbartur që nga viti 2018 e më përpara, nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël, por mungon inventari fizik dhe nuk është bërë verifikimi i dokumentacionit për këto aktive jo materiale sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Gjithashtu nuk është llogaritur amortizim në masën 15% të vlerës së mbetur. Në fakt këto shpenzime për projektimin e një investimi të kryer për krijimin apo rikonstruksionet e aktiveve afatgjata materiale ose AQT nuk duhet të kontabilizohen në llogarinë 202 ñStudime dhe kërkimeò, pasi këto janë pjesë e kostos së AQT dhe nuk janë shpenzimet për kërkime të aplikuara dhe të zhvillimit.

Kriteri: Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò Pika 2.Klasa 2, ñAktivet afatgjataò (përbërja dhe trajtimi kontabël), Kreu III. Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Pika 36

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata jo materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari te shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara

Shkaku: Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizimit të aktiveve.

Rëndësia: I lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për llogaritjen e amortizimit e aktiveve jo materiale dhe kryerjen e veprimeve kontabël të sistemimit për shpërndarjen e vlerës të studim-projektimeve sipas investimeve të kryera dhe për cdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 ñStudime dhe Kërkimeòdhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2021.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 4,291,986,973 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,463,445,830 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- ***Gjendja e llog. 210 "Toka, Troje, Terrene"*** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 në vlerën prej 25,260,855 dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 37,907,145 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në mbyllje të vitit 2020 paraqiten në vlerën prej 25,260,855 dhe në mbyllje të vitit 2021 në të njëjtën vlerë prej 37,907,145 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 35: Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" më datë 31.12.2021

Nr.	Llog	Emërtimi	Gjendje 31.12.2020	Shtesa 2021	Gjendje 31.12.2021
1	210	Troje, Terrene	337,536		337,536
2	210	Rikonstruksion, Sip te gjelberta , Rruga Marin Barleti	471,798		471,798
3	210	Rikonstruksion Sip te gjelberta , Rruga Kryesore	475,760		475,760
4	210	Rikonstruksion, Sip te gjelberta , Rruga Donika Kastrioti	469,460		469,460
5	210	Rikonstruksion, Sip te gjelberta , Rruga Skenderbeu	473,482		473,482
6	210	Mur Guridhe Blloqe, rrethues , Rreth Varrezave Publike	479,694		479,694
7	210	Sistemim Gjelberim I Zones Derede	5,933,676		5,933,676
8	210	Sporti	816,870		816,870
9	210	Varrezat e Qytetit	4,966,478		4,966,478
10	210	Vendigrumbullim plehra halil	570,020		570,020
11	210	Toka e pompave te ujit Luz	3,035,903		3,035,903
12	210	Trup rruge , rruga e lAcit	601,060		601,060
13	210	Rrethrrotullimi Luz	3,787,804		3,787,804
14	210	Shpronesime per varrezat Fushekruje	952,000		952,000
15	210	Shpronesim rruga e durresit	256,244		256,244
16	210	Shpronesim Rruga e Malit	247,479		247,479
17	210	Shpronesi zona 1/2 Thuman rindertimi VKM 528 dt 24.6.20	1,385,591	12,203,190	13,588,781
18	210	Shpronesim zonen e re Zhvillim Bubq VKM 790 dt 7.610.20		443,100	443,100
	210	Shuma totale : Toka, Troje , Terrene	25,260,855	12,646,290	37,907,145

Burimi: Bashkia Krujë

Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,804,270 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 19,804,270 lekë. Kjo vlerë përfshin kostot e mbjelljes së pemëve dekorative dhe frutore në territorin e Bashkisë Krujë, për të cilat nuk ekziston inventari fizik në numër drurësh.

Tabela nr. 36: Analiza dhe inventari fizik në vlerën bruto

NR	Emërtimi	Gjendje me 31.12.2017	Sasia	Çmimi	Shtesa 2018	Gjendja me 31.12.2018
	PYJE,KULLOTA,PLANTACIONE	**19,804,270**				**19,804,270**
1	Pyllezime te vitin 2010 te komunes Nikel	2,485,247	1	2,485,247	0	2,485,247
2	Gjelberim Ambjenti te komunes Bubq (Lulishte)	296,000	1	296,000		296,000
3	Mbjellje Peme Dekorative komuna Bubq	1,530,960	1	1,530,960	0	1,530,960
4	Pyllezim me shege " fnare cudhi zalle "komuna cudhi	5,654,781	1	5,654,781	0	5,654,781
5	Mbjellje Peme Dekorative Bashkia F.Kruje	4688052	1	4688052	0	4688052
6	Peme dekurative njesia Thumane	3196770	1	3196770	0	3196770
7	Peme dekorative,Bashkia Kruje	1952460	1	1952460	0	1952460

Burimi: Bashkia Krujë

- Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,306,445,434 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,423,340,263 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)òparaqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,634,345,227 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 1,823,791,496 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 198,837,807leke, që përbëjnë shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si rikonstruksione shkollash, ambiente shëndetësore etj., si dhe pakësim në vlerën prej 9,391,538 lekë për dy objekte të dëmtuara nga tërmeti. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 paraqitet në Aneksin B/1.

Titulli gjetjes 19:*Mbi analizën e gjendjes së llogarisë212 "Ndërtesa Konstruksione" së aktiveve afatgjatë të materiale (AAM) dhe inventarët e tyre.*

Situata:***Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"*** në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë neto 1,423,340,263 lekë dhe me kosto historike në vlerën 1,823,791,496 lekë. Në gjendjen e llogarisë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* sipas inventarit kontabël përfshihen dhe aktivet ñNdërtesa e konstruksioneò të NJA Thumanë, me vlerë 104,595,727 lekë dhe aktivi me emërtim ñNdërtime para vitit 2001ò me vlerë 27,146,269 lekë, që i përket NJA Fushë Krujë, të cilat nuk janë të analizuara si në kontabilitet ashtu dhe në inventar fizik, situatë e trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Krujë të këtyre vlerave të aktiveve të pa analizuara në mbyllje të bilancit të vitit 2015 të këtyre njësive të qeverisjes vendore, problematikë së cilës nuk i është dhënë zgjidhje.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr. 8**,** datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu III. **"**Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò pika 30, me VKM nr 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlò, Kapitulli I ñMbajtja e kontabilitetitò pika 2/c, me UMF nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar, Kreu III. ñRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyreò

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe mungesa e analizës për disa aktive me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara

Shkaku: Nga strukturat përgjegjëse nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar nga ish-Kumuna Thumanë dhe ish-Bashkia Fushë Krujë.

Rëndësia: I lartë

Rekomandim: Strukturat drejtuese, Bashkia Krujë të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialistë të fushës dhe të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. ***212*** *"Ndërtesa Konstruksione".* Për aktivetñNdërtesa e konstruksione NJA Thumanëò në vlerën 104,595,727 lekë dhe për aktivet ñNdërtime para vitit 2001 NJA Fushë Krujëò në vlerën 27,146,269 lekë nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-komuna Thumanë dhe ish-Bashkia Fushë Krujë për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite dhe për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilanc e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- Gjendja e Llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,399,440,931 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,710,398,261 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto

historike)ò paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,860,562,034 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021në vlerën 3,299,923,033 lekë. Gjatë vitit 2021 janë bërë shtesat në vlerën 439,360,999 lekë, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj. Amortizimi për vitin 2021 është llogaritur 128,403,669 lekë. Nga analiza e gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ka aktive me emërtesa të pa adresuara, duke mos përcaktuar qartë aktivin si në 25 raste në vlerën 100,332,823 lekë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 37: Gjendja e llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"

NR	EMËRTIMI	Gjendje 31.12.2021	NR	EMËRTIMI	Gjendje 31.12.2021
18	rruge	4158818	147	Investim Kanal Kullues	477000
41	Ndricim Rrugor	28695276	148	Investim Kanal Kullues	475656
42	Ujesjellesi	689654	154	Linja elektrike e komunes	309210
45	Ujesjellesi	42281676	133	Konstruksion Ure	1186532
47	Te tjera	4992583	140	Konstruksion ujesjellesi	4566354
79	Projekte rrugesh e studime	1980000	141	Blerje elektropompe	211500
117	Mirembajtje te rrugeve te komunes	1665168	142	Blerje Pompe per ujesjellesin	299500
130	Sistemim i sheshi i varrezave	468000	143	Blerje Elektromotorr	294000
140	Konstruksion ujesjellesi	4566354	146	Investim Kanal Kullues	474338
141	Blerje elektropompe	211500	147	Investim Kanal Kullues	477000
142	Blerje Pompe per ujesjellesin	299500	148	Investim Kanal Kullues	475656
143	Blerje Elektromotorr	294000	154	Linja elektrike e komunes	309210
146	Investim Kanal Kullues	474338			**100,332,823**

Burimi: Bashkia Krujë

- Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën prej 18,149,287 dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 17,468,925 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 73,703,124 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 68,329,707 lekë për të cilat ka inventar fizik . Shtesa prej 7,251,480 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2021 ne krahasim me vitin 2020 përfaqëson blerjet e bëra për kompjuter , kontejnerë metalike si dhe hyrje falas kompjuter per shkollat etj. Pakësimi në vlerën prej 12,624,897 përbëhet nga nxjerrjet jashtë përdorimit gjatë vitit 2021.

Titulli gjetjes 20:*Mbi kontabilizimet e aktiveve në* ***llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** *dhe klasifikimi i tyre.*

Situata:*Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë neto 17,468,925 lekë dhe me vlerë historike (vlerë bruto) 68,329,707 lekë, për të cilat nuk ka inventar fizik. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 214 ñInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla puneò, konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 63 artikuj aktive materiale në vlerën 47,358,283 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 ñInventar ekonomikò, dhe në 1 rast llog.215 ñMjete transportiò etj.

Kriteri: Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò Pika 2. Klasa 2, ñAktivet afatgjataò (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlò, Seksioni II ñAktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar ñpika 1/b ñKlasifikimi kontabëlò dhe Nomenklatura e llogarive te planit kontabël publik.

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë të tyre në llogarinë *214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të gjendjes së llogarisë *214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* në lidhje me saktësimin e klasifikimit të këtyre aktiveve.

Rëndësia:I lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë *214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke debituar për vlerat përkatëse të aktiveve *llog. 218 " Inventar ekonomik"* dhe *llog.215 "Mjete transporti"*etj. në kredi të llog. *214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune".*

Rastet të detajuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NR	EMËRTIMI	**Gjendje 31.12.2020**	**Gjendje me 31.12.2021**	NR	EMËRTIMI	**Gjendje me 31.12.2020**	**Gjendje me 31.12.2021**
2	Kompjutera	1796888	1796888	35	Njesia adm bubq	259300	259300
3	Kondicioner	264400	264400	36	Njesia adm Nikel	683119	683119
4	Printera	685626	685626	37	Shkolla Nikel	279558	279558
5	Pajisje zyre	344628	344628	38	Shkolla Tapize	3191725	3191725
6	Kompiu Inter Cele 2.8 GH.Z Tastj + maus	277200	277200	39	Shkolla Qereke	1618442	1618442
7	Kompjuter Intel 2 Dud E 6400 213 GHz	108000	108000	40	Shkolla Rinas	593922	593922
8	Printer Samsung A4 ALLOMESC*3200	28800	28800	41	Shkolla Kurcaj	906622	906622
9	frigorifera 2 katesh	96000	96000	42	Njesia Thumane	1812576	1812576
10	soba 1 trup 85*90*60	292800	292800	44	Shkolla Thumane	3174877	3174877
11	***Fadrome gome,Nf,Me lopate nj.Thumane***	**4675200**	**4675200**	45	Shkolla Burizane	4508398	4508398
12	Monitor	31200	31200	46	Shkolla Gramez	257413	257413
13	Desktop	132700	132700	47	Shkolla Derven	326692	326692
14	Printer , Laser , Skaner	51000	51000	48	Njesia Adm Cudhi	86000	86000
15	Modem	3300	3300	49	Shkolla Mafsheq	192683	192683
16	U.P.S 650 VA	6000	6000	50	Shkolla Shkrete	67703	67703
17	klubi sportiv	1628095	1628095	51	Shkolla Cudhi Kamp	140207	140207
18	kompjutera + tastiere + maus	548400	548400	52	Shkolla Bruz	22514	22514
19	Laptop Lonove think Pad	196651	196651	53	Shkolla Rranze	353887	353887
20	Mixher Dynakord 16 ch	318960	318960	54	Shkolla Cudhi qender	429500	429500
21	Bokse IBL 15 inch	149880	149880	55	Shkolla Nuaje	130491	130491
22	Bokse IBL 12 inch	96000	96000	56	Zyra e Gjendjes Civile	419356	419356
23	Mikrofon s3 58 A	18000	18000	57	Zyra e Sekretarit te keshillit	547900	547900
24	Tabela PrestigomultiPAD	2858128	2858128	58	Zyra e sherbimeve	130700	130700
25	Softëear I administri	68056	68056	59	Zyra e finances e tatimeve	49700	49700
26	Klient testin Elek	17696	17696	60	Zyra epolicise komunes	18500	18500
27	UPS inventar Triplite	87264	87264	61	Zyra e Finances dhe magazines	634000	634000
28	Projektor Interaktiv	594163	594163	68	printer oki b442dh	22236	22236
62	Zyra e ndihmave	242040	242040	69	kompjutera set dell 300 cope 1	81565	81565
63	Njesia Adm Fushe kruje	10624268	10624268	70	ups sppv 6501	4356	4356
64	kompjutera set dell 300 cope 1	81564	81564	71	ap fotokopje 2200	42606	42606
65	ups sppv 6501	4356	4356	67	printer oki b442dh	22236	22236
66	printer oki b442dh cope 1	22236	22236		Shuma		

- Gjendja e llogarisë 215"Mjete Transporti" në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 15,740,715 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 22,672,572 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 82,645,460 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 93,445,460 lekë, vlera e amortizimit te akumuluar 70,772,888 leke. Gjatë vitit 2021 është shtuar 1 mjet Zjarrfikëse Iveco Fiat me donacion nga Ambasada Japoneze në vlerën prej 10,800,000 lekë , ku nga ana e Bashkisë Kruje është mbuluar vetëm vlera e TVSH-së. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2020 deri në fund të vitit 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 38: Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "më datë 31.12.2021

Nr	EMËRTIMI	Gjendja 31.12.2017	Shtesa për vitin 2018	Gjendja kontab. 31.12.2018				
	MJETE TRANSPORTI	**82,645,460**	**10,800,000**	**93,445,460**				
1	**Kamion Tip IVEKO Vetshkarkues**	1734200	0	1734200	18	**Autoveture citroen xsara**	390000	390000
2	**Benz 2500**	800000	0	800000	19	**Autoveture tip Benz 250-D**	1135000	1135000
3	**Kamioncine e pastrimit**	3404025	0	3404025	20	**Kamion volvo**	1275600	1275600
4	**Autofunerali**	1781465	0	1781465	21	**Motrciklete**	100000	100000
5	**Makina tip Volvo**	4183779	0	4183779	22	**Fadrome**	3093000	3093000

6	**Minibus**	653500	0	653500	23	**Fadrome TErex**	6477760	6477760
7	**Benz 450**	3128940	0	3128940	24	**Autoveture Rover**	574560	574560
8	**Minibusi klubit sportiv**	500000	0	500000	25	**Kamion Fiat Iveko**	1479770	1479770
9	**Makine tip ford**	550927	0	550927	26	**Mitsubishi Pajero**	575058	575058
10	**Autoveture Benx**	2592500	0	2592500	27	**Kamion teknologjik**	1999999	1999999
11	**Autoveture benx**	1095000	0	1095000	28	**Kamioncine,Nisan Navar**	924000	924000
12	**Forestrade ML320 cd**	2250000	0	2250000	29	**Automjet zjarrfikese Man**	11952246	11952246
13	**Kamion veteshkarkues**	3480000	0	3480000		**Automjet zjarrfikese pompe.**	800000	800000
14	**Eskavator me goma**	4620000	0	4620000		**Ekskavator**	16347131	16347131
15	Kamion veteshk Daimle Chrysl	1,494,000		1,494,000		**Autoambulance**	115000	115000
16	Autovetur Merced Benz ML	1,998,000		1,998,000		Forestrade ML320CD	2,250,000	2,250,000
17	Zjarrfikese AB342EB		10,800,000	10,800,000		Autovinc Daimler Benz	1,140,000	1,140,000

Burimi: Bashkia Krujë

Titulli gjetjes 21: Mbi inventarin kontabël dhe fizik të gjendjes aktiveve të ***llogarisë 215****"Mjete Transporti"*dhe krahasimi i tyre me vlerëne paraqitur në bilanc.

Situata:*Gjendja e llogarisë 215"Mjete Transporti"* paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 22,672,572 lekë dhe me vlerë bruto (kosto historike) 93,445,460 lekë. 93,445,460 lekë. Për këto aktive është kryer inventari fizik, i cili nuk rakordon me inventarin kontabël për vlerën prej 7,986,465 lekë të 4 automjeteve, të cilët nuk ekzistojnë fizikisht, pasi 2 automjete janë shitur dhe nuk ka kaluar pronësia tek blerësi (Bashkisë) dhe 2 automjete kanë humbur, për të cilat nuk janë kryer asnjë procedurë për nxjerrjen dhe verifikimin e dokumentacionit ligjor e çregjistrimin e këtyre aktiveve si dhe kryerjen e veprimeve në kontabilitet. Të dhënat për këto automjete janë:

- **Automjeti Benz 2500,** me targa KR 4é .5 A. Nga Titullari është nxjerrë urdhër zhdëmtimi date 08.08.2017, në ngarkim të te z. M. V., në shumën 800,000 lekë**,** vlerë e cila është kontabilizuar në llog. 468 ñDebitorë të ndryshëmò edhe është përfshirën gjendjen e llog.215 ñmjete transportiò, duke u dubluar.
- **Kamionçina e pastrimit**, bashkia qendër Krujë, me vlere 3,404,025 lekë. Nga Bashkia Krujë është bërë kallëzimi penal me shkrim pranë Prokurorisë të rrethit gjyqësor Krujë, me shkresën nr.5344,datë 08.09.2017. Prokuroria me shkresën nr.699/1, datë 18.04.2018 ka nxjerrë aktin ñNjoftim përfundimiò dhe ka marrë Vendimin me datë 28.12.2017 ñPër pezullimin e hetimeve të çështjes penaleò.
- **Minibuz**, targa AA ...8 GN, me vlere 653,500 lekë, shitur me procedurë ñShitje me ankand publikò në bazë të kontratës nr. Prot.1463 datë 06.08.2015 në vlerën e mbetur 145,150 lekë.
- **Benz 450**, targa U 1...0, me vlere 3,128,940 lekë. Shitur me procedure ñShitje me ankand publikò në bazë të kontratës nr. Prot.4922 datë 09.06.2017 në vlerën e mbetur 305,200 lekë.

Kriteri: Udhëzim e MFE nr. 8**,** datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò i ndryshuar, pika 30, Aneksi 1 òAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò dhe Kreu II.ñParimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ñpika 18.

Ndikimi:Në këto kushte, pasqyrat financiare, nuk japin informacionin e besueshëm mbi ekzistencën ose jo të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari.

Shkaku: Nga Bashkia Krujë, nuk janë kryer procedurat e nevojshme për verifikimin dhe sistemimin e kësaj llogarie.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese, Bashkia Krujë të marrin masa, që për 2 automjetet e shitura në vlerën 3,782,440 lekë të kryejë veprimet për kalimin e pronësisë, ndërsa për automjetet e humbura në bazë të dokumentacionit ligjor në dispozicion për to, të relatojë në këshillin bashkiak për miratimin e zbritjes së vlerave të tyre prej 4,204,025 lekë nga gjendja e ***llogarisë 215*** ñMjete Transportiò dhe kryerjen e veprimeve kontabël të nevojshme sipas rasteve, për të saktësuar gjendjen reale të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari.

- Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik" në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 57,823,771 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 57,995,537 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 112,313,228 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën kontabël 117,844,719 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 664,440 lekë te pajisjeve dhe transferimet kapitale nga institucionet e tjera qendrore në vlerën 14,696,806 leke, për të cilat ishin ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimin e tyre. Ndërsa vlera e amortizimit e përllogaritur është në shumën 59,849,182 lekë.

- ***Gjendja e llogarisë 28 "Caktime aktiveve afatgjata"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,400,000 lekë. Kjo shumë përfaqëson vlerën e dy automjeteve të pastrimit në dispozicion të firmës së pastrimit ñRé 96ò fituese e tenderit të shërbimit të pastrimit më të cilën Bashkia Krujë ka lidhur kontratë shërbimi në vazhdim. Këto mjete kanë qenë aktive të ish-ndërmarrjeve komunale të shkrira, të kaluara me kontratë firmës së pastrimit në përdorim.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2021 paraqiten në Formatin nr.7/B ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò të PF si më poshtë:

Tabela nr. 39: Formatin nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"

Nr. Refere	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
20	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	**68,204,104**	**0**	**68,204,104**	**65,796,100**	**0**	**0**	**0**	**134,000,204**	**0**	**134,000,204**
202	Studime dhe kerkime	68,204,104		68,204,104	65,796,100				134,000,204	0	134,000,204
21- 28	**II. AAGJ/ MATERIALE**	**4,811,034,198**	**965,968,935**	**3,845,065,263**	**684,467,822**	**223,859,452**	**32,056,190**	**18,369,531**	**5,463,445,830**	**1,171,458,856**	**4,291,986,973**
210	Toka,troje,Terene	25,260,855		25,260,855	12,646,290				37,907,145	0	37,907,145.00
211	Pyje,Kullota Plantacione	19,804,270		19,804,270					19,804,270	0	19,804,270.00
212	Ndertime e Konstruksione	1,634,345,227	327,899,793	1,306,445,434	198,837,807	74,435,671	9,391,538	1,884,231	1,823,791,496	400,451,233	1,423,340,263.00
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,860,562,034	461,121,103	2,399,440,931	439,360,999	128,403,669			3,299,923,033	589,524,772	2,710,398,261
214	Instalitekn,makineri,paisvegla	73,703,124	55,553,837	18,149,287	7,251,480	5,058,404	12,624,897	9,751,460	68,329,707.00	50,860,781	17,468,925.00
215	Mjete transporti	82,645,460	66,904,745	15,740,715	11,010,000	3,868,143	210,000		93,445,460	70,772,888	22,672,572.00
216	Rezerva shtetrore	0		0					0	0	0.00
217	Kafshe pune e prodhimi	0		0					0	0	0.00
218	Inventar ekonomik	112,313,228	54,489,457	57,823,771	15,361,246	12,093,565	9,829,755	6,733,840	117,844,719	59,849,182	57,995,537
24	Aktive trupezuara t demtuara	0		0					0	0	0.00
28	Caktime	2,400,000		2,400,000					2,400,000	0	2,400,000.00
	T O T A L I (I + II)	**4,879,238,302**	**965,968,935**	**3,913,269,367**	**750,263,922**	**223,859,452**	**32,056,190**	**18,369,531**	**5,597,446,034**	**1,171,458,856**	**4,425,987,177**

Burimi: Bashkia Krujë

<u>Inventarizimi i aktiveve për vitin 2021 Bashkia Krujë</u>

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2021 për Bashkinë Krujë dhe Njësitë Administrative ne varësi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2021 ka dalë urdhri nr. 293 datë 19.05.2021 ñPër Inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2021ò dhe urdhër nr. 305, datë 21.05.2021: ñPër krijimin e komisionit për inventarizimin e mjeteve motorikeò në të cilat janë përcaktuar 2 komisione për kryerjen e inventarizimit.

Në bazë të këtyre urdhrave është kryer procedura e inventarizimit në zyrat e Bashkisë, magazinave dhe në NJA, në shkolla, kopshte, çerdhe , Bibliotekë, Pallati i Kulturës, Qendrës Kulturore të Fëmijve dhe Qendrës së Zjarrfikëses. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Gjithashtu, në fletët e inventarizimit në rubrikën e rezultati i inventarizimit janë bërë shënimet përkatëse në rastet e mungesave dhe tepricave, të cilat kanë rezultuar nga lëvizjet e aktiveve nga njëri objekt në tjetrin. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2021.

Është mbajtur relacion përmbledhës për rezultatin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve me nr 7090 Prot datë 12.10.2021 dhe relacion mbi inventarizimin e mjeteve motorike me nr 5397 Prot datë 30.07.2021. Nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 293, datë 19.05.2021 është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve ku janë mbajtur proces verbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit te aktiveve që kanë humbur funksionin e tyre, në të cilat janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse.
Për vlerësimin e mjeteve motorike të propozuar nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 305, datë 21.05.2021 për për procedurën e nxjerrjes jashtë përdorimi është ngritur komisioni i vlerësimit nr.306 datë 21.05.2021 ñPër ngritjen e komisionit të vlerësimit të mjeteve motorikeò si dhe janë mbajtur proces verbalet përkatëse. Komisioni ka hartuar relacionin përmbledhës për mbledhjen e aktiveve jashtë përdorimi nga subjektet e inventarizimit dhe argumentimin e vlerësimit të tyre jashtë përdorimi.
Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 99 datë 05.11.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr 895/5 datë 15.11.2021: òMbi miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të identifikuara për vlerësim dhe të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit në Administrate, Njësitë Administrative, Strukturat dhe Institucionet Arsimore të Bashkisë Krujë. Sipas këtij miratimi rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimi aktive në vlerën 35,004,848 lekë, ku sipas klasifikimit të llogarive janë:

1. Llog. 218 ñInventar ekonomikònë vlerën 9,829,755 lekë.
2. Llog.214 ñInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla puneò në vlerën 12,624,897 lekë
3. Llog.327 ñInventar i imëtò në vlerën 12,550,196 lekë.

Për asgjësimin e materialeve të nxjerra është ngritur komisioni me Urdhër nr. 673, datë 16.11.2021 ñ Për ngritjen e komisionit të asgjësimit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimi nga komisioni i vlerësimitò prej 7 vetësh, i cili ka bërë shpërbërjen e aktiveve pa vlerë përdorimi dhe i ka mbledhur pranë magazinës me flete hyrjen nr. 945 datë 21.12.2021 dhe me relaconin nr. 8810 Prot datë 28.12.2021 mbi kryerjen e procesit të nxjerrjes së Aktiveve nga Përdorimi ka bërë klasifikimin: aktive për asgjësim përfundimtar dhe aktive per hekurishte për skrap: me peshë 11,110 kg (i cili është bërë hyrje në magazinë).
Titulli gjetjes 22:*Mbi mbajtjen e librit historik të aktiveve afatgjata materiale dhe inventarizimin dhe saktësimin e vlerave të tyre aktiv për aktiv.*
Situata: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2021 në vlerën **4,291,986,973** lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje me 31.12.2021 në llogaritë: *210 "Toka, Troje, Terrene"* është në vlerën 37,907,145 lekë; *211"Pyje, Plantacione"* në vlerën 19,804,270 lekë, *212 "Ndërtesa Konstruksione"* në vlerën 1,423,340,263 lekë; *213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 2,710,398,261 lekë; *214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* në vlerën 17,468,925 lekë nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.
Për vitin 2020 dhe 2021 nga auditimi i procedurës se mbajtjes dhe kontabilizimit te aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore por njësia nuk dispononte një **regjistër analitik aktivesh sipas formatit,** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike

Kriteri: Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò Pika 2. Klasa 2, ñAktivet afatgjataò (përbërja dhe trajtimi kontabël dhe Nomenklatura e llogarive te planit kontabël publik, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò kapitulli III, pika 30.

Ndikimi: Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos ñcertifikuarò vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Shkaku: Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme që për këto aktive të mbahen kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Rëndësia:I lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

- ***Gjendja e llogarisë 219 "Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale"*** paraqitet në bilanc në vlerën 1,171,458,857 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

ñAmortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuaraò është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò pika 36.

Përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Për aktivet e llogarive: 202 ñStudim-Projektimeò; 214 ñInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla puneò dhe 218 ñInventar Ekonomikò, në të cilat përfshihen pajisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është bërë në grup dhe jo aktiv për aktiv, dhe nuk mund të verifikoheshin se si janë grupuar dhe llogaritur amortizimi për pajisjet kompjuterike.

Klasa 3"*Aktive Afatgjata Financiare*", rezultojnë në fund të vitit 2020 dhe 2021 me gjendje në vlerën 0 lekë.

Në këtë klasë përfshihet gjendja e llogarisë ***26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet"*** e cila si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt ka investime kapitale në formë aksionesh në aksioneve në Shoqëritë Aksionere ñKlubi Sportiv Kastrioti òsha dhe ñIliria SH.Aò

Titulli gjetjes 23:*Mbi kontabilizimin e investimeve kapitale në formën e aksioneve në Shoqëritë Aksionere "Klubi Sportiv Kastrioti "sha dhe "Iliria SH.A".*

Situata: Gjendja e llogarisë *26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* si në mbyllje të vitit 2017 dhe në mbyllje të vitit 2018 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur në bazë të % së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqëritë Aksionare ñKlubi Sportiv Kastriotiò të themeluar me datë 26.08.2011 dhe ñIliria

SH.Aò(klubi i futbollit Fushe-Kruje) të themeluar me datë 19.09.2011. Sipas Ekstrakteve Historike të Regjistrit Tregtar të QKR të datës 10.09.2019 rezulton se:
Bashkia Krujë zotëron në SH.A ñKlubi Sportiv Kastriotiò me vlerë kapitali 2,000,000 lekë 25% të aksioneve me vlerë nominale 1000 leke/aksioni për 2000 aksione, e shprehur në vlerë kapitali të derdhur në shumën 500,000 lekë.
Bashkia Krujë zotëron në SH.A ñIliria (klubi i futbollit Fushe-Kruje)ò me vlerë kapitali 3,500,000 lekë 100% të aksioneve me vlerë nominale 1750 leke/aksioni për 2000 aksione , e shprehur në vlerë kapitali të derdhur në shumën 3,500,000 lekë.
Për vlerën e kapitalit prej 4,000,000 lekë të derdhur nga Bashkia Krujë dhe ish-Bashkia Fushë-Krujë, e cila pas reformës territoriale është përshirë në Bashkinë Krujë, duhet të ishin kryer veprimet e kontabël në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò në kredi të llogarisë 1011, ñShtesa të fondit bazëò.
Kriteri: Udhëzimi i MFE nr. 8 datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu III. ñProcedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò pika 31.
Ndikimi: Mosevidentimi në llogarinë aktiveve afatgjata llog.26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe në llogarinë kundërparti të saj në pasiv të bilancit llog 1011, ñShtesa të fondit bazëò ka sjellë humbjen e këtyre investimeve të tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere, pasi në momentin e derdhjes të kapitalit janë rënduar shpenzimet e vitit, të cilat në fund të vitit janë mbyllur me llog.85 ñRezultati i veprimtarisë ushtrimoreò.
Shkaku: Nga Drejtoria Financës nuk janë kryer veprimet kontabël përkatëse për evidentimin e aktiveve afatgjata të krijuara nga investimet e kryera e kryera që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere.
Rëndësia:I lartë
Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa, që të kryejë veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò në kredi të llogarisë 1011, ñShtesa të fondit bazëòpër pasqyrimin në PF të investimeve kapitale në vlerën 4,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në SH.A ñKlubi Sportiv Kastriotiò për vlerën 500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 25% të aksioneve dhe SH.A ñIliria (klubi i futbollit Fushë-Krujë)ò për vlerën 3,500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve.

- Gjendja e llog. 231"Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet me vlerën prej 1,221,484,317 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 874,125,393 lekë për të cilën nuk na u paraqit analizë.

Tabela nr. 40: Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M Ë R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
			viti 2021	viti 2020
65	**B**	**PASIVET(DETYRIMET)**	**767,073,250**	**737,444,025**
66		**I.Pasivet Afat shkurtra**	**767,073,250**	**737,444,025**
67		**1. Llogari te Pagushme**	**767,073,250**	**737,444,025**
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	2,839,600	8,403,911
69	42	Detyrime ndaj personelit	21,714,400	21,699,825
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,351,493	1,326,504
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	6,446,778	6,384,276
76	436	Sigurime Shendetsore	888,460	882,929

77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	44,656,180	61,631,067
82	467	Kreditore te ndryshem	77,467,907	129,488,782
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	611,708,432	507,626,731
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**0**	**0**
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
91		**II.Pasivet Afat Gjata**	**0**	**0**
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**5,955,927,421**	**5,896,602,919**
97	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**5,955,927,421**	**5,896,602,919**
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	4,497,877,325	3,994,828,050
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	583,924,703	680,290,552
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	874,125,393	1,221,484,317
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	**E**	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**6,723,000,671**	**6,634,046,944**

Burimi: Bashkia Krujë

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 737,444,025 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 767,073,250lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- Gjendja e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikuiduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën8,403,911 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,839,600 lekë, vlerë e cila ka ardhur në rënie me një pakësim në shumën 5,564,311 lekë krahasuar me vitin 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 2 fatura të palikuiduara për mallra dhe shërbime kundrejt 2 furnitorëve në vlerën 2,839,600 lekë dhe këto detyrime janë krijuar në nëntor-dhjetor të vitit 2021 sipas bilancit, në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 41:Analiza e llogarisë 401 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"

Përshkrimi	Emërtimi	Nr	Date	Vlera e palikuiduar
Projektim mbrojtje ne brigjet e lumit zeze	Aé	33	02.11.2021	2,740,000
Furniim dhe vendosje stolash ne sheshin JANOSGH Huniadi	E. S.	3/2021	30.12.2021	99,600
Totali i Llogarise 401				**2,839,600**

Burimi: Bashkia Krujë

- Gjendja e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit" paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 21,714,400lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2022

- Gjendja e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat" paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën kontabël 1,351,493lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të

punonjësve të muajit dhjetor 2021 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2022.

- *Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore"* paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 6,446,778lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon:
a. Sigurimet shoqërore 9.5%punëdhënësi vlera 2,532,192 lekë.
b. Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 3,914,586 lekë.

- *Gjendja e llogarisë* 436 ñ*Sigurime shëndetësore*ò në fund të vitit 2021 është në vlerën kontabël 888,460 lekë, e cila përbëhet nga:
a.Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarsi vlera 444,230 lekë
b.Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 444,230 lekë.

Gjendja e llogarisë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 507,626,731 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 611,708,432 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërparti 468 ñDebitorë të ndryshëmò në aktiv të bilancit.

- Gjendja e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 61,631,067 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 44,656,180 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Krujë në mënyrë analitike.

- *Gjendja e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm"* përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në Aneksin B/2:
Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 ñPasqyra e performancës financiareò(Aneksi nr.B/3)
<u>Analiza e llogarive të të ardhurave</u> për vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën 2,428,598,640 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Librazhd paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** paraqitet në bilanc për vitin 2021në vlerën 147,701,933lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
a. Gjendja e llogarisë analitike ***7002*** **"*Tatim mbi Biznesin e vogël*"** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 3,507,325lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël* , e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
b. Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 73,745,532lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
c. Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 65,853,561lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.
- Gjendja e llogarisë***71*** **"Të ardhurat jo tatimore"** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 105,114,936lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
a. Gjendja e llogarisë ***7109*** ñ***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 24000lekë, e cila përfshin qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
b. Gjendja e llogarisë ***711*** ñ***Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 105,090,936lekë, e cila përfshin tarifat e parkimit, kamat

vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën 1,844,673,937lekë paraqitet më poshtë:
- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 320,654,672lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 320,654,672lekë diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 52,918,369lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 52,918,369lekë , diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 261,949,061lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 261,949,061lekë , diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***604 "Transferime korente te brendshme"*** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 120,468,772lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 120,468,772lekë, diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"*** paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 701,560,867lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.
Për vitin 2020 totali i te ardhurave është 2,853,824,657lekë dhe totali i shpenzimeve është 2,173,534,105lekë. Diferenca e tyre 165,681,598lekë rakordon me gjendjen e llog.85 ñRezultatin e ushtrimitò
Po kështu për vitin 2021 totali i të ardhurave në vlerë është 2,428,598,640 lekë dhe totali shpenzimeve është 1,844,673,937 lekë . Diferenca e tyre ne vlerën 583,924,703lekë rakordon me gjendjen e llog.85 ñRezultatin e ushtrimitò
Gjithashtu gjendja e llogarisë ***63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2021 është në vlerën -9,668,535 lekë .

Formati nr.6 "Investimet dhe burimet e financimit"
- Zeri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën1,221,484,317lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 1221,484,317 lekë fonde të akorduara per investime, vlera prej 18,332,806lekë investime te dhuruara në natyrë.

- Zëri **"Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale"** formati 6 e plotësuar për shumën **684,467,822** lekë në analizë rakordon me pasqyrën ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjataò kolona 4 formati 7/b.

Nga testi kontrollit për vitet 2020 dhe 2021 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:
Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:
Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.
Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

Ligjshmëria dhe saktësia e e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.
Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës.
Nga auditimi i pagesave nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit 30-ditor të paraqitjes dhe miratimit në Degën e Thesarit Lezhë, të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik *u konstatua se*:
Pagesat e kryera në llog 602 ñ*Shpenzime operative" për* ***vitin 2020***, janë kryer pagesa në **14** raste me vlerë 6,742,799 lekë, dhe *në* ***vitin 2021*** janë kryer pagesa në **8** raste në vlerën 5,595,457 lekë, likuidime me vonesë mbi afatin ligjor 30 ditor të pagesës. Rastet më konkretisht paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr. 42: Faturat e palikuidura 2020-2021

Nr	Urdhër Shpenzimi VITI 2020				Fatura		
	Ush	Datë	Vlera	Përshkrimi	Nr	Datë	Vlera
1	780	24.04.2020	240,000	Blerje kapake pusetash per territorin e Bashkise Kruje	110	25.11.2019	240,000
2	781	24.04.2020	888,000	Blerje materiale per infrastrukturen publike	90	31.12.2019	888,000
3	782	24.04.2020	2,647,584	Blerje dru zjarri per Bashkine Kruje	4	30.12.2019	2,647,584
4	783	24.04.2020	305,755	Sherbim i parkimit te automjeteve te Bashkise Kruje	46	01.03.2020	305,755
5	784	24.04.2020	87,984	Blerje gaz i lengshem per gatim per cerdhet dhe kopshtet e	52	30.01.2020	87,984
6	785	24.04.2020	18,612	Blerje gaz i lengshem per gatim per cerdhet dhe kopshtet e	4	28.020.2020	18,612
7	786	24.04.2020	13,877	Blerje kafeterie (caj,Kafe) per qendren sociale Fushe Kruje	51	30.01.2020	13,877
8	788	24.04.2020	649,564	Sherbim i ruajtjes se eskavatorit te bordit te kullimit	89	30.12.2019	649,564
9	789	24.04.2020	4,000	Sherbim interneti	325	31.03.2020	4,000
10	790	24.04.2020	724,380	Blerje Nafte	64	04.04.2020	724,380
11	791	24.04.2020	259,200	Sherbim transporti i eskavatoriot me rimorkiator	22	03.02.2020	259,200
12	792	24.04.2020	575,460	Sherbime mekanike per automjetet e Bashkise Kruje	47	12.12.2019	575,460
13	1217	17.06.2020	294,600	Prodhimi e furnizimi me shtypshkrime sipas kerkese	281	19.07.2019	294,600
14	1218	17.06.2020	33,783	Sherbim I ruajtjes se eskavatorit te bordit te kullimit	12	27.04.2020	33,783
						Shuma	**6,742,799**

Viti 2021

Nr	Urdhër Shpenzimi VITI 2021				Fatura		
	Ush	Datë	Vlera	Përshkrimi	Nr	Datë	Vlera
1	1205	23.06.2021	23,750	Sherbi postar B.Kruje,F.Kruje,Thumane,Bubq,Nikel,Cudhi	75	30.04.2021	23,750
2	1627	06.08.2021	1,907,617	Sherbim pastrimi Dé shpk	28	02.04.2021	1,907,617
3	2284	09.11.2021	162,648	Blerje ushqime me origjine shtazore, Loti II	652	28.09.2021	162,648
4	2308	16.11.2021	962,526	Sherbim pastrimi	39/	07.05.2021	962,526
5	2309	18.11.2021	784,096	Sherbim pastrimi	40	07.05.2021	784,096
6	2507	15.12.2021	375,304	Sherb mirembaj per vendgrumbull e mbetje urbane F Kruje	73/	22.09.2021	375,304
7	2662	24.12.2021	1,379,516	Energji institucionet e Nj Adm Thumane	165	31.07.2021	1,379,516
						Shuma	**5,595,457**

Burimi: Bashkia Krujë

Për pagesat e kryera për investime të llog. 230-231 ñ*Shpenzime për investime*ò, rezultoi se *për vitin 2020* janë kryer pagesa në 43 raste me vlerë 18,890,409 lekë dhe *në vitin 2021* janë kryer pagesa në 23 raste të me vlerë 189,604,962 lekë, likuidim me vonesë mbi afatin ligjor 30 ditor të pagesës nga data e mbërritjes së faturës. Rastet më konkretisht paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr. 43: Pagesat per investimet llogaria 230-231 "Shpenzime për investime"

Nr.		Urdhër Shpenzimi			Fatura		
		VITI 2020					
	Ush	Datë	Vlera	Përshkrimi	Nr	Datë	Vlera
1	497	10.03.2020	6,516	Kolaudim :Riparim me asfaltobeton i demtuara ne territorin bashkise	126	28.10.2019	6,516
2	500	10.03.2020	418,754	Mbikqyrje:Sistemim-asfaltim i rruges Hyrese thumane	940	20.05.2019	418,754
3	501	10.03.2020	7,318	Kolaudim:Sist-asfalt i rrugeve mazhe e madhe dhe korriku	92	10.07.2019	7,318
4	502	10.03.2020	3,208	Kolaudim:Sist-asfalt i rruges Marin Barleti	90	03.07.2019	3,208
5	503	10.03.2020	9,600	Kolaudim:Sist-asfalt i rruges Mazhe e Vogel	414	29.05.2019	9,600
6	504	10.03.2020	216,476	Mbikqyrje:Sistemim-asfaltim i rrugeve te Sinurit	176	28.10.2019	216,476
7	505	10.03.2020	11,220	Kolaudim:Ndertim trotuari dhe ndricim rrugor nga qendra e bushneshit	05	01.02.2019	11,220
8	508	11.03.2020	2,948,986	Sist-asfalt i rrug NJA e gjimnazit Shote Galica dhe 9 vjecare Adem Gjeli	69	02.09.2019	2,948,986
9	510	11.03.2020	79,792	Mbikq:Sist-asfalt i rrug NJA e gjimnazit Shote Galica dhe 9 vjecare Adem Gjeli	112	19.09.2019	79,792
10	511	11.03.2020	4,900	Kolaud: Sist-asfalt i rrug NJA e gjimnazit Shote Galica dhe 9 vjecare Adem Gjeli	117	18.09.2019	4,900
11	537	11.03.2020	5,194	Kolaud:Ndertim Kuz Kameras e fshat fushe kruje	123	28.10.2019	5,194
12	538	11.03.2020	90,706	Mbikqyrje:Ndertim Kuz Kameras e fshat fushe kruje	117	04.10.2019	90,706
13	539	11.03.2020	1,670,511	Sist asfalt i rruges se rryteve Larushk F Kruje	20	20.04.2019	2,138,120
14	541	11.03.2020	329,489	Sist asfalt i rruges se rryteve Larushk F Kruje	23	30.04.2019	1,221,035
15	543	11.03.2020	98,994	Mbikqyrje:Sist asfalt i rruges se rryteve Larushk F Kruje	31	07.05.2019	98,994
16	544	12.03.2020	1,569,793	Ndertim Kuz Kameras fshat Fushe Kruje	4	25.04.2019	1,569,793
17	1100	02.06.2020	236,625	Mbikqyrje punimesh objekti: Sist asfalt i rr Abaz Ulliri Nikel,Kruje	135	11.12.2019	236,626
18	1282	22.06.2020	12,304	Kolaudim punimesh per objektin Rikonstruksion I shkolles Kurcaj	73	24.12.2018	12,304
19	1283	22.06.2020	87,691	Mbikqyrje punimesh objekti: Sist asfalt i rruge se Lateve,Larushk F.Kruje	328	13.02.2019	87,691
20	1284	22.06.2020	9,480	Kolaudim: Sistemim asfaltim I rrugeve te Sinurit fshat Fushe Kruje	293	09.12.2019	9,480
21	1285	22.06.2020	9,480	Kolaudim : Sistemim asfaltim I rruges se Rryteve Larushk Fushe Kruje	253	25.07.2019	9,480
22	1286	22.06.2020	9,600	Kolaudim punimesh objekti: Sistemim asfaltim I rruges Abaz Ulliri,nja Nikel	128	28.10.2019	9,600
23	1287	22.06.2020	4,296	Kolaud: Sistemim asfaltim I degezimit nr 1 te rruges se bashkise,nj adm F Kruje	60	02.09.2019	4,296
24	1288	22.06.2020	6,000	Kolaudim punimesh objekti: Ndertim Kuz-Kameras e fshat Fushe Kruje	360	29.05.2019	6,000
25	1289	22.06.2020	44,851	Mbikqyrje punimesh objekti: Ndertim Kuz Kameras e fshatit Fushe Kruje	28	24.04.2019	44,851
26	1627	28.07.2020	431,520	Ndert Kuz Sist e ndricim rrugor I rrug Kodheli nr 2 lagja Adem Gjeli Fushe Kruje	05	25.09.2018	431,520
27	1965	25.08.2020	577,178	Rikualifikim I dy qendrave urbane te qytetit	193	16.04.2019	577,178
28	2227	28.09.2020	13,920	Kolaudim punimesh:Rehabilitim I diges se ujembledhesit Tapize	15	10.06.2020	13,920
29	2228	28.09.2020	42,360	Mbikqyrje punimesh:Rikualifikimi I dy qendrave urbane	74	02.04.2019	42,360
30	2229	28.09.2020	6,000	Kolaudim punimesh:Rikualifikimi I dy qendrave urbane	358	28.05.2019	6,000
31	2317	02.10.2020	850,782	Mbikqyrje punimesh:Rehabilitim I diges se ujembledhesit Tapize	1	16.07.2020	850,782
32	2320	02.10.2020	695,831	Sist asf rrug Abazi e ndricim rrugor rrug Clirim e 5 Maji prane unaz vogel F Kruj	36	30.08.2019	695,831
33	2462	20.10.2020	86,276	Mbikqyrje punimesh:Sistemim asfaltim I rrugeve te lagjes Ziri,F Kruje	71	15.02.2019	86,276
34	2466	20.10.2020	9,600	Kolaudim punimesh: Sistemim asfaltim I rrugeve Ziri,F Kruje	364	27.05.2019	9,600
35	2467	20.10.2020	7,080	Kolaud: Sist asfa I rruges Myftari prane Burgut te Sigurise se Larte,F Kruje	271	01.10.2019	7,080
36	2468	20.10.2020	303,814	Mbikq:Sist asf I rruges nga superstrad varrez katolik Derven, Thumane,Loti nr 1	1050	01.10.2019	303,815
37	2738	26.11.2020	2,690,766	Sistemim asfaltim I rrugeve te lagjes Ziri F Kruje	01	30.01.2019	2,690,766
38	2740	26.11.2020	804,774	Sistemim asfaltim I rruges se Lateve,Larushk F Kruje	24	30.04.2019	804,774
39	2821	01.12.2020	69,647	Mbikq:Sist asf rr Abazi e ndric rrugor I rr clirim e 5 Maj pran unaz voge Lot VI	70	13.07.2019	69,647
40	2822	01.12.2020	8,400	Kolaud Sist asf rr Abazi e ndric rrugor I rr clirim e 5 Maj pran unaz voge Lot VI	89	03.07.2019	8,400
41	2825	01.12.2020	103,710	Mbikq: Sist asfaltim I rruges Myftari prane burgut te sigurise Nj Adm F Kruje	111	19.09.2019	103,710
42	2826	01.12.2020	1,937,810	Ndertim Kuz lagja B.Visha dhe sistemim asfaltim I rruges se Pepeve	53	20.09.2018	1,937,810
43	2994	24.12.2020	800,000	Mbikqyrje:Shtim I sasise se furnizimit me uje te qytetit te Krujes	36	19.08.2020	1,000,000
						Shuma	**18,890,409**

Viti 2021

Nr	Urdher Shpenzimi					Fatura	
	VITI 2021						
	Ush	Datë	Vlera	Përshkrimi	Nr	Datë	Vlera
1	262	12.02.2021	248,280	Blerje kompjutera per Bashkine Kruje	4830	24.12.2020	248,280
2	511	17.03.2021	2,145,230	Ndertim I linjes kryesore ujesjellesit Bubq lagja Doda Nj Bubq	180	19.02.2019	2,145,230
3	1213	24.06.2021	223,141	Mbikq Sist asf rrug nga stacioni trenit-Kisha Murqine , Bubq	988	04.07.2019	224,341

4	1408	09.07.2021	2,913,600	Sistemim-asfaltim I rruges Kruje-Picrrage,faza e II-te	3/2021	24.06.2021	2,913,600
5	1410	09.07.2021	10,000,000	Shtes kontra Zgjerim rrug hyres qytettit parki e rikual qendr qyte	37	21.05.2018	72,881,838
6	1412	09.07.2021	2,000,000	Projektim mbrojtje ne brigjet e lumit Zeze	33	02.11.2020	7,740,000
7	1675	24.08.2021	3,129,242	Sist-Asf sheshit para kishes e rrug lidhes,fsha Gramez, Thumane	18/2021	24.05.2021	5,155,292
8	1677	24.08.2021	152,670	Mbikq: Sist-Asf shesh para kishe e rrug lidhes,fsh Gramez,Thuma	29/2021	25.06.2021	152,670
9	1678	24.08.2021	10,710	Kolaud Sist-Asf shesh para kishe e rrug lidhes,fsh Gramez,Thuma	30/2021	25.06.2021	10,710
10	1925	30.09.2021	11,443,619	Shtes kontra Zgjerim rrug hyres qytettit parki e rikual qendr qyte	37	21.05.2018	72,881,838
11	1983	13.10.2021	44,000	Mbikqyrje: Shtim I sasise se furnizimit me uje te qytetit te Krujes	84	21.12.2020	44,000
12	2117	26.10.2021	164,443	Mbikq: Sist-asf rrug lidhes nga rr Sh.Cela-rr shkoll ,fshati Arramer	9/2021	08.07.2021	164,443
13	2118	26.10.2021	13,290	Kolaud:Sist-asf rrug lidhes nga rr Sh.Cela-rr shkoll ,fshati Arramer	31/2021	08.07.2021	13,290
14	2248	04.11.2021	6,545,340	Sistemim Asfaltim I rruges se Ukeve,Tapize Nj Adm Nikel,Kruje	5/2021	31.05.2021	7,171,944
15	2442	03.12.2021	3,672,322	Sistemim asfaltim I rruges Engjelli ,fshati Bilaj,Nj Adm Bubq ,Kruj	4/2021	31.05.2021	5,467,530
16	2444	03.12.2021	172,172	Mbikq; Sist asf I rruges Engjelli ,fshati Bilaj,Nj Adm Bubq ,Kruje	73/2021	08.10.2021	172,172
17	2445	03.12.2021	12,533	Kolaud; Sist asf I rruges Engjelli ,fshati Bilaj,Nj Adm Bubq ,Kruje	13/2021	08.10.2021	12,533
18	2446	03.12.2021	226,176	Mbikq: Sist Asfaltim I rruges se Ukeve,Tapize Nj Adm Nikel,Kruje	74/2021	08.10.2021	226,176
19	2447	03.12.2021	17,638	Kolaud:Sist Asfal I rruges se Ukeve,Tapize Nj Adm Nikel,Kruje	14/2021	08.10.2021	17638.00
20	2636	24.12.2021	2,055,180	Sistemim asfaltim I rruges se shkolles Qereke,Nj Adm Nikel	145/2021	09.08.2021	2,055,180
21	2639	24.12.2021	8,908	Kolaud Sist Asfal I rruges se shkolles Qereke ,Nj adm Nikel Kruje	41/2021	15.10.2021	8,908
22	2640	24.12.2021	5,167,236	Sist-asfaltim I rruges se Trojes ,Bushnesh,Nj A Thumane Kruje	37/2021	25.10.2021	5,167,236
23	2646	24.12.2021	3,337,415	Sistemim asfaltim I rrugeve te lagjes Magaze,Nj A Fushe Kruje	33/2021	08.10.2021	4,730,113
						Shuma	**189,604,963**

Burimi: Bashkia Krujë

Titulli gjetjes 24:*Mbi pagesat nëpërmjet bankës të faturave të mbërritura mbi afatin 30 ditor.*

Situata: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 89 raste faturash me vlerë 220,833,627 lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Krujë, *e ndarë 57* raste në vlerën 25,633,208 lekë janë kryer pagesa të vonuara në vitin 2020 dhe 32 raste në vlerën 195,200,419 lekë në vitin 2021, ku në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh (mos realizim të ardhurash).

Kriteri: Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 52[16], me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò i ndryshuar, neni 44 ñKontrolli i shpenzimeveò

Ndikimi: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të pa likuiduara

Shkaku: Likuidim me vonese i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh i pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh. ndërsa një pjesë e rasteve ka ardhur edhe si rezultat i vendosjes së limit të kufizuar të arkës për likuidim nga MFE në fund të viteve ushtrimore 2020- 2021,duke shtyrë radhën e likuidimeve.

Rëndësia:I mesëm

Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

[16]në të cilën përcaktohet se*: "Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik."*

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet me magazinën.

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga Nën/Kryetari.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi zj. S. S. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe të hartueses së Pasqyrave Financiare.

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2020-31.12.2021.

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 ï 31.12.2021, nevojat për prokurime në Bashkinë Krujë janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat e sektorëve përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për secilin vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e studimit të nevojave reale që ka njësia vendore për punë, mallra e shërbime, si dhe në përputhje të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.

Për vitin 2020: Bashkia Krujë ka zhvilluar gjithsej 40 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 628,619,891 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 604,228,328.1 lekë pa TVSH, diferencë midis tyre prej 24,391,562.9 lekë pa TVSH, ose në masën 3.8 % të fondit limit pa TVSH, të prokuruar, nga të cilat:

- **Blerje me vlerë të vogël,** 18 procedura, me fondin limit në total prej 8,348,406.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 6,086,382.00 lekë, duke kursyer shumën prej 2,262,024.00 lekë;
- **Negocim pa shpallje**, 3 procedura, me fondin limit në total prej 5,583,333.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 3,414,076.00 lekë, duke kursyer shumën prej 2,169,257.00 lekë;
- **E hapur,** 5 procedura, me fondin limit në total prej 586,974,992.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 574,370,954.00 lekë, duke kursyer shumën prej 12,604,038.00 lekë;
- **Kërkesë për propozim**, 11 procedura, me fondin limit në total prej 27,481,827.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 20,125,916.10 lekë, duke kursyer shumën prej 7,355,910.90 lekë;
- **Procedura nën 100 mijë lekë**, 3 procedura, me fondin limit në total prej 586,974,992.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 231,000.00 lekë, duke kursyer shumën prej 333.00 lekë;

Për vitin 2021: Bashkia Krujë ka zhvilluar gjithsej 87 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 1,078,789,821.00 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 1,001,416,509.00 lekë pa TVSH, diferencë midis tyre prej 77,373,312.00 lekë pa TVSH, ose në masën 7.1 % të fondit limit pa TVSH të prokuruar, nga të cilat:

- **Blerje me vlerë të vogël,** 23 procedura, me fondin limit në total prej 11,270,831.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 8,861,368.00 lekë, duke kursyer shumën prej 2,409,463.00 lekë;
- **Negocim pa shpallje**, 1 procedurë, me fondin limit në total prej 833,333.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 830,000.00 lekë, duke kursyer shumën prej 3,333.00 lekë;
- **E hapur,** 8 procedura, me fondin limit në total prej 136,686,165.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 116,137,479.00 lekë, duke kursyer shumën prej 20,548,686.00 lekë;
- **Kërkesë për propozim**, 36 procedura, me fondin limit në total prej 151,025,499.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 97,890,903.00 lekë, duke kursyer shumën prej 53,134,596.00 lekë;
- **E kufizuar,** 11 procedura, me fondin limit në total prej 778,255,660.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 777,040,389.00 lekë, duke kursyer shumën prej 1,215,271.00 lekë;
- **Procedura nën 100 mijë lekë**, 8 procedura, me fondin limit në total prej 718,333.00 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 656,370.00 lekë, duke kursyer shumën prej 61,963.00 lekë;

*****

Për aktivitetin e vitit 2020 janë audituar 3 procedura të llojit e hapur me vlerë totale të fondit limit 547,344,955 lekë pa TVSH ose 87%.

1. Procedura e prokurimit me objekt: ***"Shërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujën" viti 2020.***

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**:** ñ*Shërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujën"* **viti 2020**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 236, datë 12.05.2020	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 237, datë 12.05.2020:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. R. D. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E Hapurò		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 16,624,110 lekë	**6. Oferta fituese** Ré 96 ShPK, me vlerë 16,537,418.6 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 86,691 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 05.06.2020	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i bashkisë 2020 (të ardhurat + transfertat specifike)	**10. Operatorët Ekonomikë** a) BOE ñRé 96ò ShPK dhe ñLé 2é 7ò ShPK b) OE ñFé ò ShPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 25.06.2020	**15. Vlera e kontratës (me TVSH)**	**19,844,902.3**

Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë ka vendosur që shërbimin me objekt:*Shërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujën"* ta kryejë me marrëveshje kuadër me afat 1 vjeçar bazuar në Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 914 ñPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Bashkia Krujë për prokurimin e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane pranë Njësisë së Prokurimit është paraqitur kërkesa me nr. 2232 Prot., datë 12.05.2020 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Investimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori gjendet dokumentacioni:

- Preventivi me çmime (ditor, mujor, vjetor);
- Grafiku i shërbimit (ditor, mujor, vjetor);
- Specifikime teknike;
- Relacioni teknik;
- Inventari i rrugëve dhe kontenierëve;
- Hartat.

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrin nr. 236 datë 12.05.2020 ñPër zhvillimin e procedurës së hapur ï marrëveshje kuadër për 12 muaj me objekt ñShërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. të zhvillojnë procedurën për shërbimin e pastrimit me vlerë të Fondit Limit (FL) 16,624,110 lekë. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 12.05.2020 me afat kohor për dorëzimin e ofertave datë 05.06.2020. Lloji i procedurës ñe hapurò është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 12.05.2020.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 12.05.2020 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim pastrimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò çmimin më të ulët.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike është Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve Publike referuar Urdhrit nr. 57, datë 22.01.2020 ñPër ngarkimin e strukturave përgjegjëse në Bashkinë Krujë për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit të parashikuara për vitin 2020ò.

Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar nga z. E. S. - Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve Publike, shkresë e datës 12.05.2020. Sipas kësaj shkrese OE duhet të vërtetojnë se disponojnë:

- Sipërfaqe sheshi në pronësi ose me qira për vendqëndrimin dhe shërbimin e përditshëm të mjeteve teknologjike;
- Numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës 23 punonjës përfshirë dhe stafin e përhershëm;
- Mjetet dhe makineritë e mëposhtme për kryerjen e shërbimit:

Nr.	Lloji i makinerisë	Njësia	Sasia
1	Autofshesë me fshesa rrul e flutur	copë	1
2	Kamion teknologjik plehrash	copë	1
3	Autobot uji për larje/larje specifike rrugësh	copë	1
4	Kontenierë të lëvizshëm për hedhje mbeturinash.	copë	4
5	Fadromë me goma me kapacitet të kovës 0.25-1 m^3	copë	1

Llogaritja e fondit limit

Fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò është llogaritur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Investimeve dhe është orientuar në tetë lloj shërbimesh:

1. Pastrim me autofshesë i rrugëve, shesheve e trotuareve - me vlerë vjetore 3,891,269.4 lekë pa TVSh;
2. Pastrimi me fshesë i rrugëve, shesheve dhe trotuareve - me vlerë vjetore 3,346,235.2 lekë pa TVSh;

3. Transport mbetje urbane ï me vlerë vjetore 5,410,066.4 lekë pa TVSh;
4. Pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh ï me vlerë vjetore 293,578.8 lekë pa TVSh;
5. Larje rrugësh, sheshesh dhe trotuaresh ï me vlerë vjetore 1,626,956.1 lekë pa TVSh;
6. Pastrim territori urban ï me vlerë vjetore 1,683,704 lekë pa TVSh;
7. Sistemim, ngarkim dheu, zhavorrishte, inerte, barishte, etj., me ekskavator 0.25 m^3 në mjet ï me vlerë vjetore 212,500 lekë pa TVSh;
8. Transport dheu, inerte, barishte, etj. ï me vlerë vjetore 159,800 lekë pa TVSh;

Shuma vjetore e fondit limit është përllogaritur 16,624,109.9 lekë pa TVSh.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim pastrimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 12.05.2020.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura nga NJP janë në përputhje me llojin e shërbimit që kërkohet të prokurohet nga Bashkia Krujë.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 237, datë 12.05.2020 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. F. C. (Kryetar), zj. I. H. dhe z. R. D.

Më datë 05.06.2020 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò me FL 16,624,110 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) ñRé 96ò SHPK me NIPT K13é 10W dhe ñLé 2é 7ò ShPK me NIPT K77é 01L, dhe OE ñFé ò ShPK me NIPT K31é 10F. KVO ka vendosur se i duhet më shumë se një ditë punë kohë për të vlerësuar ofertën.

Më datë 09.06.2020 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit ñtë hapurò me objekt ñShërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò me FL 16,554,072.05 lekë. Është sõkualifikuar OE ñFé ò ShPK për mosplotësim dokumentacioni sipas DST. Nga auditimi rezulton se OE nuk i plotësonte kriteret e kërkuara. Është kualifikuar oferta e BOE ñRé 96ò SHPK dhe ñLé 2é 7ò ShPK **me vlerë oferte 16,537,418.6 lekë pa TVSh**, i cila nga auditimi rezulton se i plotëson kriteret e kërkuara.

Raporti përmbledhës nr. 2884 Prot., është hartuar nga KVO dhe miratuar nga titullari i AK më datë 17.06.020.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 2884/1 Prot, është hartuar më datë 18.06.2020 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 37 datë 22.06.2020.

Në përfundim të procedurave për ofrimin e shërbimit të pastrimit në Qytetin e Fushë-Krujës me BOE është lidhur kontratë sipërmarrje me nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr. 302, datë 25.06.2020 ñPër lidhje dhe zbatim kontrateò me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me BOE ñRé 96ò ShPK dhe ñLé 2é 7ò ShPKështë lidhur kontrata me vlerë 16,537,418.6 lekë pa TVSh dhe 19,844,902.3 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës është hartuar më datë 03.07.2020 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 42, datë 13.07.2020.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës që do të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit në Qytetin e Fushë-Krujës është ngritur me urdhrat e Kryetarit të Bashkisë nr. 303, datë 25.06.2020 me përbërje z. N. L., z. R. Gj. dhe z. R. A.

1. Raportimet

Nga auditimi rezulton se, kontraktuesi nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020, neni 13, pika 1 dhe pika 2 ñ1. *Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore në të cilat duhet të parashikojë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për proceset e punës, sipas preventivit në përputhje me Specifikimet Teknike. Në raporte duhet të paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikëqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjithave rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë si dhe një përmbledhje të të gjithave situacioneve të cilat ja përcjell kontraktuesi gjatë kësaj kohe. 2. Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Krujë 5(pesë) kopje të raportit vjetor brenda 5(pesë) ditëve nga përfundimi i kontratës shoqëruar me situacionin e fundit të shërbimit".*

2. Edukimi ambiental

Nga auditimi rezultoi se, kontraktuesi për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2020-2021 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambjenteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambjental i cili, duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Veprime këto që janë në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020, nenin 18, pika 1 dhe pika 2 ñ1. *Kontraktuesi duhet të zhvillojë një program të edukimit publik të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të Qytetit të Fushë Krujës... 2. Kontraktuesi duhet të kryejë një herë në 6 muaj Program Edukimi Ambiental i cili do të përbëhet nga prodhimi dhe transmetimi i një spoti televiziv sipas idesë dhe përmbajtjes së AK..."*

Në kushtet e mos realizimit të programe të edukimit publik dhe ambjental supervizorët e AK nuk kanë aplikuar gjoba ndaj kontraktuesit në kundërshtim me përcaktimet e kontratës, neni 28 ñPenalitet dhe gjobatò, germa f)*Në rast se kontraktuesi nuk përbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 18 dhe kapitullit të "Specifikimeve Teknike", për kryerjen e Edukimit Publik Ambiental, supervizorët e Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Krujë aplikojnë gjobë në masën 500,000 (pesëqind mijë) lekë. Kontraktuesit do t'i njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambiental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambiental Autoriteti Kontraktor vendos penalitetin e radhës në masën 1,000,000 (një milion) lekë. Gjobat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor në situacionin e radhës të paraqitur për likuidim nga ana e Kontraktorit.*

3. Kontenierët

Nga vizitat në terren të grupit të auditimit në disa rrugë të Qytetit të Fushë Krujës u konstatua se kontenierët ishin të amortizuar dhe të pa pajisur me rrota e të pa larë.

Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e kontratës të shërbimit të pastrimit neni 20, pika 4 *"Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve kur këta të fundit dëmtohen..."*.

Gjithashtu, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë proces verbal apo dokument tjetër justifikues në të cilin të identifikohet dëmtimi i rrotave të kontenierëve ose zëvendësimi i tyre për zërit pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh për ndërrimin përkatësisht të 206 rrota kontenierësh * 600 lekë = 123,600 lekë, si dhe 9 % të fitimit dhe 8 % e shpenzimeve për këtë zë, në total për 144,612 lekë.

Në dokumentacionin e paraqitur supervizorët e AK gjatë kryerjes së mbikëqyrjes dhe monitorimit të shërbimit nuk rezulton që të kenë konstatuar raste të mungesës së konteinerëve apo dëmtimit të tyre, si rezultat supervizorët e AK nuk kanë aplikuar ndalesat ndaj kontraktuesit në kundërshtim me përcaktimet e kontratës, neni 28, germa d) ñ*Në rastet kur konstatohet mungesa apo dëmtimi i konteinerëve të vënë në dispozicion nga AK, ...të*

specifikuara nga specifikimet e ndodhura për çdo rast ose/dhe çdo shkak. Kontraktuesi është i detyruar të paguajë kundravleftën e konteinerit të dëmtuar. Në raste se nuk kryhet riparimi i konteinerit ose zëvendësimi i tij nga ana e Kontraktorit atëherë AK mban vlerën e dëmit ose konteinerit sipas vlerës së kontabilizuar nga Bashkia Krujë nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim".

Kuota e amortizimit të kontenierëve llogaritet në preventivin e OE në 10% amortizim për kontenier ose në vlerën 164,800 lekë në vit, ndërkohë që kontenierët janë në inventarin e bashkisë, si dhe 9 % të fitimit dhe 8 % e shpenzimeve për këtë zë, në total për 192,816 lekë. Ky veprim bie në kundërshtim me përllogaritjen e fondit limit për zërin pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh si dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñMenaxhimi i aktiveve të Njësisë së Sektorit Publikò, pika III/30 ku citohet: ñ*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia." Gjithashtu, nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë ndonjë riparim të kontenierëve për të cilin të mund të llogaritet ndonjë vlerë tjetër mbi zërat e përmendur për pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh.*

4. Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit

Nga auditimi lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes dhe monitorimit të shërbimit të pastrimit nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 3032 datë 25.06.2020 me përbërje z. N. L., z. R. Gj., z. K. B. dhe z. R. A., rezultoi se referuar proces verbaleve ditore të mbajtura nga grupi i punës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës nga 248 ditë (për periudhën nga data 01.07.2020 ï 30.06.2021, duke mos llogaritur ditët pushim dhe ditët e festave zyrtare për të dy vitet sipas periudhave) vetëm 160 ditë janë kryer kontrolle dhe monitorime lidhur me realizimin e zërave të kontratës së pastrimit.

Sa më sipër rezulton se, grupi i punës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit në Qytetin e Krujës nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratën nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020, neni 22, pikat 1,2,3,4,5 *"1. Supervizorët e Autoritetit Kontraktor në prani të përfaqësuesve të autorizuar të Kontraktuesit, kryejnë kontroll ditor të shërbimit sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor... 2. Supervizorët mbajnë proces verbale dhe situacione ditore për masën e kryerjes së shërbimit aplikojnë ndalesa gjoba dhe llogarisin masën e penaliteteve për punë të pakryer sipas dispozitave kontratës. 3.Situacionet ditore vendosen në sasi sipas çdo zëri pune të shprehur në lekë në përputhje me proces verbalet ditore dhe preventivin e kontratës. 4. Situacionet ditore hartohen nga Supervizorët e Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Krujë në prani ose jo të Drejtuesit Teknik të Shërbimit të Pastrimit, për punën e kryer, sipas orarit dhe grafikut të punimeve të miratuara nga të dyja palët... 5. Situacionet mujore do të hartohen në bazë të proces verbaleve dhe situacioneve ditore të nënshkruara nga të dyja palët.*

Titulli i gjetjes 25:*Mangësi në procesin e mbikëqyrjes.*

Situata: Nga auditimi lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes dhe monitorimit të shërbimit të pastrimit nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 3032 datë 25.06.2020, rezultoi se referuar proces verbaleve ditore të mbajtur, nga 248 ditë (për periudhën nga data 01.07.2020 ï 30.06.2021, duke mos llogaritur ditët pushim dhe ditët e festave zyrtare për të dy vitet sipas periudhave) vetëm 160 ditë janë kryer kontrolle dhe monitorime lidhur me realizimin e zërave të kontratës së pastrimit duke mos pasqyruar informacion mbi cilësinë e kryerjes së shërbimit të pastrimit për ditët e tjera.

Kriteri: Kontrata nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020, neni 22, pikat 1, 2, 3, 4, 5.
Efekti: Mos pasqyrim i saktë i situatës nga shërbimi i ofruar.
Shkaku: Neglizhencë në përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes
Rëndësia:E mesme
Rekomandim: Grupet e punës që kanë detyrën e mbikëqyrjes së zbatimit të kontratës të marrin masa për mbikëqyrjen ditore të shërbimit të pastrimit duke pasqyruar në akt kontrollet e mbajtura çdo element të kontratës si dhe duke dhënë një vlerësim për përmbushjen e metodologjive të aplikuara si dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.
Titulli i gjetjes 26:*Mangësi në raportimet që duhet të paraqes OE mbi përmbushjen e kontratës së vitit 2020*
Situata: Nga auditimi rezulton se, për shërbimin e pastrimit për vitin 2020 OE nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi lidhur me emrat dhe titujt e personelit mbikëqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjitha rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë.
Kriteri: Kontrata nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020, neni 13, pika 1 dhe pika 2.
Efekti: Mungesë transparence në monitorimin e zbatimit të kontratave.
Shkaku: Neglizhencë në përmbushjen e përcaktimeve të kontratës së vitit 2020.
Rëndësia:E mesme
Rekomandim:Në të ardhmen mbikëqyrësi i zbatimit të kontratës të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë për detyrimet që ka OE si dhe pasqyrimin me përpikëri të përmbushjes së përcaktimeve të kontratës në çdo element të saj.
Titulli i gjetjes 27:*Mos hartimi dhe aplikimi i edukimit ambiental për kontratën e vitit 2020.*
Situata: Nga auditimi rezultoi se, kontraktuesi për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2020 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambjental i cili, duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Si pasojë e mos përmbushjes së këtij detyrimi, autoriteti kontraktor duhet të kishte aplikuar gjoba ndaj kontraktuesit si vijon: Në rast se kontraktuesi nuk përbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 18 dhe kapitullit të "Specifikimeve Teknike", për kryerjen e Edukimit Publik Ambiental, supervizorët e Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Krujë aplikojnë gjobë në masën 500,000 (pesëqind mijë) lekë. Kontraktuesit do tã njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambiental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambiental Autoriteti Kontraktor vendos penalitetin e radhës në masën 1,000,000 (një milion) lekë. Gjobat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor në situacionin e radhës të paraqitur për likuidim nga ana e Kontraktorit.
Kriteri: Kontrata nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020, nenin 18, pika 1 dhe pika 2 dhe neni 28 germa f.
Efekti: Mospërmbushje e detyrimeve kontraktore për edukimin ambiental të qytetarëve.
Shkaku: Neglizhencë në përmbushjen e detyrimeve.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò për mospërmbushjen e kushteve të kontratës së pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.
Titulli i gjetjes 28:*Likuidimi i punimeve të pakryera.*
Situata: Nga vizitat në terren të grupit të auditimit në disa rrugë të Qytetit të Fushë Krujës u konstatua se kontenierët ishin të amortizuar dhe të pa pajisur me rrota e të pa larë.Gjithashtu, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë proces verbal apo dokument tjetër justifikues në të cilin të identifikohet dëmtimi i rrotave të kontenierëve ose zëvendësimi i tyre

për zërin pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh për ndërrimin përkatësisht të 206 rrota kontenierësh.
Kriteri: Kontrata nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020, neni 20, pika 4.
Efekti: Likuidim i vlerës prej 144,612 lekë (206 rrota kontenierësh * 600 lekë = 123,600 lekë, si dhe 9 % të fitimit dhe 8 % e shpenzimeve për këtë zë), pavarësisht mos kryerjes së ndërrimit të rrotave të kontenierëve.
Shkaku: Mangësi në mbikëqyrjen dhe dokumentimin e shërbimeve të mirëmbajtjes për kontenierët.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për arkëtimin e vlerës 144,612 lekë për shërbimin e pakryer të ndërrimit të rrotave të kontenierëve, nga BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò.

Titulli i gjetjes 29:*Përfshirja në mënyrë të gabuar në vlerën e kontratës të amortizimit të kontenierëve.*
Situata: Nga auditimit rezulton se, në zërat që përbëjnë vlerën e kontratës është përfshire dhe kuota e amortizimit të kontenierëve në masën 10 % ose në vlerën164,800 lekë në vit, ndërkohë që kontenierët janë në pronësi dhe pjesë e aseteve në inventarin e bashkisë dhe si do aktiv tjetër amortizimi i tyre është pakësim në zërin kapital. Ashtu si edhe vetë bashkia e ka shprehur në neni 28, germa d) ñ*Në rastet kur konstatohet mungesa apo dëmtimi i konteinerëve të vënë në dispozicion nga AK, …të specifikuara nga specifikimet e ndodhura për çdo rast ose/dhe çdo shkak. Kontraktuesi është i detyruar të paguajë kundravleftën e konteinerit të dëmtuar. Në raste se nuk kryhet riparimi i konteinerit ose zëvendësimi i tij nga ana e Kontraktorit atëherë AK mban vlerën e dëmit ose konteinerit sipas vlerës së kontabilizuar nga Bashkia Krujë nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim",* zëri kontenierë është kontabilizuar në pasqyrat financiare të bashkisë dhe do shtesë apo pakësim i ka efektet në kapitalin e bashkisë dhe jo të OE. Po kështu pavarësisht që përfaqësuesit e bashkisë e cilësojnë këtë vlerë amortizimi si për fond për mirëmbajtje, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë formë dokumentimi apo evidence që të jenë identifikuar dëmtime dhe më tej riparime ose mirëmbajtje të kontenierëve. Për këtë zë është përshirë në vlerën e kotratës edhe 9% të fitimit dhe 8% e shpenzimeve për këtë zë, në total për 192,816 lekë për vitin 2020.
Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñMenaxhimi i aktiveve të Njësisë së Sektorit Publikò, pika III/30 dhe kontrata e shërbimit të pastrimit, neni 28, germa d.
Efekti: Llogaritje në mënyrë të gabuar si pjesë e kontratë vlera prej192,816 lekë.
Shkaku:Përfshirja në mënyrë të gabuar në vlerën e kontratës të amortizimit të kontenierëve.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për kthimin e vlerës 192,816 lekë për amortizimin e kontenierëve nga BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò, si dhe mos përfshirjen e këtij zëri në vlerën e kontratave të ardhshme.

2. Procedura e prokurimit me objekt: "Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Krujë" viti 2020
Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "*Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Krujë*" viti 2020**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 118 datë 18.02.2020	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 119, datë 18.02.2020:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. I. Sh. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E Hapurò		

5. Fondi Limit (pa TVSH) 39,996,270 lekë	**6. Oferta fituese** BOE ñDé ò SHPK dhe ñFé ò SHPK me vlerë oferte39,789,658 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit** 206,612 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 24.03.2020	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i bashkisë (të ardhurat + transferta e pakushtëzuar)	**10. Operatorët Ekonomikë** BOE ñD...ò SHPK dhe ñF...ò SHPK
11. Ankimime AK, **Nuk ka**	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** **Nuk ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 08.04.2020	**15. Vlera e kontratës (me TVSH)**	**47,747,589**

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit

Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë ka vendosur që shërbimin me objekt:*"Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Krujë"* ta kryejë me marrëveshje kuadër me afat 2 vjeçar bazuar në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, neni 30, neni 35/1, pika 1 ñ*Për kontratat publike, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër pas kryerjes së një procedure të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence apo me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, ndërsa për kontratat sektoriale, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër edhe pas kryerjes së një procedure me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit*ò, si dhe VKM-së nr. 914 ñPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Bashkia Krujë për prokurimin e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane pranë Njësisë së Prokurimit është paraqitur kërkesa me nr. 1041 Prot, datë 18.02.2020 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Investimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori gjendet dokumentacioni:

- Preventivi me çmime (ditor, mujor, vjetor dhe 2 vjeçar);
- Grafiku i shërbimit (ditor, mujor, vjetor dhe 2 vjeçar);
- Specifikime teknike;
- Relacioni teknik;
- Inventari i rrugëve dhe konteinerëve;
- Hartat e territorit që do të mbulohet me shërbim.

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrin nr. 118, datë 18.02.2020 ñPër zhvillimin e procedurës së hapur ï marrëveshje kuadër për 24 muaj me objekt ñPastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Krujëò.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. të zhvillojnë procedurën për shërbimin e pastrimit me vlerë të Fondit Limit (FL) 39,996,270 lekë. Të tre anëtarët e NJP kanë firmosur formularin e deklarimit të konfliktit të interesit.

Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 27.02.2020 me afat kohor për dorëzimin e ofertave datë 24.03.2020. Lloji i procedurës ñe hapurò është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër protokolli të mbajtur më datë 18.02.2020.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 18.02.2020 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim pastrimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane për Qytetin e Krujësò çmimin më të ulët.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike është Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve Publike referuar Urdhrit nr. 57, datë 22.01.2020 ñPër ngarkimin e strukturave përgjegjëse në Bashkinë Krujë për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit të parashikuara për vitin 2020ò.

Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar nga z. E. S. - Drejtor Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve Publike, shkresa pa numër Prot e datës 18.02.2020. Sipas kësaj shkrese OE duhet të vërtetojnë se disponojnë:
- sipërfaqe për vendqëndrimin e mjeteve në pronësi ose me qira brenda territorit të Bashkisë Krujë;
- Numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës 24 punonjës përfshirë dhe stafin e përhershëm;
- Mjetet dhe makineritë e mëposhtme për kryerjen e shërbimit

Nr.	Lloji i makinerisë	Njësia	Sasia
1	Autofshesë me fshesa rrul e flutur	copë	1
2	Kamion vetëshkarkues me peshë mbajtëse 5 ton	copë	1
3	Fadromë me goma me kapacitet të kovës 0.25-1 m^3	copë	1
4	Kamion teknologjik plehrash (kompaktor) me kapacitet mbajtës deri në 7 ton	copë	1
5	Autobot uji për larje/larje speciale rrugësh	copë	1
6	Konteinerë të lëvizshëm për hedhje mbeturinash (Karroca)	copë	4
7	Konteinerë mbeturinash 11001 (1.1 m^3)	copë	22
8	Kamion teknologjik plehrash (kompaktor) me kapacitet mbajtës mbi 7 ton	copë	1

Llogaritja e fondit limit

Fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt ñPastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Krujëò është llogaritur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Investimeve e cila me shkresën nr. 1041 Prot, datë 18.02.2020 i ka dërguar NJP në Bashkinë Krujë kërkesën për realizimin e procedurës së sipërcituar. Bashkëlidhur kërkesës janë edhe dokumentet përkatëse për llogaritjen e fondit limit si, grafikët e shërbimeve ditor, mujor dhe vjetor, preventivat përmbledhës për zërat e shërbimeve ditor, mujor dhe vjetor si dhe analiza teknike e kostos së pastrimit sipas llojeve të shërbimeve. Referuar dokumentacionit përkatës shërbimi i pastrimit dhe largimi i mbetjeve urbane në Qytetin e Krujës është orientuar në tetë lloj shërbimesh, si vijon:

1. Shërbim pastrimi me autofshesë i rrugëve, shesheve dhe trotuareve - me vlerë vjetore 3,782,240 lekë pa TVSH;
2. Shërbim pastrimi me fshesë i rrugëve, shesheve dhe trotuareve - me vlerë vjetore 3,346,200 lekë pa TVSH;
3. Transport i mbetjeve urbane ï me vlerë vjetore 9,349,360.3 lekë pa TVSH;
4. Pastrim, larje, dezinfektim dhe mirëmbajtje konteinerësh ï me vlerë vjetore 493,777.7 lekë pa TVSH;
5. Larje rrugësh, sheshesh dhe trotuaresh ï me vlerë vjetore 1,626,900 lekë pa TVSH;
6. Pastrim territori urban ï me vlerë vjetore 1,262,655 lekë pa TVSH;
7. Sistemim, ngarkim dheu dhe inerte me ekskavator 0.25 m^3 në mjet ï me vlerë vjetore 75,000 lekë pa TVSH;
8. Transport dheu dhe inerte ï me vlerë vjetore 56,100 lekë pa TVSH;

Shuma vjetore e fondit limit është përllogaritur 19,992,233 lekë pa TVSH, për 2 vite është 39,984,446 lekë pa TVSH.

Për zërat e shërbimeve nga 1-6 është bërë llogaritja e analizës teknike të kostos nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Investimeve ndërsa për zërat 7 dhe 8 kosto është llogaritur bazuar në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim pastrimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane për Qytetin e Krujësò NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër, më datë 18.02.2020.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura nga NJP janë në përputhje me llojin e shërbimit që kërkohet të prokurohet nga Bashkia Krujë.

Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 119 datë 18.02.2020 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. F. C. (Kryetar), znj. I. H. dhe z. I. Sh.

Më datë 24.03.2020 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt ñPastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Krujëò me FL 39,996,270 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) ñDé ò SHPK me NIPT L34é 01V dhe ñFé ò SHPK me NIPT J61é 18S.

Më datë 25.03.2020 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit ñtë hapurò me objekt ñPastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Krujëò me FL 39,996,270 lekë. Nuk ka operatorë të sõkualifikuar, ka paraqitur ofertë vetëm BOE ñDé ò SHPK dhe ñFé ò SHPK **me vlerë oferte 39,789,658.56 lekë pa TVSH**, i cili është kualifikuar nga KVO.

Nga auditimi i dokumenteve të OE fitues rezulton se në DT është kërkuar ñKamion vetëshkarkues me peshë mbajtëse 5 tonò ndërsa nga BOE është paraqitur kamioni me targa AA9é LB me kapacitet nga 7.5-18 ton.Për mjetinFadromë me goma me kapacitet të kovës 0.25-1 m^3 dokumentacioni i paraqitur nga BOE nuk tregon kapacitetin e kovës së fadromës.

Raporti përmbledhës nr. 1765 Prot, është hartuar nga KVO më datë 02.04.2020, duke iu referuar raportit përmbledhës Titullari i AK ka miratuar po më datë 02.04.2020 vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 1765/1 Prot, është hartuar më datë 02.04.2020 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 18 datë 06.04.2020.

Në përfundim të procedurave për ofrimin e shërbimit të pastrimit në Qytetin e Krujës me BOE janë lidhur dy kontrata sipërmarrje me afat një vjeçar, kontrata nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe kontrata nr. 2500 Prot datë 16.04.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin nr. 187, datë 08.04.2020 ñPër lidhje dhe zbatim kontrateò me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me BOE ñDé ò SHPK dhe ñFé ò SHPKjanë lidhur dy kontrata sipërmarrje me afat një vjeçar, kontrata nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 me vlerë 19,894,829 lekë pa TVSHdhe 23,873,795 lekë me TVSH, dhe kontrata nr. 2500 Prot datë 16.04.2021 me vlerë 19,890,537 lekë pa TVSHdhe 23,868,645 lekë me TVSH. Formulari i njoftimit të kontratës është hartuar më datë 28.10.2020 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 94, datë 02.11.2020.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës që do të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit në Qytetin e Krujës është ngritur me urdhrat e Kryetarit të Bashkisë nr. 188, datë 08.04.2020 dhe nr. 227 datë 16.04.2021 me përbërje z. F. N., z. E. G. dhe z. Sh. M.

1. Kryerja e shërbimit të pastrimit në rrugët që kryhen punime

Titulli i gjetjes 30:*Pagesë për realizimin e shërbimit të pastrimit në rrugën "Lekë Zaharia",për periudhën që ajo ka qenë në rikonstruksion.*

Situata: Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit në regjistrin e realizimit të prokurimeve për vitin 2021 dhe listës së investimeve të përfunduara po në këtë vit rezulton se në Qytetin e Krujës është sistemuar dhe asfaltuar rruga ñLekë Zahariaò që bën pjesë në listën e rrugëve dhe shesheve të Njësisë Vendore Krujë për tõu pastruar. Punimet janë kryer në afatet 26.05.2021 - 03.08.2021

Referuar kushteve të kontratave nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, neni 11, pika 11.6 ñ*Kontraktuesi do të ndërpresë zbatimin e punimeve të shërbimit të pastrimit, për një afat kohor të caktuar, në ato raste kur për shkaqe teknike (punime për rikonstruksionin e rrugëve, kryerja e shërbimit ose e një pjese të shërbimit është e pamundur. Ndërprerja e shërbimit ose modifikimi i tij, për këtë rast do të kryhet vetëm pas njoftimit zyrtar dhe miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë*ò.
Nga auditimi rezultoi se, nuk ka asnjë korrespondencë apo dokumentacion të besueshëm midis AK Bashkia Krujë dhe Kontraktuesit lidhur me mos realizimin e shërbimit të pastrimit në këtë rrugë për periudhën që ajo ka qenë në rikonstruksion si dhe zëvendësimin e saj me rrugë të tjera që janë sistemuar në vitin paraardhës dhe nuk janë pjesë e kontratës, sipas afatit të punimeve. Sipas llogaritjeve, zërat e punimeve që nuk janë kryer në këtë rrugë për periudhën që ajo ka qenë në rikonstruksion janë në vlerën 42,332 lekë.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Data e fillimit të punimeve	Data e përfundimit të punimeve	Zërat e punime që duhet të kryheshin	Vlera për secilin zë	Vlera totale
1	Sistemim-asfaltim i rrugës "Lekë Zaharia", Krujë.	26.05.2021	03.08.2021	Pastrim me autofshesë Pastrim me fshesë Larje	17,800 16,141 8,391	**42,332**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kontratave nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, neni 11, pika 11.6 si dhe tabelës së rrugëve për tô pastruar, e miratuar nga AK ñ*nërastin e kryerjes së punimeve në rrugë apo sheshe të veçanta të kësaj tabele, gjatë periudhës së kontraktimit, mbikëqyrësi i kontrasës duhet të pezullojë procesin e pastrimit me fshesë e autofshesë, si dhe larjet, deri në njoftimin për përfundimin e punimeve. Në kompensim të sipërfaqeve e volumeve të kontratës për rastet kur punohet mund të shtohen rrugicat e asfaltuara në vitin paraardhës e të papërfshira në tabelë dhe të zbriten rrugët që do të asfaltohen në vitin aktual e që përfshihen brenda tabelës"*.
Kriteri: Kontrata e pastrimit nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, neni 11, pika 11.6.
Ndikimi: Pagesë e kontrakturesit në kundërshtim me përcaktimet e kontratës, në vlerën **42,332lekë.**
Shkaku: Mos zbatimi i kushteve të kontratës së pastrimit.
Rëndësia:E mesme
Rekomandim: Nga Bashkia Krujë të merren masa për arkëtimin e vlerës **42,332lekë** nga BOE ñDé ò SHPK dhe ñFé ò paguar për periudhën që rruga ñLekë Zahariaò ka qenë duke u sistemuar dhe nuk janë kryer shërbimet e pastrimit dhe larjes.

2. Raportimet - Edukimi ambiental - Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit
Titulli i gjetjes 31:*Mos zbatim i neneve të kontratës së pastrimit nga kontraktuesi.*
Situata 1 Raportimet: Nga auditimi rezulton se, kontraktuesi nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi në kundërshtim me kushtet e kontratave nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, neni 13, pika 1 dhe pika 2 ñ1. *Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore në të cilat duhet të parashikojë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për proceset e punës, sipas preventivit në përputhje me Specifikimet Teknike. Në raporte duhet të paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjithave rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar*

në kontratë si dhe një përmbledhje të të gjithave situacioneve të cilat ja përcjell kontrakuesi gjatë kësaj kohe. 2. Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Krujë 5(pesë) kopje të raportit vjetor brenda 5(pesë) ditëve nga përfundimi i kontratës shoqëruar me situacionin e fundit të shërbimit".

Situata 2 Edukimi ambiental: Nga auditimi rezultoi se, kontraktuesi për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2020-2021 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambjenteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambjental i cili duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Veprime këto që janë në kundërshtim me kushtet e kontratave nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, nenin 18, pika 1 dhe pika 2 ñ1. *Kontraktuesi duhet të zhvillojë një program të edukimit publik të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të Qytetit të Krujës... 2. Kontraktuesi duhet të kryejë një herë në 6 muaj Program Edukimi Ambiental i cili do të përbëhet nga prodhimi dhe transmetimi i një spoti televiziv sipas idesë dhe përmbajtjes së AK..."*

Në kushtet e mos realizimit të programe të edukimit publik dhe ambjental supervizorët e AK nuk kanë aplikuar gjoba ndaj kontraktuesit në kundërshtim me përcaktimet e kontratave, neni 28 ñPenalitet dhe gjobatò, germa f)*Në rast se kontraktuesi nuk përbush detyrimin e përcaktaur në kontratë sipas nenit 18 dhe kapitullit të "Specifikimeve Teknike", për kryerjen e Edukimit Publik Ambiental, supervizorët e Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Krujë aplikojnë gjobë në masën 500,000(peseqindmije) lekë. Kontraktuesit do t'i njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambiental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambiental Autoriteti Kontraktor vendos penalitetin e radhës në masën 1,000,000 (njëmilion) lekë. Gjobat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor në situacionin e rradhës të paraqitur për likuidim nga ana e Kontraktorit.*

Situata 3 Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit: Nga auditimi lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes dhe monitorimit të shërbimit të pastrimit nga grupi i punës i ngritur me urdhrat nr. 188, datë 08.04.2020 dhe nr. 227 datë 16.04.2021 me përbërje z. F. N., z. E. G. dhe z. Sh. M., rezultoi se referuar proces verbaleve ditore të mbajtura nga grupi i punës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës nga 632 ditë (për periudhën nga data 08.04.2020 -31.12.2021) vetëm 73 ditë janë kryer kontrolle dhe monitorime lidhur me realizimin e zërave të kontratës së pastrimit. Sa më sipër rezulton se, grupi i punës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit në Qytetin e Krujës nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratat nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, neni 22, pikat 1,2,3,4,5 *"1. Supervizorët e Autoritetit Kontraktor në prani të përfaqësuesve të autorizuar të Kontraktuesit, kryejnë kontroll ditor të shërbimit sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor... 2. Supervizorët mbajnë proces verbale dhe situacione ditore për masën e kryerjes së shërbimit aplikojnë ndalesa gjoba dhe llogarisin masën e penaliteteve për punë të pakryer sipas dispozitave kontratës. 3. Situacionet ditore vendosen në sasi sipas çdo zëri pune të shprehur në lekë në përputhje me proces verbalet ditore dhe preventivin e kontratës. 4. Situacionet ditore hartohen nga Supervizorët e Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Krujë në prani ose jo të Drejtuesit Teknik të Shërbimit të Pastrimit, për punën e kryer, sipas orarit dhe grafikut të punimeve të miratuara nga të dyja palët... 5. Situacionet mujore do të hartohen në bazë të proces verbaleve dhe situacioneve ditore të nënshkruara nga të dyja palët.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi grupi i punës për mbikëqyrjen e kontratës së shërbimit të pastrimit z. *F. N., z. E. G. dhe z. Sh. M.*

Kriteri: Kontrata e pastrimit nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, neni 13, pika 1 dhe pika 2, nenin 18, pika 1 dhe pika 2, neni 22, pikat 1,2,3,4,5.

Ndikimi: Mos ofrim i shërbimit të pastrimit në përputhje me përcaktimet në kontratën e pastrimit.
Shkaku: Mos zbatimi i kushteve të kontratës së pastrimit dhe monitorim jo efektiv nga grupi i punës për mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE ñDé ò SHPK dhe ñFé òpër moszbatimin e kushteve të kontratave të pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.

3. Makineritë
Nga verifikimi i makinerive të deklaruara që do të përdoren për realizimin e shërbimit të pastrimit për periudhën e vlefshmërisë së kontratës rezultoi se:
1. Autofshesë me fshesa rrul e flutur ï Në dokumentacionin e marrjes pjesë në procedurën e prokurimit publik OE ka paraqitur mjetin me targë Aé T 15 marrë me qira me një afat të pacaktuar konform kërkesave të përcaktuara në DT. Nga verifikimi rezulton se OE disponon mjetin me targa Aé T 87 të cilin e ka me certifikatë pronësie të datës 03.10.2021.
2. Kamion vetëshkarkues me peshë mbajtëse 5 ton ï OE disponon mjetin me targa AA9é B i paraqitur në dokumentacion e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.
3. Fadromë me goma me kapacitet të kovës 0.25-1 m^3 ï Në dokumentacionin e marrjes pjesë në procedurën e prokurimit publik OE ka paraqitur mjetin me targë Kr 7é 4A marrë me qira konform kërkesave të përcaktuara në DT. Nga verifikimi rezulton se OE disponon mjetin me targa Aé T 36 të cilin e ka me certifikatë pronësie të datës 15.03.2022.
4. Kamion teknologjik plehrash (kompaktor) me kapacitet mbajtës deri në 7 ton ï OE disponon mjetin me targa AA0é I i paraqitur në dokumentacion e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.
5. Autobot uji për larje rrugësh ï OE disponon mjetin me targa AA5é I i paraqitur në dokumentacion e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.
6. Kamion teknologjik plehrash (kompaktor) me kapacitet mbajtës mbi 7 ton ï Në dokumentacionin e marrjes pjesë në procedurën e prokurimit publik OE ka paraqitur mjetin me targë AA1é D konform kërkesave të përcaktuara në DT. Nga verifikimi rezulton se OE e ka shitur mjetin me targa AA1é D dhe disponon mjetin me targa AB9é C të cilin e ka me certifikatë pronësie të datës 16.11.2020. Kapaciteti i mjetit të ri është në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në DT.

3. Procedura e prokurimit me objekt: "Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë"viti 2020
Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "***Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë***" viti 2020**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 172 datë 18.03.2020	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 119, datë 18.02.2020:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. I. K. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E Hapurò		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 490,724,575 lekë	**6. Oferta fituese** BOE ñBé ò SHPK, ñEé ò SHPK dhe ñBé ò SHPK me vlerë oferte 489,345,776 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit** 1,378,799 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 20.04.2020	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** BOE ñBé ò SHPK, ñEé ò SHPK dhe ñBé ò SHPK; OE ñGé Cé ò SHPK.

11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 15.05.2020	**15. Vlera e kontratës (me TVSH)**	587,214,932 lekë

Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit

Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë është procedurë e financuar nga buxheti i shtetit. Me shkresën nr. 495 Prot, datë 14.02.2020 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është dërguar detajimi i buxhetit të viteve 2020-2022 për shpenzime kapitale me financim të brendshëm për programin ñFurnizimi me ujë dhe kanalizimeò, në Bashkinë Krujë. Buxheti total i planifikuar në 3 vite është në vlerën 490,724,575 lekë pa TVSH (98,144,915 lekë, 98,144,915 lekë, 294,434,745 lekë) dhe588,869, 490 lekë me TVSH, (117,773,898 lekë, 117,773,898 lekë, 353,321,694 lekë).

Mbështetur në shkresën e sipër cituar Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (DPKT) në Bashkinë Krujë me shkresën nr. 1671 Prot, datë 18.03.2020, ka paraqitur kërkesë Njësisë së Prokurimit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë*ò, me vlerë të fondit limit 490,724,575 lekë. Bashkëlidhur kërkesës DPKT ka dorëzuar edhe dokumentacionin:

- Preventiv me çmime;
- Grafiku i ekzekutimit të punimeve;
- Specifikime Teknike;
- Raport Teknik;
- Raport Mjedisor;
- Projekti Teknik;
- Kriteret e veçanta të kualifikimit.

Llogaritja e fondit limit

Vlera totale e investimit e llogaritur bazuar në projektet dhe preventivat e hartuara nga studio projektuese ñEé ò SHPK, është 471,095,592 lekë pa TVSH 588,869,490 lekë me TVSH.

Investimi përbëhet nga katër zëra kryesore punimesh me nënzërat përkatës:

Rikonstruksion i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë:

1. Ndërtim pus i ri në stacionin Hasan - me vlerë 3,649,479 lekë me TVSH;
2. Punime në godinën e stacionit - me vlerë 9,126,147 lekë me TVSH;
    a. Punime ndërtimore
    b. Punime elektrike
3. Tubacion transmetimi, tubacion shpërndarje Depo-Qytet - me vlerë 434,476,643 lekë me TVSH;
    a. Punime asfaltimi në trupin e rrugës/rrjeti shpërndarës
    b. Punime asfaltimi në trupin e rrugës/rrjeti kryesor
    c. Tubacione ujësjellësi rrjeti shpërndarës
    d. Instalim i matësve në Qytetin e Fushë Krujës
    e. Instalim i matësve në Qytetin e Krujës
    f. Punime kalim kanalesh të hapura prog.1+580-1+600
    g. Punime kalim kanalesh të hapura prog.4+100-4+100
    h. Materialet për ajrueset
    i. Ndërtim pusete në rrjetin shpërndarës prog. 2+280
4. Ndërtim depo - me vlerë 141,617,220 lekë me TVSH;
    1. Punime betoni
    2. Punime elektrike

3. Punime ndërtimore
4. Projekti i instalimit të tubacioneve në dhomën e manovrimit

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me përcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 ñPër Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyreò, i ndryshuar.

Hartimi i specifikime teknike dhe DT

Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 171 datë 18.03.2020 ñPër caktimin e personave përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për objektin ñ*Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë*ò, ka caktuar z. G. H. me detyrë Përgjegjës i Prokurimeve në Bashkinë Krujë dhe z. R. L. me detyrë Inxhinier në UKK Sh.A Krujë të hartojnë kriteret e veçanta të kualifikimit. Grupi i punës me proces verbalin pa numër protokolli datë 18.03.2020 ka hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit ñ*Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë*ò.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 172 datë 18.03.2020 ku ka ngarkuar NJP me përbërje z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt ñ*Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë*ò me vlerë të fondit limit 490,724,575 lekë pa TVSH. Më datë 18.03.2020 NJP ka mbajtur dy proces verbale pa numër protokolli ku ka përcaktuar që lloji i procedurës së prokurimit të jetë *"e hapur"* dhe si kriter vlerësues të ofertave ñ*çmimin më të ulët*ò.

Njësia e Prokurimit ka hartuar më datë 18.03.2020 proces verbalin pa numër protokolli për hartimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit për procedurën e hapur me objekt ñ*Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë*ò.

Shpallja e procedurës është bërë në Buletinin e APP-së nr. 15 datë 24.03.2020.

Titulli i gjetjes 32:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në hartimin e kritereve në DT.*

Situata: Nga auditimi i kritereve të vendosura në DT janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe të pa argumentuara, përkatësisht:

1.Në DT pika 2.3.2. Licensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës/MIE, është kërkuar që OE duhet të paraqesë licencën e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin si më poshtë vijon:

N.P ï 12C (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

N.S ï 19 A (Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë)

Referuar projekt preventivit të punimeve, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 ñPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò.

Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme të licencave, është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, neni 46, pika 1 ñ*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese*ò, dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 26,

pika 5, ñ*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenënë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*ò.

2. Në DT pika 2.3.5/a kërkohet që **"**Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë ose pajisur me licencë individuale pjesë të stafit te tij, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë: 4 (katër) Inxhinier Ndërtimi; 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, profili transport; 1 (një) Inxhinier Elektrik; 3 (tre) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik; 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik; 2 (dy) Inxhinier Mjedisi; 2 (dy) Inxhinier Mekanik; 2 (dy) Inxhinier Gjeolog.

Nga grupi i punës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe NjP nuk është argumentuar numri i inxhinierëve 17 (shtatëmbëdhjetë) me zërat dhe volumin e punimeve.

2.3.5/b ñ*Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar 3 (tre) Teknik Ndërtimi + 1 (një) Teknik Topograf të vërtetuar me kontratë pune, cv, librezë pune, Licencë Zbatimi e lëshuar nga ministria përkatëse, me eksperiencë mbi 15 vite pune ku njëri prej tyre duhet të jetë i specializuar dhe i pajisur me licencë për Grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum Publik dhe largimit të ujerave të ndotura, lëshuar nga Enti rregullator i sektorit të furnizimit me ujë"*.

Kriteri i vendosur nga AK lidhur me eksperiencën në punë mbi 15 vite konsiderohet i panevojshëm pasi në momentin që Teknikët e Ndërtimit dhe Tekniku Topograf janë pajisur me Licencë Zbatimi nga autoritetet përgjegjës, tregon se kanë kapacitetet dhe eksperiencën e mjaftueshme për të kryer punimet e specifikuara në licencën që disponojnë. Gjithashtu, kërkesa për teknikë ndërtimi dhe teknikë topograf është e panevojshme në momentin që janë kërkuar inxhinier në këto fusha.

3. Në DT pika 2.3.9- është kërkuar ñ*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Licence për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, <u>1 Mjek të Përgjithshëm</u>. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) Mjek të Përgjithshëm".*

4. Në DT pika 2.3.11- është kërkuar:a)**"***Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës ose të duhet të ketë kontraktuar <u>1 Ekspert Zjarrfikës</u> i pajisur me licence dhe i regjistruar si subjekt në QKR (eksperti) , kontrata e lidhur ndërmjet OE dhe Ekspertit zjarrfikës e nënshkruar ndërmjet palëve duhet të përfshijë në kohëzgjatjen e saj të gjithë periudhën e vlefshmërisë së kontratës e cila prokurohet në këtë procedurë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin. Detyrimisht të paraqitet certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria e MZSH.*

b)Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) Ekspert Zjarrfikës.

Kriteret e pikës 2.3.9 dhe 2.3.11 nuk janë në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 74, pika 3, *"...Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje*ò

AK nuk mund të kërkojë nga 1 Mjek të Përgjithshëm dhe 1 Ekspert Zjarrfikës për secilin OE por duhet të vlerësojë dhe argumentojë sa Mjek të Përgjithshëm dhe Ekspertë Zjarrfikës

duhen gjithsej si dhe duhet të përcaktojë kërkesën në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punime. AK kriteret për stafin inxhinierik, stafin teknik dhe punonjësit e tjerë i kërkon në total pavarësisht nëse është BOE apo jo, ndërsa për Mjek të Përgjithshëm dhe Ekspertë Zjarrfikës thjesht kërkon nga një për secilin operator në rast bashkimi, pa vlerësuar nevojat reale për këto lloj specialistësh.

5. Në DT pika2.3.12-Personeli dhe fuqia punëtore kërkohet që ñ*Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës dhe për të provuar këtë kusht duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën, Janar 2019 - Mars 2020 i të paktën 250 (dyqind e pesëdhjetë) personave duke përfshirë stafin e përhershëm*ò.

Nga NjP nuk është argumentuar numri i fuqisë punëtore (250) në përputhje me natyrën volumin dhe grafikun e punimeve, duke vështirësuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik me rezultat uljen e konkurrencës.

6.Në DT pika 2.3.16-*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, kërkohen mjetet si vijon*:

Mjetet	***Sasia***	***Gjëndja***
Kamion me kapacitet mbajtës minimum 15-20 (njëzet) ton	*25 (copë)*	*Pronësi / qira*
Kamione vetshkarkues 5 – 10 ton	*3 (cope*	*Pronësi / qira*
Kamionçine kapaciteti mbajtës ÷5 ton	*5 (copë)*	*Pronësi / qira*
Fadrome me goma	*3 (copë)*	*Pronësi / qira*
Minifadroma	*4 (copë)*	*Pronësi / qira*
Minieskavator	*4 (copë)*	*Pronësi / qira*
Eskavator me goma	*3 (copë)*	*Pronësi / qira*
Eskavator me zinxhir	*6 (cope)*	*Pronësi / qira*
Autobetoniere	*1 (copë)*	*Pronësi / qira*
Betoniere Kantieri	*8 (copë)*	*Pronësi / qira*
Vibrator betoni	*4 (copë)*	*Pronësi / qira*
Autovinç (Kamion me vinc)	*3 (copë)*	*Pronësi / qira*
Autobot Uji	*5 (copë)*	*Pronësi / qira*
Makineri për ngjitje tubash PE	*2 (copë)*	*Pronësi / qira*
Apart testimimi tubacioneve nën presion	*1 (copë)*	*Pronësi / qira*
Cekiç hidraulik për eskavatore /matrapik	*2 (copë)*	*Pronësi / qira*
Kompaktor ngjeshës (pjaster Vibruese ose tokmak)	*1 (copë)*	*Pronësi / qira*
Motogjenerator,gjenerator	*2 (copë)*	*Pronësi / qira*
Saldatriçe	*3 (copë)*	*Pronësi / qira*
Kompresor	*2 (copë)*	*Pronësi / qira*
Pompë uji	*4 (copë)*	*Pronësi / qira*
Mjete për transport tubash (gjysëm rimorkio)	*2 (copë)*	*Pronësi / qira*
Depozita uji	*4 (cope)*	*Pronësi / qira*
Instrument Topogjeodezik (total station)	*1 (copë)*	*Pronësi / qira*
Asfaltoshtruese	*2 (copë)*	*Pronësi / qira*
Rrul cilindër-cilindër 10-12 ton asfalti	*2 (copë)*	*Pronësi / qira*
Autobitumatriçe	*2 (copë)*	*Pronësi / qira*
Makineri dhe Nyje inerte e pajisur me kodin 3.I.B QKL	*1 (copë)*	*Pronësi / qira*
Fabrikë Asfalti e pajisur me kodin 3.I.B	*1 (copë)*	*Pronësi/ kontratë furnizimi*

NjP nuk ka argumentuar numrin mjeteve teknike të nevojshme për realizimin e punimeve. Gjithashtu, kërkesa për *"Makineri dhe Nyje inerte e pajisur me kodin 3.I.B QKL, në pronësi ose me qira"* duke përjashtuar mundësinë e marrjes me ñK*ontratë furnizimi"* është një kërkesë diskriminuese dhe përjashtuese.

7. Në DT pika 2.3.17- është kërkuar: ò*Do të organizohet një vizitë në kantier datë **14.04.2020** në mënyrë të tillë që Operatoret Ekonomikë të mund të familjarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar ekonomik duhet të konfirmoje paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë dhe shpjegime në lidhje me objektin ku do ndërhyhet si dhe mënyrën e financimit sipas*

*kushtëzimeve nga burimi i financimit. Të gjitha kostot e OE që lidhen me vizitën në kantier do të mbulohen nga vetë ata. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Sektorit të Prokurimit Publik Bashkia Krujë. Të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në procedurë duhet të paraqiten në kantier për të cilën do të pajisen me vërtetim nga Bashkia Krujë, mosparaqitja e këtij vërtetimi është kusht s'kualifikues*ò.

Ky kriter është hartuar referuar Kreut II. Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, Seksioni 1. Hartimi i ofertës, pika 1.3 *"(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier në _____ (dd/mm/vv) në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familjarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime dhe të cilat do tu shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomikë. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur".*

Vendosja e një kriteri të tillë në kriteret e veçanta për kualifikim konsiderohet i tepërt pasi nga autoriteti kontraktor është ngarkuar në SPE informacion i hollësishëm dhe i mjaftueshëm mbi gjendjen aktuale të objektit si dhe janë publikuar ñPreventivi i punimeveò, ñRelacioni Teknikò, ñSpecifikimet Teknikeò, ñGrafiku i punimeveò, ñProjekti i Zbatimitò, etj. Mos pjesëmarrja në takimin e organizuar, nuk mund të penalizojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës gjatë vlerësimit të ofertave për të konsideruar të suksesshme ose jo ofertën e tyre ekonomike të dorëzuar në procedurën e prokurimit. Pra, ky kriter nuk duhet të ishte vendosur si kusht sõkualifikues.

8. Në DT pika 2.3.18 *Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë Certifikatat e Standardizimit si vijon të vlefshme*:

- Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ***ISO 9001:2015;***

- *Certifikatën e menaxhimit të cilësisë* ***ISO 14001-2015;***

Certifikata ISO 14001-2015 është e dubluar me Certifikatën ISO 9001:2015 dheështë e panevojshme për këtë objekt prokurimit, pasi karakteristikat e mallrave dhe punimeve janë përshkruar hollësisht në projekt preventiv, dhe AK ka detyrimin ligjor të monitorojë zbatimin e kontratës.

- Certifikatën e sigurisë së trafikut rrugor ***ISO39001-2012;***

- *Certifikatën e sigurisë së trafikut rrugor* ***PASS 99-2012;***

Certifikatë ISO 39001-2012dhe PASS 99-2012 përcaktojnë kërkesat minimale të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor.Të dyja certifikatat e sipërcituara janë për sigurinë e trafikut rrugor, janë të dubluara, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe ndikojnë në operatorët ekonomik pjesëmarrës në prokurim.

- *Certifikatën e menaxhimit të energjisë* ***ISO50001-2012;***

Certifikata ISO 50001-2012 është një standard për të hartuar, zbatuar dhe mbajtur sistemet e menaxhimit të energjisë. Lidhet me hartimin e politikave për një përdorim sa më eficient të energjisë si dhe përdor të dhënat për të kuptuar më mirë vendimmarrjen për përdorimin e energjisë, pra vendos qëllimet dhe objektivat për të përmbushur politikat. Kjo certifikatë nuk gjen mbështetje dhe është e panevojshme për këtë objekt prokurimi.

- *Certifikatën për menaxhimin e sigurisë së informacionit* ***ISO 27001:2013;***

Certifikata ISO 27001:2013 është një standard që lidhet me menaxhimin e sigurisë së informacionit, specifikon kërkesat për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit brenda organizatës. Ky standard nuk gjen mbështetje dhe është i panevojshëm për këtë objekt prokurimi pasi projekti nuk ka të bëjë me asnjë përcjellje informacioni apo menaxhim informacioni. Informacioni dhe të dhënat që janë të nevojshme për realizimin e këtij projekti

janë publikuar konform kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk përbëjnë informacion sekret apo të klasifikuar.

- *Certifikatën për sistemin e menaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimit* ***ISO 28001:2007****;*

Certifika ISO 2800:2007 është një standard që paraqet kërkesat dhe udhëzimet për organizatën në zinxhirin e furnizimit ndërkombëtar, për të krijuar dhe zbatuar proceset e sigurisë së zinxhirit të furnizimit, për të ngritur dhe dokumentuar nivelin minimal të sigurisë në zinxhirin e furnizimit ose në segmente të caktuara të tij. Ky standard gjithashtu, nuk është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

- Certifikatën për sistemin e veshjes së kanaleve ***CEN/TR 13331-1:2002****.*

Nga shqyrtimi i zërave të preventivit nuk konstatohet të ketë zë që lidhet me veshjen e kanaleve në këto kushte kërkesa e këtij standardi nuk është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Vendosja kritereve për certifikatat e listuara më sipër është në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, neni 30 ñKërkesat e cilësisëò, pika 1 dhe pika 2 ku përcaktohet se: *"1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit".*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NjP z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. dhe z. R. L. me detyrë Inxhinier në UKK Sh.A Krujë.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, neni 46, pika 1, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, neni 26, pika 5, neni 30, pika 1 dhe pika 2, neni 74, pika 3.

Ndikimi: Ulje e numrit të OE që paraqesin interes për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën 489,345,776 lekë pa TVSH.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kritereve nga NJP dhe specialistët e ngarkuar për hartimin e kritereve specifike të përzgjedhjes dhe vendosje e kritereve pa argumentim.

Rëndësia:E lartë

Rekomandim: Njësia e Prokurimit në çdo rast të përcaktimit të kritereve kualifikuese, duhet të analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim. Gjithashtu, nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë më përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT.

Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 173, datë 18.03.2020 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. C. (Kryetar), znj, I. H. (Anëtare) dhe z. I. K. (Anëtar).

KVO më datë 20.04.2020 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë*ò. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 2 operatorë ekonomik/BOE, si më poshtë:

1. BOE ñBé ò SHPK, ñEé ò SHPK dhe ñBé ò SHPK, me vlerë ekonomike të ofertës

489,345,776 lekë pa TVSH;

2. OE ñGé Cé ò SHPK, me vlerë ekonomike të ofertës 490,599,550 lekë pa TVSH.

KVO më datë 22.04.2020 ka hartuar proces verbalin e vlerësimit për procedurën e prokurimit ñe hapurò me objekt ñ*Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë*ò. Pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e OE, KVO ka argumentuar si më poshtë:

1. OE ñGé Cé ò SHPKme vlerë ekonomike të ofertës 490,599,550 lekë pa TVSHnuk ka dorëzuar dokumentacionin e rregullt sipas kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në DT. Nga auditimi rezultoi se OE **nuk** i plotëson kriteret e vlerësuara edhe nga KVO si mangësi.

2. Ka dorëzuar dokumentacionin ligjor dhe atë teknik në përputhje me kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta për kualifikim, sikurse janë kërkuar në DT BOE ñBé ò SHPK, ñEé ò SHPK dhe ñBé ò SHPK, me vlerë ekonomike të ofertës 489,345,776 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, rezulton se KVO ka bërë vlerësimin e ofertave për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim duke kualifikuar **BOE "B…" SHPK, "E…" SHPK dhe "B…" SHPK, me vlerë ekonomike të ofertës 489,345,776 lekë pa TVSH**.

Për vendimmarrjen e KVO-së nuk ka patur ankesa nga OE i sõkualifikuar.

Raporti përmbledhës me nr. 2108 Prot, është hartuar nga KVO më datë 30.04.2020. Duke iu referuar raportit përmbledhës Titullari i AK ka miratuar po më datë 30.04.2020 vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 2108/1 Prot, është hartuar më datë 04.05.2020 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 26 datë 11.05.2020.

Nuk ka ankesa nga OE i sõkualifikar.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin nr. 240, datë 15.05.2020 ñPër lidhje dhe zbatim kontrateò me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me BOE ñBé ò SHPK, ñEé ò SHPK dhe ñBé ò SHPK është lidhur kontrata me nr. 2281 Prot, datë 15.05.2020 me vlerë 489,345,776 lekë pa TVSHdhe 587,214,932 lekë me TVSH. Formulari i njoftimit të kontratës është hartuar më datë 18.05.2020 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 30, datë 26.05.2020.

Operatorët Ekonomikë kanë nënshkruar kontratën e bashkimit me nr. 1344, datë 17.04.2020 ku angazhohen në kryerjen e punimeve më masën: ñBé ò SHPK ï 60% (351,785,405 lekë), ñBé ò SHPK ï 25% (147,587,996 lekë) dhe ñEé ò SHPK ï 15% (87,965,530 lekë).

Titulli i gjetjes 33: *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua si më poshtë vijon:

1. OE ñEé ò SHPK nuk plotëson kriterin **2.3.1 b)** *"punëve të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është në shumën prej **981,449,150** lekë pa TVSH... duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim".*

2. Referuar dokumentacionit të paraqitur stafi inxhinierik i kërkuar në pikën **2.3.5-a),** të DT nuk plotëson kriterin ñ*Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, ... si dhe të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit*ò. Pjesa më e madhe e stafit inxhinierik të paraqitur figuron në listë pagesat e Operatorëve Ekonomik përkatës duke variuar nga 9-11 muaj me ndërprerje.

3. OE ñBé ò SHPK nuk plotëson kriterin **2.3.11-a)***"Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës ose të duhet të ketë kontraktuar një Ekspert Zjarrfikës...Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) Ekspert Zjarrfikës.*

4. OE ñBé ò SHPK nuk plotëson kriterin **2.3.12- "***Personeli dhe fuqia punëtore: Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës ... duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën, Janar 2019 - Mars 2020 i të paktën 250 (dyqind e pesëdhjetë) personave duke përfshirë stafin e përhershëm*ò.

Referuar dokumentacionit të paraqitur për periudhën Janar 2019 - Mars 2020numri i punonjësve të OE ñBé ò SHPK varion nga 131-157, dhe numri mesatar i punonjësve të deklaruar për këtë periudhë është 142. Në kontratën e bashkimit OE ñBé ò SHPK do të kryejë 60% të punimeve që e përkthyer kjo në numër punonjësish është 150 punonjës.

Sa trajtuar më sipër BOE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DT dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE ñBé ò SHPK, ñBé ò SHPK,ò dhe ñEé ò SHPK, si dhe nuk duhet tôi kishte propozuar Titullarit të AK shpalljen fitues të tyre. KVO ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 24 ñAnulimi i një procedure prokurimiò, pika nr.1, germa (ç) ñ*Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm (ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit",*neni 46 ñKualifikimi i ofertuesveò, pika 1, ñ*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese*ò dhe neni 53 ñShqyrtimi i ofertaveò, pika 3, *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji".*

Duke shpallur fitues BOE ñBé ò SHPK, ñBé ò SHPK,ò dhe ñEé ò SHPK, të cilët nuk i plotësojnë kriteret e DT, është lidhur kontratë me vlerën **587,214,932 lekë me TVSH** me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit për Prokurimet Publike.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së z. F. C., znj. I. H. dhe z. I. K.

Kriteri: Ligji nr. 9643,datë20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar,neni 24 pika 1,germa ç, neni 46 pika 1, neni, 53, pika 3.

Ndikimi: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

Shkaku: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Krujë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

*****

Për aktivitetin e vitit 2021 janë audituar gjithsej 10 procedura të llojit e hapur/kërkesë për propozim/e kufizuar me vlerë totale të fondit limit 638,086,632 lekë pa TVSH ose 60%.

Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2021 – 31.12.2021	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	87	1,078,789,821	1,001,416,509
-Të hapura	8	136,686,165	116,137,479
-Negocim pa shpallje	1	833,333	830,000
- Kërkesë me propozim	36	151,025,499	97,890,903
- E Kufizuar	11	778,255,660	777,040,389

Procedura 01.01.2021 – 31.12.2021	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
- Blerje e vogël	23	11,270,831	8,861,368
- Procedura nën 100 mijë lekë	8	718,333	656,370

1.Procedura e prokurimit me objekt: "Sistemim asfaltim i rrugës Krujë-Picrragë (Faza e II-të)", viti 2021.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "***Sistemim asfaltim i rrugës Krujë-Picrragë (Faza e II-të)***" viti 2021**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 179 datë 23.03.2020	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 180, datë 23.03.2021:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. I. K. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E Hapurò		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 14,312,643 lekë	**6. Oferta fituese** ñKé ò SHPK me vlerë oferte 8,674,960 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit** 5,637,683 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 26.04.2021	**9. Burimi Financimit:**Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** ñBé ò SHPK, ñKé Dé ò SHPK, ñUé ò SHPK, ñKé ò SHPK, ñNé ò SHPK, ñAé ò SHPK, BOE ñOé ò SHPK dhe ñAé Ké ò SHPK, ñZé ò SHPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** Nuk ka	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 24.05.2021	**15. Vlera e kontratës (me TVSH)**	10,409,952 lekë

Nga auditimi rezulton se, kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kulifikuar nuk u konstatuan parregullsi. OE i kualifikuar dhe shpallur fitues përmbush kriteret e vendosura në DT.

2. Procedura e prokurimit me objekt: "Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)" viti 2021.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "***Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)***" viti 2021**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 207 datë 02.04.2021	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 208, datë 02.04.2021:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. Xh. M. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E Hapur e thjeshtuarò		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 3,437,134 lekë	**6. Oferta fituese** ñEé ò SHPK me vlerë oferte3,412,420 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit** 24,714 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 19.04.2021	**9. Burimi Financimit:** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** ñEé ò SHPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** Nuk ka	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 05.05.2021	**15. Vlera e kontratës (me TVSH)**	4,094,904 lekë

Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit

Sektori i Bordit të Kullimit në Bashkinë Krujë me shkresën nr. 2162 Prot, datë 02.04.2021, ka paraqitur kërkesë Kryetarit të Bashkisë dhe për dijeni Njësisë së Prokurimit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò. Bashkëlidhur kërkesës Sektori i Bordit të Kullimit ka dorëzuar edhe dokumentacionin:

- Preventivi për të tre objektet;
- Specifikimet Teknike për të tre objektet;
- Relacion Teknik;
- Grafiku i punimeve për të tre objektet;
- Kërkesat e veçanta të kualifikimit;
- Projekt zbatimi për të tre objektet.

Llogaritja e fondit limit

Projekt preventivi për investimin me objekt ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò është hartuar nga studio projektuese ñEé Cé Gé ò dhe është si vijon:

- Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës me vlerë të zërave të punimeve 1,666,667 lekë pa TVSH;
- Rehabilitimi i Përroit të Bardhit me vlerë të zërave të punimeve 1,000,000 lekë pa TVSH;
- Rehabilitimi i pritës lumore Murqinë me vlerë të zërave të punimeve 770,046 lekë pa TVSH;

Vlera totale e Fondit Limit është llogaritur 3,437,134 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me përcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 ñPër Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyreò, i ndryshuar.

Hartimi i specifikime teknike dhe DT

Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 04 datë 05.01.2021 ñPër ngarkimin e strukturave përgjegjëse në hartimin dhe përgatitjen e kërkesave të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike të procedurave të prokurimit publik për vitin 2021ò ka ngarkuar Sektorin e Bordit të Kullimit për të hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò. Në zbatim të urdhrit të sipër cituar z. K. L. më datë 02.04.2021 ka hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin për procedurën e prokurimit me objekt ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 207 datë 02.04.2021 ku ka ngarkuar NJP me përbërje z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò me vlerë të fondit limit 3,437,134 lekë pa TVSH. Më datë 02.04.2021 NJP ka mbajtur dy proces verbale pa numër protokolli ku ka përcaktuar që lloji i procedurës së prokurimit të jetë *"procedurë e hapur e thjeshtuar"* referuar ligjit nr. 162/2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 49 dhe VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò, neni 39 dhe si kriter vlerësues të ofertave do të jetë ñ*oferta ekonomikisht më e favorshme e bazuar në çmim*ò referuar përcaktimeve të ligjit nr. 162/2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 87 dhe VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò, neni 31.

Njësia e Prokurimit ka hartuar më datë 02.04.2021 proces verbalin pa numër protokolli për hartimin dhe miratimin e dokumentave të tenderit për procedurën e hapur me objekt ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò.

Shpallja e procedurës është bërë në Buletinin e APP-së nr. 54 datë 12.04.2021.
Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në VKM-në nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò, neni 39, pika 4, NJP më datë 07.04.2021 ka mbajtur proces verbalin për dërgimin ftesë ndaj 5 OE për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.
Titulli i gjetjes 34:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në hartimin e kritereve në DT.*
Situata: Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuan kritere të ekzagjeruara dhe të paargumentuara si vijon:
1. Në DT pika **2.4.1***"Liçensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës/MIE". O.E duhet të kenë domosdoshmërisht Liçencë Profesionale të shoqërisë për realizimin e punëve, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, "NP - 6/A Diga dhe tunele hidroteknike".* Kjo kërkesë është e panevojshme, nuk është në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit dhe zërat e punimeve të preventivit.
2. Në DT pika **2.3.9-** ñ*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Kandidati/ofertuesi duhet të disponojë makineritë dhe mjetet si vijon në pronësi ose me qira.*

I.MAKINERI	***Njësia***	***Sasia***	***Pronësia***
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	*copë*	*2*	*Pronësi ose me qira*
Eskavator me goma.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Eskavator me zinxhir.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Elektrovinç për nxjerrje materialesh nga kulla e komandimit.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Kamjonçinë 3.5 ton.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Sondë horizontale për pastrim tubacionesh në diga rezervuaresh.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
II.PAJISJE			
Tub ajrimi për punime nën nivel.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Motogjenerator mbi 5.5 kv.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Saldatriçe.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Kanellë gazi.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Kokore për punonjësit.	*copë*	*15*	*Pronësi ose me qira*
Betonierë.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*
Kuti e ndihmës së shpejtë.	*copë*	*1*	*Pronësi ose me qira*

Referuar preventivit zërat e punimeve që do të kryhen në këtë procedurë prokurimi janë:
1. Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m≥, në kanale pjerrësi > 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet;
2. Transport dheu me auto deri 2.0 km (materiali i gërmuar);
3. Rrafshim e ngjeshje dheu në trup dige me cilindër me dhëmbë;
4. Transport dheu me auto deri 2.0 km (materiali për mbushjen);
5. Rrafshim skarpate në gërmim,ekskavator 0.25m^3.
Kërkesa për mjetet dhe makineritë e mëposhtme janë të paargumentuara dhe nuk janë në përputhje me preventivin e punimeve:
- Elektrovinç për nxjerrje materialesh nga kulla e komandimit;
- Sondë horizontale për pastrim tubacionesh në diga rezervuaresh;
- Tub ajrimi për punime nën nivel;
- Motogjenerator mbi 5.5 kv;
- Saldatriçe;
- Betonierë.
Këto kritere, kanë ndikuar në numrin e pjesëmarrësve si dhe janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, ligjit nr. 162/2020

datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 77, pika 1, ñKërkesat për kualifikim...*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës*ò, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 26, pika 5, ñ*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*ò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. dhe z. K. L. Sektori i Bordit të Kullimit.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 77, pika 1. VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, neni 26, pika 5.

Ndikimi: Ulje e numrit të OE që paraqesin interes për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën 3,437,134lekë pa TVSH.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kritereve nga NJP dhe specialistët e ngarkuar për hartimin e kritereve specifike të përzgjedhjes dhe vendosje e kritereve pa argumentim.

Rëndësia:E lartë

Rekomandim: Njësia e Prokurimit në çdo rast të përcaktimit të kritereve kualifikuese, duhet të analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim. Gjithashtu, nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë më përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT.

Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 208, datë 02.04.2021 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. C. (Kryetar), znj, I. H. (Anëtare) dhe znj. Xh. M. (Anëtare).

KVO më datë 19.04.2021 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò, me fond limit 3,437,134 lekë. Konstatohet se për këtë procedurë në sistem ka hedhur ofertë vetëm OE ñEé ò shpk me vlerë ekonomike të ofertës 3,412,420 lekë pa TVSH.

Më datë 20.04.2021 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit për procedurën e prokurimit të sipërcituar dhe pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur, ka kualifikuar për plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit OE ñEé ò SHPK me vlerë ekonomike të ofertës 3,412,420 lekë pa TVSH.

Më datë 28.04.2021, KVO ka hartuar Raportin Përmbledhës me nr. 2773 Prot. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave KVO-ja ka vendosur që OE ñEé ò SHPK **me ofertën e paraqitur në vlerën 3,412,420lekë pa TVSH** plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Duke iu referuar raportit përmbledhës Titullari i AK ka miratuar po më datë 28.04.2021 vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit me OE të kualifikuar.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 2773/1 Prot, është hartuar më datë 28.04.2021 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 66 datë 04.05.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin nr. 263, datë 05.05.2021 ñPër lidhje dhe zbatim kontrateò me OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuaret nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò. Me OE ñEé ò SHPK është lidhur kontrata me nr. 2925 Prot, datë 05.05.2021 me vlerë 3,412,420 lekë pa TVSHdhe 4,094,904 lekë me TVSH. Formulari i njoftimit të kontratës është publikuar në buletin e APP-së nr. 70, datë 10.05.2021.

Titulli i gjetjes 35:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave*

Situata: Nga shqyrtimi i ofertës fituese, u konstatua se:

1. Për *Rehabilitim e pritës lumore Murqinë* preventivi i ofertës së plotësuar nga OE nuk i është i njëjtë me preventivin e hedhur nga AK në SPE. Në preventivin e plotësuar nga OE mungon një zë i punimeve, përkatësisht zëri nr. 5 ñ*Rrafshim skarpate në gërmim, ekskavator 0.25m^3*ò.

Preventivi i hedhur në sistem nga NjP				**Preventivi i plotësuar nga OE**				
Nr.	**Përshkrimi i punimeve**	**Njësia**	**Sasia**	**Përshkrimi i punimeve**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi**	**Vlera**
1	*Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m≥, në kanale pjerrësi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk në mjet*	M^3	183.40	*Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m≥, në kanale pjerrësi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk në mjet*	M^3	183.40	*300*	*55,020*
2	*Transport dheu me auto deri 2.0 km (materiali i gërmuar)*	M^3	183.400	*Transport dheu me auto deri 2.0 km (materiali i gërmuar)*	M^3	183.400	*200*	*36,680*
3	*Rrafshim e ngjeshje dheu në trup dige me cilinder me dhëmbë*	M^3	774.82	*Rrafshim e ngjeshje dheu në trup dige me cilindër me dhëmbë*	M^3	774.82	*100*	*77,482*
4	*Transport dheu me auto deri 2.0 km (materiali për mbushjen)*	M^3	774.820	*Transport dheu me auto deri 2.0 km (materiali për mbushjen)*	M^3	774.820	*200*	*154,964*
5	*Rrafshim skarpate në gërmim, ekskavator 0.25m^3*	M^3	10,464	-	-	-	-	-

Referuar projekt preventivit të punimeve në llogaritjen e fondit limit zëri nr. 5 ñ*Rrafshim skarpate në gërmim,ekskavator 0.25m^3*ò për sasinë 10,464 m^3 parashikohet në **vlerën 240,672 lekë** pa TVSH (10,464*23).

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.9 të DT për mjetet dhe makineritë. OE nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me disponimin e mjetit ñElektrovinç për nxjerrje materialesh nga kulla e komandimitò ndërsa për mjetin ñSondë horizontale për pastrim tubacionesh në diga rezervuareshò ka paraqitur një faturë blerje por nuk shoqërohet me foto të mjetit sipas kërkesave të DT pika 2.3.9/d ñ*Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit*ò. Gjithashtu, asnjëri nga këto mjete nuk është i deklaruar në shtojcën nr. 10 të plotësuar nga OE.

OE ñEé ò SHPK **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DT dhe në këto kushte KVO nuk duhet ta kishte kualifikuar, si dhe nuk duhet tã kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1. ñ*Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura*ò, neni 92, pika 3 ñ*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin*

*e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*ò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. F. C., znj, I. H. dhe znj. Xh. M.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.
Ndikimi: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.
Shkaku: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim 1: Bashkia Krujë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **240,672 lekë** nga OE ñEé ò SHPK për zërin e punime të preventivit të nr. 5 ñ*Rrafshim skarpate në gërmim,ekskavator 0.25m*^{3}ò për sasinë 10,464 m^3 në objektin ñ*Rehabilitim e pritës lumore Murqinë".*
Rekomandim 2: Bashkia Krujë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

3. Procedura e prokurimit me objekt: "Gjelbërim dhe mbjellje pemësh dekorative në Bashkinë Krujë" viti 2021.
Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**:** ñ*Gjelbërim dhe mbjellje pemësh dekorative në Bashkinë Krujë*ò viti 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 220 datë 12.04.2021	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 221, datë 12.04.2021:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. F. N.(Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñKërkesë për propozimò		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,666,250 lekë	**6. Oferta fituese** ñAé Ké ôôSHPK me vlerë oferte1,483,000 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit** 183,250 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 23.04.2021	**9. Burimi Financimit:** Buxheti i Bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** ñAé Ké ôôSHPK ñAé ôôSHPK ñEé Ké ôôP.F
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** Nuk ka	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 25.05.2021	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)**	1,779,600 lekë

Nga auditimi rezulton se, kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kulifikuar nuk u konstatuan parregullsi. OE i kualifikuar dhe shpallur fitues përmbush kriteret e vendosura në DT.

4. Procedura e prokurimit me objekt: "Sistemim-Asfaltim i rrugës Picrragë, Faza III-të" viti 2021.
Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**:** ñ***Sistemim-Asfaltim i rrugës Picrragë, Faza III-të***ò viti 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 619 datë 11.10.2021	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 620, datë 11.10.2021:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. I. K. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: ñProcedurë e hapur e thjeshtuarò		

5. Fondi Limit (pa TVSH) 10,654,067 lekë	**6. Oferta fituese** ñKé õõSHPK me vlerë oferte6,276,920 lekë pa TVSH	**7. Diferenca me fondin limit** 4,377,147 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 22.10.2021	**9. Burimi Financimit:** Buxheti i Bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** ñKé õõSHPK ñBé õõSHPK ñKé Dé õõSHPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** Nuk ka	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 25.11.2021	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)**	7,532,304 lekë

Nga auditimi rezulton se, kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kulifikuar nuk u konstatuan parregullsi. OE i kualifikuar dhe shpallur fitues përmbush kriteret e vendosura në DT.

5. Procedura e prokurimit me objekt: "Sistemim-Asfaltim i rrugës Lekë Zaharia" viti 2021.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**:** ñ***Sistemim-Asfaltim i rrugës Lekë Zaharia***ò viti 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 210 datë 02.04.2021 **4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** ñe hapurò	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 211, datë 02.04.2021:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. I.K. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 13,498,350 lekë	**6. Oferta fituese** ñBé õõSHPK me vlerë oferte7,968,175 lekë pa Tvsh	**7. Diferenca me fondin limit** 5,530,175 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 22.04.2021	**9. Burimi Financimit:** Buxheti i Bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** ñKé õõSHPK ñBé õõSHPK ñKé Dé õõSHPK ñUé ò SHPK ñNé ò SHPK ñJé ò SHPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** Nuk ka	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 24.05.2021	**15. Vlera e kontratës (me TVSH)**	9,561,810 lekë

Nga auditimi rezulton se, kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kulifikuar nuk u konstatuan parregullsi. OE i kualifikuar dhe shpallur fitues përmbush kriteret e vendosura në DT.

6. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtim i objektit të polit të ri administrativ Njësia Administrative Bubq Krujë në kuadër të rindërtimit" viti 2021

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "***Ndërtim i objektit të polit të ri administrativ Njësia Administrative Bubq Krujë në kuadër të rindërtimit***" viti 2021**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 212 datë 02.04.2021 **4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "**e kufizuarò	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-**Urdhër nr. 213, datë 02.04.2021: 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. I. K. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSH) 238,129,843 lekë	**6. Oferta fituese** ñBé ò SHPK, vlerë oferte 237,995,994 lekë	**7. Diferenca me fondin limit** 133,849 lekë

8. Data e hapjes së ofertave: Faza e I - 19.04.2021 Faza e II ï 20.05.2021	**9. Burimi Financimit:** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** ñ4 é ò SHPK ñBé ò SHPK ñKé Cé ò SHPK ñEé ò SHPK ñEé ò SHPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** Nuk ka	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka

b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 14.06.2021	**15. Vlera e kontratës (pa TVSH)**	237,995,994 lekë

Mbi realizim e procedurës së prokurimit

Ndërtim i objektit të polit të ri administrativ Njësia Administrative Bubq Krujë është realizuar sipas VKM-së nr.72 datë 03.02.2021 ñPër përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të objektit ñPoli i ri administrativò, Njësia Administrative Bubq, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatueseò pika 1, ñ*Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të objektit "Poli i ri administrativ", njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë, në vlerën 238,129,843 lekë pa TVSH.*ò

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të territorit ka paraqitur kërkesën me nr. 2197 Prot, datë 02.04.2021 Titullarit të Bashkisë dhe NjP për fillimin e procedurës së prokurimit.

Për projektin është marrë oponenca teknike nga Institutit të Ndërtimit me shkresën 729/3 datë 02.06.2021.

Në proces verbalin e mbajtur më datë 02.04.2021 është përcaktuar që lloji i procedurës të jetë ñ*E kufizuar në formën e marrëveshjes kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit*ò.

Llogaritja e fondit limit

Vlera totale e investimit është llogaritur nga studio projektuese ñE...ò SHPK, dhe bazuar në projektet dhe preventivat e hartuara është 238,129,843 lekë pa TVSH.

Investimi përbëhet nga Punime Ndërtimi 10 zëra dhe Punime Siteme të Jashtme 6 zëra.

Hartimi i specifikime teknike dhe DT

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 219 datë 02.04.2021 ñPër caktimin e personave përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për objektin ñ*Ndërtim i objektit të polit të ri administrativ Njësia Administrative Bubq Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit*òò, i përbërë nga Përgjegjësi i Prokurimeve Publike në Bashkinë Krujë z. G. H. dhe Ing. E. S., Drejtori i DPKZhT.

Grupi i punës me shkresën nr. 2197/1 datë 02.04.2021 ka hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin e procedurës së prokurimit të sipër cituar.

Zhvillimi i procedurës është kryer referuar urdhrit të prokurimit nr. 212 datë 02.04.2021 ku përcaktohet NjP me përbërje z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. të zhvillojnë procedurën e prokurimit me objekt *Ndërtim i objektit të polit të ri administrativ Njësia Administrative Bubq Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit*ò, me FL të kontratës të lidhur për një periudhë 12 mujore në shumën 238,129,843 lekë, procedurë ñe kufizuarò, marrëveshje kuadër. Për hartimin dhe miratimin e DT është mbajtur proces verbali përkatës më datë 02.04.2021. Shpallja e procedurës është bërë në Buletinin e APP-së nr. 50 datë 06.04.2021.

Kualifikimi i OE fitues do të ndjekë 2 faza:

Faza 1 – Kualifikimi / marrëveshja kuadër

Kandidatët do të dorëzojnë kapacitetet teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin për paraqitjen e ofertës financiare dhe dokumentet e kërkuara në DT. Autoriteti përgjegjës, do të shqyrtojë dokumentet e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, sëkualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë sëkualifikim. Autoriteti përgjegjës, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të dorëzojnë me dokumentacionin edhe një çmim/ofertë referues/e, e cila gjatë fazës së dytë nuk duhet të jetë më e lartë.

Faza 2 – Paraqitja e ofertës/ lidhja e kontratës

Autoriteti përgjegjës dërgon një ftesë për të dorëzuar ofertën, kandidatëve që janë kualifikuar palë në marrëveshjen kuadër në Fazën 1. Ofertat shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kritereve përkatëse nga Autoriteti përgjegjës. Ky i fundit ia jep kontratën atij Ofertuesi që ka paraqitur ofertën më të mirë të vlerësuar.

Në proces verbalin e mbajtur më datë 02.04.2021 është përcaktuar si kriteri përzgjedhjes së fituesit ò*Oferta ekonomikisht më e favorshme*ò dhe *Kriteret e Vlerësimit si vijon*:

(i)	Çmimi më i ulët	[60 Pikë]
(ii)	Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit	[30 Pikë]
(iii)	Cilësia	[10 Pikë]

Titulli i gjetjes 36:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në hartimin e kritereve në DT.*

Situata: Nga auditimi i kritereve të vendosura për kualifikim, u konstatua se është hartuar proces verbali përkatës por vendosja e kritereve nuk është argumentuar teknikisht duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:

1. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën **2.3.4** të DT ñ*Personeli dhe fuqia punëtore: Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës... duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën, Shtator 2020-Shkurt 2021 i të paktën 180 punonjës*ò. AK nuk ka kryer analizë ku të parashikohet fuqia punëtore që nevojitet për secilin zë punimesh sipas afateve kohore të grafikut të punimeve.

2. Nuk është argumentuar kriteri **2.3.6/d "***Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si 1 (një) punonjës Çertifikuar për Sigurimin dhe kontrollin e cilësisë ISO9001:2015 shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit".*

3. Në DT pika **2.3.6/e** kërkohet që **"***Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si "Ekspert zjarrfikës"të shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit*ò. Ndërsa në pikën **2.3.8** kërkohet që ñ*Operatori ekonomik të ketë të punësuar 1 (një) Ekspert zjarrfikës të shoqëruar me: - kontratë pune të vlefshme, certifikatën e zjarrfikësit, si dhe të jetë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit*ò. Këto dy kritere mbivendosin njëri-tjetrin dhe krijojnë paqartësi për OE të interesuar.

4. Nukjanëargumentuar llojet dhe sasitë e makinerive dhe mjeteve të kërkuara nga AK **në pikën 2.3.11 të DT**, veçanërisht sasia e makinerive/mjeteve si vijon (1-5):

Nr.	***Emri i mjetit***	***Njësi***	***Sasi***	***Statusi***
1	*Kamiona vetëshkarkues min 15 -30 ton*	*Copë*	*15*	*Në pronësi ose me qira*
2	*Betoniere 500 litra*	*Copë*	*6*	*Në pronësi ose me qira*
3	*Autobetoniere*	*Copë*	*5*	*Në pronësi ose me qira*
4	*Nyje inerte*	*Copë*	*1*	*Në pronësi/ qira /kontratë furnizimi*
5	*Nyje betoni*	*Copë*	*1*	*Në pronësi/ qira /kontratë furnizimi*
6	*Rimorkiator*	*Copë*	*2*	*Në pronësi ose me qira*
7	*Kokë tërheqëse e Rimorkiatorit*	*Copë*	*2*	*Në pronësi ose me qira*
8	*Gurë thyese mobile*	*Copë*	*1*	*Në pronësi ose me qira*

Ndërsa, kërkesa për mjetet *"Rimorkiator, Kokë tërheqëse e rimorkiatorit dhe Gurë thyese mobile"* konsiderohet e ekzagjeruar. Rezulton se këto kritere, nuk janë argumentuar teknikisht edhe pse është hartuar proces verbali përkatës.

5. Në DT pika **2.3.11 germa e dhe f** kërkohet:***e)*** *...Në rast se Nyja e Inerteve është me qira ose kontratë furnizimi duhet të paraqitet kontrata e qirasë/furnizimti e shoqëruar me*

dokumente që vërtetojnëpronësinë e saj, (Leje shfrytëzimi për karrierën, leje mjedisore për karrierën, leje mjedisore për impiantin).
f) *...Për Nyjën e betonit nëse është marrë me qira, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë me kohëzgjatje deri në përfundim të realizimit të kërkesave të kësaj procedure. Në këtë rast duhet të paraqitet kontrata e qirasë dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit.*
Në rastin që operatorët ekonomikë disponojnë kontratë furnizimi për Nyje inerte dhe Nyje betoni, rezulton se kërkesat për paraqitjen e dokumentit që vërteton pronësinë, lejemjedisore, leje shfrytëzimi etj. ju drejtohet personave të tretë, që nuk janë pjesëmarrës nëkëtë procedurë prokurimi.
Sa më sipër, AK ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, përkatësisht ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 77, pika 1, ñKërkesat për kualifikim...*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës*ò, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 26, pika 5, ñ*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*ò, neni 61, pika 2 ñ*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*ò

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. dhe Ing. E. S., Drejtori i DPKZhT.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 77, pika 1. VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, neni 26, pika 5, neni 61, pika 2.
Ndikimi: Ulje e numrit të OE që paraqesin interes për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën 237,995,994 lekë lekë pa TVSH.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kritereve nga NJP dhe specialistët e ngarkuar për hartimin e kritereve specifike të përzgjedhjes dhe vendosje e kritereve pa argumentim.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Njësia e Prokurimit në çdo rast të përcaktimit të kritereve kualifikuese, duhet të analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim. Gjithashtu, nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë më përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT.

Vlerësimi i ofertave
Për vlerësimin e ofertava Titullari i AK ka ngritur KVO me Urdhrin nr. 213 datë 02.04.2021 me përbërje z. F. C., znj. I. H. dhe z. I. K.
Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati kohor për ekzekutiminështë 12 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Afati i ekzekutimit të punimeve është 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.
KVO më datë 19.04.2021 ha mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për Fazën e I të procedurës së prokurimit ku konstatohet se në SPE kanë ngarkuar dokumentacionin 5 OE, si më poshtë:

- OE ñ4é ò SHPK, me NIPT K...5016L;
- OE ñBé ò SHPK, me NIPT J...206R;
- OE ñKé Cé ò SHPK, me NIPT K...004W;
- OE ñEé ò SHPK, me NIPT K6...202W;
- OE ñEé ò SHPK, me NIPT K....229P.

Më datë 26.04.2021 KVO ka mbajtur proces verbalin për vlerësimin e ofertave të Fazës së I-rë duke sëkualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:
1. OE ñEé ò SHPK, për arsyet e mëposhtme:
- Nuk ka paraqitur vërtetimpër shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore tëlëshuar nga ana e njësive vendore ku ka ushtruar aktivitet, pika 2.1/c e DT;
- Nuk ka numrin e kërkuar të punonjësve, mesatarisht 180 punonjës për periudhën Shtator 2020-Shkurt 2021, pika 2.3.4 e DT;
- Nuk ka paraqitur dokumentacion ku të provojë që disponon të gjitha makineritë e kërkuara sipas pikës 2.3.11 të DT;
2. OE ñEé ò SHPK, për arsyet e mëposhtme:
- OE në kundërshtim me kërkesat e DT nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet ligjore dhe teknike të kërkuara, përveç ekstraktit të thjeshtë të QKB-së.
3. OE ñKé Cé ò SHPK, për arsyet e mëposhtme:
- OE nuk ka sjellë asnjë dokument ku të provojë se disponon në pronësi ose me qira mjetet e kërkuara në DT.

Nga auditimi rezultoi se OE **nuk** i plotësojnë kriteret e sipërcituara dhe të vlerësuara nga KVO si mangësi.
Nga KVO janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjeskuadër:
1. OE ñ4é ò SHPK, me NIPT K.....016L;
2. OE ñBé ò SHPK, me NIPT J....206R.

Në fazën e parë të procedurës së kufizuar nuk ka klasifikim në bazë të ofertës ekonomike dhe teknike.
Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër është publikuar në Buletinin e APP-së nr. 69 datë 07.05.2021.
Me OE të kualifikuar në fazën e parë është nënshkruar marrëveshja kuadër ku përcaktohen dhe detyrimet e palëve.
Titulli i gjetjes 37:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave*
Situata: Nga auditimi i fazës së kualifikimit të ofertave rezulton se:
1.OE ñBé ò SHPK nuk plotëson kriterin e **DT2.3.5** ñ*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë përkatëse si më poshtë:*
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi.
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukturë).
- 1 (një) Inxhinier Mekanik.
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik.
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet /Topograf/Markshajder/Gjeomatik .
- 1 (një) Inxhinier Elektrik.
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi.

Operatori ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierike për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt krahas stafit të përcaktuar në pikën 2.3.4 edhe staf mbështetës inxhinierik si më poshtë:
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier gjeodet
- 1 (një) Inxhinier mekanik
- 1 (një) Inxhinier ndërtimit profil strukturist
Rezulton se, 9 Inxhinierë (Ing. Ndërtimi M. Gj., Ing. Hidroteknik A. M., Ing. Gjeodet R. Ç., Ing. Gjeodet F. D., Ing. Mekanik E. R., Ing. Ndërtimi A. P., Ing. Mekanik H. P., Ing. Ndërtimi J. Sh., Ing Ndërtimi H. B.) nga stafi inxhinierik i paraqitur nga OE sipas kërkesës më sipër janë të deklaruar edhe në kontratën që OE ka me Bashkinë Krujë me objekt ñ*Rehabilitim i puseve ekzistuese dhe ndërtim i ri i linjës së transmetimit dhe shpërndarjes së Ujësjellësit Fushë Krujë*ò, fakt ky që nuk është marrë në konsideratë nga KVO gjatë vlerësimit të këtij kriteri.
Theksojmë se, kontrata e lidhur për Rehabilitimin e puseve ekzistuese dhe ndërtimin e Ujësjellësit Fushë Krujë përfundon më datë 15.05.2022, që do të thotë se inxhinierët e sipër deklaruar nuk mund të angazhohen në kontrata të tjera referuar DT të procedurës së ujësjellësit.
Gjithashtu, nga diplomat e paraqitura për Inxhinierët e Ndërtimit asnjëri nuk është i profilit Strukturist.
2. OE ñBé ò SHPK nuk plotëson kriterin e DT **2.3.7-"***Krahas stafit OE të ketë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:*

.....		
- Hidraulik	*3 (tre)*	*Certifikatë trajnimi ose Dëshmi Profesionale;*
- Saldator	*2 (dy)*	*Certifikatë trajnimi ose Dëshmi Profesionale;*
- Karpentierë	*5(pesë)*	*Certifikatë trajnimi ose Dëshmi Profesionale;*
- Murator	*5 (pesë)*	*Certifikatë trajnimi ose Dëshmi Profesionale;*
-Bojaxhi	*3 (tre)*	*Certifikatë trajnimi ose Dëshmi Profesionale.*

OE ñBé ò Shpk ka paraqitur dokumentacion për 5 Karpentierë dhe për 1 Murator. Në total duhen 10 punonjës, 5 Karpentier dhe 5 Murator dhe jo 6 sa janë paraqitur. Është paraqitur dokumentacion për 1 Saldator nga 2 që kërkohen edhe pse 1 nga 3 Hidraulikët e paraqitur ka kualifikimin edhe si Saldator, në Kontratën e punës është i punësuar si Hidraulik dhe plotëson kriterin për 3 Hidraulikë, nuk mund të numërohet edhe si Saldator. Është paraqitur dokumentacion vetëm për 1 Bojaxhi nga 3 që kërkohen.
3. Asnjëri nga OE të kualifikuar në fazën e I-rë (OE ñ4é ò SHPK, ñBé ò SHPK) nuk plotëson kriterin e **DT2.3.8** ï ñ*Operatori ekonomik të ketë të punësuar një Ekspert Zjarrëfikës të shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, certifikatën e zjarrfikësit, si dhe të jetë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit*ò.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, ñ*Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura*ò, neni 92 pika 3, ñ*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*ò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. F. C., znj. I. H., z. I. K.

Për sa trajtuar më sipër, nga Bashkia Krujë përkatësisht, KVO janë paraqitur observacione me shkresën 3609/1 Prot, datë 12.07.2022 administruar në KLSH me nr. 259/4 Prot, datë 12.07.2022 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Në lidhje me mangësinë e konstatuar nga KLSH se OE "B…" SHPK nuk plotëson kriterin e DT 2.3.5 ñOperatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt..... dokumentacioni i paraqitur nga subjekti ne lidhje me numrin e nevojshëm të stafit inxhinerik për realizimin e punimeve, bazuar në pikën 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet që "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj". KVO në vlerësimin e realizuar ka gjykuar se paraqitja nga ana e subjektit "B…" SHPK, të dokumenteve ligjore që vërtetojnë disponimin e stafit inxhinierik, i ka kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftueshme për të realizuar objektin e prokurimit. Ky përfundim është në përputhje të plotë dhe me nenin 46 pika të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006" Për prokurimin publik". Përsa i përket konstatimit se subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor për të njëjtin staf inxhinierik që ka paraqitur dhe tek një procedurë tjetër prokurimi ku është shpallur fitues nga autoriteti kontraktor bashkia Krujë, e kundështojme për faktin se subjektet ndërtimore në Republikën e Shqipërisë, angazhohen në shumë kontrata të puneve publike gjatë vitit, të cilat kanë afatin dhe modalitetet e tyre të punës, por kjo nuk nënkupton se stafi inxhierik i një shoqërie nuk mund të angazhohet në disa punë të njëkohshme, pasi natyra e punës në terren ashtu edhe intelektuale e stafit inxhinierik nuk përbën pengesë për realizimin në kohë dhe me cilësi të punimeve. Një kontratë e tillë me vlerë jo të vogël nuk mund të realizohet kurrsesi nga një shoqëri pa kapacitete dhe e cila realizon vetëm një punë të ngjashme në një hark jo të shkurtër kohor.

2. Në lidhje me mangësinë e nxjerrë nga KLSH, se subjekti "B…" sh.p.k, nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.7 të DT, në të cilën kërkohet që subjektet pjesëmarrëse, krahas stafit duhet të kenë dhe stafin mbështetës, duhet ndryshuar sepse:

Nga verifikimi i dokumentave të paraqitura nga subjekti për të vërtetuar se disponon stafin mbështetës të kërkuar në DT, KVO bazuar në pikën 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet që "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, ...", gjykoi se paraqitja e dokumenteve vërteton se operatori ekonomik disponon stafin mbështetës, është mëse e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është vendosur kriteri i kualifikimit, dhe nuk përbën shkak për s'kualifikimin e subjektit.

Po ashtu KVO ka gjykuar se në rast së një punonjës i specializuar në një fushë të caktuar, është i specializuar njëkohësisht dhe në një fushë tjetër, është plotësisht i pranueshëm në një proces pune të tillë, i cili nuk ka volume të tilla të papërballueshme.

3. *Në lidhje me mangësinë e nxjerrë nga KLSH, se të dy OE e kualifikuara në fazën e parë të procedurës së kufizuar të prokurimit, "B…" SHPK dhe "4…" SHPK nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8 të DT, në të cilën kërkohet që subjektet pjesëmarrëse, duhet të kenë pjesë të stafit një ekspert zjarrfikës, duhet ndryshuar sepse:*

Nga verifikimi i dokumenteve të ngarkuara në sistemin elektronik të prokurimeve nga të dy subjektet e kualifikuar në fazën e parë të procedurës së kufizuar të prokurimit, rezultoi se të dy subjektet kanë paraqitur dokumentacionin ku vërtetojnë se kanë pjesë të stafit të tyre ekspertinzjarrfikës, konkretisht subjekti "4…" SHPK ka paraqitur Inxh. Markshajder z. H. A.

i është i specializuar dhe si ekspert zjarrfikës, po ashtu subjekti " B…" SHPK ka paraqitur Ark. z. E. M. i është i specializuar dhe si ekspert zjarrfikës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Kontrata e lidhur për Rehabilitimin e puseve ekzistuese dhe ndërtimin e Ujësjellësit Fushë Krujë përfundon më datë 15.05.2022, që do të thotë se inxhinierët e sipër deklaruar nuk mund të angazhohen në kontrata të tjera referuar përcaktimeve të DT të procedurës së rehabilitimit të puseve.
2. KVO ka numëruar të njëjtin punonjës për dy pozicione të ndryshme duke u bazuar në faktin që disa punonjës kanë certifikata kualifikimi në disa fusha. Kjo nuk është e saktë sepse në DT kërkohet një numër i caktuar punonjësish për secilin profil i cili në total përbën stafin inxhinierik, mbështetës apo fuqinë punëtore. Duke numëruar dy herë të njëjtin punonjës vetëm se ai ka dy certifikata kualifikimi në përfundim numri i punonjësve dhe specialistëve të kërkuar në DT nuk përmbushet.
3. Në DT kërkohet që OE të kenë të punësuar një Ekspert Zjarrfikës dhe jo një nga punonjësit të ketë edhe kualifikimin si ekspert zjarrfikës. Janë dy kritere që ndryshojnë nga njëri-tjetri. Në DT kërkohet një Inxhinier apo një Arkitekt dhe një Ekspert Zjarrfikës që do të thotë dy punonjës dhe jo një punonjës me dy kualifikime. I njëjti punonjës nuk mund të numërohet dy herë kur në DT është specifikuar ndryshe.

Në rastin e kualifikimit të ofertave të vlefshme edhe nëse ato përmbajnë devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, KVO duhet të cilësonte në proces verbalin e vlerësimit të ofertave se cilat ishin këto devijime që OE nuk i plotësonin dhe pse ato nuk cenonin kërkesat e përcaktuara në DT.

Në argumentimin ligjor të observacioneve KVO i referohet ligjit të prokurimeve që është shfuqizuar.

Sa më sipër, pretendimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi ato nuk janë të argumentuara sidomos lidhur me devijimet e toleruara nga KVO dhe mos ndikimin e tyre në përmbushjen e detyrimeve të kontratës specifike.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.

Ndikimi: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

Shkaku: Operatorët Ekonomik janë kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Krujë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

Faza e dytë

Faza e dytë fillon me publikimin dhe dërgimin e shtojcës nr. 2 të DT òFtesa për ofertëò OE të kualifikuar dhe me të cilët është nënshkruar Marrëveshja Kuadër. Shtojca nr. 2 është miratuar nga Titullari i AK me nr. 3102 Prot, datë 12.05.2021. Në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, neni 41, pika 3. ñ*Përzgjedhja e fituesve, që zbatojnë kontratat publike në kuadër të procesit të rindërtimit, kryhet sipas kritereve të vlerësimit në lidhje me objektin e kontratës që prokurohet dhe janë cilësia, çmimi dhe koha e zbatimit të kontratës*ò dhe DT kriteret e vlerësimit do të jenë: Grafiku i zbatimit 0-30 pikë, Çmimi më i ulët 0-60 pikë dhe Cilësia 0-10 pikë.

OE kanë paraqitur pranë AK dokumentacionin e ofertës ekonomike dhe KVO më datë 20.05.2021 ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave. Proces verbali i vlerësimit të ofertave nr. 3401 Prot, është hartuar më datë 24.05.2021, ku në përfundim të vlerësimit rezulton se **OE "4…" SHPK është vlerësuar me 99.33 pikëme çmim oferte 238,120,415 lekë dheOE "B…" SHPK është vlerësuar me 99.67 pikë me çmim oferte 237,995,994 lekë**.

Raporti përmbledhës nr. 3411 Prot, është hartuar më datë 25.05.2021 për të dyja fazat dhe është miratuar nga Titullari i AK po më datë 25.05.2021. Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar në Buletinin e APP nr. 84 datë 3.05.2021.

Për lidhjen e kontratës Titullari i AK ka miratuar urdhrin nr. 411, datë 14.06.2021 ñPër lidhje dhe zbatim kontrateò, në zbatim të cilit me OE të shpallur fitues **"B…" SHPK** është lidhur kontrata me nr. 3998 Prot, datë 14.06.2021 me vlerë totale 237,995,994 lekë pa tvsh me afat të përfundimit të punimeve brenda 4 muajve nga data e fillimit të tyre. Leja e ndërtimit është miratuar më Vendim nr. 187/1 datë 24.08.2021, shkresa me numër 5883/1 Prot, afati kohor 4 muaj. Punimet duhet të fillojnë brenda 3 ditëve nga data e lejes së ndërtimit të dhënë nga DPKZhT në Bashkinë Krujë (27.08.2021-27.12.2021). Kontrata fillestare është amenduar me kontratën me nr. 8578/2 Prot, datë 20.12.2021 duke përcaktuar aftin 67 ditë për përfundimin e punimeve (27.12.2021-07.03.2022).

7. Procedura e prokurimit me objekt "Rindërtim i Shkollës 9 vjeçare "Hajdar Zogu", Fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit" viti 2021.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "***Rindërtim i Shkollës 9 vjeçare "Hajdar Zogu", Fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit***" viti 2021**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 123 datë 18.02.2021	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-**Urdhër nr. 125, datë 18.02.2021: 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. E. S. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "e kufizuarò		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 103,147,686lekë	**6. Oferta fituese** BOE ñNé Sé ò SHPK dhe ñShé ò SHPK, vlerë oferte 102,994,662 lekë	**7. Diferenca me fondin limit** 153,024 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: Faza e I - 01.03.2021 Faza e II - 06.04.2021	**9. Burimi Financimit:** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** BOE ñGé Cé ò SHPK, ôôAé Ké SHPK; BOE ñNé Sé ò SHPK dhe ñShé ò SHPK; BOE ñZé ò SHPK dhe ñFé ò SHPK; OE ñEé ò SHPK.
11. Ankimime AK, Po	**12. Përgjigje ankesës nga AK,** Po	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 29.04.2021	**15. Vlera e kontratës (pa TVSH)**	102,994,662 lekë

Mbi realizim e procedurës së prokurimit

Rindërtim i shkollës 9 vjeçare ñHajdar Zoguò, Fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë është realizuar sipas VKM-së nr.1145 datë 24.12.2020 ñPër përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të objektit arsimor Shkolla 9 vjeçare ñHajdar Zoguò, Fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë dhe caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatueseò, pika 1, ñ*Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të objektit arsimor Shkolla 9 vjeçare "Hajdar Zogu", Fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë, në vlerën 103,147,686 lekë pa TVSH.*ò

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të territorit ka paraqitur kërkesën me nr. 1124 Prot, datë 18.02.2021 Titullarit të Bashkisë dhe NjP për fillimin e procedurës së prokurimit.

Për projektin është marrë oponenca teknike nga Institutit të Ndërtimit me shkresën 452/2 datë 29.04.2021.
Në proces verbalin e mbajtur më datë 18.02.2021 është përcaktuar që lloji i procedurës të jetë ñ*E kufizuar në formën e marrëveshjes kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit*ò.
Llogaritja e fondit limit
Vlera totale e investimit është llogaritur nga studio projektuese ñE...ò SHPK, dhe bazuar në projektet dhe preventivat e hartuara është 103,147,686lekë pa TVSH.
Investimi përbëhet nga Punime Ndërtimi dhe Instalime 23 zëra dhe Punime për pajisje 4 zëra.
Hartimi i specifikime teknike dhe DT
Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 124 datë 18.02.2021 ñPër caktimin e personave përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për objektin ñ*Rindërtim i Shkollës 9 vjeçare "Hajdar Zogu", Fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë në kunadër të procesit të rindërtimit*ò, i përbërë nga Përgjegjësi i Prokurimeve Publike në Bashkinë Krujë z. G. H. dhe Ing. R. B., Drejtori i DPKZhT.
Grupi i punës më datë 18.02.2021 ka hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin e procedurës së prokurimit të sipër cituar.
Zhvillimi i procedurës është kryer referuar urdhrit të prokurimit nr. 123 datë 18.02.2021 ku përcaktohet NjP me përbërje z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. të zhvillojnë procedurën e prokurimit me objekt ñ*Rindërtim i Shkollës 9 vjeçare "Hajdar Zogu", Fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit*ò, me FL të kontratës të lidhur për një periudhë të vlefshme të marrëveshjes kuadër 12 mujore në shumën 103,147,686 lekë, procedurë ñe kufizuarò, marrëveshje kuadër. Për hartimin dhe miratimin e DT është mbajtur proces verbali përkatës më datë 18.02.2021. Shpallja e procedurës është bërë në Buletinin e APP-së nr. 25 datë 19.02.2021.
Kualifikimi i OE fitues do të ndjekë 2 faza:
Faza 1 – Kualifikimi / marrëveshja kuadër
Kandidatët do të dorëzojnë kapacitetet teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin për paraqitjen e ofertës financiare dhe dokumentet e kërkuara në DT. Autoriteti përgjegjës, do të shqyrtojë dokumentet e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, sõkualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë sõkualifikim. Autoriteti përgjegjës, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të dorëzojnë me dokumentacionin edhe një çmim/ofertë referues/e, e cila gjatë fazës së dytë nuk duhet të jetë më e lartë.
Faza 2 – Paraqitja e ofertës/ lidhja e kontratës
Autoriteti përgjegjës dërgon një ftesë për të dorëzuar ofertën, kandidatëve që janë kualifikuar palë në marrëveshjen kuadër në Fazën 1. Ofertat shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kritereve përkatëse nga Autoriteti përgjegjës. Ky i fundit ia jep kontratën atij Ofertuesi që ka paraqitur ofertën më të mirë të vlerësuar.
Në proces verbalin e mbajtur më datë 18.02.2021 është përcaktuar si kriteri përzgjedhjes së fituesit ò*Oferta ekonomikisht më e favorshme*ò dhe *Kriteret e Vlerësimit si vijon*:

(i)	Çmimi më i ulët	[60 Pikë]
(ii)	Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit	[30 Pikë]
(iii)	Cilësia	[10 Pikë]

Titulli i gjetjes 38:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në hartimin e kritereve në DT.*

Situata: Nga auditimi i kritereve të vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:
1.Në DT pika 2.3.2. ñLicenca profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës e vlefshme sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës/MIE, është kërkuar që OE duhet të paraqesë licencën e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin si më poshtë vijon:
N.P ï 12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
Referuar projekt preventivit të punimeve rezulton se të vetmet zëra punimesh që parashikohen në preventiv në zërin ñPunime për sistemim sheshiò janë për mbjellje bari finadë pemësh dhe shkrurresh dekorative. Këto procese nuk kërkojnë domosdoshmërisht licencë për punime të Inxhinierisë së mjedisit.
2.Në DT pika 2.3.5 ñ*OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë përkatëse si më poshtë:*
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
b)-*OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt krahas stafit të përcaktuar tek pika 2.3.5 duhet të ketë staf mbeshtetës inxhinierik si me poshtë:*
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili strukturist
- 2 (dy) Teknik Ndërtimi;
- 1 (një) Teknik Topograf;
- 1 (një) Hekurkthyes;
- 2 (dy) Hidraulik;
- 3 (tre) Elektricist;
- 1 (një) Bojaxhi;
- 1 (një) Karpentier;
- 1 (një) Specialist ndërtimi;
- 1 (një) Pllakashtrues;
- 1 (një) Specialist për ndihmën e parë;
- 2 (dy) Specialist Saldator;
- 1 (një) Automakinist;
- 10 (dhjetë) Shoferë ;
- 3 (tre) Eskavatorist me goma dhe zinxhir/ Manovrator;
AK ka kërkuar staf inxhinierik të kualifikuar të ndarë në dy grupe kualifikimi, por nuk ka argumentuar ndarjen e tyre sipas grupeve përkatëse.
Gjithashtu, nuk është argumentuar kërkesa për 2 Inxhinier të profilit strukturist, referuar zërave të punimeve të preventivit ndërsa kërkesa për 1 Inxhinier Gjeolog dhe 1 Inxhinier Mjedisi është e ekzagjeruar, pasi në preventiv nuk rezultojnë të përfshihen punime të tilla që të nevojitet ekspertiza profesionale e këtyre inxhinierëve.
c)-*OE të paraqesë për stafin e mësipërm* ***kontratat noteriale të punës****, diplomë dhe ose kualifikimin përkatës për secilin punonjës. Dëshmia e kualifikimit dhe/ose diploma të jetë e lëshuar nga institucione të licencuara shtetërore Arsimore Profesionale Shtetërore. Stafi i*

mësipërm të figuroje në listëpagesat e shoqëris1 minimalisht 4 muajt e fundit (tetor 2020-janar 2021).
Kërkesa e vendosur nga AK për të paraqitur **kontratë noteriale të punës** për stafin mbështetës së sipër cituar është e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës së Republikës së Shqipërisëò i ndryshuar neni 12 ò*Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim",* neni 21 pika 1 *"Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë".* Në këto kushte kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe ul konkurrencën.
3. Në DT pika 2.3.6- "*OE ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht*:
Certifikatë SSH EN 12102, e vlefshme, si edhe Deklarata e Konformitetit të instalimit dhe funksionimit nga prodhuesi i pajisjeve.
Shënim: Kërkesat e standardit ndërkombëtar SSH EN 12102, mbulohen nga certifikatatISO 3744; 3745. Sigurimi i çdo njërës prej tyre do të përmbushte kushtin e kërkuar".
Certifikata SSH EN 12102 është për kondicionerë, njësi ftohëse me lëng, pompa nxehtësie dhe çlagështuesit me kompresorë që vihen në lëvizje në mënyrë elektrike ... pompat e nxehtësisë për ngrohjen dhe ftohjen e ambjentit, çlagështuesit dhe ftohësit industrialë.
Certifikata ISO 3744:2010 specifikon metodat për përcaktimin e nivelit të fuqisë së zërit ose nivelit të energjisë së zërit të një burimi zhurme nga nivelet e presionit të zërit të matur në një sipërfaqe që mbështjell burimin e zhurmës (makineri ose pajisje) në një mjedis që përafrohet me një fushë të lirë akustike pranë një ose më shumë planeve reflektuese.
Certifikata ISO 3745:2012 lidhet me akustikën dhe përcaktimin e niveleve të fuqisë së zërit dhe niveleve të energjisë së zërit të burimeve të zhurmës duke përdorur presionin e zërit.

Referuar përshkrimit të certifikatave konstatohet së AK nuk ka qenë i qartë në vendosjen e këtyre standardeve/certifikatave si kërkesa për OE. Këto certifikata nuk janë të njëjta dhe krijojnë konfuzion për OE të interesuar të marrin pjesë në procedurën e prokurimit dhe gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Vendosja e kësaj kërkese është e ekzagjeruar, joproporcionale dhe mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë të OE në fazën e vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, AK kërkon që ñ*Në rast se operatorët ekonomik nuk janë vetë mbajtës të ndonjërës prej certifikatave të mësipërme, ata duhet të paraqesin edhe Autorizimin e Prodhuesit (Manufacturer Authorisation Form) në emër të tij, lëshuar nga prodhuesi i pajisjeve ose përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi për të lëshuar autorizim, vërtetuar kjo me dokumentacionin që provon se prodhuesi e lejon përfaqësuesin e autorizuar prej tij të lëshojë autorizim prodhuesi*ò.
Me këtë kërkesë rezulton se AK përfshin në procedurë palë të treta të cilët nuk janë kandidatë në procedurën konkrete të prokurimit. AK mund të kërkonte një vetëdeklarim nga OE ofertues që prodhuesi është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë dhe të rezervojë të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE shpallet fitues.

4. Në DT pika 2.3.7-*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, kërkohen mjetet si vijon*:

Mjetet	***Sasia***	***Gjëndja***
Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 10 - 12 ton	*copë 5*	*Pronësi / qira*
Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtës mbi 20 ton	*copë 2*	*Pronësi / qira*
Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 3-5 ton	*copë 3*	*Pronësi / qira*
Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	*copë 3*	*Pronësi / qira*
Eskavator me goma	*copë 1*	*Pronësi / qira*
Greider	*copë 1*	*Pronësi / qira*
Rrul	*copë 1*	*Pronësi / qira*
Nivelues betoni (helikopter)	*copë 2*	*Pronësi / qira*
Minieskavator	*copë 2*	*Pronësi / qira*
Kamion me vinc kapacitet mbajtes 6.5 - 8.5 ton	*copë 1*	*Pronësi / qira*
Fadrome (kove para dhe krahe mbrapa)	*copë 1*	*Pronësi / qira*
Kantier ndertimi (zyre)	*copë 1*	*Pronësi / qira*
Autobot uji	*copë 1*	*Pronësi / qira*
Autobetoniere	*cope 3*	*Pronësi / qira*
Autopompë betoni	*cope 1*	*Pronësi / qira*
Nyje Inertesh	*copë 1*	*Pronësi/ kontratë qiraje furnizimi*
Nyje Betoni	*copë 1*	*Pronësi/ kontratë qiraje furnizimi*
Betoniere kantier	*copë 2*	*Pronësi / qira*
GPS	*copë 1*	*Pronësi / qira*
Vinç karrel	*copë 2*	*Pronësi / qira*
.....		

AK nuk ka argumentuar llojin dhe sasinë e makinerive të kërkuara në raport me punimet konkrete që duhet të kryhen sipas volumit të tyre dhe grafikut të punimeve, nuk ka analiza teknike të hartara për këtë qëllim. Këto kritere, nuk janë argumentuar edhe pse është hartuar proces verbali përkatës.

5. Në DT pika 2.3.7 kërkohet***h)*** *Nyja e inerteve Pronësi, Kontratë Qiraje, Kontratë Furnizimi të jenë të pajisura me (Leje shfrytëzimi, plane vendosje, leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizuesi të ketë status aktiv në QKB.* ***i)*** *Nyja e betonit Pronësi, Kontrate Qiraje, Kontratë Furnizimi të jenë të pajisura me (Leje shfrytëzimi, plane vendosje, leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizuesi të ketë status aktiv në QKB.*

Në rastin që operatorët ekonomikë disponojnë kontratë furnizimi për Nyje inerte dhe Nyje betoni, rezulton se kërkesat për paraqitjen e dokumentit që vërteton pronësinë, LejeMjedisore me kod III.1.B, leje shfrytëzimi etj ju drejtohet personave të tretë, që nuk janë pjesëmarrës nëkëtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër AK ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, përkatësisht ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 77, pika 1, ñ*Kërkesat për kualifikim...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës*ò, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 26, pika 5, ñ*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*ò, neni 61, pika 2 ñ*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*ò

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. dhe Inxhinier z. R. B., Drejtori i DPKZhT.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 77, pika 1. VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, neni 26, pika 5, neni 61, pika 2.
Ndikimi: Ulje e numrit të OE që paraqesin interes për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit dhe paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën 102,994,662 lekë pa TVSH.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në hartimin e kritereve nga NJP dhe specialistët e ngarkuar për hartimin e kritereve specifike të përzgjedhjes dhe vendosje e kritereve pa argumentim.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Njësia e Prokurimit në çdo rast të përcaktimit të kritereve kualifikuese, duhet të analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kritere të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim. Gjithashtu, nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë më përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT.

Ankesa
Lidhur me procedurën e sipër cituar ka paraqitur ankesë pranë AK, OE ñNé ò SHPK më datë 24.02.2021. Ankesa ka si objekt kundërshtimin e disa kritereve të vendosura nga AK në DT. Nga AK është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1314/1 Prot, datë 01.03.2021 ku AK deklaron mos kompetencë në trajtimin e ankesës referuar përcaktimeve të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 42 pika 9, ñ*Në rastin e ankesave për dokumentet etenderit operatorët ekonomikë ankohen brenda 2ditëve nga publikimi i dokumenteve të tenderit nëKomisionin e Prokurimit Publik (KPP), qëshqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 3 ditëvenga data e depozitimit të ankesës në përputhje meparashikimet e Kodit të ProceduraveAdministrative dhe këtij akti. Me kalimin e këtijafati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim,autoriteti kontraktor vijon procedurën eprokurimit*ò.

Vlerësimi i ofertave
Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK ka ngritur KVO me Urdhrin nr. 125 datë 18.02.2021 me përbërje z. F. C., znj. I. H. dhe z. E. S.
Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati kohor për ekzekutiminështë 12 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.
Afati i ekzekutimit të punimeve është 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.
KVO më datë 01.03.2021 ha mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për Fazën e I të procedurës së prokurimit ku konstatohet se në SPE kanë ngarkuar dokumentacionin 4 OE/BOE, si më poshtë:

- BOE ñGé Cé ò SHPK, me NIPT J64é 43V dhe ñAé Ké ò SHPK, me NIPT J61é 13R;
- BOE ñNé Sé ò SHPK, me NIPT L79é 02O dhe ñShé ò SHPK me NIPT K07é 03N;
- BOE ñZé ò SHPK, me NIPT J84é 11K dhe ñFé ò SHPK me NIPT K17é 04C;
- OE ñEé ò SHPK, me NIPT K67é 02W.

Më datë 10.03.2021 KVO ka mbajtur proces verbalin për vlerësimin e ofertave të Fazës së I-rë duke sëkualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:
1. OE ñEé ò SHPK, pasi përveç ekstraktit historik nuk ka asnjë dokument ku të provojë se plotëson kriteret e vendosura në DT.
2. BOE ñëZé ôò SHPK, dhe ñFé ò SHPK nuk plotëson kriteret:
- Pika 2.3.1 Kontrata për punë të ngjashme;
- Pika 2.3.5/e për Ekspert Zjarrfikës;
- Pika 2.3.5/f për Inxhinier-Auditim Energjie;
Nga auditimi rezultoi se OE/BOE **nuk** i plotësojnë kriteret e sipërcituara dhe të vlerësuara nga KVO si mangësi.
Nga KVO janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjeskuadër:
1. BOE ñGé . Cé ò SHPK, me NIPT J64é 43V dhe ñAé Ké ò SHPK, me NIPT J61é 13R;
2. BOE ñNé Sé ò shpk, me NIPT L79é 02O dhe ñShé ò SHPK me NIPT K07é 03N;
Në fazën e parë të procedurës së kufizuar nuk ka klasifikim në bazë të ofertës ekonomike dhe teknike.
Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër është publikuar në Buletinin e APP-së nr. 43 datë 24.03.2021.
Me OE të kualifikuar në fazën e parë është nënshkruar marrëveshja kuadër ku përcaktohen dhe detyrimet e palëve.
Për këtë fazë nuk ka patur ankesa.
Titulli i gjetjes 39:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave*
Situata: Nga auditimi i fazës së kualifikimit të ofertave rezulton se:
1. BOE ñNé Sé ò SHPK dhe ñShé òSHPK nuk plotësojnë kriterin e **DT2.3.5 e)-"***OE të ketë të punësuar 1 Ekspert Zjarrfikës të shoqëruar me kontratë noteriale pune, certifikatën e zjarrfikësit, librezë pune, cv, të jetë në listë pagesa për periudhën 12(dymbëdhjetë), muajt e fundit, gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrfikës të jetë i pajisur me licence Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL"*. Dokumentacioni i paraqitur nga OE ñNé Sé ò SHPK për Ekspertin Zjarrfikës nuk është i plotë sipas kërkesës në DT, mungon kontrata noteriale e punës gjithashtu as operatorët ekonomikë as eksperti zjarrfikës nuk janë të pajisur me licence Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL.
2. BOE ñNé Sé ò SHPK dhe ñShé òSHPK nuk plotësojnë kriterin e **DT2.3.5 g)-***OE duhet të ketë të paktën 2 (dy) Punonjës Specialist të Certifikuar dhe trajnuar për Punimet në lartësi D.P.I. Rënia nga lartësitë, punime në fasade, etj. sipas VKM nr.312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" e dhënë nga një organizatë certifikimi e akredituar shqiptare ose e huaj. Të jenë me kontratë noteriale pune individuale dhe te figurojnë në Listë pagesat e shoqërisë për të paktën 12 muajt e fundit.*
Rezulton se nga 2 punonjës të kërkuar është paraqitur dokumentacion vetëm për 1 punonjës dhe ai jo me kontratë noteriale pune.
3. BOE ñNé Sé ò SHPK dhe ñShé òSHPK nuk plotësojnë kriterin e **DT2.3.6** *OE ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë*. Rezulton se asnjëri nga OE nuk ka paraqitur certifikatën OHSAS 18001- 2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) si një nga certifikatat e kërkuara në DT.
4. BOE ñNé Sé ò SHPK dhe ñShé òSHPK nuk plotësojnë kriterin e **DT2.3.7** *"Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës".*

1. Kamioncinë vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 3-5 ton (3 copë).
Është paraqitur dokumentacion vetëm për 2 mjete nga 3 që kërkohet dhe në dokumentacionin e njërit mjet (AA5é H) mungon foto e mjetit në kundërshtim me pikën **2.3.6/d** *"Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto te vetme mjeti dhe targa e tij".*
2. Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 1.5-2 ton (3 copë).
Është paraqitur dokumentacion vetëm për 2 mjete nga 3 që kërkohet në DT.
3. Greider (1 copë).
Dokumentacioni i paraqitur për këtë makineri nuk shoqërohet me foto.
4. Autobetionere (3 copë).
Është paraqitur dokumentacion i rregullt vetëm për 2 autobetoniere nga 3 që kërkohet. Dokumentacioni i paraqitur për 4 autobetoniere të tjera (AA2é G, AA2é G, AA2é G, AA2é G) tregon se mjetet janë në pronësi të OE ñVé ò dhe nuk shoqërohen me kontratë të marrjes me qira.
5. BOE ñGé Cé ò SHPK, dhe ñAé Ké ò SHPK nuk plotëson kriterin e **DT2.3.7** *"Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës".*
Për mjetet *Autobetionere (3 copë)* BOE ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar vetëm për 2 mjete ndërsa për mjetin e tretë me targa LU2é 3C deklaruar në shtojcën e mjeteve nuk është paraqitur dokumentacioni i duhur.

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1, ñ*Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura*ò, neni 92 pika 3, ñ*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*ò.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. F. C., znj. I. H., z.E. S.

Për sa trajtuar më sipër, nga Bashkia Krujë përkatësisht, KVO janë paraqitur observacione me shkresën 3609/1 Prot, datë 12.07.2022 administruar në KLSH me nr. 259/4 Prot, datë 12.07.2022 si më poshtë:
Pretendimet e subjektit:
1. Në lidhje me mangësinë e konstatuar për BOE "N… S…" SHPK dhe " Sh…" SHPK, se nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.5 të DT, pasi dokumentacioni i paraqitur nga BOE nuk është i plotë, mungon kontrata noteriale e punës dhe as eksperti zjarrfikës nuk është i pajisur me licence Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL dhe asnjëri nga subjektet nuk është i pajisur me licence Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL e kundërshtojmë sepse ekspertizjarrfikës i paraqitur është konsideruar i mjaftueshëm bazuar në pikën 4 te nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet që "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj"

2. Në lidhje me mangësinë e nxjerrë nga KLSH, se BOE "N… S…" SHPK dhe " Sh…" SHPK, nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.5 te DT, në të cilën kërkohet se OE duhet të kenë të paktën 2 punonjës specialist të certifikuar dhe trajnuar për punimet në lartësi, pasi nga 2 të kërkuar është paraqitur vetëm 1, e kundërshtojmë sepse bazuar në pikën 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet që "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime nga karakteristikat, …apo gabime të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj".
Pavarësisht faktit që është paraqitur vetëm një punonjës, KVO në vlerësimin e realizuar, gjykoi se paraqitja e dokumenteve që vërteton se operatori ekonomik ka në stafin e tij vetëm një punonjës specialist të certifikuar dhe trajnuar për punimet në lartësi, është mëse e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është vendosur kriteri i kualifikimit.
3. Në lidhje me konkluzionet e nxjerra nga KLSH, se BOE "N… S…" SHPK dhe " Sh…" SHPK, kanë mangësi në mjetet e paraqitura e kundërshtojmë për faktin se, nga verifikimi i dokumenteve të ngarkuara në sistem rezulton se BOE kanë në pronësi të tyre dhe me qira të gjithë mjetet tip kamioçine të kërkuara, kontretisht disponojnë në pronësi dhe me qira mjetet me targa si vijon: GJ1…7B, BR0…8B, AA2…H, BZ1…9B.
Për sa i përket konstatimit për mjetin tip grejder e kundërshtojmë për faktin se kërkesa e DT për paraqitjen e fotove nuk është konsideruar nga KVO si një element thelbësor dhe kusht për s'kualifikimin e BOE, pasi subjektet ofertues deklarojnë dhe mundësinë e verifikimit të tyre nga ana e autoritetit kontraktor.
Për sa i përket konstatimit të mangësive në lidhje me mjetin tip autobetobiere se nga ana e BOE "N… S…" SHPK dhe " Sh…" SHPK janë paraqitur 2 autobetoniere nga 3 të kërkuara, e kundërshtojmë se bazuar në pikën 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet që "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, ….", nga ana e KVO është gjykuar se paraqitja e dokumenteve që vërteton se BOE disponojnë 2 autobetoniere, është mëse e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është vendosur kriteri i kualifikimit, dhe nuk përbën shkak për s'kualifikimin e BOE.
4. Në lidhje me konkluzionet e nxjerra nga KLSH, se BOE "G… C…" SHPK dhe " A… K… SHPK, kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur për mjetin tip autobetoniere, duhet ndryshuar për arsye se nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve, BOE vërtetojnë se disponojnë 3 autobetoniere, duke përmbushur plotësisht kriterin e vendosur në DT, konkretisht është paraqitur dokumentacioni i rregullt ligjor për këto 3 autobetoniere me targa si vijon, LU2…3C, LU2…2C, AA3…N.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Fakti që KVO e ka konsideruar të mjaftueshëm dokumentacionin e paraqitur nga BOE lidhur me Ekspertin Zjarrfikës edhe pse ai nuk plotëson qartë kriteret e vendosura në DT nuk do të thotë se dokumentacioni i paraqitur është i plotë dhe në përputhje me DT. Gjykimi i KVO-së lidhur me vlerësimin e këtij kriteri nuk është i argumentuar.

Për pikën 2 dhe 3. Në rastin e kualifikimit të ofertave të vlefshme edhe nëse ato përmbajnë devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit KVO duhet të cilësonte në proces verbalin e vlerësimit të ofertave se cilat ishin këto devijime që OE nuk i plotësonin dhe pse ato nuk cenonin kërkesat e përcaktuara në DT. Gjithashtu, pretendimi i KVO-së se ñ*2 autobetoniere, është mëse e mjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është vendosur kriteri i kualifikimit dhe nuk përbën shkak për skualifikimin e BOE*ò nuk është i saktë pasi kërkesat specifike ku përfshihen dhe nevojat për mjete dhe makineri janë hartuar nga ekspertë të përcaktuar nga Titullari i AK, i cili ka gjykuar se për kryerjen e punimeve duhet një numër i caktuar mjetesh dhe makinerish dhe tolerancat e paargumentuara që ka

bërë KVO si jo të rëndësishme në disa kritere po të konsiderohen të gjitha së bashku nuk janë më devijime të vogla nga kriteret e DT.
4. Vlerësimi i dokumentacionit nga grupi i auditimit po ashtu është bërë në sistem dhe për mjetin me targa LU2é 3C deklaruar në shtojcën e mjeteve nuk është paraqitur dokumentacioni i duhur.
Në argumentimin ligjor të observacioneve KVO i referohet ligjit të prokurimeve që është shfuqizuar.
Sa më sipër, pretendimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi ato nuk janë të argumentuara sidomos lidhur me devijimet e toleruara nga KVO dhe mos ndikimin e tyre në përmbushjen e detyrimeve të kontratës specifike.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.
Ndikimi: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.
Shkaku: Operatorët Ekonomik janë kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

Faza e dytë
Faza e dytë fillon me publikimin dhe dërgimin e shtojcës nr. 2 të DT òFtesa për ofertëò OE të kualifikuar dhe me të cilët është nënshkruar Marrëveshja Kuadër. Shtojca nr. 2 është miratuar nga Titullari i AK me nr. 2119 Prot, datë 31.03.2021. Në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, neni 41, pika 3. ñ*Përzgjedhja e fituesve, që zbatojnë kontratat publike në kuadër të procesit të rindërtimit, kryhet sipas kritereve të vlerësimit në lidhje me objektin e kontratës që prokurohet dhe janë cilësia, çmimi dhe koha e zbatimit të kontratës*ò dhe DT kriteret e vlerësimit do të jenë: Grafiku i zbatimit 0-30 pikë, Çmimi më i ulët 0-60 pikë dhe Cilësia 0-10 pikë.
OE kanë paraqitur pranë AK dokumentacionin e ofertës ekonomike dhe KVO më datë 06.04.2021 ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave. Proces verbali i vlerësimit të ofertave nr. 2333 Prot, është hartuar më datë 09.04.2021, ku në përfundim të vlerësimit rezulton se **BOE "G… C…" SHPK dhe "A… K…" SHPK është vlerësuar me 99.22 pikë me çmim oferte 103,042,193 lekë dhe OE BOE "N… S…" SHPK dhe "Sh…" SHPKështë vlerësuar me 100 pikë me çmim oferte 102,994,662 lekë.**

Raporti përmbledhës nr. 2334 Prot, është hartuar më datë 09.04.2021 për të dyja fazat dhe është miratuar nga Titullari i AK po më datë 09.04.2021. Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar në Buletinin e APP nr. 57 datë 16.04.2021.
Për lidhjen e kontratës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin nr. 243, datë 29.04.2021 ñPër lidhje dhe zbatim kontrateò, në zbatim të cilit me BOE të shpallur fitues **"N… S…" SHPK dhe "Sh…" SHPK** është lidhur kontrata me nr. 2791 Prot, datë 29.04.2021 me vlerë totale 102,994,662 lekë pa TVSH me afat të përfundimit të punimeve brenda 4 muajve nga data e fillimit të tyre. Leja e ndërtimit është miratuar më Vendim nr. 208/1 datë 24.09.2021, shkresa me numër 6772/1 Prot, afati kohor 4 muaj. Punimet duhet të fillojnë brenda 3 ditëve nga momenti i komunikimit të lejes së ndërtimit të dhënë nga DPKZhT në Bashkinë Krujë.

Kontrata fillestare është amenduar me kontratën nr. 428/2 Prot, datë 27.01.2022 duke përcaktuar afatin 20 ditë nga data e përfundimit të punimeve referuar kontratës bazë.

8. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtim i Atrium Center Thumanë, Njësia Administrative Thumanë Bashkia Krujë, në kuadër të procesit të rindërtimit" viti 2021. Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim i Atrium Center Thumanë, Njësia Administrative Thumanë Bashkia Krujë, në kuadër të procesit të rindërtimit" viti 2021</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 110 datë 12.02.2021</td><td colspan="2" rowspan="2">2. Njësia e Prokurimit:
1. G. H.
2. E.C.
3. A. G.</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 112, datë 12.02.2021:
1. F. C. (Kryetar)
2. I. H. (Anëtare)
3. I. K. (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "e kufizuarò</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)
220,210,898 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta fituese
ñAé 2é 4ò ShPK, vlerë oferte 220,079,942 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin limit
130,956 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave:
25.02.2021</td><td colspan="2">9. Burimi Financimit: Buxheti i shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
1.BOE ñLé ò dhe ñEé ò ShPK
2.BOE ñBé ò dhe ñ2é ò ShPK
3.OE ñAé 2é 4ò ShPK
4.OE ñShé Aé ò ShPK
5.OE ñEé Vé ò ShPK
6.BOE ñAé Gé ò dhe ñFé Bé & Cé COò ShPK</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK,
Ka</td><td colspan="2">12. Përgjigje ankesës nga AK,
Ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</td></tr>
<tr><td colspan="4">b. Kontrata</td></tr>
<tr><td colspan="2">14. Lidhja e kontratës 23.04.2021</td><td>15. Vlera e kontratës (pa tvsh)</td><td>220,079,942 lekë</td></tr>
</table>

Mbi realizim e procedurës së prokurimit

Ndërtim i objektit të Atrium Center Njësia Administrative Thumanë Krujë është realizuar sipas VKM-së nr.1144 datë 24.12.2020 ñPër përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të objektit ñAtrium Centerò, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatueseò pika 1, ñ*Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit të objektit "Atrium Center", njësia administrative Thumanë, Bashkia Krujë, në vlerën 220,079,942 lekë pa TVSH.*ò

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të territorit ka paraqitur kërkesën Titullarit të Bashkisë dhe NjP për fillimin e procedurës së prokurimit me nr. 1008 Prot., datë 12.02.2021.

Është dërguar në Bashkinë Krujë oponenca me miratim nga Institutit i Ndërtimit me nr. 453/2, datë 05.05.2021.

Në proces verbalin e mbajtur më datë 12.02.2021 është përcaktuar që lloji i procedurës të jetë ñ*E kufizuar në formën e marrëveshjes kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit*ò.

Llogaritja e fondit limit

Vlera totale e investimit është llogaritur nga studio projektuese ñEé ò ShPK, dhe bazuar në projektet dhe preventivat e hartuara është 220,210,898 lekë pa TVSh.

Investimi përbëhet nga Punime Ndërtimi 10 zëra dhe Punime Sistemime të Jashtme 6 zëra.

Hartimi i specifikime teknike dhe DT

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 111 datë 12.02.2021 ñPër caktimin e personave përgjegjës për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për objektin ñ*Ndërtimi i objektit Atrium Center Thumanë, Njësia Administrative Thumanë Bashkia Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit*ò, i përbërë nga Përgjegjësi i Prokurimeve Publike në Bashkinë Krujë z. G. H. dhe Ing. E. S., Drejtori i DPKZhT.

Grupi i punës me shkresën nr. 1010/1 datë 12.02.2021 ka hartuar kriteret e veçanta për kualifikimin e procedurës së prokurimit të sipër cituar.
Zhvillimi i procedurës është kryer referuar Urdhrit të prokurimit nr. 110 datë 12.02.2021 ku përcaktohet NjP me përbërje z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. të zhvillojnë procedurën e prokurimit me objekt *Ndërtim i objektit Atrium Center Njësia Administrative Thumanë Bashkia Krujë në kuadër të procesit të rindërtimit*ò, me FL të kontratës të lidhur për një periudhë 12 mujore në shumën 220,210,898 lekë, procedurë ñe kufizuarò, marrëveshje kuadër. Për hartimin dhe miratimin e DT është mbajtur proces verbali përkatës më datë 12.02.2021. Shpallja e procedurës është bërë në Buletinin e APP-së nr. 22 datë 15.02.2021.
Kulifikimi i OE fitues do të ndjekë 2 faza:

Faza 1 – Kualifikimi / marrëveshja kuadër

Kandidatët do të dorëzojnë kapacitetet teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin për paraqitjen e ofertës financiare dhe dokumentet e kërkuara në DT. Autoriteti përgjegjës, do të shqyrtojë dokumentet e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, skualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë skualifikim. Autoriteti përgjegjës, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të dorëzojnë me dokumentacionin edhe një çmim/ofertë referues/e, e cila gjatë fazës së dytë nuk duhet të jetë më e lartë.

Faza 2 – Paraqitja e ofertës/ lidhja e kontratës

Autoriteti përgjegjës dërgon një ftesë për të dorëzuar ofertën, kandidatëve që janë kualifikuar palë në marrëveshjen kuadër në Fazën 1. Ofertat shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kritereve përkatëse nga Autoriteti përgjegjës. Ky i fundit ia jep kontratën atij Ofertuesi që ka paraqitur ofertën më të mirë të vlerësuar.
Në proces verbalin e mbajtur më datë 25.02.2021 është përcaktuar si kriteri përzgjedhjes së fituesit ò*Oferta ekonomikisht më e favorshme*ò dhe *Kriteret e Vlerësimit si vijon*:

(i) Çmimi më i ulët [60 Pikë]
(ii) Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit [30 Pikë]
(iii) Cilësia [10 Pikë]

Titulli i gjetjes 40:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në hartimin e kritereve në DT.*

Situata: Nga auditimi i kritereve të vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:
1. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën **2.3.4** të DT ñ*Personeli dhe fuqia punëtore: Kandidati/ofertues duhet të vërtetojë se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës... duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën, Gusht 2020-Janar 2021 i të paktën 280 punonjës*ò.
2. Nukjanëargumentuar llojet dhe sasitë e makinerive dhe mjeteve të kërkuara nga OE të interesuar veçanërisht e makinerive/mjeteve si vijon:

Nr.	*Emri i mjetit*	*Njësi*	*Sasi*	*Statusi*
1	*Kamiona vetëshkarkues min 15 dhe 25 ton*	*Copë*	*10*	*Në pronësi ose me qira*
2	*Rimorkiator*	*Copë*	*2*	*Në pronësi ose me qira*
3	*Kokë tërheqëse e Rimorkiatorit*		*2*	*Në pronësi ose me qira*
4	*Betoniere 500 litra*	*Copë*	*6*	*Në pronësi ose me qira*
5	*Autobetoniere*	*Copë*	*10*	*Në pronësi ose me qira*
6	*Nyje inerte*	*Copë*	*1*	*Në pronësi/ qira /kontratë furnizimi*
7	*Nyje betoni*	*Copë*	*1*	*Në pronësi/ qira /kontratë furnizimi*
8	*Gurë thyese mobile*	*Copë*	*1*	*Në pronësi ose me qira*

Këto kritere, janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 77,

pika 1, ñKërkesat për kualifikim...*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës*ò, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 26, pika 5, ñ*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*ò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. G. H., znj. E. C. dhe znj. A. G. dhe Inxhinier E. S., Drejtori i DPKZhT.
Kriteri: Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 77, pika 1. VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, i ndryshuar, neni 26, pika 5.
Efekti: Kufizim në pjesëmarrjen e OE në garë.
Shkaku: Vendosja e kritereve të pashoqëruara me argumenta.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Njësitë e prokurimit në procedurat përkatëse të prokurimeve të marrin masa për argumentimin dhe analizimin nëpërmjet përllogaritjeve në çdo rast të vendosjes së një kriteri në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së OE në konkurrim.

Ankesë
Lidhur me procedurën e sipër cituar ka paraqitur ankesë pranë AK, OE ñLé ò ShPK më datë 22.02.2021. Ankesa ka si objekt kundërshtimin e kriterit 2.3.4 të vendosura nga AK në DT për ñPersonelin dhe fuqinë punëtoreò. Nga AK është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1120/1 Prot, datë 22.02.2021 ku AK deklaron mos kompetencë në trajtimin e ankesës referuar përcaktimeve të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò neni 42 pika 9, ñNë rastin e ankesave për dokumentet e tenderit operatorët ekonomikë ankohen brenda 2 ditëve nga publikimi i dokumenteve të tenderit në Komisionin e Prokurimit Publik (KPP), që shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe këtij akti. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon procedurën e prokurimitò.

Vlerësimi i ofertave
Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK ka ngritur KVO me Urdhrin nr. 112 datë 12.02.2021 me përbërje z. F. C., zj. I. H. dhe z. I. K.
Afati i ekzekutimit të punimeve është 4 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.
KVO më datë 25.02.2021 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për Fazën e I të procedurës së prokurimit ku konstatohet se në SPE kanë ngarkuar dokumentacionin 6 OE, si më poshtë:

1.BOE ñLé ò dhe ñEé ò ShPK
2.BOE ñBé ò dhe ñ2é ò ShPK
3.OE ñAé 2é 4ò ShPK
4.OE ñShé Aé ò ShPK
5.OE ñEé Vé ò ShPK
6.BOE ñAé Gé ò dhe ñFé Bé & Cé . COò ShPK

Më datë 08.03.2021 KVO ka mbajtur proces verbalin për vlerësimin e ofertave të Fazës së I-rë duke sëkualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:
1. BOE ñBé ò dhe ñ2é ò ShPK, për arsyet e mëposhtme:

- BOE në kontratën e bashkëpunimit nr. 2619, datë 24.02.2021, nuk ka paraqitur ndarjen në përqindje të punës;
-Automjetet tip betoniere me targa AB1é Y dhe AB 1é Y të marra me qira nuk disponojnë certifikatë transporti;
- Automjetet tip betoniere me targa AA8é F, AA4é A dhe AA 8é F të marra me qira nga OE disponojnë certifikatë transporti për llogari të vet nga Bashkia Krujë;
- Automjetet tip autobetoniere dhe 1 autopompë betoni me targa AA0é N dhe AA 2é L të marra me qira nga OE disponojnë certifikatë transporti për llogari të vet nga Bashkia Këlcyrë;
2. OE ñShé Aé ò ShPK, për arsyet e mëposhtme:
- Të ketë kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit (88,084,359 lekë) dhe as punë të ngjashme për tre vitet e fundit që të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit (440,421,496 lekë), subjekti nuk ka vërtetuar se tre vitet e fundit të ketë kryer punë të ngjashme sa dyfishi i fondit limit, sipas DST pika 2.3.1;
- OE sipas pikës 2.3.4 të DST nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se posedon 1 inxhinier hidroteknik, nga 3 hidroteknikë ka vërtetuar se ka 2, nga 10 karpentierë vërtetuar se ka vetëm 5, nga 10 muratorë ka vërtetuar se ka 4, nga 6 pllakashtrues ka vërtetuar se ka 2, nga 5 automakinistë ka vërtetuar se ka 2 dhe nga 2 buldozeristë ka vetëm 1;
- OE nuk ka paraqitur OHSAS ISO 45001-2018 sipas kërkesës 2.3.8 të DST;
3. OE ñEé Vé ò ShPK, nuk plotëson asnjë kusht të DS, pasi i vetmi dokument është një Ekstrakt i Thjeshtë.
Nga auditimi rezultoi se OE nuk i plotësojnë kriteret e sipërcituara dhe të vlerësuara nga KVO si mangësi.
Nga KVO janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjeskuadër:

1. BOE ñLé ò dhe ñEé ò ShPK
2. OE ñAé 2é 4ò ShPK
3. OE ñEé Vé ò ShPK
4. BOE ñAé Gé ò dhe ñFé Bé & Cé COò ShPK

Në fazën e parë të procedurës së kufizuar nuk ka klasifikim në bazë të ofertës ekonomike dhe teknike.
Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër është publikuar në Buletinin e APP-së nr. 43 datë 24.03.2021.
Me OE të kualifikuar në fazën e parë është nënshkruar marrëveshja kuadër ku përcaktohen dhe detyrimet e palëve.
Titulli i gjetjes 41:*Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave*
Situata: Nga auditimi i fazës së kualifikimit të ofertave rezulton se:
1. BOE ñLé ò dhe ñEé ò ShPK, nuk plotëson kriterin e DT **2.3.4**-ñ*Personeli dhe fuqia punëtore: Kandidati/ofertues duhet të vërtetoje se disponon numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës dhe për këtë duhet të ketë një punësim mesatar për periudhën , Gusht i vitit 2020 , deri në Janar 2021 i të paktën 280 (dyqind e tetëdhjete) personave duke përfshirë stafin e përhershëm*. Sipas dokumentacionit të paraqitur OE nuk e plotëson numrin mesatar të punonjësve që kërkohet 6 muaj e fundit për tâu kualifikuar lidhur me këtë kriter.
2. OE ñAé 2é 4ò ShPK nuk plotëson kriterin e DT **2.3.1***"Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën" Të ketë kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit (88,084,359 lekë) dhe as punë të ngjashme për tre vitet e fundit që të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit (440,421,496 lekë), subjekti nuk ka vërtetuar se tre vitet e fundit të ketë kryer punë të*

ngjashme sa dyfishi i fondit limit. Pasi asnjë punë e ngjashme nuk ka vlerën sa 40% e fondit limit, si dhe totali i punëve të ngjashme sipas dokumenteve të OE është në vlerë 351,232,468 lekë dhe jo 440,421,496 lekë sipas DT.

- Nuk plotëson kriterin e DT **2.3.11** *"Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës", përkatësisht për:*

1) nuk ka dokument që disponon nyje betoni dhe nga 8 copë vibrator thellësie OE ka paraqitur dokumente për 5 copë;

2) nuk ka paraqitur të gjithë fotot për tabelat paralajmëruese për sigurinë në objekt por nga 15 ka sjellë 11 foto për këto tabela, si dhe ka paraqitur 3 foto për 5 karroca dore të cilat e disponon.

- Nuk plotëson kriterin e DT **2.3.11 pika e** *"Për nyjen e betonit në pronësi duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore lëshuar nga QKL fotot, vendndodhja e impiantit, karta teknologjike e prodhimit të betonit lëshuar nga institucionet përkatëse. Nëse është marre me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë me kohëzgjatje deri në përfundim të realizimit të kërkesave të kësaj procedure. Në këtë rast duhet të paraqesë kontratën e qirasë dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit."*

3. BOE ñAé Gé ò dhe ñFé Bé & Cé COò ShPK, nuk plotëson kriterin e DS **2.3.9** ñ*Operatori ekonomik të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte" dhe (QKL) Kodi III.2.B Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme.*ò

Sa më sipër rezulton se, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 80, Parimet e procesit të përzgjedhjes, pika 1. ñ*Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme: a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura*ò Neni 92, pika 3 ñ*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*ò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. F. C., zj. I. H., z.I. K.

Bashkia Krujë, ka paraqitur observacion me shkresën nr. 360/1, datë 12.07.2022 protokolluar në KLSH me nr.259/4 datë 12.07.2022, ku citohet:

Pretendimet e subjektit:

1. Në lidhje me mangësitë e konstatuara për BOE "L…" ShPK dhe "E…" ShPK nuk plotësojnë kriterin 2.3.4 lidhur me numrin e nevojshëm të punonjësve për realizmin e punimeve, bazuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2014, neni 53 pika 4, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku citohet "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme dhe nëse ajo përmban devijime të vogla...."si dhe bazuar në pikën 8 të nenit 26 të VKM-së 914, datë 29.11.2014 "Për miratimin e rregullave të PP" si dhe pikës 3 të nenit 74 të kësaj VKM, KVO në vlerësimin e realizuar, se nga paraqitja e dokumenteve ligjore që vërtetojnë disponimin e punonjësve, BOE i ka kapacitete teknike për të realizuar objektin e prokurimit. Ky përfundim është në përputhje dhe me nenin 46 të LPP.

2. Në lidhje me konstatimin se "A…" ShPK nuk plotëson kushtet e përvojës së mëparshme, rezulton se subjekti ka paraqitur punë të ngjashme "kontratë sipërmarrje me objekt rikonstruksion dhe sistemim i ngrohjes të shkollës 9-vjeçare" si dhe "kontratë sipërmarrje me objekt ndërtim kaparoni industrial";
3. Lidhur me konstatimin se "A…" ShPK ka mangësi në mjetet e paraqitura, rezulton se ai ka në pronësi nyjen e betonit për të cilin ka paraqitur të gjithë dokumentacionin ligjor si dhe lejen e mjedisit;
4. Lidhur me mangësinë në paraqitjen e vibratorëve të thellësisë, KVO bazuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2014, neni 53 pika 4, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, gjykon se paraqitja e vetëm 5 nga 8 vibratorë të kërkuar është e mjaftueshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Për këto observacione nuk ka fakte të reja dhe këto pretendime janë të njejtat që janë dërguar në akt-konstatime, dhe për të cilat grupi i auditimit i ka sqaruar në Projekt Raportin e Auditimit.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 ñPër Prokurimin Publikò, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.
Efekti: Mundësia për të mos garantuar përmbushjen me sukses të kapacitetit teknik.
Shkaku: Mos vlerësimi i saktë i dokumentacionit të paraqitur.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

Faza e dytë
Faza e dytë fillon me publikimin dhe dërgimin e shtojcës nr. 2 të DT òFtesa për ofertëò OE të kualifikuar dhe me të cilët është nënshkruar Marrëveshja Kuadër. Shtojca nr. 2 është miratuar nga Titullari i AK me nr. 1885 Prot., datë 23.03.2021. Në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 ñPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyroreò, neni 41, pika 3. ñ*Përzgjedhja e fituesve, që zbatojnë kontratat publike në kuadër të procesit të rindërtimit, kryhet sipas kritereve të vlerësimit në lidhje me objektin e kontratës që prokurohet dhe janë cilësia, çmimi dhe koha e zbatimit të kontratës*ò dhe DT kriteret e vlerësimit do të jenë: Grafiku i zbatimit 0-30 pikë, Çmimi më i ulët 0-60 pikë dhe Cilësia 0-10 pikë.
OE kanë paraqitur pranë AK dokumentacionin e ofertës ekonomike dhe KVO më datë 30.03.2021 ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave. Proces verbali i vlerësimit të ofertave nr. 2122 Prot., është hartuar më datë 01.04.2021, ku në përfundim të vlerësimit rezulton se **OE "A… 2…4" ShPK është vlerësuar me 100 pikë** me çmim oferte 220,079,942 lekë, dhe **BOE "A… G…" ShPK dhe "F… B… & C… CO" ShPK është vlerësuar me 94.14 pikë me çmim oferte 220,146,636 lekë**.
Raporti përmbledhës nr. 2142 Prot., është hartuar më datë 01.04.2021 për të dyja fazat dhe është miratuar nga Titullari i AK po më datë 01.04.2021. Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar në Buletinin e APP nr. 51 datë 07.04.2021.
Për lidhjen e kontratës Titullari i AK ka miratuar urdhrin nr. 240, datë 23.04.2021 ñPër lidhje dhe zbatim kontrateò në zbatim të cilit me OE të shpallur fitues është lidhur kontrata me nr. 2699 Prot., datë 23.04.2021 me vlerë totale 220,079,942 lekë pa TVSh me afat të përfundimit të punimeve brenda 4 muajve nga data e fillimit të tyre. Punimet duhet të fillojnë brenda 3 ditëve nga data e lejes së ndërtimit të dhënë nga DPKZhT në Bashkinë Krujë.

9. Procedura e prokurimit me objekt "Sistemim-asfaltim i rrugës Gramëz-Sukth Vendas (Faza e II), Krujë" viti 2021.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

9. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**: "**Sistemim-asfaltim i rrugës Gramëz-Sukth Vendas (Faza e II), Krujëò **viti 2021**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 530 datë 11.08.2021 **4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E Hapurò**	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 531, datë 11.08.2021:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. I. K. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSh) 16,405,651 lekë	**6. Oferta fituese** Ué ShPK, me vlerë 8,999,595 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 7,406,056 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 27.08.2021	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i bashkisë 2021 (të ardhurat + transfertat specifike)	**10. Operatorët Ekonomikë** a) Bé ShPK b) Dé 05 ShPK c) Né ShPK ç) Ké Té ShPK d) Ué ShPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 28.09.2021	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)**	**10,799,514 lekë**

Nga auditimi konstatohet se, rezulton se kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kualifikuar nuk u konstatuan parregullsi. U konstatua se OE i kualifikuar dhe shpallur fitues përmbush kriteret e vendosura në DT.

10. Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujën" viti 2021.

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit:

10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt**:** ñ*Shërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujën"* **viti 2021**		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 376 datë 07.06.2021 **4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E Hapurò**	**2. Njësia e Prokurimit:** 1. G. H. 2. E. C. 3. A. G.	**3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 377, datë 07.06.2021:** 1. F. C. (Kryetar) 2. I. H. (Anëtare) 3. R. D. (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa TVSh) 16,624,110 lekë	**6. Oferta fituese** Ré 96 ShPK, me vlerë 16,554,072.05 lekë pa TVSh	**7. Diferenca me fondin limit** 70,038 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 24.06.2021	**9. Burimi Financimit:** Nga buxheti i bashkisë 2021 (të ardhurat + transfertat specifike)	**10. Operatorët Ekonomikë** BOE ñRé 96ò ShPK dhe ñLé 2é 7ò ShPK
11. Ankimime AK, Nuk ka	**12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka**	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka**
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës 07.07.2021	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)**	**19,864,886.46**

Autoriteti Kontraktor Bashkia Krujë ka vendosur që shërbimin me objekt:*Shërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujën"* ta kryejë me marrëveshje kuadër me afat 1 vjeçar bazuar në Ligjin nr. 162/2020 ñPër Prokurimin Publikò, dhe VKM-së nr. 914 ñPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Bashkia Krujë për prokurimin e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane pranë Njësisë së Prokurimit është paraqitur kërkesa me nr. 3806 Prot.,

datë 07.06.2021 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Investimeve. Bashkëlidhur kërkesës përgatitur po nga kjo drejtori gjendet dokumentacioni:

- Preventivi me çmime (ditor, mujor, vjetor);
- Grafiku i shërbimit (ditor, mujor, vjetor);
- Analiza teknike e kostos për shërbimin e pastrimit (sipas zërave);
- Tabela e rrugëve, shesheve e trotuareve në territorin e njësisë administrative;
- Të dhëna të përafërta për numrin e popullsisë dhe numrin e familjeve për vitet 2018-2020;
- Përllogaritja e mbetjeve urbane;
- Relacioni teknik;
- Specifikime teknike.

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrin nr. 376 datë 07.06.2021 ñPër zhvillimin e procedurës së hapur ï marrëveshje kuadër për 12 muaj me objekt ñShërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujënòò.

Referuar këtij urdhri ngarkohet NJP me përbërje: z. G. H., zj. E. C. dhe zj. A. G. të zhvillojnë procedurën për shërbimin e pastrimit me vlerë të Fondit Limit (FL) 16,624,110 lekë. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më datë 08.06.2021 me afat kohor për dorëzimin e ofertave datë 24.06.2021. Lloji i procedurës ñe hapurò është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 07.06.2021.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 07.06.2021 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim pastrimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò çmimin më të ulët.

Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike është Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve Publike referuar Urdhrit nr. 04, datë 05.01.2021 ñPër ngarkimin e strukturave përgjegjëse në Bashkinë Krujë për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit të parashikuara për vitin 2021ò.

Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar nga z. N. L. - Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve Publike, shkresa nr. 3805 Prot., e datës 07.06.2021. Sipas kësaj shkrese OE duhet të vërtetojnë se disponojnë:

- Sipërfaqe për vendqëndrimin e mjeteve në pronësi ose me qira brenda territorit të Bashkisë Krujë;
- Numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës 23 punonjës përfshirë dhe stafin e përhershëm;
- Mjetet dhe makineritë e mëposhtme për kryerjen e shërbimit:

Nr.	Lloji i makinerisë	Njësia	Sasia
1	Autofshesë me fshesa rrul e flutur	copë	1
2	Kamion teknologjik plehrash	copë	1
3	Autobot uji për larje/larje specifike rrugësh	copë	1
4	Kontenierë të lëvizshëm për hedhje mbeturinash. (Karroca)	copë	4
5	Fadromë me goma me kapacitet të kovës 0.25-1 m^3	copë	1

Llogaritja e fondit limit

Fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò është llogaritur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Investimeve dhe është orientuar në tetë lloj shërbimesh:

1. Pastrim me autofshesë i rrugëve, shesheve e trotuareve - me vlerë vjetore 3,891,269.4 lekë pa TVSh;

2. Pastrimi me fshesë i rrugëve, shesheve dhe trotuareve - me vlerë vjetore 3,346,235.2 lekë pa TVSh;
3. Transport mbetje urbane ï me vlerë vjetore 5,410,066.4 lekë pa TVSh;
4. Pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh ï me vlerë vjetore 293,578.8 lekë pa TVSh;
5. Larje rrugësh, sheshesh dhe trotuaresh ï me vlerë vjetore 1,626,956.1 lekë pa TVSh;
6. Pastrim territori urban ï me vlerë vjetore 1,683,704 lekë pa TVSh;
7. Sistemim, ngarkim dheu, zhavorrishte, inerte, barishte, etj., me ekskavator 0.25 m^3 në mjet ï me vlerë vjetore 212,500 lekë pa TVSh;
8. Transport dheu, inerte, barishte, etj. ï me vlerë vjetore 159,800 lekë pa TVSh;

Shuma vjetore e fondit limit është përllogaritur 16,624,109.9 lekë pa TVSh.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim pastrimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 07.06.2021.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura nga NJP janë në përputhje me llojin e shërbimit që kërkohet të prokurohet nga Bashkia Krujë.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 377, datë 07.06.2021 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. F. C. (Kryetar), zj. I. H. dhe z. R. D.

Më datë 24.06.2021 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt ñShërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò me FL 16,624,110 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) ñRé 96ò ShPK me NIPT K13é 10W dhe ñLé 2é 7ò ShPK me NIPT K77é 01L. KVO ka vendosur se i duhet më shumë se një ditë punë kohë për të vlerësuar ofertën.

Më datë 28.06.2021 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit ñtë hapurò me objekt ñShërbim Pastrimi dhe depozitimit të mbetjeve urbane për Fushë-Krujënò me FL 16,554,072.05 lekë. Nuk ka operatorë të sëkualifikuar, ka paraqitur ofertë vetëm BOE ñRé 96ò ShPK dhe ñLé 2é 7ò ShPK **me vlerë oferte 16,554,072,05 lekë pa TVSh**, i cili është kualifikuar nga KVO.

Raporti përmbledhës nr. 4397 Prot., është hartuar nga KVO dhe miratuar nga titullari i AK më datë 28.06.2021.

Formulari i njoftimit të fituesit nr. 4397/1 Prot., është hartuar më datë 29.06.2021 dhe është publikuar në buletinin e APP-së nr. 104 datë 05.07.2021.

Në përfundim të procedurave për ofrimin e shërbimit të pastrimit në Qytetin e Fushë-Krujës me BOE është lidhur kontratë sipërmarrje me nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr. 480, datë 07.07.2021 ñPër lidhje dhe zbatim kontrateò me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me BOE ñRé 96ò ShPK dhe ñLé 2é 7ò ShPK është lidhur kontrata me vlerë 16,554,072 lekë pa TVSh dhe 19,864,886 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës është hartuar më datë 07.07.2021 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 109, datë 12.07.2021.

Nga auditimi konstatohet se, nuk është pjesë e dokumentacioni foto për mjetin fadromë me goma me kapacitet të kovës 0.25-1 m^3, të marrë me qira, sipas DST pika 3.3.7 për mjetet

germa f, ku citohet se *"OE duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit".*

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës z. F. C., zj. I. H. dhe z. R. D.

Zbatimi i kontratës

Grupi i punës që do të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit në Qytetin e Fushë-Krujës është ngritur me urdhrat e Kryetarit të Bashkisë nr. 481, datë 07.07.2021 me përbërje z. N. L., z. R. A. dhe z. K. B.

1. Kryerja e shërbimit të pastrimit në rrugët që kryhen punime

Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit në regjistrin e realizimit të prokurimeve për vitin 2021 dhe listës së investimeve të përfunduara po në këtë vit rezulton se në Qytetin e Fushë-Krujës janë sistemuar dhe asfaltuar 4 rrugë (rrugët ñÇlirimiò, Rruga ñ5 Majiò, Rruga e vjetër hyrëse e Tiranës pranë Xhamisë dhe Rruga lidhëse S. Çela dhe Rruga e shkollës) që bëjnë pjesë në listën e rrugëve dhe shesheve të Njësisë Vendore Fushë-Krujë për tâu pastruar. Punimet janë kryer në afatet si më poshtë:

1. Rruga ñÇlirimiò për periudhën 10.12.2021-09.02.2022;
2. Rruga ñ5 Majiò për periudhën 10.12.2021-09.02.2022;
3. Rruga e vjetër hyrëse e Tiranës pranë Xhamisë për periudhën 25.08.2021-24.09.2021;
4. Rruga lidhëse S. Çela dhe Rruga e shkollës për periudhën 30.04.2021-26.05.2021.

Referuar kushteve të kontratës nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, neni 11, pika 11.6 ñ*Kontraktuesi do të ndërpresë zbatimin e punimeve të shërbimit të pastrimit, për një afat kohor të caktuar, në ato raste kur për shkaqe teknike (punime për rikonstruksionin e rrugëve, kryerja e shërbimit ose e një pjese të shërbimit është e pamundur. Ndërprerja e shërbimit ose modifikimi i tij, për këtë rast do të kryhet vetëm pas njoftimit zyrtar dhe miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë*ò.

<u>*Nga auditimi konstatohet se,*</u> nuk ka asnjë korrespondencë midis AK Bashkia Krujë dhe Kontraktuesit lidhur me mos realizimin e shërbimit të pastrimit në këto dy rrugë për periudhën që ato kanë qenë në rikonstruksion si dhe zëvendësimin e tyre me rrugë të tjera që janë sistemuar në vitin paraardhës dhe nuk janë pjesë e kontratës, sipas afatit të punimeve. Sipas llogaritjeve, zërat e punimeve që nuk janë kryer sipas sipërfaqeve të rrugëve në këto 2 rrugë për periudhën që ato kanë qenë në rikonstruksion, ***janë në vlerën 22,847 lekë***. Sqarojmë se proces verbali i mbajtur nga mbikëqyrësit e kontratës për Rruga ñÇlirimiò dhe ñ5 Majiò grupi i auditimit e vlerëson si dokument nuk ofron siguri të arsyeshme, pasi nuk ka numër protokolli, por mban vetëm datën paraardhëse të fillimit të sistemim-asfaltimit, si dhe në proces verbal këto dy rrugë janë zëvendësuar me aksin nacional të vjetër të Laçit (pjesë përballë Poliklinikës-Unaza e qytetit), rrugë e cila është në listën e rrugëve të Fushë Krujës që OE pastron.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Data e fillimit të punimeve	Data e përfundimit të punimeve	Sipërfaqja m^2	Vlera për secilin zë në m^2 në muaj	Vlera totale në lekë
1	Sistemim-asfaltim i rrugës ñÇlirimiò	10.12.2021	09.02.2022	855	Larje me a. fshesë ï 5.4 Larje me fshesë ï 5.07	12,400
2	Sistemim-asfaltim i rrugës ñ5 Majiò	10.12.2021	09.02.2022	720	Larje me a. fshesë Larje me fshesë	10,447
TOTAL						**22,847**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kontratave nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, neni 11, pika 11.6 si dhe tabelës së rrugëve për tû pastruar, e miratuar nga AK ñ*nërastin e kryerjes së punimeve në rrugë apo sheshe të veçanta të kësaj tabele, gjatë periudhës së kontraktimit, mbikëqyrësi i kontratës duhet të pezullojë procesin e pastrimit me fshesë e auto-fshesë, si dhe larjet, deri në njoftimin për përfundimin e punimeve. Në kompensim të sipërfaqeve e volumeve të kontratës për rastet kur punohet mund të shtohen rrugicat e asfaltuara në vitin paraardhës e të papërfshira në tabelë dhe të zbriten rrugët që do të asfaltohen në vitin aktual e që përfshihen brenda tabelës"*.

2. Raportimet

Nga auditimi rezulton se, kontraktuesi nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, neni 13, pika 1 dhe pika 2 ñ1. *Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore në të cilat duhet të parashikojë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për proceset e punës, sipas preventivit në përputhje me Specifikimet Teknike. Në raporte duhet të paraqiten dhe emrat dhe titujt e personelit mbikëqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjithave rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë si dhe një përmbledhje të të gjithave situacioneve të cilat ja përcjell kontraktuesi gjatë kësaj kohe. 2. Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Krujë 5(pesë) kopje të raportit vjetor brenda 5(pesë) ditëve nga përfundimi i kontratës shoqëruar me situacionin e fundit të shërbimit".*

3. Edukimi ambiental

Nga auditimi rezultoi se, kontraktuesi për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2021-2022 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambjenteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambjental i cili, duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Veprime këto që janë në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, nenin 18, pika 1 dhe pika 2 ñ1. *Kontraktuesi duhet të zhvillojë një program të edukimit publik të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të Qytetit të Fushë Krujës... 2. Kontraktuesi duhet të kryejë një herë në 6 muaj Program Edukimi Ambiental i cili do të përbëhet nga prodhimi dhe transmetimi i një spoti televiziv sipas idesë dhe përmbajtjes së AK..."*

Në kushtet e mos realizimit të programe të edukimit publik dhe ambjental supervizorët e AK nuk kanë apkikuar gjoba ndaj kontraktuesit në kundërshtim me përcaktimet e kontratave, neni 28 ñPenalitet dhe gjobatò, germa f)*Në rast se kontraktuesi nuk përbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 18 dhe kapitullit të "Specifikimeve Teknike", për kryerjen e Edukimit Publik Ambiental, supervizorët e Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Krujë aplikojnë gjobë në masën 500,000(pesëqind mijë) lekë. Kontraktuesit do t'i njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambiental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambiental Autoriteti Kontraktor vendos penalitetin e radhës në masën 1,000,000 (një milion) lekë. Gjobat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor në situacionin e radhës të paraqitur për likuidim nga ana e Kontraktorit.*

4. Konteinerët

Nga vizitat në terren të grupit të auditimit në disa rrugë të Qytetit të Fushë Krujës u konstatuan se konteinerët ishin të amortizuar dhe një pjesë të pa pajisur me rrota e të pa larë.

Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e kontratave të shërbimit të pastrimit neni 20, pika 4 *"Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen mirëmbajtjen dhe riparimin e konteinerëve kur këta të fundit dëmtohen..."*.

Gjithashtu, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë proces verbal apo dokument tjetër justifikues në të cilin të identifikohet dëmtimi i rrotave të kontenierëve ose zëvendësimi i tyre për zërit pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh për ndërrimin përkatësisht të 206 rrota kontenierësh * 600 lekë = 123,600 lekë, si dhe 9 % të fitimit dhe 8 % e shpenzimeve për këtë zë, në total për 144,612 lekë.

Në dokumentacionin e paraqitur supervizorët e AK gjatë kryerjes së mbikëqyrjes dhe monitorimit të shërbimit nuk rezulton që të kenë konstatuar raste të mungesës së konteinerëve apo dëmtimit të tyre, si rezultat supervizorët e AK nuk kanë aplikuar ndalesat ndaj kontraktuesit në kundërshtim me përcaktimet e kontratave, neni 28, germa d) ñ*Në rastet kur konstatohet mungesa apo dëmtimi i konteinerëve të vënë në dispozicion nga AK, ...të specifikuara nga specifikimet e ndodhura për çdo rast ose/dhe çdo shkak. Kontraktuesi është i detyruar të paguajë kundravleftën e konteinerit të dëmtuar. Në raste se nuk kryhet riparimi i konteinerit ose zëvendësimi i tij nga ana e Kontraktorit atëherë AK mban vlerën e dëmit ose konteinerit sipas vlerës së kontabilizuar nga Bashkia Krujë nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim".*
Kuota e amortizimit të kontenierëve llogaritet në preventivin e OE në 10% amortizim për kontenier ose në vlerën 164,800 lekë në vit, ndërkohë që kontenierët janë në inventarin e bashkisë, si dhe 9 % të fitimit dhe 8 % e shpenzimeve për këtë zë, në total për 192,816 lekë. Ky veprim bie në kundërshtim me përllogaritjen e fondit limit për zërin pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh si dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñMenaxhimi i aktiveve të Njësisë së Sektorit Publikò, pika III/30 ku citohet: ñ*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia." Gjithashtu, nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë ndonjë riparim të kontenierëve për të cilin të mund të llogaritet ndonjë vlerë tjetër mbi zërat e përmendur për pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh.*

5. Mbikëqyrja gjatë kryerjes së shërbimit të pastrimit

Grupi i punës që do të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit në Qytetin e Fushë-Krujës është ngritur me urdhrat e Kryetarit të Bashkisë nr. 481, datë 07.07.2021 me përbërje z. N. L., z. R. A. dhe z. K. B. Rezultoi se referuar proces verbaleve ditore të mbajtura nga grupi i punës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës është kryer çdo ditë supervizim për pastrimin por akt-kontrollet nuk kanë përcaktuar në sasi sipas çdo zëri pune të shprehur në lekë në përputhje me proces verbalet ditore dhe preventivin e kontratës duke mos përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratat nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, neni 22, pikat 3, *Situacionet ditore vendosen në sasi sipas çdo zëri pune të shprehur në lekë në përputhje me proces verbalet ditore dhe preventivin e kontratës.*

6. Makineritë

Nga verifikimi i makinerive të deklaruara që do të përdoren për realizimin e shërbimit të pastrimit për periudhën e vlefshmërisë së kontratës rezultoi se:
1. Autofshesë me fshesa rrul e flutur ï Në dokumentacionin e marrjes pjesë në procedurën e prokurimit publik OE ka paraqitur mjetin me targë TR6é 5A të cilin, e ka me certifikatë pronësie të datës 07.04.2008;

2. Kamion teknologjik plehrash ï OE disponon mjetin me targa KR7é 2A i paraqitur në dokumentacion e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, të cilin e ka me certifikatë pronësie të datës 28.04.2008;
3. Autobot uji për larje/larje speciale rrugësh ï OE disponon mjetin me targa AA2é V i paraqitur në dokumentacion e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, të cilin e ka me certifikatë pronësie të datës 10.04.2018;
4.Kontenierë të lëvizshëm për hedhje mbeturinash - OE disponon kontenierët e paraqitur në dokumentacion e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit;
5. Fadromë me goma me kapacitet të kovës 0.25-1m^3 ï Në dokumentacionin e marrjes pjesë në procedurën e prokurimit publik OE ka paraqitur mjetin me targë ACé 9 konform kërkesave të përcaktuara në DT. Këtë automjet e ka marrë me qira sipas kontratës së qirasë nr. 4018, datë 21.06.2021. ***Nga verifikimi në terren ky automjet nuk ndodhej në vendin e parkimit.***

Titulli i gjetjes 42:*Mangësi në plotësimin e kritereve të kualifikimit për kontratën e vitit 2021.*
Situata: Nga auditimi konstatohet se, në setin e dokumenteve të dorëzuara nga BOE ñ Ré 96ò dhe ñLé 2é 7ò, në sistemin elektronik të prokurimit nuk evidentohen fotot e fadromës, pjesë e kritereve të kualifikimit. Mjeti faromë, është marrë me qira dhe bashkëlidhur kontratës së qerasë, janë paraqitur edhe 2 foto, njëra ballore dhe tjetra anësore e prerë (mjeti nuk është fotografuar i plotë), pra në asnjërën prej fotove nuk dallohet targa për të kuptuar që bëhet fjalë për të njëjtin mjet. Së dyti, fotot janë pa ngjyra duke e bërë të pamundur identifikimin e elementëve të mjetit me ato të dokumentacioneve të këtij mjeti. Për sa më lart, grupi i auditimit nuk krijon siguri të arsyeshme që mjeti i kërkuar në objektin e prokurimit është i njëjti si në dokumentet e tenderit ashtu edhe në foto.
Kriteri: DST pika 3.3.7 për mjetet germa f.
Efekti: Pamundësia për të identifikuar mjetin e kërkuar.
Shkaku: Mos vlerësimi i plotë i dokumentacionit të dorëzuar.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Bashkia Krujë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.
Titulli i gjetjes 43:*Mospërdorim me eficiencë i fondeve në dispozicion për shërbimin e pastrimit për kontratën e vitit 2021.*
Situata: Nga auditimit rezulton se nuk ka asnjë korrespondencë midis AK dhe Kontraktuesit lidhur me mos realizimin e shërbimit të pastrimit në këto dy rrugë për periudhën që ato kanë qenë në rikonstruksion si dhe zëvendësimin e tyre me rrugë të tjera që janë sistemuar në vitin paraardhës dhe nuk janë pjesë e kontratës, sipas afatit të punimeve. Sipas llogaritjeve, zërat e punimeve që nuk janë kryer sipas sipërfaqeve të rrugëve në këto 2 rrugë për periudhën që ato kanë qenë në rikonstruksion, *janë në vlerën 22,847 lekë.* Sqarojmë se proces verbali i mbajtur nga mbikëqyrësit e kontratës për Rruga ñÇlirimiò dhe ñ5 Majiò grupi i auditimit e vlerëson si dokument nuk ofron siguri të arsyeshme, pasi nuk ka numër protokolli, por mban vetëm datën paraardhëse të fillimit të sistemim-asfaltimit, si dhe në proces verbal këto dy rrugë janë zëvendësuar me aksin nacional të vjetër të Laçit (pjesë përballë Poliklinikës-Unaza e qytetit), rrugë e cila është në listën e rrugëve të Fushë Krujës që OE pastron.
Kriteri: Kontrata nr.4670 Prot., datë 07.07.2021, neni 11, pika 11.6 si dhe tabelës së rrugëve për tû pastruar, e miratuar nga AK.
Efekti: Mbivendosje e shërbimit të pastrimit në rrugë që janë klasifikuar një herë pjesë e rrugëve që do marrin shërbim.

Shkaku:Zëvendësim i gabuar i rrugëve në rikonstruksion.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim:Në funksion të përdorimit të fondeve sa më me eficiencë,Bashkia Krujë të marrë masa që në të ardhmen të jetë e kujdesshme në shqyrtimin e listës së rrugëve që janë pjesë e kontratës që janë për tu pastruar, duke përzgjedhur në rastet e nevojës së zëvendësimit rrugë që nuk janë pjesë e kësaj liste dhe që nuk marrin shërbim pastrimi.
Titulli i gjetjes 44:*Mangësi në raportimet që duhet të paraqes OE mbi përmbushjen e kontratës së vitit 2021.*
Situata: Nga auditimi rezulton se, për shërbimin e pastrimit për vitin 2020 dhe 2021 OE nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi lidhur me emrat dhe titujt e personelit mbikëqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjitha rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë.
Kriteri: Kontrata nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, neni 13, pika 1 dhe pika 2.
Efekti: Mungesë transparence në monitorimin e zbatimit të kontratave.
Shkaku: Neglizhencë në përmbushjen e përcaktimeve të kontratës së vitit 2021.
Rëndësia:E mesme
Rekomandim:Në të ardhmen mbikëqyrësi i zbatimit të kontratës të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë për detyrimet që ka OE si dhe pasqyrimin me përpikëri të përmbushjes së përcaktimeve të kontratës në çdo element të saj, pa anashkaluar ato detyrime që duken të një rëndësie më të ulët.
Titulli i gjetjes 45:*Mos hartimi dhe aplikimi i edukimit ambiental për kontratën e vitit 2021.*
Situata: Nga auditimi rezultoi se, kontraktuesi për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2021 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambjental i cili, duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Si pasojë e mos përmbushjes së këtij detyrimi, autoriteti kontraktor duhet të kishte aplikuar gjoba ndaj kontraktuesit si vijon: Në rast se kontraktuesi nuk përbush detyrimin e përcaktuar në kontratë sipas nenit 18 dhe kapitullit të "Specifikimeve Teknike", për kryerjen e Edukimit Publik Ambiental, supervizorët e Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Krujë aplikojnë gjobë në masën 500,000 (pesëqind mijë) lekë. Kontraktuesit do tô njoftohet masa e gjobës së aplikuar si dhe afati i përcaktuar për kryerjen e detyrimit të Edukimit Ambiental. Në rast se brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, Kontraktori nuk realizon Edukimin Publik Ambiental Autoriteti Kontraktor vendos penalitetin e radhës në masën 1,000,000 (një milion) lekë. Gjobat do të mbahen nga Autoriteti Kontraktor në situacionin e radhës të paraqitur për likuidim nga ana e Kontraktorit.
Kriteri: Kontrata nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, nenin 18, pika 1 dhe pika 2 dhe neni 28 germa f.
Efekti: Mospërmbushje e detyrimeve kontraktore për edukimin ambjental të qytetarëve me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 500,000 lekë.
Shkaku: Neglizhencë në përmbushjen e detyrimeve.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara nga buxheti në vlerën 500,000 lekë duke vlerësuar një nga mundësitë, ose aplikimin e gjobës prej 500,000 lekë ndaj BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò për mospërmbushje të detyrimit të përcaktuar nga 28 i kontratës nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, ose mbajtjen e kësaj vlerë në situacionet aktuale të shërbimit të pastrimit duke qenë se BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò është përsëri OE fitues që po ofron shërbimin e pastrimit për vitin 2022.
Titulli i gjetjes 46:*Likuidimi i punimeve të pakryera.*

Situata: Nga vizitat në terren të grupit të auditimit në disa rrugë të Qytetit të Fushë Krujës u konstatua se kontenierët ishin të amortizuar dhe të pa pajisur me rrota e të pa larë.
Gjithashtu, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë proces verbal apo dokument tjetër justifikues në të cilin të identifikohet dëmtimi i rrotave të kontenierëve ose zëvendësimi i tyre për zërin pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh për ndërrimin përkatësisht të 206 rrota kontenierësh.
Kriteri: Kontrata nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021 e shërbimit të pastrimit neni 20, pika 4.
Efekti: Likuidim i vlerës prej 144,612 lekë (206 rrota kontenierësh * 600 lekë = 123,600 lekë, si dhe 9 % të fitimit dhe 8 % e shpenzimeve për këtë zë për të dy kontratat), pavarësisht mos kryerjes së ndërrimit të rrotave të kontenierëve.
Shkaku: Mangësi në mbikëqyrjen dhe dokumentimin e shërbimeve të mirëmbajtjes për kontenierët.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për arkëtimin e vlerës 144,612 lekë për shërbimin e pakryer të ndërrimit të rrotave të kontenierëve, nga BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò.
Titulli i gjetjes 47:*Përfshirja në mënyrë të gabuar në vlerën e kontratës të amortizimit të kontenierëve.*
Situata: Nga auditimit rezulton se, në zërat që përbëjnë vlerën e kontratës është përfshire dhe kuota e amortizimit të kontenierëve në masën 10 % ose në vlerën164,800 lekë në vit, ndërkohë që kontenierët janë në pronësi dhe pjesë e aseteve në inventarin e bashkisë dhe si do aktiv tjetër amortizimi i tyre është pakësim në zërin kapital. Ashtu si edhe vetë bashkia e ka shprehur në neni 28, germa d) ñ*Në rastet kur konstatohet mungesa apo dëmtimi i konteinerëve të vënë në dispozicion nga AK, …të specifikuara nga specifikimet e ndodhura për çdo rast ose/dhe çdo shkak. Kontraktuesi është i detyruar të paguajë kundravleftën e konteinerit të dëmtuar. Në raste se nuk kryhet riparimi i konteinerit ose zëvendësimi i tij nga ana e Kontraktorit atëherë AK mban vlerën e dëmit ose konteinerit sipas vlerës së kontabilizuar nga Bashkia Krujë nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim",* zëri kontenierë është kontabilizuar në pasqyrat financiare të bashkisë dhe do shtesë apo pakësim i ka efektet në kapitalin e bashkisë dhe jo të OE. Po kështu pavarësisht që përfaqësuesit e bashkisë e cilësojnë këtë vlerë amortizimi si për fond për mirëmbajtje, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë formë dokumentimi apo evidence që të jenë identifikuar dëmtime dhe më tej riparime ose mirëmbajtje të kontenierëve. Për këtë zë është përshirë në vlerën e kotratës edhe 9% të fitimit dhe 8% e shpenzimeve për këtë zë, në total për 192,816 lekë për vitin 2021.
Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñMenaxhimi i aktiveve të Njësisë së Sektorit Publikò, pika III/30 dhe kontrata e shërbimit të pastrimit, neni 28, germa d.
Efekti: Llogaritje në mënyrë të gabuar si pjesë e kontratë vlera prej192,816 lekë.
Shkaku:Përfshirja në mënyrë të gabuar në vlerën e kontratës të amortizimit të kontenierëve.
Rëndësia:E lartë
Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për kthimin e vlerës 192,816 lekë për amortizimin e kontenierëve nga BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò, si dhe mos përfshirjen e këtij zëri në vlerën e kontratave të ardhshme.

2.5 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Auditimi i fundit në Bashkinë Krujë
Auditimi i fundit në Bashkinë Krujë është kryer në vitin 2019 për periudhën 01.01.2017-30.09.2019, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën 605/6 datë 25.12.2019. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 15 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 4 masa për uljen e borxhit tatimor në shumën 257,338,424 lekë, pranuar nga subjekti.
- 2 masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

1. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 15, germa j ñhartimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimitò, Bashkia Krujëpër zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 1084/8 datë 26.05.2020 ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8239/1 Prot, datë 14.01.2020, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Bashkia Krujëka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Rezulton se nga Bashkia Krujë me shkresën nr. 8239/1 Prot, datë 18.06.2020është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 30, pika 2, ñ*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhënaò.* Raportimi 6 mujor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve është dërguar në KLSH brenda afateve ligjore.

3. *Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH*

Sikurse është cituar më lart, Bashkia Krujëka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 8239/1 Prot, datë 14.06.2020dhe ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 50, pika 5, *"Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij"*.

4.Auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Krujë

Kontrolli i Lartë i Shtetit në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 31, pika 3, kryen auditimin e zbatimit të rekomandimeve në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit. Përkatësisht në zbatim të këtij detyrimi KLSH ka zhvilluar në Bashkinë Krujë auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 610 Prot, datë 25.06.2020, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në përfundim të auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve, me shkresën nr. 610/51, datë 04.12.2020, KLSH ka dërguar në Bashkinë Krujë Raportin Përfundimtar të auditimit me kërkesën për zbatimin e rekomandimeve që në përfundim të auditimit kanë rezultuar të pa zbatuara. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se janë rekomanduar gjithsej:
- 3 masa organizative;
- 1 masa për uljen e borxhit tatimor.

Masa organizative

1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet e kontabilizimit në rastet e kryerjes së investimeve në momentin e mbërritjes së faturës dhe çeljes së fondeve, për njohjen dhe realizimin e investimeve, duke prekur llogaritë përkatëse në mënyrë që, në fund të vitit të ushtrimor të paraqiten në bilanc detyrimet reale ndaj të tretëve në llogaritë e detyrimeve.
2. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë të gjitha veprimet e kontabilizimit sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike për kontratat e lidhura për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për të pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar që nga çelja e fondeve, me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës), deri në kapitalizimin e aktivitdhe jo thjesht, kur ndërhyn pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.
3. Rekomandim: KLSh i rikërkon, Titullarit të Bashkisë të marrë masat, për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe njëkohësisht përshpejtimin e masave që janë në process zbatimi.
Masa për uljen e borxhit tatimor
1. Rekomandim: KLSh i kërkon titullarit të Bashkisë Krujë ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat e konsideruara në proces zbatimi, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë.
Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSh-së rezulton se, çështjet që adresojnë këto rekomandime janë të përfshira në programin e auditimit që u zhvillua, për këtë arsye grupi i auditimit është shprehur në akt-konstatimet përkatëse sipas pikave të programit të auditimit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME
Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE
1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, procesi i realizimit të minutave të takimit për mbledhjet që ka kryer GMS, për vitet 2020 dhe 2021, nuk është i dokumentuar në formë shkresore. Si rrjedhim i kësaj, nuk ka të evidentuara as vendime, që vijnë si rezultat i çështjeve që janë diskutuar në këto mbledhje. Takimi i vetëm i dokumentuar është rasti kur GMS është mbledhur për ñCaktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022ò, bazuar në Vendim nr. 106, datë 28.12.2021. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar, neni 27, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1 Rekomandim: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat në mënyrë që, temat më problematike që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik dhe të dokumentohen takimet e realizuara nga GMS dhe vendimet e marra për diskutimet përkatëse.

Deri më datë 31.12.2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, nuk është hartuar Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, i cili referuar në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3. theksohet se është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit, me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe

qëllimet do të arrihen. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat që të hartojë në mënyrë periodike Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, i cili ndihmon në organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

Deri më datë 31.12.2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, nuk është hartuar Plani i Veprimit për arritjen e objektivave, i cili paraqet hapat që do të ndërmerren për të arritur objektivat e njësisë publike dhe për minimizimin e risqeve apo mangësive. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.1029. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar, Neni 8, pika a.

3.1 Rekomandim: Bashkia Krujë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat që të hartojë në mënyrë periodike Planin e Veprimit për arritjen e objektivave, duke bërë të mundur realizimin dhe përmbushjen e objektivave duke siguruar minimizimin e risqeve.

Deri më datë 31.12.2022

4. Gjetje nga auditimi: Referuar Urdhër nr. 733, nr. 8543 Prot., datë 16.12.2021, zj. S. D. është emëruar përkohësisht në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm e pa pajisur me certifikatë të audituesit të brendshëm. Eksperienca e mëparshme e punës së zj. S. D., nisur nga fakti që nuk ka certifikatën e audituesit të brendshëm, është jo e mjaftueshme për tu punësuar pranë NjAB të Bashkisë Krujë, referuar këtu edhe faktit se ajo nuk ka diplomë universitare të nivelit të dytënë shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera. Ajo ka vetëm diplomë të nivelit të parë, Bachelor në Menaxhim Biznesi. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, Neni 11, pika 2 a) dhe 2 ç). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa që në pozicionin e specialistit të NjAB, të punësohet një person që përmbush kriteret për të qenë pjesë e kësaj strukture dhe mundëson funksionimin e auditit të brendshëm në mënyrë efektive.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka dërguar Kartën e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, për periudhën objekt auditimi, siç parashikohet në ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, Neni 14, pika b). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa që Karta e Auditimit si një akt administrativ që përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm, duhet të dërgohet me shkresë përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në mënyrë që aktiviteti dhe statusi organizativ i njësisë së auditimit të brendshëm të bëhet i njohur dhe të jetë i identifikueshëm nga MFE.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë nuk ka hartuar dhe miratuar një program për sigurimin e cilësisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, për vitet 2020 dhe 2021, në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik pika 7.1.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1 Rekomandim: Bashkia Krujë duhet të hartojë në mënyrë periodike Programin e Sigurimit të Cilësisë të NjAB, për aq kohë sa ai shërben si një mjet apo tregues përpërmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm të njësisë publike.

Deri më datë 31.12.2022

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë nuk ka hartuar dhe miratuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, për secilin nga auditimet e ushtruara nga NjAB për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, Neni 12, pika d. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1 Rekomandim: Pas përfundimit të angazhimit të auditimit, NjAB të marrë masat që dosja që përmban gjithë dokumentacionin e auditimit duhet të pajiset edhe me një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Kjo ndihmon në monitorimin dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve në auditimin e radhës nga NjAB, për të parë se si dhe deri në çfarë mase janë zbatuar ato.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për periudhën 2020-2021 *u konstatua se*:
a. Fondet buxhetore për *vitin 2020* janë realizuar në shumën 2,371,923 mijë lekë nga 2,955,879 mijë lekë të planifikuara ose në masën 80.24% dhe për *vitin 2021* janë realizuar në shumën 1,844,674 mijë lekë nga 2,388,932 mijë lekë të planifikuara ose në masën 77.22%. Në mosrealizim kanë ndikuar realizimi në nivele jo të kënaqshme i:
- llog. 602 ñ*Shpenzime operative*ò në masën 39% në *vitin 2020* e 63% në *vitin 2021*;
- llog. 230-231 ñ*Shpenzime për investime*ò në masën 76.14% në *vitin 2020* e 77.2% në vitin 2021
- llog. 600-601ñ*paga e sigurime*ò në masën 86%,
- llog. 604 ñ*emergjencat civile*ò në masën 87% në *vitin 2020* e 57% në *vitin 2021.*

Mosrealizimi i fondeve në këto zëra shpenzimesh tregon për programime të pa studiuara dhe me rezervë mos realizimi i projekteve në vlerë të plotë, për të cilat nuk është bërë një analizë faktoriale për përmirësimin e punës për një planifikim mbi baza reale.
b. Në fund të periudhave ushtrimore 2020-2021, Bashkia Krujë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlera relativisht të konsiderueshme, ku në **fund të** *vitit 2020* janë në vlerën *50,030,364 lekë,* dhe në fund të*vitit 2021* janë në vlerën *36,909,191lekë*, por me një trend ulje nga viti në vit.Nga analiza e detyrimeve të prapambetura rezultojnë që, në fund të vitit 2021 janë të pa likuiduara gjithsej 111 raste faturash, kontratash, procese gjyqësorë dhe detyrime ndaj DRTT për TAP me vlerë 36,909,191 lekë të krijuara dhe të trashëguara që nga vitet 2015 e përparanga ish-komunat për të cilat mungon dokumentacioni.
c. Të ardhurat janë realizuar për *vitin 2020* në masën 91.3%. dhe për vitin 2021 në masën 94%, ndërsa vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, paraqitet në nivele relativisht të larta, në shumën 241,254 mijë lekë. Referuar këtyre treguesve të të ardhurave të realizuara, konstatohet se financimi i buxhetit vjetor 2021 është bërë në masën më të madhe prej 85% nga Buxheti i Shtetit (transferta e pakushtëzuar, transferta e kushtëzuar, transferta specifike, FZHR e Ministritë e Linjës) dhe 15% nga të ardhurat e veta.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò nenet 42,43,47,50,52 dhe 65; ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò neni 40,42, me Udhëzimin e MFE nr. 09 datë 20.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò pika 106, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar neni 12 pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria Ekonomike të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Metodologjia që DTTV përdor për të realizuar planifikimin vjetor të taksave dhe tarifave vendore nuk bën të mundur një parashikim real të të ardhurave të veta të Bashkisë Krujë. Rezulton të ketëdiferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit të bashkisë për sa i takon pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzime, për zërat që bashkia mund të parashikojë. Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale.

Këto veprime janë në kundërshtim meligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*ò, i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar;Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Vendore*ò i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò; Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*ò; Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 27.02.2019 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022*"; VKB-në 93, datë 12.12.2019 ñ*Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020*ò; VKB-në nr. 104, datë 28.12.2020 ñ*Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021*ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujë të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucione të tjera vendore përkatëse me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve në nivel bashkie që duhet të ngarkohen me detyrime për taksat dhe tarifat vendore, si rrjedhojë nuk mund të identifikohet as numri i familjeve debitore. Veprime këto në kundërshtim me

ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Bashkia Krujë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të marrë masat të ngrejë një grup pune për të identifikuar të gjithë familjarët që paguajnë detyrimet e bashkisë lidhur me taksat dhe tarifat familjare.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kushteve të akt marrëveshjeve për pagesën e detyrimeve vendore me këste rezultoi se, nga 23 marrëveshje që Bashkia Krujë ka lidhur gjatë vitit 2020, 13 subjekte nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes. Ndërsa për vitin 2021, nga 36 akt marrëveshje që janë lidhur, 14 subjekte nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes.

Nga auditimi i dokumentacionit që duhet për të nënshkruar akt marrëveshjet për likuidimin e detyrimeve vendore me këste, rezulton se ka mangësi në dokumentacion si vijon:

- Të gjithë akt marrëveshjet janë të pa protokolluara;
- Në njërin rast rezulton se, afati i akt marrëveshjes është lidhur për një periudhë prej 27 muaj;
- Pjesërisht nuk kanë kërkesë me shkrim nga ana e tatimpaguesit për të hyrë më marrëveshje për pagesë me këste;
- Në asnjë rast nuk rezulton që nga DTTV të jetë kërkuar garanci bankare përpara se të nënshkruhet marrëveshja për pagesat me këste.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 77, pika 2, 3, 4, 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Krujëgjatë hartimit të akt marrëveshjeve me subjektet debitorë të marrë masat që këto akt marrëveshje të kenë përmbajtjen dhe formën e dokumenteve zyrtare si dhe të plotësojë dokumentacionin e duhur që justifikon dhe mbështet hyrjen në marrëveshje me subjektet për likuidimin e detyrimit me këste.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 318 dosjeve të përzgjedhura të përfituesve të granteve të rikonstruksionit DS1/DS2/DS3 rezultoi se:

- Dosjet janë të inventarizuara por inventari nuk ka datë;
- Në dosje mungon kërkesa për ndihmë sipas përcaktimeve të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu II, pika 13/ç;
- 12 dosje DS1 nuk kanë nuk ka asnjë dokument që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu II, pika 13/ë;
- Asnjë nga 318 dosjet e audituara DS1/DS2/DS3 nuk ka projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit dhe preventivin e punimeve që kërkohen të financohen nëpërmjet grantit për individët ose familjet që përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu IV. Grantet për Rikonstruksionin, pika 2/b.

Nga auditimi i 100 dosjeve të përzgjedhura të përfituesve të bonusit të qirasë rezultoi se:

- Në 26 dosje nga 100 nuk ka asnjë dokument që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 5, datë 06.01.2020, e ndryshuar Kreu II, pika 13/ë;
- Në 2 dosje nuk ka specifikim për nivelin e dëmit DS...;

- Vetëm 6 dosje kanë akt ekspertize të thelluar;
- 11 dosje janë pa inventar;
- Inventari i dosjeve nuk ka datë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Krujë të ngrejë një grup pune për të verifikuar dokumentacionin në dosjet e përfituesve të granteve të rikonstruksionit DS1/DS2/DS3 dhe përfituesve të bonusit të qirasë si dhe të bëhet plotësimi i këtyre dosjeve kur është e mundur.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4342 ñ*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*ò në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 73,799,447 lekë, e cila nuk rakordon për vlerën 4,097,464 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit në vlerën 77,896,911 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llog. 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò për vlerën 2,839,600 lekë, llog. 42 ñ*Detyrime ndaj personelit*ò për vlerën 21,714,400 lekë, llog. 431 ñ*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*ò për vlerën 1,351,493 lekë, llog. 435 ñ*Sigurime shoqërore*ò për vlerën 6,446,778 lekë, llog. 436 ñ*Sigurime shëndetësore*ò për vlerën 888,460 lekë, llog. 466 ñ*Mjete në ruajtje'* në vlerën 44,656,180 lekë. Gjithashtu kjo llogari nuk rakordon dhe me llog. 7206 ñ*Financim të pritshëm nga buxheti*ò në Formatin e Performancës së PF, gjendja e së cilës në fund të vitit 2021 është në vlerën 763,937,770 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò Kreu II, pika 15/b,59 /a, Kreu III, pika 32**,** Aneksi 1, pika 3.3, nënpika 8. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël e gjendjes së llogarisë 4342 ñ*Operacione me shtetin (të drejta)*ò në fund vitit 2021 të paraqitur gabim, duke përfshirë në mënyrë të saktë vlerat e detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit dhe në rakordim me gjendjen në llog. 7206 ñ*Financim i pritshëm nga buxheti*ò. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuara.

Brenda datës 31.12.2022

14. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202*"Studime dhe Kërkime"* në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto prej 34,000,204 lekë dhe me kosto historike në vlerën prej 134,000,204 lekë, e cila përfaqëson vlerën e 68 projekt-studimeve për investime. Nga këto, vlera prej 44,192,686 lekë e 60 projekt-studimeve e mbartur që nga viti 2018 e më përpara, nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël, por mungon inventari fizik dhe nuk është bërë verifikimi i dokumentacionit për këto aktive jo materiale sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Gjithashtu nuk është llogaritur amortizim në masën 15% të vlerës së mbetur. Në fakt këto shpenzime për projektimin e një investimi të kryer për krijimin apo rikonstruksionet e aktiveve afatgjata materiale ose AQT nuk duhet të kontabilizohen në llogarinë 202 ñ*Studime dhe kërkime*ò, pasi këto janë pjesë e kostos së AQT dhe nuk janë shpenzimet për kërkime të aplikuara dhe të zhvillimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë*

*e qeverisjes së përgjithshme*ò Aneksi pika 2. klasa 2, Kreu III, pika 36. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për llogaritjen e amortizimit e aktiveve jo materiale dhe kryerjen e veprimeve kontabël të sistemimit për shpërndarjen e vlerës të studim-projektimeve, sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 ñ*Studime dhe Kërkime*ò dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Brenda datës 31.12.2022

15. Gjetje nga auditimi: Gjendja e Llogarisë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë neto 1,423,340,263 lekë, dhe me kosto historike në vlerën 1,823,791,496 lekë. Në gjendjen e llogarisë *212"Ndërtesa Konstruksione",* sipas inventarit kontabël përfshihen dhe aktivet ñ*Ndërtesa e konstruksione*ò të NJA Thumanë, me vlerë 104,595,727 lekë dhe aktivi me emërtim ñ*Ndërtime para vitit 2001*ò me vlerë 27,146,269 lekë, që i përket NJA Fushë Krujë, të cilat nuk janë të analizuara si në kontabilitet ashtu dhe në inventar fizik, situatë e trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Krujë të këtyre vlerave të aktiveve të pa analizuara në mbyllje të bilancit të vitit 2015 të këtyre njësive të qeverisjes vendore, problematikë së cilës nuk i është dhënë zgjidhje. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr. 8,datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kreu III dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò i ndryshuar, Kreu III. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese, Bashkia Krujë të marrë masa për ngritjen e një komisioni me specialistë të fushës dhe të kryejë inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të llog. *212"Ndërtesa Konstruksione".* Për aktivetñNdërtesa e konstruksione NJA Thumanëò në vlerën 104,595,727 lekë dhe për aktivet ñNdërtime para vitit 2001 NjA Fushë Krujëò në vlerën 27,146,269 lekë nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-komuna Thumanë dhe ish-Bashkia Fushë Krujë për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite dhe për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në bilanc e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Brenda datës 31.12.2022

16. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë *214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerë neto 17,468,925 lekë dhe me vlerë historike (vlerë bruto) 68,329,707 lekë. *Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 214 "Instalime* teknike, makineri, pajisje, vegla puneò, konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 63 artikuj aktive materiale në vlerën 47,358,283 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 ñ*Inventar ekonomik*ò, dhe në 1 rast llog. 215 ñ*Mjete transporti*ò etj. këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò Aneksi 1 pika 2, klasa 2, dhe Nomenklatura e llogarive te planit kontabël publik. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë *214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke debituar për vlerat përkatëse të aktiveve *llog. 218 "Inventar ekonomik"*

dhe *llog. 215 "Mjete transporti"* etj. në kredi të llog. *214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune".*

Brenda datës 31.12.2022

17. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë *215"Mjete Transporti"* paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën neto 22,672,572 lekë dhe me vlerë bruto (kosto historike) 93,445,460 lekë. 93,445,460 lekë. Për këto aktive është kryer inventari fizik, i cili nuk rakordon me inventarin kontabël për vlerën prej 7,986,465 lekë të 4 automjeteve, të cilët nuk ekzistojnë fizikisht, pasi 2 automjete janë shitur sipas kontratave datë 06.08.2015 dhe 09.06.2017 dhe nuk ka kaluar pronësia tek blerësi (Bashkisë) dhe 2 automjete kanë humbur, (1 me procedim në prokurori të pushuar me datë 18.04.2018 dhe 1 me urdhër-zhdëmtimi datë 08.08.2017 për personin përgjegjës), aktive të cilat vazhdojnë të jenë të evidentura në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8**,** datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò Aneksi 1 dhe Kreu II,pika 18. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese, Bashkia Krujë të marrin masa, që për 2 automjetet e shitura në vlerën 3,782,440 lekë të kryejë veprimet për kalimin e pronësisë, ndërsa për automjetet e humbura në bazë të dokumentacionit ligjor në dispozicion për to, të relatojë në këshillin bashkiak për miratimin e zbritjes së vlerave të tyre prej 4,204,025 lekë nga gjendja e llogarisë *215 "Mjete Transporti"* dhe kryerjen e veprimeve kontabël të nevojshme sipas rasteve, për të saktësuar gjendjen reale të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari.

Brenda datës 31.12.2022

18. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit ushtrimor 2021 gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) paraqitet në vlerën 4,291,986,973 lekë. Nga verifikimi i inventarëve kontabël rezultoi se janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos ñ*certifikuar*ò vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me ne kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñ*Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò kapitulli III, pika 30. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit**,** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Brenda datës 31.12.2022

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i PF rezultoi se, gjendja e llogarisë *26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur prej 500,000

lekë në bazë të 25% së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqërinë Aksionare ñKlubi Sportiv Kastriotiò dhe vlerën e kapitalit të derdhur prej 3,500,000 lekë në bazë të 25% së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqërinë Aksionare ñIliria (klubi i futbollit Fushe-Kruje)ò. Mos evidentimi në llogarinë e aktiveve afatgjata llog. 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*ò dhe në llogarinë kundërparti të saj në pasiv të bilancit llog. 1011, ñ*Shtesa të fondit bazë*ò ka sjellë mos pasqyrim të këtyre investimeve eventuale të kryera nga Bashkia Krujë në vlerën 4,000,000 lekë, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò Kreu III. ñ*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò pika 31. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë të marrë masa që në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 të kryejë veprimet kontabël përkatëse për pasqyrimin në PF të investimeve në vlerën 4,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në ShA ñKlubi Sportiv Kastriotiò për vlerën 500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 25% të aksioneve dhe ShA ñIliria (Klubi i Futbollit Fushë-Krujë)ò për vlerën 3,500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve.

Brenda datës 31.12.2022

20. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 89 raste faturash me vlerë 220,833,627 lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Krujë, *e ndarë 57* raste në vlerën 25,633,208 lekë janë kryer pagesa të vonuara në vitin 2020 dhe 32 raste në vlerën 195,200,419 lekë në vitin 2021, ku në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh (mos realizim të ardhurash). Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 44 ñ*Kontrolli i shpenzimeve*ò. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 72-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes dhe monitorimit të shërbimit të pastrimit nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 3032 datë 25.06.2020, referuar proces verbaleve ditore të mbajtur, nga 248 ditë (për periudhën nga data 01.07.2020 ï 30.06.2021, duke mos llogaritur ditët pushim dhe ditët e festave zyrtare për të dy vitet sipas periudhave) vetëm 160 ditë janë kryer kontrolle dhe monitorime lidhur me realizimin e zërave të kontratës së pastrimit duke mos pasqyruar informacion mbi cilësinë e kryerjes së shërbimit të pastrimit për ditët e tjera. Këto veprime janë në kundërshtim mekontratën nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020, neni 22, pikat 1, 2, 3, 4, 5. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandim: Grupet e punës që kanë detyrën e mbikëqyrjes së zbatimit të kontratës të marrin masa për mbikëqyrjen ditore të shërbimit të pastrimit duke pasqyruar në akt kontrollet

e mbajtura çdo element të kontratës si dhe duke dhënë një vlerësim për përmbushjen e metodologjive të aplikuara si dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, për shërbimin e pastrimit për vitin 2020 dhe 2021, BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi lidhur me emrat dhe titujt e personelit mbikëqyrës të vendosur nga Kontraktuesi, një përmbledhje të të gjitha rasteve të dëmtimeve të pronës private dhe publike, dëmtime fizike, të cilat janë shkaktuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përcaktuar në kontratë. Këto veprime janë në kundërshtim mekontratën nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020 dhe nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, neni 13, pika 1 dhe pika 2.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandim: Në të ardhmen mbikëqyrësi i zbatimit të kontratës të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë për detyrimet që ka OE si dhe pasqyrimin me përpikëri të përmbushjes së përcaktimeve të kontratës në çdo element të saj, pa anashkaluar ato detyrime që duken të një rëndësie më të ulët.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kushteve të kontratës së pastrimit për vitin 2020 rezulton se:

- Kontraktuesi BOE ñDé ò ShPK dhe ñFé ò ShPK, nuk ka hartuar dhe paraqitur pranë Bashkisë Krujë raporte mujore dhe vjetore monitorimi në kundërshtim me kushtet e kontratave nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, neni 13, pika 1 dhe pika 2;
- Kontraktuesi për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2020-2021 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambiental i cili duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Veprime këto që janë në kundërshtim me kushtet e kontratave nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, nenin 18, pika 1 dhe pika 2;
- Në kushtet e mos realizimit të programe të edukimit publik dhe ambiental supervizorët e AK nuk kanë aplikuar gjoba ndaj kontraktuesit në kundërshtim me përcaktimet e kontratave, neni 28 ñ*Penalitet dhe gjobat*ò, germa f.
- Lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes dhe monitorimit të shërbimit të pastrimit nga grupi i punës rezultoi se, referuar proces verbaleve ditore të mbajtura për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës nga 632 ditë (për periudhën nga data 08.04.2020-31.12.2021) vetëm 73 ditë janë kryer kontrolle dhe monitorime lidhur me realizimin e zërave të kontratës së pastrimit. Sa më sipër rezulton se, grupi i punës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratës së pastrimit në Qytetin e Krujës nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratat nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot datë 16.04.2021, neni 22, pikat 1,2,3,4,5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1 Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE ñDé ò ShPK dhe ñFé ò ShPKpër moszbatimin e kushteve të kontratave të pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit rezulton se, nuk ka asnjë korrespondencë midis AK dhe Kontraktuesit lidhur me mos realizimin e shërbimit të pastrimit për rrugët ñÇlirimiò dhe ñ5 Majiò për periudhën që ato kanë qenë në rikonstruksion si dhe zëvendësimin e tyre me rrugë të tjera që janë sistemuar në vitin paraardhës dhe nuk janë pjesë e kontratës, sipas afatit

të punimeve. Sipas llogaritjeve, zërat e punimeve që nuk janë kryer sipas sipërfaqeve të rrugëve për periudhën që ato kanë qenë në rikonstruksion, *janë në vlerën 22,847 lekë*. Sqarojmë se proces verbali i mbajtur nga mbikëqyrësit e kontratës për këto rrugë, vlerësohet nga grupi i auditimit si dokument që nuk ofron siguri të arsyeshme, pasi nuk ka numër protokolli. Këto veprime janë në kundërshtim me Kontratën nr.4670 Prot., datë 07.07.2021, neni 11, pika 11.6 si dhe tabelës së rrugëve për tâu pastruar, e miratuar nga AK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1 Rekomandim: Në funksion të përdorimit të fondeve sa më me efiçencë, Bashkia Krujë të marrë masa që në të ardhmen të jetë e kujdesshme në shqyrtimin e listës së rrugëve që janë pjesë e kontratës që janë për tâu pastruar, duke përzgjedhur në rastet e nevojës së zëvendësimit rrugë që nuk janë pjesë e kësaj liste dhe që nuk marrin shërbim pastrimi.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, kontraktuesi ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò për periudhën e vlefshmërisë së kontratës 2020-2021 nuk ka zhvilluar asnjë program të edukimit publik të destinuar për të ndërgjegjësuar qytetarët lidhur me mbajtjen pastër të ambienteve publike. Gjithashtu, nuk ka kryer as programin e edukimit ambiental i cili, duhet të ishte një spot televiziv një herë në 6 muaj. Në kushtet e mos realizimit të programe të edukimit publik dhe ambiental supervizorët e AK nuk kanë aplikuar gjoba ndaj kontraktuesit në kundërshtim me përcaktimet e kontratës nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020 dhe nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021, nenin 18, pika 1 dhe pika 2 dhe neni 28 germa f. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1 Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa ndaj BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2007ò për mos përmbushjen e kushteve të kontratës së pastrimit duke aplikuar gjobat në raport me llojin e detyrimit të kontratës që nuk është përmbushur nga operatorët ekonomik.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 ñ*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*ò, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, **nga Titullari i njësisë publike,** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **957,860 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga vizitat në terren të grupit të auditimit në disa rrugë të qytetit të Fushë Krujës u konstatua se kontenierët ishin të amortizuar dhe të pa pajisur me rrota e të pa larë.Gjithashtu, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë proces verbal apo dokument tjetër justifikues në të cilin të identifikohet dëmtimi i rrotave të kontenierëve ose zëvendësimi i tyre për zërin pastrim, larje, dezinfektim e mirëmbajtje kontenierësh për ndërrimin përkatësisht të 206 rrota kontenierësh. Këto veprime janë në kundërshtim mekontratën nr. 3126 Prot., datë 25.06.2020 dhe nr. 4670 Prot., datë 07.07.2021 e shërbimit të pastrimit neni 20, pika 4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **289,224 lekë** për shërbimin e pakryer të ndërrimit të rrotave të kontenierëve, nga BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò.

Korrik 2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit rezulton se, në zërat që përbëjnë vlerën e kontratës është përfshire dhe kuota e amortizimit të kontenierëve në masën 10 % ose në vlerën164,800 lekë në vit, ndërkohë që kontenierët janë në pronësi dhe pjesë e aseteve në inventarin e bashkisë dhe si çdo aktiv tjetër amortizimi i tyre është pakësim në zërin kapital. Ashtu si edhe vetë bashkia e ka shprehur në nenin 28, germa d, zëri kontenierë është kontabilizuar në pasqyrat financiare të bashkisë dhe çdo shtesë apo pakësim i ka efektet në kapitalin e bashkisë dhe jo të OE. Po kështu pavarësisht që përfaqësuesit e bashkisë e cilësojnë këtë vlerë amortizimi si fond për mirëmbajtje, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë formë dokumentimi apo evidence që të jenë identifikuar dëmtime dhe më tej riparime ose mirëmbajtje të kontenierëve. Për këtë zë është përshirë në vlerën e kontratës edhe 9 % të fitimit dhe 8 % e shpenzimeve, në total për 385,632 lekë për vitin 2020 dhe 2021. Këto veprime janë në kundërshtim meUdhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Menaxhimi i aktiveve të Njësisë së Sektorit Publik*ò, pika III/30 dhe kontrata e shërbimit të pastrimit, neni 28, germa d. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për kthimin e vlerës **385,632** lekë për amortizimin e kontenierëve nga BOE ñRé 96ò dhe ñLé 2é 7ò, si dhe mos përfshirjen e këtij zëri në vlerën e kontratave të ardhshme.

Korrik 2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në Qytetin e Krujës është sistemuar dhe asfaltuar rruga ñLekë Zahariaò që bën pjesë në listën e rrugëve dhe shesheve të Njësisë Vendore Krujë për tâu pastruar. Punimet janë kryer në afatet 26.05.2021 - 03.08.2021. Grupi i punës për mbikëqyrjen e kontratës, nuk ka asnjë korrespondencë apo dokumentacion të besueshëm midis AK Bashkia Krujë dhe Kontraktuesit lidhur me mos realizimin e shërbimit të pastrimit në këtë rrugë për periudhën që ajo ka qenë në rikonstruksion, si dhe zëvendësimin e saj me rrugë të tjera që janë sistemuar në vitin paraardhës dhe nuk janë pjesë e kontratës, sipas afatit të punimeve. Sipas llogaritjeve, zërat e punimeve që nuk janë kryer në këtë rrugë për periudhën që ajo ka qenë në rikonstruksion janë në vlerën 42,332 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kontratave nr. 1832 Prot, datë 08.04.2020 dhe nr. 2500 Prot. datë 16.04.2021, neni 11, pika 11.6 si dhe tabelës së rrugëve për tâu pastruar, e miratuar nga AK. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Krujë të merren masa për arkëtimin e vlerës **42,332 lekë** nga BOE ñDé ò ShPK dhe ñFé ò paguar për periudhën që rruga ñLekë Zahariaò ka qenë duke u sistemuar dhe nuk janë kryer shërbimet e pastrimit dhe larjes.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: ñ*Shërbim mirëmbajtje për liqenet dhe rezervuarët nën administrimin e Bashkisë Krujë, (Rehabilitimi i Përroit të Kreshnicës, rehabilitim i Përroit të Bardharit dhe rehabilitim i pritës lumore Murqinë)*ò viti 2021, me fond limit 3,437,134 lekë pa TVSh, me fitues OE ñEé ò ShPK me vlerë oferte3,412,420 lekë pa TVSh ka rezultuar se, për *Rehabilitim e pritës lumore Murqinë* preventivi i ofertës së plotësuar nga OE nuk i është i njëjtë me preventivin e hedhur nga AK në SPE. Në preventivin e plotësuar nga OE mungon një zë i punimeve, përkatësisht zëri nr. 5 ñ*Rrafshim skarpate në gërmim, ekskavator 0.25m*^{3}ò, me vlerë **240,672 lekë** pa TVSH.

Gjithashtu, referuar aktit të marrjes në dorëzim të punimeve rezulton se ky zë nuk është realizuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 95-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **240,672 lekë** nga OE ñEé ò ShPK për zërin e punime të preventivit të nr. 5 ñ*Rrafshim skarpate në gërmim, ekskavator 0.25m*^{3}ò për sasinë 10,464 m^3 në objektin ñ*Rehabilitim e pritës lumore Murqinë".*

Menjëherë

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi se, për periudhën 2020-2021 janë debitorë 25 qytetarë me vlerë totale 699,615 lekë, ndërsa vlera e detyrimit nga legalizimet e kryera për herët deri më datë 31.12.2020 është 62,939,445 lekë. Në total të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet janë në vlerën **63,639,060 lekë.**Gjithashtu, gjatë vitit 2020 ASHK nuk ka dërguar informacion pranë Bashkisë Krujë lidhur me legalizimet e kryera dhe bashkia nga ana e saj nuk ka dërguar asnjë kërkesë për informacion drejtuar ASHK-së.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñPër sistemin e taksavevendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; ligjin nr. 95/2018 ñ për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñPër sistemin e taksavevendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c; ligjin nr. 98/2020 ñ për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñPër sistemin e taksavevendoreò, i ndryshuar, neni 1, ñnë nenin 27, pika 3, shkronja ñcò; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ñ Për përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimittë të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizimò pika 5; VKB-në 93, datë 12.12.2019 ñMbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020ò; VKB-në nr. 104, datë 28.12.2020 ñMbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për ñTaksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimetò dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me **vlerë 63,639,060lekë**. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Krujë të bashkëpunojnë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Krujë u konstatua se, për vitin 2020, janë marrë 28 masa administrative ñGjobëò nga të cilat nuk janë paguar 22 gjoba me vlerë 9,200,000 lekë. Për vitin 2021 janë marrë 25 masa administrative ñGjobëò me vlerë totale 16,202,600 lekë nga të cilat nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë gjobë. Në përfundim për periudhën 2020-2021të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale **25,402,600 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike dhe IMTV në Bashkinë Krujë të ndjekin të gjitha hapat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **25,402,600 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Rezulton se, në Bashkinë Krujë në fund të vitit 2021 të jenë 2251 subjekte debitorë me vlerë totale të detyrimit 530,511,820 lekë. Gjithashtu, bashkia nuk ka të dhëna lidhur me numrin total të familjeve që kanë detyrim të paguajnë taksat dhe tarifat vendore dhe si rrjedhojë, nuk është e mundur të identifikohet saktë as numri i familjeve debitore. Në total vlera progresive e detyrimit për familjet debitore e regjistruar është 84,024,149 lekë. Në përfundim, borxhi tatimor i Bashkisë Krujë më datë 31.12.2021 është në vlerën **614,535,969lekë**. Nga ana e Bashkisë Krujë nuk janë marrë të gjitha masat për të bërë të mundur përmirësimin e gjendjes së debitorëve progresiv, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **614,535,969 lekë** nga taksapaguesit privat dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatës për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitorë. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgojë listën e subjekteve debitorë të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë së Financës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Krujë për periudhën nën auditim ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit me pakicë të lëndëve djegëse 31 subjekte që rezultojnë të pa pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit duke sjellë një efekt financiar me vlerë totale **7,166,460 lekë** të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatuan disa mungesa, përkatësisht:

- Mungonin pjesërisht autorizimet nga Bashkia Krujë për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesës së detyrimit ligjor për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesave të detyrimeve tatimore vjetore.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjinnr. 8450, datë 24.2.1999, ñpër përpunimin,transportimin dhe tregtimin e naftës,gazit dhe nënprodukteve të tyreò, tëndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2, pika 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **7,166,460 lekë** ndaj Bashkisë Krujë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave nga asetet e dhëna me qira rezulton se, qiramarrësi M. S. nuk ka paguar detyrimet e kontratës për vlerën **68,400 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, Ligjin nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata

të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve të marrë masat që subjekti ñM. S.ò të paguajnë detyrimin për vlerën **68,400 lekë** dhe të ndiqen me përpikmërikushtet e kontratave të qirasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi se, për periudhën 2020-2021 janë debitorë 25 qytetarë me vlerë totale 699,615 lekë, ndërsa vlera e detyrimit nga legalizimet e kryera deri më datë 31.12.2020 është 62,939,445 lekë. Në total të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet janë në vlerën **63,639,060 lekë.** Gjithashtu, gjatë vitit 2020 ASHK nuk ka dërguar informacion pranë Bashkisë Krujë lidhur me legalizimet e kryera dhe bashkia nga ana e saj nuk ka dërguar asnjë kërkesë për informacion drejtuar ASHK-së.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñ*Për sistemin e taksavevendore"*, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; ligjin nr. 95/2018 ñ për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñ*Për sistemin e taksavevendore*ò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c; ligjin nr. 98/2020 ñ për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,ñ*Për sistemin e taksavevendore*ò, i ndryshuar, neni 1, ñnë nenin 27, pika 3, shkronja ñcò; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ñ*Për përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimittë të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim*ò pika 5; VKB-në 93, datë 12.12.2019 ñ*Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020*ò; VKB-në nr. 104, datë 28.12.2020 ñ*Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021*ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për ñ*Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet*ò dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me **vlerë 63,639,060 lekë**. Gjithashtu, strukturat e Bashkisë Krujë të bashkëpunojnë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Krujë u konstatua se, për vitin 2020, janë marrë 28 masa administrative ñGjobëò nga të cilat nuk janë paguar 22 gjoba me vlerë 9,200,000 lekë. Për vitin 2021 janë marrë 25 masa administrative ñGjobëò me vlerë totale 16,202,600 lekë nga të cilat nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë gjobë. Në përfundim për periudhën 2020-2021të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale **25,402,600 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike dhe IMTV në Bashkinë Krujë të ndjekin të gjitha hapat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **25,402,600 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Rezulton se, në Bashkinë Krujë në fund të vitit 2021 të jenë 2251 subjekte debitorë me vlerë totale të detyrimit 530,511,820 lekë. Gjithashtu, bashkia nuk ka të dhëna lidhur me numrin total të familjeve që kanë detyrim të paguajnë taksat dhe tarifat vendore dhe si rrjedhojë, nuk është e mundur të identifikohet saktë as numri i familjeve debitore. Në total vlera progresive e detyrimit për familjet debitore e regjistruar është 84,024,149 lekë. Në përfundim, borxhi tatimor i Bashkisë Krujë më datë 31.12.2021 është në vlerën **614,535,969lekë**. Nga ana e Bashkisë Krujë nuk janë marrë të gjitha masat për të bërë të mundur përmirësimin e gjendjes së debitorëve progresiv, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **614,535,969 lekë** nga taksapaguesit privat dhe familjarë, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatës për bllokimin e llogarive bankare, masat e sigurimit të detyrimit tatimor, etj., për taksapaguesit debitorë. Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në fund të çdo viti të dërgojë listën e subjekteve debitorë të plotë dhe të saktë pranë Drejtorisë së Financës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Krujë për periudhën nën auditim ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit me pakicë të lëndëve djegëse 31 subjekte që rezultojnë të pa pajisur me autorizim/licencë për ushtrimin e aktivitetit duke sjellë një efekt financiar me vlerë totale **7,166,460 lekë** të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Krujë.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatuan disa mungesa, përkatësisht:

- Mungonin pjesërisht autorizimet nga Bashkia Krujë për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesës së detyrimit ligjor për pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit;
- Mungonin pjesërisht konfirmimet e pagesave të detyrimeve tatimore vjetore.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 ñ*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñ*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjinnr. 8450, datë 24.2.1999, "për përpunimin,transportimin dhe tregtimin e naftës,gazit dhe nënprodukteve të tyre*ò, tëndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2, pika 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizimin përkatës të pajisen menjëherë me autorizim për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën **7,166,460 lekë** ndaj Bashkisë Krujë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave nga asetet e dhëna me qira rezulton se, qiramarrësi M. S. nuk ka paguar detyrimet e kontratës për vlerën **68,400 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, Ligjin nr. 139/2015 ñ*Për Vetëqeverisjen Vendore*ò, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo*

*kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñ*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 30-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve të marrë masat që subjekti ñM. S.ò të paguajnë detyrimin për vlerën **68,400 lekë** dhe të ndiqen me përpikmërikushtet e kontratave të qirasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 15 germat b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, neni 59 ñKompetenca dhe procedura për masat disiplinoreò, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 ñKodi i punës në Republikën e Shqipërisëò, neni 37, ñMasa disiplinoreò, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Krujë** tã kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

V. ANEKSET

Aneksi nr. 1: Detyrimet e prapambetura të detajuara në fund të vitit 2021

Emertimi	SUBJEKTI	Nr/v/fat/kont.	Data	4864100	4864200	4864400	4864900	4670800	PER	PER
			vendimit	v.gjyqes	bler.sher	investi	tjera		LIKUJDIM 31.12.2020	LIKUJDIM 31.12.2021
V.Gjyq z. A. M.	A. M.	276	23,06,2010	11670000				11670000	5,670,000	4,670,000
V.Gjyq z. L. Q.	L. Q.	541	22,11,2013	3463085				3463085	963,085	500,000
V.Gjyq z. B. V.	B. V.	287	04,06,2012	1984300				1984300	984,300	-
V.Gjyqesor z. S. G.	S. G.	3531	02,07,2015	2647883				2647883	1,647,883	-
V.Gjyq z. R. Ll.	R. LL.	244	16,02,2012	358750				358750	100,000	-
Totali:				22881556				22881556	9,365,268	5,170,000
Kolaud :Sist asf rrug. shkoll 4	L. P.	kontrate.				8800		8800	8,800	8,800
Sist asf i rruges Kasme kruje	Jé , SH.P.K	kontrate.				11634760		11634760	11,634,760	11,634,760
Mbik. Ndert rrug lagja kasme.	V. G.	kontrate	23,07,2013			240000		240000	240,000	240,000
Mbik. objekti:Sistem perroi	S. Sh.	19933454	07,07,2015			80000		80000	80,000	80,000
Mbik.:Rrethrrotull e trotua tek	N. M.	23534352	21,08,2015			4200		4200	4,200	4,200
Mbik. objekti:Sistemim perroi	D. P.	112142	07,07,2015			400000		400000	400,000	400,000
Sakarrac-Kruje.	L. P.	kontrate	28,06,2013			45187		45187	45,187	45,187
banimit Derede,	L. P.	kontrate	20,09,2013			25889		25889	25,889	25,889
Kolaud:Rikons rruge ne lagje	L. P.	kontrate.	9,10,2013			159824		159824	159,824	159,824
Mbikq:Ndert rrug shullaz Kruje	S. T.	23686102	05,09,2015			2160		2160	2,160	2,160
KolaudNdert rrug shullaz Kruj	M. K.	22265706	17,09,2015			1440		1440	1,440	1,440
MbikqSist e ndric rrug e malit.	Dé E	18953322	01,09,2015			150000		150000	150,000	150,000
Mbikq Asf rruge para shkolle	Zé 06	3783077	15,05,2013			44000		44000	44,000	44,000
MbikqShtese e rikons shkolla	A. Th.	201255	08,09,2009			84365		84365	84,365	84,365
Kolaud:Shtese e rikon shkolla	B. S.	kontrate	16,09,2009			85258		85258	85,258	85,258
Sist asf ndric blloku.4,F. Kruje	Fé , SH.P.K	41601945	30,10,2012			29,493,056		29493056	15,493,056	8,493,056
"	diference fature	41601945	30,11,2011			1,315,532		1315532	1,315,532	1,315,532
Kolaud.Sist asfaltim blloku		776818	03,12,2012			73410		73410	73,410	73,410
Sist asfal shesh F.-Kruj F.II-re	Té Eé	72293294	30,11,2010			7260127		7260127	232,581	-
"	"	72293314	31,12,2010			1444225		1444225	1,444,225	548
Kolaud asfaltim rruga e lacit	A. A.	kontrate.	13,04,2010			27555		27555	27,555	27,555
Sist asfalt rruga Kishe-Gabine	Sé 2F	KONTRATE	15,03,2011			3499179		3499179	13,219	13,219
Ndric pjesor F Kruje faza I-re	Sé 2F	87160367	01,05,2011			249647		249647	249,647	-
Mbikq Ndric pjes F Kruje faza I	N. P.	kontrate	09,02,2011			105743		105743	105,743	105,743
Kolaud Ndric pjes F Kruje faz I	M. D.	kontrate	02,05,2011			15000		15000	15,000	15,000
Mbikqi:Sistem asfalt rruga	A. A.	kontrate.	03,05,2011			92010		92010	92,010	92,010
Rik fush sport "Redi Maloku"	Bé	diference	19,04,2011			149998		149998	149,998	149,998
Mbikq.Rikons i fushe sportit	H. M.	71635220	08,07,2011			56326		56326	56,326	56,326
Kolaud:Rikons i fushe sportit	P. G.	85441112	06,07,2011			25642		25642	25,642	25,642
Mbikq:Siste asfal ,trotu ,ndric e	N. B.	85324927	03,12,2012			143473		143473	143,473	143,473
Kolaud Ndert mur mbajt Halil.	M. T.	kontrate	18,10,2012			6371		6371	6,371	6,371
Rivesh asfaltobe rruge durresit.	Gé Eé Cé	diference	13,05,2011			144367		144367	144,367	144,367
Sistemim asfaltim i rruges Lacit	Gé Eé Cé	diference	13,05,2011			738217		738217	738,217	738,217
Mbikq:Sist asfaltim rrug Sabri	Ié	kontrate	09,09,2014			3480		3480	3,480	3,480
MbikqNdert KUB ,Larushk.	N. M.	kontrate	29,10,2014			4560		4560	4,560	4,560
KolaudSist asfalt i rruges	M. K.	12622946	01,07,2015			4123		4123	4,123	4,123
Sist asf rrug Zhabjak bllok8 F.K	Vé Eé	18392201	02,02,2015			241311		241311	241,311	241,311
Kolaud objekSist asfal rruga	R. Ll.	kontrate	11,03,2015			6873		6873	6,873	6,873
Mbikq Rehab fasad F.Kruje	Dé Pé		09,06,2015			79200		79200	79,200	79,200
KoalaudSist asfalt i rruges	Té	Kontrate	26,06,2015			26400		26400	26,400	26,400
Shprones unaza vpgel f.kruje	M. D.	VKM,571	3,09,2015			123000		123000	123,000	123,000

Shprones unaza vpgel f.kruje	S. D.	VKM,571	3,09,2015			38590		38590	38,590	38,590
Kolaud:ndert shkolles mesme,"	Dé Pé	kontrate	22,06,2015			10800		10800	10,800	10,800
Mbikq :Shtrim me cakell	B. M.	7264869	20,10,2014			5520		5520	5,520	5,520
Kolaud Ndert depo uji Thuman	B. M.	7264890	13,05,2015			20000		20000	20,000	20,000
Kolaud Shtri cakell Markagjon	Gé SH.P.K	5446919	20,10,2014			10000		10000	10,000	10,000
Blerje paisje kompjuterike	SHé AL	15647794	02,10,2014			59880		59880	59,880	59,880
Rikonstruksion rruga gramez.	SHé AL	kontrate				79914		79914	79,914	79,914
Rikons rruge rurale k. Nikel.	L. K.	kontrate	21,05,2015			5400		5400	5,400	5,400
MbikqRivesh asf rrug K Nikel.	V. T.	18556180	15,06,2015			8520		8520	8,520	8,520
Mbikq Sist gjelb shkol Ramazan	Né Sé	23346206	08,07,2015			26400		26400	26,400	26,400
Mbikq Asf rrug perroi brateve	D. P.	kontrate	09,09,2013			4920		4920	4,920	4,920
Kolaud Rikons rrug rura Nikel	Sh. Gj.	kontrate.	03,07,2013			1920		1920	1,920	1,920
Mbikq Asfa rrug shkolla Tapize	L. K.	kontrate	16,10,2013			12600		12600	12,600	12,600
Mbikq Asf rrug kthes ura tapize	N. M.	kontrate	22,10,2014			3348		3348	3,348	3,348
Kolaud:Rivesh asf rrug k Nikel	N. M.	kontrate	05,06,2015			3360		3360	3,360	3,360
Mbikqy:Asfa rru perroi Brateve	Mé Sé	kontrate	17,06,2013			52000		52000	52,000	52,000
Mbikq:Asfal rruge rural Nikel	Ié	kontrate	21,06,2013			24000		24000	24,000	24,000
Asfalt i rruge shkolla tapize	Ké SH.P.K	kontrate	18,10,2013			367076		367076	367,076	367,076
Asfal rrug perro brate-Shkgrep	Ké Sh.P.k.	kontrate	11,06,2013			1525210		1525210	1,525,210	1,525,210
MbikqAsfal rrug perro brateve.	Sh. A.	Kontrate	13,04,2011			109721		109721	109,721	109,721
Totali:						68011302		68011302	36,150,381	27,224,476
Darke iftari	R. D.	2	03,08,2013		144,000			144,000	144,000	144,000
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	42384082	04.12.2009		7,794			7,794	7,794	7,794
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	42947886	05.09.2009		5,400			5,400	5,400	5,400
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	42947854	06.08.2009		10,974			10,974	10,974	10,974
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	42384053	06.11.2009		7,380			7,380	7,380	7,380
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	67049261	07.01.2010		26,148			26,148	26,148	26,148
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	42947921	07.07.2009		3,018			3,018	3,018	3,018
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	42384018	07.10.2009		8,178			8,178	8,178	8,178
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	4787883	08.02.2006		16,166			16,166	16,166	16,166
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20058602	08.04.2006		34,184			34,184	34,184	34,184
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20196852	08.07.2006		8,508			8,508	8,508	8,508
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20196889	08.08.2006		9,680			9,680	9,680	9,680
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	33391738	08.11.2007		6,108			6,108	6,108	6,108
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20770302	08.12.2006		18,518			18,518	18,518	18,518
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	4792459	09.03.2006		18,374			18,374	18,374	18,374
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20058563	09.06.2006		17,470			17,470	17,470	17,470
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20058631	10.05.2006		14,090			14,090	14,090	14,090
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20770291	10.10.2006		12,630			12,630	12,630	12,630
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20770421	10.11.2006		16,664			16,664	16,664	16,664
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	20770261	11.09.2006		11,126			11,126	11,126	11,126
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	33391707	11.10.2007		5,952			5,952	5,952	5,952
Shpenzime postare	POSTA KRUJE	34461476	11.12.2007		5436			5436	5,436	5,436
Blerje materiale ndertimi	Pé SH.P.K.	28971221	10,07,2015		50100			50100	50,100	50,100
"	"	28971222	10,07,2015		27000			27000	27,000	27,000
"	"	18971223	10,07,2015		21600			21600	21,600	21,600
Blerje toneri	I. B.	8158313	07,08,2015		4000			4000	4,000	4,000
Saldatrice	E. K.	4798	28,01,2013		26500			26500	26,500	26,500
Blerje pjese kembimi	A. V.	7965	19,12,2013		39050			39050	39,050	39,050
Mallra sherbime	Sh. A.	15941	06,11,2013		4000			4000	4,000	4,000
Buke	L. V.	6393704	01,11,2010		39200			39200	39,200	39,200
"	'	6393705	30,12,2010		20230			20230	20,230	20,230
"	"	6393706	31,03,2011		19320			19320	19,320	19,320
"	"	6393703	31,12,2009		21980			21980	21,980	21,980
Blerje rere e granil	Pé , SH.P.K	167162	04,05,2012		31440			31440	31,440	31,440
"	"	5584709	24,10,2012		56000			56000	56,000	56,000
Blerje toner e kancelari	Sh. A.	1014	31,10,2012		99050			99050	99,050	99,050
Blerje materiale hidraulike	A. D.	3888	24,07,2015		9850			9850	9,850	9,850
Blerje kancelari	Sh. A.	1030	28,01,2013		9756			9756	9,756	9,756
*	"	1031	28,01,2013		13600			13600	13,600	13,600
*	"	1032	28,01,2013		13150			13150	13,150	13,150
*	"	1020	08,01,2013		14910			14910	14,910	14,910
*	"	1021	08,01,2013		45470			45470	45,470	45,470
*	"	1026	08,01,2013		41774			41774	41,774	41,774
Sherbim fotokopje	*	1035	10,02,2014		9800			9800	9,800	9,800
Blerje grile veneciane	K. N.	55	06,02,2013		9800			9800	9,800	9,800
Blerje vegla pune	A. D.	7447148	24,03,2015		9300			9300	9,300	9,300
Blerje pusete +kapake pusete	Ké SH.P.K	68025550	06,09,2010		4200			4200	4,200	4,200
Blerje kortolina	Sh. A.	1019	31,12,2012		21700			21700	21,700	21,700
Materiale te ndryshme	A. V.				29450			29450	29,450	29,450
Formatim kompjuteri	J. M.	7579964	21,10,2014		7000			7000	7,000	7,000
Formatim kompjuteri	J. M.	7579960	16,10,2014		10000			10000	10,000	10,000
Blerje nafte	A... Pé	6685320	23,01,2015		237000			237000	237,000	237,000
Totali:					1396028			1396028	1,354,028	1,354,028
Riparim kompjuteri	M. B.	5671	29,01,2014					7000	7,000	7,000
Miremb e kompjut +fotokopjve	Té Eé	kontra	20,04,2015					6800	6,800	6,800
Mikq mirembejtje lumit Zeze.	Zé 06	Kontrat	17,09,2013					5880	5,880	5,880
Totali:								19680	19,680	19,680
sigurime te prapambetura	Drejtoria e taksave						1,974,004	1974004	1,974,004	1,974,004
tap I prapambetur	Drejtoria e taksave						889,683	889683	889,683	889,683
Tatim burim keshilltare	Drejtoria e taksave						152,460	152460	152,460	152,460

Tatim burim keshilltare	Drejtoria e taksave						124860	124860	124,860	124,860
Totali:						**0**		**3,141,007**	**3141007**	**3,141,007**	**3141007**
Totali :										**-**	
TOTALI PERGJITHESHEM				**22,881,556**	**1,396,028**	**68,011,302**	**3,141,007**	**95,449,573**	**50,030,364**	**36,909,191**

Aneksi nr. 2: Projektet e investimeve me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre.

		Viti 2020 -2021								
Nr.	**Instituc ioni financues**	**Objekti**	**Fondi (leke me TVSH)/ Buxhet**	**Operatori ekonomik fitues**	**Vlera e Kontrates me TVSH**	**Data e lidhjes se Kontrates**	**Likujdimi me TVSH para vitit 2020**	**Likujdimi faktik me TVSH VITI 2020**	**Likujdimi faktik me TVSH VITI 2021**	**Mbetur pa likujduar vlera e kontrates 31.12.2021**
1	Bashkia	Sist-Asf rr.sherr-Ura Telit Nikel	9,206,495		6,625,596	08.04.2019	3,206,495	3,000,000	419,101	-
2	Bashkia	Sis-Asf rr. Varr Magaz-Kodre Loce	7,859,181		5,486,898	08.04.2019	859,181	3,500,000	1,127,717	-
3	Bashkia	Sist-Asf rr. Shememi Babaj Kruje	7,017,280		5,546,154	28.03.2019	3,017,300	2,000,000	528,854	-
4	Bashkia	Mbikq:Rehabilitim I Diges Tapize	3,199,388		2,835,938	18.07.2019		2,835,938		-
5	Bashkia	Kolaud :Rehabilitim I Diges Tapize	8,823		13,920	30.09.2019		13,920		-
6	Bashkia	Sist -Asf rrug Sinurit F kruje	12,356,716		8,883,048	18.04.2019	5,956,956	2,926,092		-
7	Bashkia	Mbikq Sist-Asf rr. Sinurit F.kruje	250,937		216,476	18.04.2019		216,476		-
8	Bashkia	Kolaud : Sist-Asf rr. Sinurit F.kruje	30,782		9,480	17.05.2019		9480		-
9	Bashkia	Sist-Asf rr.Nj shk.Sh.Galica F. Kruje	3,566,124		2,948,986	20.06.2019		2,948,986		-
10	Bashkia	Mbikq: Sist-Asf rr. shk.Sh.Galic F. Kr	93,432		79,792	20.05.2019		79,792		-
11	Bashkia	Kolaud Sist-Asf rr. shk.Sh.Galic F. Kr	14,365		4,900	17.05.2019		4,900		-
12	Bashkia	Nd Kuz , L B. VISHA e Sist rr. pepe	2,152,310		1,960,034	09.08.2017	22,224	1,937,810		-
13	Bashkia	Proje Mbrojt Lumobrigjet Lum Zez	10,982,454		10,740,000	26.09.2018	3,000,000	3,000,000	2,000,000	2,740,000
14	Bashkia	Sist-Asf rr. Mazhe Vogel, Nj A Bubq	6,612,840		4,988,820	09.04.2019	1,613,008	2,500,000	875,812	-
15	Bashkia	KolaSis-Asf rr. Mazh Vog, NjA Bubq	19,163		9,600	17.05.2019		9,600.00		-
16	Bashkia	Sist-Asf rr. Mazhe Madhe Nj A Bubq	5,325,281		4,010,111	09.04.2019	525,415	2,400,000	1,084,696	-
17	Bashkia	Kol Sis-As rr. Mazh madh, NjA Bubq	17,772		7,318	09.05.2019		7,318		-
18	Bashkia	Sist-Asf I rruges Abaz Ulliri , Nikel	13,903,980		8,890,350	21.05.2019	6,952,122	1,938,228		-
19	Bashkia	Mbikq Sist-Asf rr. Abaz Ulliri , Nikel	274,036		236,625	21.05.2019		236,625		-
20	Bashkia	Kolaud: Sist-Asf rr. Abaz Ullir, Nikel	29,045		9,600	17.05.2019		9,600		-
21	Bashkia	Rip me asfaltobet rruge te demtuar	5,265,881		3,671,798	29.05.2019	1,265,881	2,000,000	405,917	-
22	Bashkia	Mbikq Rip me asfalto rrug te demt	131,277		112,465	29.05.2019		112,465		-
23	Bashkia	Kolaud Rip me asfalto rrug te demt	17,731		6,516	17.05.2019		6,516		-
24	Bashkia	Kolaud rruges Marin Barleti , Kruje	12,120		3,208	17.05.2019		3,208		-
25	Bashkia	Kol.Nd. Trot ndric rrug qend Bushn	19,652		11,220	12.12.2018		11,220		-
26	Bashkia	Kontrat shtes : Zgjer rr. Kryes Ri Sheshi M.Merlika Kruje	21,760,534		21,760,534	20.08.2018	12,200,000	9,560,534		-
27	Bashkia	Sis-Asf rrug Stac tren Kish Murqine	12,854,604		10,001,383	30.04.2019	3,854,809	4,500,000	1,646,574	-
28	Bashkia	Mbikq Sis-Asf rr. St tren Kish Murqi	258,584		223,141	09.04.2019			223,141	-
29	Bashkia	Kontrat shtes :Zgjer rrug hyrese parkim e rikual I qendres kruje	72,883,422		72,883,422	21.05.2018	41,439,803	10,000,000	21,443,619	-
30	Bashkia	Sist-Asf rr. Kish Rol-Rr.LiDukagj I ri	9,245,958		7,870,610	28.06.2019	4,377,578	3,200,000	293,032	-
32	Bashkia	Sis-Asf rr.Varre Derven, NJA Thuma	19,356,501		14,344,348	18.04.2019	6,556,501	6,400,000	1,387,847	-
33	Bashkia	MbikqSis-As rr.Varr Derv, NJ Thum	350,873		303,814	18.04.2019		303,814		-
34	Bashkia	Sist -AsfalI rruges Hyrese Thumane	29,590,020		27,811,416	28.12.2018	16,318,695	11,492,721		-
35	Bashkia	Mbikq : Sist -Asf rr. Hyrese Thuman	482,258		418,754	28.12.2018		418,754		-
36	Bashkia	Sist-Asf rrug Abaze Clirimi 5 Maji	3,112,693		2,924,424	09.04.2019	2,228,593.00	695,831		-
37	Bashkia	MbikqSist-Asf rr. Abaze Cliri 5 Maji	81,552		69,647	09.04.2019		69,647		-
38	Bashkia	Kolaud Sist-Asf rr. Abaze Cliri 5 Maj	13,832		8,400	09.05.2019		8,400		-
39	Bashkia	Ndertim Kuz Kameras Fushe Kruje	3,779,389		2,740,651	10.04.2019	1,819,709.00	920,942		-
40	Bashkia	Mbikq Ndert Kuz Kameras F. Kruje	98,264		90,706	10.04.2019		90,706		-
41	Bashkia	KolaudNdert Kuz Kameras F. Kruje	15,534		5,194	17.05.2019		5,194		-
42	Bashkia	Sist-Asf rruges se Rryteve larushk	4,462,609		3,820,020	08.04.2019	928,474.00	2,000,000	891,546.00	-
43	Bashkia	Mbikq.Sist-Asf rr. se Rryteve larush	115,786		98,994	08.04.2019		98,994		-
44	Bashkia	Kolaud Sist-Asf rr. se Rrytev larush	16,818		9,480	17.05.2019		9,480		-
45	Bashkia	Sist-Asfal I rruges se lagjes Ziri	3,855,953		2,690,766	31.12.2018		2,690,766		-
46	Bashkia	Mbikq : Sist-Asfal rrug se lagjes Ziri	101,026		86,276	31.12.2018		86,276		-
47	Bashkia	Kolaud Sist-Asfal rrug se lagjes Ziri	15,702		9,600	27.02.2019		9,600		-
48	Bashkia	Sis-Asf rr. Myftar-Burgsiguri F Kruj	4,743,615		3,820,020	08.04.2019		2,743,615	1,076,405	-
49	Bashkia	MbikqSis-Asf rr.Myfta-Burg sig. F K	121,248		103,710	08.04.2019		103,710		-
50	Bashkia	Kol. Sis-Asf rr.Myfta-Burg sig. F Kru	17,221		7,080	17.05.2019		7,080		-
51	Bashkia	Nd. kuz Sisndric rrugKodhe, A Gjel	4,500,987		4,017,804	31.05.2017	3,586,284	431,520		-
52	Bashkia	MbikNd. kuz Sis,ndric.rr.Kodh,A Gj	42,050		36,000	31.05.2017		36,000		-
53	Bashkia	Rikualifikim I Dy qendrave urbane	1,893,208		1,552,591	11.01.2019	975,413.00	577,178		-
54	Bashkia	MbikqRikual I Dy qendrave urbane	49,602		42,360	11.01.2019		42,360		-
55	Bashkia	KolaudRikual I Dy qendra urbane	12,264		6,000	27.02.2019		6,000		-
56	Bashkia	Sist -Asfaltim I rruges se lateve	3,919,134		3,346,695	12.02.2018 : 08.04.2019	2,541,921.00	804,774		-
57	Bashkia	MbikqSist-Asfal I rruges se lateve	102,682		87,691	12.12.2018		87,691		-
58	Bashkia	Kolaud Sist -Asf degez 1 rr e B. F Kr	15,835		4,296	17.05.2019		4,296		-
59	Bashkia	Ndertim Kuz Kameras	1,868,819		1,569,804	31.12.2018		1,569,793		-
60	Bashkia	Mbikq :Ndertim Kuz Kameras	48,590		44,851	31.12.2018		44,851		-
61	Bashkia	Kolaudim Ndertim Kuz Kameras	12,239		6,000	27.02.2019		6,000		-
62	Bashkia	Blerje kontenjere metalike	4,000,000		3,996,000	06.09.2019	2,056,697.00	1,939,303		-
63	Bashkia	Ndert.linjes ujesjell Bubq	2,847,622		2,145,230	31.12.2018		2,145,230		-
64	Bashkia	Ble kompjutera per Bashkine Kruje	300,000		248,280	21.12.2020			248,280.00	-
65	Bashkia	Bl kontenje metalik per B. Kruje	500,000		358,320	12.11.2020		358,320		-
66	Bashkia	Bl pompe zhytese per Nj Ad Bubq	500,000		468,000	07.04.2020		468,000		-
67	Bashkia	Bl mjet e makineri pune Dr. Shërb	120,000		112,800	11.11.2020		112,800		-
68	Bashkia	Bl autovetuAparat e Administrates	2,000,000		1,998,000	25.11.2020		1,998,000		-
69	Bashkia	Blerje kamion veteshkarkues	1,500,000		1,494,000	25.11.2020		1,494,000		-
70	Bashkia	Bl autovinc per Ndricimin Rrugor	1,200,000		1,114,000	29.10.2020		1,114,000		-

71	Bashkia	Sist-Asf I rruges se Shkolles Qereke	3,317,657		2,055,180	22.07.2021			2,055,180	-
72	Bashkia	MbikqSist-Asf I rrug Shkoll Qereke	86,923		74,232	22.07.2021			74,232	-
73	Bashkia	KolaudSist-Asf I rrug Shkoll Qereke	14,403		8,908	09.09.2021			8,908	-
74	Bashkia	Sis-Asf rr. para Kishe-Rr. lidh Gram	7,823,104		5,155,292	29.04.2021			3,129,242	2,026,050
75	Bashkia	MbikqSis-Asf rr.Kish-Rr. lidh Gram	177,636		152,670	29.04.2021			152,670	-
76	Bashkia	KolaudSis-Asf rr.Kish-Rr. lidh Gram	21,092		10,710	26.05.2021			10,710	-
77	Bashkia	Sist-Asf rrug Aer Rinas , Nj Ad Nikel	3,958,869		3,118,536	28.09.2021			2,374,404	744,132
78	Bashkia	MbikqSist-Asf rr. Aer Rina Nj Nikel	102,772		88,579	28.09.2021				88,579
79	Bashkia	KolaudSist-Asf rr. Aer Rina Nj Nikel	15,917		14,509	10.12.2021				14,509
80	Bashkia	Sis-Asf rr. Gramz-Sukth Vend.Faz II	19,686,781		10,799,514	28.09.2021			7,029,780	3,769,734
81	Bashkia	MbikSis-As rr. Gram-Sukt Vend.F II	355,291		307,687	28.09.2021				307,687
82	Bashkia	Kol.Sis-As rr. Gram-Sukt Vend.F II	34,483		33,068	25.11.2021				33,068
83	Bashkia	Sist-Asf rrug se Lagjes Ziri , Magaze	8,343,538		4,730,113	01.07.2021			3,337,415	1,392,698
84	Bashkia	MbikqSist-Asf rr. Lagj Ziri , Magaze	186,562		160,438	01.07.2021			160,438	-
85	Bashkia	Kolaud.Sis-Asf rr. Lagj Ziri , Magaze	21,772		15,840	03.08.2021			15,840	-
86	Bashkia	Sist-Asf rr. Lidh S. Cela Arramer F K	8,602,587		5,240,603	30.04.2021			3,441,035	1,799,568
87	Bashkia	MbikqSis-As rr. S. Cela Arramer F K	190,776		164,443	29.04.2021			164,443	-
88	Bashkia	Kol.Sis-As rr. S. Cela Arramer F K	22,076		13,290	28.05.2021			13,290	-
89	Bashkia	Sist.-Asf rruge Kruje Picrrage II	13,344,836		10,409,952	24.05.2021			2,913,600	7,496,352
90	Bashkia	MbikqSist.-Asf rr. Kruje Picrrage II	265,803		278,239	24.05.2021				278,239
91	Bashkia	KolaudSist.-Asf rr. Kruje Picrrage II	28,312		22,080	26.05.2021				22,080
92	Bashkia	Sist.-Asf rruge Kruje Picrrage III	12,784,882		7,532,304	25.11.2021			1,218,204	6,314,100
93	Bashkia	MbikqSist.-Asf rr. Kruje Picrrage III	235,000		222,246	25.11.2021				222,246
94	Bashkia	KolaudSist.-Asf rr. Kruj Picrrage III	12,500		11,476	29.12.2021				11,476
95	Bashkia	Sist –Asf Rr. Thanz. Rip rr. Grumbul	12,383,825		7,380,768	24.11.2021			3,693,432	3,687,336
96	Bashkia	MbikSis–Asf Rr. Than. Rip rr. Grum	253,000		216,854	24.11.2021				216,854
97	Bashkia	Kol.Sis–Asf Rr. Than. Rip rr. Grum	13,500		11,237	29.12.2021				11,237
98	Bashkia	Sist-Asf I rruges se Trojes Bushnesh	10,426,059		6,188,316	28.09.2021			6,188,148	168
99	Bashkia	Mbikq.Sist-Asf rrug Troje Bushnesh "	225,997		189,544	28.09.2021			157,953	31,591
100	Bashkia	Kolaud.Sis-Asf rr. Troje Bushnesh	24,578		22,745	10.12.2021			22,74	-
101	Bashkia	Sist-Asf I Rruges se Ukeve , Tapize	13,090,680		7,964,772	29.04.2021			6,545,340	1,419,432
102	Bashkia	Mbikq.Sist-Asf Rrug Ukeve , Tapiz	262,060		226,176	29.04.2021			226,176.00	-
103	Bashkia	Kolaud Sist-Asf Rrug Ukeve , Tapiz	27,967		17,638	26.05.2021			17,638	-
104	Bashkia	Sist-Asf rr Engjeli Bilaj , Nj Ad BUBQ	9,180,806		5,467,530	29.04.2021			3,672,322	1,795,208
105	Bashkia	Mbik.Sist-Asf rr. Engjeli Bilaj BUBQ	200,043		172,172	29.04.2021			172,172	-
106	Bashkia	KolSist-Asf rr. Engjeli Bilaj BUBQ	22,786		12,533	26.05.2021			12,533	-
107	Bashkia	Ble kompjutera per Bashkine Kruje	3,000,000		2,460,000	21.07.2021			2,460,000	-
108	Bashkia	Bl mobilje per instituc Arsimore	800,000		664,440	28.10.2021			664,440	-
109	Bashkia	Bl kontenje metalik per B. Kruje	960,000		907,200	23.04.2021			907,200	-
110	Bashkia	Sist-Asf rr.Abaze –Rr.D.Kastrioti	5,607,806		3,502,247	29.04.2021				3,502,247
111	Bashkia	Mbikq.Sist-Asf rr.Abaze-D.Kastrio	137,740		118,106	29.04.2021				118,106
112	Bashkia	Kol.Sist-Asf rr.Abaze-D.Kastriot	17,923		9,432	26.05.2021				9,432
113	Bashkia	Sist-Asf rr Topalle Tapiz , Nj Nikel	10,253,006		5,697,060	23.08.2021				5,697,060
114	Bashkia	Mbik.Sis-Asf rr.Topall Tapiz, Nikel	217,224		187,129	23.08.2021				187,129
115	Bashkia	KolSis-Asf rr.Topall Tapiz, Nikel	24,348		22,464	18.10.2021				22,464
116	Bashkia	Sis -Asf rr. Xhami, ndert. kuz , pjese fundore rr.Selman Arramer F.Kruj	851,467		744,000	23.08.2021				744,000
117	Bashkia	MbikqSis -Asf rr. Xhami, ndert. kuz , pjese fundore rr.Selman Arramer	22,308		19,051	23.08.2021				19,051
118	Bashkia	Kol.Sis -Asf rr. Xhami, ndert. kuz , pjese fundore rr.Selman Arramer	7,237		6,717	16.12.2021				6,717
119	Bashkia	Rreth e Sis, Varre Kraste Kruje	3,084,077		2,187,938	10.12.2021				2,187,938
120	Bashkia	Mbikq.Rreth e Sis,Varre Krast Kruj	85,866		55,360	10.12.2021				55,360
121	Bashkia	Sist-Asf rr. Allushev,Arramer F. Kru	2,562,845		1,807,080	28.09.2021				1,807,080
122	Bashkia	MbikqSist-Asf rr. Allushev,Arramer	67,146		57,343	28.09.2021				57,343
123	Bashkia	Kol.Sist-Asf rr. Allushev,Arramer	12,465		12,000	25.11.2021				12,000
124	Bashkia	Sis-Asf rr Clirim 5 Maj L.SMTF. Kruj	6,039,605		3,553,567	07.12.2021				3,553,567
125	Bashkia	Mbik.Sis-Asf rr Clirim 5 Maj L. SMT	145,005		125,096	07.12.2021				125,096
126	Bashkia	Sist-Asf rr Kish Katolik Thumane ,	4,204,548		2,627,328	24.11.2021				2,627,328
127	Bashkia	Mbik.Sist-Asf rr.Kish Katoli Thuman	110,159		94,076	24.11.2021				94,076
128	Bashkia	Kol.Sist-Asf rr.Kish Katoli Thuman	16,388		6,829	29.12.2021				6,829
129	Bashkia	Sist -Asf I Rruges Leke Zaharia	16,198,020		9,561,810	24.05.2021				9,561,810
130	Bashkia	Mbikq.Sist -Asf Rrug Leke Zaharia	307,816		266,105	24.05.2021				266,105
131	Bashkia	Kolaud.Sist -Asf Rrug Leke Zaharia	31,669		21,122	26.05.2021				21,122
132	Bashkia	Sist Asf Rrug Nene Tereza kruje	6,167,068		3,595,322	07.12.2021				3,595,322
133	Bashkia	Mbikq.Sist-Asf. Rrug Nene Tereza k	148,190		127,091	07.12.2021				127,091
134	Bashkia	Ndert Kolekt fundor KUB L.Grumb	1,629,494		1,152,050	23.08.2021				1,152,050
135	Bashkia	Mbik.Nd Kolekt fund KUB L.Grumb	42,367		35,849	23.08.2021				35,849
136	Bashkia	KolNd Kolekt fund KUB L.Grumb	8,128		5,377	04.10.2021				5,377
137	Bashkia	Bl. kamion teknologLargim Mbetje	4,000,000		3,959,800	22.12.2021				3,959,800
138	Bashkia	Mbik.Rinder Atrium Center Thuma	1,695,073		1,695,073	23.04.2021				1,695,073
139	Bashkia	Mbik.Nd Polit te Ri Administ Bubq	1,822,884		1,822,884	01.07.2021				1,822,884
140	Bashkia	Mbik.Rinder Shk 9 vjec Hajdar Zogu	1,086,919		1,086,919	29.04.2021				1,086,919
141	Bashkia	Mbik.Rind Shk 9 vjec Velleze Masha	818,799		818,799	02.07.2021				818,799
			499,062,556	**-**	**389,562,823**	**-**	**125,303,059**	**100,364,354**	**84,492,031**	**79,403,368**
1	M Rinde	proje nderhy rehabil demtime termet	64,047,500		63,746,100	16.04.2021			63,746,100	-
2	M Rinde	Ndertim I atrium center thumana	220,210,898		220,079,942	23.04.2021			35,256,999	184,822,943
3	M Rinde	Ndert objekt te Polit ten ri NJA Bubq	238,129,843		237,995,994	14.06.2021			47,625,968	190,370,026
4	M Rinde	Rindert Shk.9 vjec Hajdar Zogu Tapiz	103,147,686		102,994,662	29.04.2021			20,629,500	82,365,162
5	M Rinde	Rinder shk 9 vjec Vellez Masha Bubq	72,944,207		72,793,016	02.07.2021			14,558,841	58,234,175
			698,480,134	**-**	**697,609,714**	**-**	**-**	**-**	**181,817,408**	**515,792,306**
1	M.Bujqes	Rehabilitim I Diges Tapize	208,640,000		204,444,551	18.07.2019	180,399,649	24,044,902		-
2	M Arsim	Rik. shtes Anes ShkMesme L Kastr	135,373,932		135,174,097	12.09.2019	114,149,537	21,024,524		-
	Bashkia		58,017,399		58,017,399			29,008,700	29,008,658	
3	M.Inf.AKUK	Shtim Sasi Furniz me Uje qytet Kruj	378,165,420		376,513,869	24.07.2019	76,633,084	70,000,000	40,000,000	189,880,785
4	M.Inf.AKUK	Mbik.Shtim Sasi Furn Uje qytet Kruj	4,489,069		3,863,858	13.09.2019	779,033	1,156,000	1,000,000	928,825
5	M.Inf.AKUK	Rehab puse ekzist, ndert linje transmeti e shpernda ujesje F.Kruje	588,869,490		587,214,932	15.05.2020		117,773,898.	10,000,000	459,441,034
6	M.Inf.AKUK	Mbik. Rehab puse ekzist, ndert linje transmeti e shpernda ujesje F.Kruje	5,428,626		4,502,496	15.05.2020		1,085,725	200,000	3,216,771

			1,378,983,936	**-**	**1,369,731,202**	**-**	**371,961,303**	**264,093,749**	**80,208,658**	**653,467,415**
		Rehab Salles Koncert Pallat Kultur "Ibrahim Berdaku "kruje	4,554,138		4,457,387	14.06.2021			3246670	1,210,717
1	Bashkefinanc im , Bashkia +Q. Zvicer		22,286,935		22,286,935	14.06.2021			16233348	6,053,587
		Shtes punim Rehab Salles Koncert Pallat Kultur "Ibrahim Berdaku "kruje	2,915,992		2,915,992	24.11.2021				2,915,992
	Bashkia		584,000		583,198	24.11.2021				583,198
2	Bashkia	Mbikq.Rehab Salles Koncert Pallat	83,184		83,184	14.06.2021				83,184
	donacion	Kultur "Ibrahim Berdaku "kruje	425,918		415,918	14.06.2021				415,918
3	Bashkia	Kol.Rehab Salles Koncert Pallat	3,400		3,400	16.12.2021				3,400
	donacion	Kultur "Ibrahim Berdaku "kruje	17,000		17,000	16.12.2021				17,000
4	Bashkia	Blerje automjeti zjarrfikes per Bashkine Kruje	9,210,000		9,000,000	14.06.2021			9,000,000	-
	Donacion Ambasad Japoneze		1,842,000		1,800,000	14.06.2021			1,800,000	-
			41,922,567	**-**	**41,563,014**	**-**	**-**	**-**	**30,280,018**	**11,282,996**

Aneksi nr.4: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet31.12.2021

lekë

Nr.	**Emër Atësi Mbiemër**	**Detyrimi /taksa**	**Paguar**	**Mbetur**
1	A. S. H.	18,856	18,856	
2	A. Xh. F.	40,963		40,963
3	A.S. M., F. I. M.	13,979	13,979	
4	B. M. M.	24,870	24,870	
5	D. K. S.	18,368		18,368
6	D. M. S.	25,520	25,520	
7	D. R. S.	52,829	52,829	
8	E. Q. B.	19,018	19,018	
9	F. F. K.	32,347	32,347	
10	Gj. N. M., M. P. M.	12,354	12,354	
11	M. H. L.	5,689	5,689	
12	M. K. S.	30,397	30,397	
13	N. M. F.	26,821	26,821	
14	P. H. D.	23,082	23,082	
15	P. S. P.	54,129	54,129	
16	P. S. K.	5,689	5,689	
17	P. Gj. Gj.	12,516	12,516	
18	R. V. C.	18,856	18,856	
19	S. Z. S.	47,790		47,790
20	S. L. A.	5,689	5,689	
21	Sh. R. H.	56,242	56,242	
22	Sh. H. M.	17,555	17,555	
23	Sh. S. Sh.	688,399	688,399	
24	Xh. Sh. L.	33,160	33,160	
	TOTAL	**1,285,118**	**1,177,997**	**107,121**

Burimi: Bashkia Krujë

Aneksi nr.5: Përfituesit e bonusit të qirasë sipas Vendimeve të Këshillit Bashkiak

Nr.	VKB	Ap.1+1	Ap.2+1	Ap.3+1	Totali
1	VKB nr. 106 datë 29.12.2019 ñPër miratimin e listës së familjeve të evakuara që kanë mbetur të pastrehaò	64	100	68	232
2	VKB nr. 10 datë 30.01.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	475	544	496	1515
3	VKB nr. 18 datë 24.02.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	123	162	168	453
4	VKB nr. 25 datë 27.03.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	23	31	43	97
5	VKB nr. 35 datë 22.04.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	11	6	16	33
6	VKB nr. 39 datë 29.05.20202 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	14	15	17	46
7	VKB nr. 47 datë 16.06.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	4	4	3	11
8	VKB nr. 48 datë 22.06.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	2	2	2	6
9	VKB nr. 58 datë 06.07.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	3	10	6	19
10	VKB nr. 60 datë 30.07.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	9	4	5	18
11	VKB nr. 67 datë 21.08.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	2	2	2	6
12	VKB nr. 73 datë 30.09.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	7	5	5	17
13	VKB nr. 113 datë 28,12.2020 ñPër disa shtesa në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	2	7	8	17
14	VKB nr. 4 datë 11.01.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	341	430	388	1159
15	VKB nr. 7 datë 05.02.2021òPër disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 106 datë 26.12.2019ò	1	4	3	8
16	VKB nr. 8 datë 05.02.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	78	92	99	269
17	VKB nr. 19 datë 26.02.2021òPër disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 106 datë 26.12.2019ò	6	10	1	17
18	VKB nr. 20 datë 26.02.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	15	27	31	73
19	VKB nr. 22 datë 09.03.2021òPer subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	8	6	12	26
20	VKB nr. 26 datë 31.03.2021òPër ndryshimin në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	1	4	9	14
21	VKB nr. 29 datë 31.03.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	1	12	8	21
22	VKB nr. 30 datë 19.04.2021òPër disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 106 datë 26.12.2019ò	1	0	1	2
23	VKB nr. 31 datë 19.04.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	9	10	13	32
24	VKB nr. 38 datë 31.05.2021"Për disa ndryshime në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	0	0	1	1
25	VKB nr. 39 datë 31.05.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	5	10	4	19
26	VKB nr. 44 datë 28.06.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	7	4	3	14
27	VKB nr. 59 datë 26.07.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	2	7	8	17
28	VKB nr. 76 datë 31.08.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	8	3	4	15
29	VKB nr. 78 datë 31.08.2021òPër disa ndryshime në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò				
30	VKB nr. 85 datë 22.10.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	3	6	3	12
31	VKB nr. 86 datë 22.10.2021òPër disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	1	1	4	6
32	VKB nr. 109 datë 28.12.2021òPër subvencionimin e pagesës së qirasë sipas aktit normativ nr. 37 datë 24.12.2020ò	6	5	5	16
33	VKB nr. 110 datë 28.12.2021òPër disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 106 datë 29.12.2019ò	0	3	0	3
	Totali përfitues	1232	1526	1436	4194
	Vlera sipas strukturës së apartamentit	10,000	15,000	20,000	

	Vlera totale	12,320,000	22,890,000	28,720,000	63,930,000

Burimi: Bashkia Krujë, përpunoi grupi i auditimit

Aneksi nr.6: Rakordim i Fondeve të Rindërtimit deri më datë 31.12.2021

VKM	Dega Thesarit	Emërtimi i produktit	Vlera e Financimit viti 2020	Përdorimi i Fondeve 2020	Vlera e trashëguar për vitin 2021	Vlera e financimit viti 2021	Përdorimi i Fondeve 2021	Fonde të disponueshme
Nr.540, 08.07.2020	0716	Rikonstruksion i banesave individuale dhe njësive të banimit	660,700,000	615,350,000	45,350,000		3,250,000	42,100,000
Nr.732, 16.09.2020	0716	Rikonstruksion i banesave individuale dhe njesive te banimit në ndërtesa (pallat)	86,000,000	73,500,000	12,500,000		500,000	12,000,000
Nr. 1135 24.12.2020	0716	Rikonstruksion i banesave individuale dhe njësive të banimit	12,150,000		12,150,000		11,300,000	850,000
Nr. 333 02.06.2021	0716	Rikonstruksion i banesave individuale dhe njësive të banimit			-	89,100,000	85,450,000	3,650,000
		Shuma totale e fondeve të rindërtimit me kap. 01 me Kod Projekti 94902AB	**758,850,000**	**688,850,000**	**70,000,000**	**89,100,000**	**100,500,000**	**58,600,000**

Burimi: Bashkia Krujë

Aneksi nr.7: Inventari kontabël i llogarisë 212 "Ndërtesa " me 31.12.2021

	Emertimi	Gjendja 31.12.2020	Gjendja 31.12.2021	Nr.	Emertimi	Gjendja 31.12.2020	Shtesat per 2021	Gjendja 31.12.2021
	NDERTESA				NDERTESA	**1634406228**	**198837807**	**1,823,791,497**
1	Shkolla e mesme Kruje	74851926	74,851,926	78	Rikonstruks shkolle Mazhe Vogel	Prish termet		
2	Shkolla Nr 1	77270100	77,270,100	79	Ndertim Shkolle e re Mallkuc	15890774		15,890,774
3	Shkolla Nr 2	60283207	60,283,207	80	Ndertim Shkolle e re Murqine	8210754		8,210,754
4	Nyja Sanitare Abaze	158849	158,849	81	Rikonstruksion Shkolle Budull	Prish termet		
5	Shkolla nr 3 Berbere	180000	180,000	82	Ndert muri rrethues Shkolle Bubq	Prish termet		
6	Shkolla nr 4	8224112	8,224,112	83	Ndertim Zyrash te Komunes Bubq	7992127		Prish termet
7	Shkolla Barkanesh	15000	15,000	84	Ripar te zyrave te komunes Bubq	399411		Prish termet
8	Shkolla Dane Fushe - Madhe	40000	40,000	85	Ndertim qendre shendetesore Bubq	Prish termet		
9	Shkolla Picrrage	10000	10,000	86	Ndertim Ambulance Mallkuc	1012467		1,012,467
10	Shkolla Vjeter Abaze	25000	25,000	87	Ndertim Ambulance Bilaj	720000		720,000
11	Kopshti nr 1 , Hoxhe	150000	150,000	88	Ndertim Ambulance Budull	720000		720,000
12	Kopshti nr 3	35000	35,000	89	Ndertim Ambulance Ura gjoles	720000		720,000
13	Kopshti nr 2 , me ushqim Derede	750000	Prish termet	90	Ndertim Ambulance Budull Koder	720000		720,000
14	Kopshti pa dreke Hoxhe	34096	34,096	91	Ndertim Ambulance Mazhe Vogel	720000		720,000
15	Kopshti nr 4 , Gurkuqe	24762	24,762	92	Ndert Ambulance Mazhe Madhe	942593		942,593
16	Pika spitalore Ambulatore Varosh	15132	15,132	93	Ndertim Ambulance Murqine	1166666		1,166,666
17	Kopshti Kovace	24941	24,941	94	Shkolla cudhi zalle (qender)	2020000		2,020,000
18	Kopshti tek Celt (Tek Teqja)	19017	19,017	95	Shkolla cudhi kampt	58975		58,975
19	Cerdhja Hoxhe nr 1	325000	325,000	96	Shkolla nuaj qender	Prish termet		
20	Cerdhja Derede	250000	Prish termet	97	Shkolla mafsheq	60000		60,000
21	Cerdhja nr 3	158000	158,000	98	Kopshti mafsheq	48000		48,000
22	Cerdhja nr 4 ,Varosh	250000	250,000	99	Ambulanca Shqeze	799600		799,600
23	Cerdhja nr 5 , Berbere	184000	184,000	100	Ambulanca Nuaje	2501880		2,501,880
24	Godi e Bashk + shtesat vitit 2004	8765890	8,765,890	101	Shkolla Shkrete	67600		67,600
25	Zyrat e Komunales	253685	253,685	102	Shkolla Rranze	3438333		3,438,333
26	Banjot Publike	2491005	2,491,005	103	Zyrat e komunes	10042915		10,042,915
27	Shtepia e pionierit	180000	180,000	104	Kopshti Nuaje	61000		61,000
28	Riparimi I kateve te Bashkise	1178711	1,178,711	105	Shkolla Bruz Mal	1320000		1,320,000
29	Shkolla Brret	3513439	3,513,439	106	Shkolla Kroji I Madh	381464		381,464
30	Qendra kulturore	256990255	256,990,255	107	**Ndertime Njesia Thumane**	**104595727**		**104595727**
31	Rikostru Obelisku I Skenderbeut	970960	970,960	108	Ndertime para vitit 2001	27146269		27146269
32	Shkolla e mesme e reja	652450	652,450	109	Rikonstruksion tregu fshatar	4716811		4716811
33	Klubi sportiv	2545408	2,545,408	110	Rikonstruksion bashkia fushe kruje	7079619		7079619
34	Sistemimi vzarrezave publike	2250264	2,250,264	111	Rikonstruksion gjendja civile	2035559		2035559
35	Shkallet e hekurit te bashkia	130,000	130,000	112	Rikonstruksion banjot publike	1866403		1866403
36	Tabela e bashkise	40000	40,000	113	Ndertim catia e bashkise	3858627		3858627
37	Siste I varrezave te deshmoreve	248005	248,005	114	Dega e mobilizimit ushtarak	2200000		2200000
38	Godina e Stadiumit	1956420	1,956,420	115	Depo e agroeksportit	39576139		39576139
39	Zyra e Gjendje Civile (rikostruk)	792722	792,722	116	Rrethim I stadiumit fushe kruje	4250908		4250908
40	Konvikti I shkolles se mesme	79529993	79,529,993	117	Rik shkallet e stadiumit fushe kruje	5934772		5934772
41	Stadiumi I ri	2868556	2,868,556	118	Ndert tenda e fush sport fushe kruje	396000		396000
42	Fusha e Vjeter	398700	398,700	119	Rikonstr fusha e sportit fushe kruje	12151872		12151872

43	Lulishte	5000000	5,000,000	120	Rikonstr kendi sportiv shkol Hasan	491398		491398
44	Rip te ndryshme te mure rrethues	357834	357,834	121	Rikonstr shpia kultures fushe kruje	15605331		15605331
45	Varrezat e deshmoreve	1858959	1,858,959	122	Shtee e riko shk 9-vjec Q. fush kruje	71851151		71851151
46	Varrezat	3333472	3,333,472	123	Rrethim I shkolles 9-vjecare Halil	1579000		1579000
47	Muri rrethues I kopshtit nr 1	153600	153,600	124	Rikonstruksion kopshti fushe kruje	23250000		23250000
48	Ndertim muri ndares tek tregu	462000	462,000	125	Rikonstruksion shkolla Luz	Prish termet		
49	Muri rrethues I varrezave	430800	430,800	126	Rikonstruks poliklinika fushe kruje	24758761		24758761
50	Mbikqyrje Gjimnazi	360963	360,963	127	Ndertim ambulanca Arameras	1519647		1519647
51	Ndertesa e shkolles Nikel	46474963	46,474,963	128	Rikonstruksi shkoll nr 4 (viti2014)	55745715		55745715
52	Ndertesa e shkolles Tapize	10339862	10,339,862	129	Ndertim palestra shkolla 4 (2015)	8855458		8855458
53	Ndertesa e shkolles Qereke	5918751	5,918,751	130	Gjimnazi Shote Galica Fushe Kruje	165016488		165016488
54	Ndertesa e shkolles Rinas	10126392	10,126,392	131	Rrethim varrezave Fushe Kruje	443880		443880
55	Ndertesa e shkolles Kurcaj	6737912	6,737,912	132	Rikonstruksi shkol e mesme Kruje	60000		60000
56	Ndertesa e shkolles Mukje	169783	169,783	133	Ndertim palestra shkolla 4 (2015)	21878366		21878366
57	Ndertesa shkollles Greps	460003	460,003	134	Supervizi qendra kulturore Kruje.	595932		595932
58	Ndertesa e shkolles Verjon	30000	30,000	135	Mbik.Ndert palës shk 9vje S. Shehu	15720		15720
59	Ndertesa njesise+ rrethimi	19122460	19,122,460	136	Kolaud.ndert.palester shk nr 4	57600		57600
60	Qendra Shendetesore Nikel	2892809	2,892,809	137	Mbik.Rik.shte an shk nr.4	576000		576000
61	Qendra Shendetes Tapize	4546358	4,546,358	138	sist & ngrohje gjimna (2015),(	25500645		25500645
62	Qendra Shendetes Qereke	1529806	1,529,806	139	rehabilit I fasada fkr (2015)	28396269		28396269
63	Qendra Shendetes Rinas	1482853	1,482,853	140	Banesat e romeve	21231355		21231355
64	Qendra Shendetes Kurcaj	1645268	1,645,268	141	"Rikons I godines Bashki Kruje	68533884		68533884
65	Shkolla e mesme Bubq	Prish termet		142	Rik. Shkoll e ambjente Nj Cudhi	4241545		4241545
66	Shkolla 9 Vjecare Bubq	Prish termet		143	Rik Shkoll Mesme Bash Borizane	74614076		74614076
67	Shkolla 9 Vjecare Budull	Prish termet		144	Rip I varrezave te Deshmoreve	2395596		2395596
68	Shkolla 9 Vjecare Bilaj	Prish termet		145	Rik Banesash per rom e egjiptjan	14701319		14701319
69	Shkolla 9 Vjecare Mallkuc	45000	45,000	146	" Rehab /perfor banes ekzist për komunitet te varfer e pa perkrah	13899974		13899974
70	Shkolla 9 Vjecare Mazhe Vogel	Prish termet		147	Mbikq Rehab/perfor banes ekzist për komunitet varfer e pa perkra	183400		183400
71	Shkolla Fillore Mazhe Madhe	10000	10,000	148	Rik ambulanc Tapize Nj Ad Nikel		1766585	1766585
72	Shkolla fillore Tari	35000	35,000	149	Mbikq ambulanc Tapiz NjA Nikel		26376	26376
73	Shkolla fillore Murqine	10000	10,000	150	Rik e shtes shk mesme,L Kastriot		193191455	193191455
74	Kopshti Bubq	Prish termet		151	Mbikq Rik shtes shk mesm Kastri		1922784	1922784
75	Kopshti Mazhe Vogel	Prish termet		152	Rik shkoll Kurcaj Kegli		1895563	1895563
76	Kopshti Murqine	15000	15,000	153	Mbikq Rik shkoll Kurcaj Kegli		22740	22740
77	Kopshti Budull	Prish termet		154	KolaudRik shkoll Kurcaj Kegli		12304	12304

Aneksi nr.8: Analiza e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm"

Nr	***Emertimi***	***SUBJEKTI***	***Nr/v/fat/kont.***	***Data***	LIKUJDIM 31.12.2021
1	V.Gjyqesor z.A.M.		276	23,06,2010	4,670,000
2	V.Gjyqesor z.L. Q.		541	22,11,2013	500,000
	Totali:				**5,170,000**
1	Kolaudim punimesh:Sistemim asfaltim rruga para shkolles 4		kontrate.		8,800
2	Sistemim asfaltim i rruges Kasme kruje		kontrate.		11,634,760
3	Mbik. punimesh objekti:Ndertim rruga lagja kasme.		kontrate	23,07,2013	240,000
4	Mbik. punimesh objekti:Sistemim perroi		19933454	07,07,2015	80,000
5	Mbik.:Rrethrrotullim dhe trotuare tekKryqezimi lek Zaharia		23534352	21,08,2015	4,200
7	Mbik.punimesh objekti:Sistemim perroi		112142	07,07,2015	400,000
9	Kolaud Sistemim i kapazhit te ujesjellesit Sakarrac -kruje		kontrate	28,06,2013	45,187
11	Kolaud Sistemim-gjelberim i zones se banimit derede		kontrate	20,09,2013	25,889
12	Kolaudi per objektin:Rikonstruksion i rruges ne lagjen Pengile		kontrate.	9,10,2013	159,824
14	Mbikqyerje per objektin:Ndertim rruga shullaz Kruje		23686102	05,09,2015	2,160
15	Kolaudim punimesh objekti:Ndertim rruga shullaz Kruje		22265706	17,09,2015	1,440
16	Mbikqyerje per objektin:Sistemim dhe ndricim rruga e malit.		18953322	01,09,2015	150,000
17	Mbikq:Asfaltim i rruges para shkolles 9 vjecare fushe kruje		3783077	15,05,2013	44,000
19	Mbikq:Shtese e rikons shkolla 9 vjecare Fushe Kruje		201255	08,09,2009	84,365
21	Kolaudim Shtese e rikonstruksion shkolla 9 vjecare Fushe Kruje		kontrate	16,09,2009	85,258
23	Sistemim asfaltim ndricim blloku nr.4,Fushe Kruje		41601945	30,10,2012	8,493,056
24	"	diference fature	41601945	30,11,2011	1,315,532
25	Kolaudim punimesh per objektin:Sistemim asfaltim blloku		776818	03,12,2012	73,410
30	"	"	72293314	31,12,2010	548
31	Kolaudim punimesh objekti:Sistemim asfaltim rruga e lacit		kontrate.	13,04,2010	27,555
32	Sistemim asfaltim rruga Kishe-Gabine		KONTRATE	15,03,2011	13,219
34	Mbikqyerje objekti:Ndicim pjesor i qytetit Fushe Kruje f.I		kontrate	09,02,2011	105,743
35	Kolaudator objekti:Ndricim pjesor i qytetit FusheKruje F.I		kontrate	02,05,2011	15,000
36	Mbikq:Sistemim asfaltim rruga Larushk I siperm		kontrate.	03,05,2011	92,010
38	Rikonstruksion i fushe s sportit ,"Redi Maloku",f.Kruje		diference	19,04,2011	149,998
39	Mbikq Rikonstruksion i fushe sportit redi Maloku Fushe Kruje		71635220	08,07,2011	56,326
41	Kolaud:Rikonstruksion i fushe sportit redi Maloku Fushe kruje		85441112	06,07,2011	25,642
43	Mbikq:Sist asfa ,trotuare ,ndricim e gjleberim blloku nr 3 fkruje		85324927	03,12,2012	143,473
45	Kolaudator objekti:Ndertim muri mbajtes ne Halil.		kontrate	18,10,2012	6,371
46	Riveshje asfaltobeton rruga e durresit.		diference	13,05,2011	144,367

47	Sistemim asfaltim i rruges Lacit		diference	13,05,2011	738,217
48	Mbikqyerje objekti:Sistemim asfaltim rrugaSabri Cela fkruje		kontrate	09,09,2014	3,480
50	Mbikqyerje punimesh objketi:Ndertim KUB ,Larushk.		kontrate	29,10,2014	4,560
51	Kolaud:Sist asf i rrug SMT e sistem I ujra sheshi poliklini F.kruje		12622946	01,07,2015	4,123
53	Sistemim asfaltim i rruges Zhabjaku e blloku 8 F.Kruje		18392201	02,02,2015	241,311
54	Kolaudim :Sistemim asfaltim rruga Zhabjaku e blloku nr 8		kontrate	11,03,2015	6,873
56	Mbikqyerje punimesh objekti:Rehabilitim fasadave F.Kruje			09,06,2015	79,200
57	Koalaudator punimesh :Sistemim asfaltim i rruges magaze		Kontrate	26,06,2015	26,400
59	Shpronesim unaza vpgel f.kruje		VKM,571	3,09,2015	123,000
60	*Shpronesim unaza vpgel f.kruje*		*VKM,571*	*3,09,2015*	38,590
61	*Kolaudator per objektin:ndertim shkolles mesme," Shote Galica*		*kontrate*	*22,06,2015*	10,800
64	Mbikqyerje punimesh :Shtrim me cakell		7264869	20,10,2014	5,520
65	Kolaudim punimesh :Ndertim depo uji tip kulle thumane		7264890	13,05,2015	20,000
66	Kolaud Shtrim me cakell(markagjon vendgrumbull I plehrave		5446919	20,10,2014	10,000
67	Blerje paisje kompjuterike		15647794	02,10,2014	59,880
68	Rikonstruksion rruga gramez.		kontrate		79,914
69	Rikonstruksion i rrugeve rurale komuna Nikel.		kontrate	21,05,2015	5,400
70	Mbikqyerje objekti :Riveshje asfalt rrugeve Komuna Nikel.		18556180	15,06,2015	8,520
71	Mbikq objekti:Sistemim gjelberim shkolla Ramazan Karaj , Nikel		23346206	08,07,2015	26,400
72	Mbikqyerje objekti:Asfaltim rruga perroi i brateve		kontrate	09,09,2013	4,920
73	Kolaudator objekti:Rikonstruksion rruget rurale Nikel		kontrate.	03,07,2013	1,920
74	Mbikqyerje objekti:Asfaltim rruges shkolla tapize		kontrate	16,10,2013	12,600
75	Mbikqyerje objekti:Asfaltim rruges kthesa ura tapize		kontrate	22,10,2014	3,348
76	Kolaudim objekti:Riveshje asfalt i rrugeve komuna Nikel		kontrate	05,06,2015	3,360
77	Mbikqyerje objketi:Asfaltim rruga perroi Brateve		kontrate	17,06,2013	52,000
78	Mbikqyerje objketi:Asfaltim rrugeve rurale Nikel		kontrate	21,06,2013	24,000
79	Asfaltim i rrugeve shkolla tapize		kontrate	18,10,2013	367,076
80	Asfaltim rruga perroi brateve ,Shkolla grepse.		kontrate	11,06,2013	1,525,210
81	Mbikqyerje objekti:Asfaltim rruga perroi i brateve.		Kontrate	13,04,2011	109,721
83	Sistemim -Asfaltim I rruges Engjelli Bilaj		fature	31.05.2021	1795208
84	Sistemim -ASFALTIM I RRUGES SE UKEVE SIT NR 1		fature	31.05.2021	626604
85	Sistemim -Asfaltim I rruges se Ukeve SIT PERF		fature	06.07.2021	792828
86	Sistemim -Asfaltim I rruges lidhese Sh.Cela-Rr Shkolles		fature	08.06.2021	1799568
87	Sistemim -Asfaltim I rruges Kruje Picrrage		fature	29.07.2021	7496112
88	Ndërt kolektori fundor KUB Lagja "Grumbull", Nj.A.Fushë Krujë,		fature	02.09.2021	1152048
89	mbikqyrje punimiesh		fature	26.11.2021	35849
90	Sistemim -Asfaltim I rruges se Topalleve		fature	16.09.2021	5113860
91	Sistemim -Asfaltim I rruges topalli nikel		fature	19.10.2021	583200
92	Mbikqyrje e rruges:"Sistemim-Asfaltim I rruges Topalli Nikel		fature	18.11.2021	187129
93	Kolaudim punimesh :"Sistemim -Asfaltim I rruges Topalli		fature	22.11.2021	22464
94	Sistemim -Asfaltim I rruges se vjeter te Tiranes		fature	25.09.2021	744000
95	Kolaudim rruga e selmaneve prane xhamise		fature	30.12.2021	5598
96	Sistemim -Asfaltim I rruges se Allusheve NJ ad Fkruje		fature	18.10.2021	1807080
97	Sistemim -Asfaltim I rruges Magaze faza 3		fature	08.10.2021	1392698
98	Sist -Asfa shesh para Kishes e Rrug Lidhes Fsha Gramez Thuma		fature	24.05.2021	2026050
99	Rehabilitim I salles se koncerteve sit perfundimtar		fature	30.11.2021	1793717
100	Mbikqyrje punimesh :"Rehabilitim I salles se koncerteve		fature	13.12.2021	83184
101	Sistemim-Asfaltim I rruges SE AERPORTIT RINAS		fature	22.10.2021	744132
102	Mbikqyrje "Sistemim-Asfaltim I rruges degezimi rinas		fature	08.12.2021	88579
103	Sistemim -Asfaltim I rruges Grames Sukth Vendas sit perf		fature	25.11.2021	3769734
104	Mbikq :"Sistemim-Asfaltim I rruges Gramzes Sukth Vendas"		fature	15.12.2021	307687
105	rehabilitim I sheshit tanush topia		fature	30.12.2021	520800
106	rruga e thanzes		fature	29.12.2021	3687336
107	mbikqyrje rruga e thanzes		fature	28.12.2021	216854
	Totali:				64,016,795
1	Darke iftari		2	03,08,2013	144,000
2	Shpenzime postare 20 fatura vitet 2006-2009		42384082	04.12.2009	250,604
23	Blerje materiale ndertimi 3 fatura		28971221	10,07,2015	98,700
26	Blerje toneri		8158313	07,08,2015	4,000
27	Saldatrice		4798	28,01,2013	26,500
28	Blerje pjese kembimi		7965	19,12,2013	39,050
29	Mallra sherbime		15941	06,11,2013	4,000
30	Buke 4 fatura vitet 2009-2010-2011		6393704	01,11,2010	82,730
34	Blerje rere e granil 2 fatura		167162	04,05,2012	87,440
36	Blerje toner e kancelari		1014	31,10,2012	99,050
37	Blerje materiale hidraulike		3888	24,07,2015	9,850
38	Blerje kancelari 6 fatura		1030	28,01,2013	638,660
44	Sherbim fotokopje	*	1035	10,02,2014	9,800
45	Blerje grile veneciane		55	06,02,2013	9,800

46	Blerje vegla pune		7447148	24,03,2015	9,300
47	Blerje pusete +kapake pusete		68025550	06,09,2010	4,200
48	Blerje kortolina		1019	31,12,2012	21,700
49	Materiale te ndryshme				29,450
50	Formatim kompjuteri		7579964	21,10,2014	7,000
51	Formatim kompjuteri		7579960	16,10,2014	10,000
52	Blerje nafte		6685320	23,01,2015	237,000
56	Riparim kompjuteri		5671	29,01,2014	7,000
57	Mirembajtje e kompjuterave +fotokopjve		kontrate	20,04,2015	6,800
58	MikqyrjepunimeshPer mirembejtje lumit Zeze.		Kontrate.	17,09,2013	5,880
59	sigurime te prapambetura				1,974,004
60	tap I prapambetur				889,683
61	Tatim burim keshilltare				152,460
62	Tatim burim keshilltare				124,860
53	Sherb pastrimit e depozitimit te mbetjeve urbane Fushe Kruje		10/2021	30.12.2021	1655407
54	Sherbim Vnedgrumbullimi I mbetjeve urbane Fkruje		186/2021	31.12.2021	249740
55	Sherbim tarife permbarimore Astrea shpk		21/2021	21.07.2021	1,861250
	Totali:				8,281,112.00
	Totali :				
	TOTALI PERGJITHESHEM				**77,467,907**

Aneksi nr.9: Formati nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare"

Nr. rresh	Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR 2021	VITI I MEPARSHEM 2020
1	**A**	**TE ARDHURAT**	**2,428,598,640**	**2,853,824,657**
2	***70***	***I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET***	**147,701,933**	**164,719,921**
3	**700**	**1.Tatimi mbi te Ardhurat**	**3,507,325**	**3,812,403**
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	3,507,325	3,812,403
7	*7009*	*Te tjera Tatime mbi te ardhurat*		
8	**702**	**2.Tatimi mbi Pasurine**	**78,341,047**	**89,502,589**
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	73,745,532	88,553,943
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe	147,950	68,448
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	4,447,565	880,198
12	**703**	**3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit**	**65,853,561**	**69,912,456**
17	7035	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	65,853,561	69,912,456
18	**704**	**4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare**	**0**	**0**
24	**708**	**6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare**		**1,492,473**
25	**709**	**7.Gjoba e Kamat vonesa**		
26	***75***	***II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE***	**0**	**0**
34	***71***	***III.TE ARDHURA JO TATIMORE***	**105,114,936**	**88,648,800**
35	**710**	**1.Nga ndermarrjet dhe pronesia**	**24,000**	**48,000**
36	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	24,000	48,000
39	**711**	**2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare**	**105,090,936**	**88,600,800**
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	57,997,253	58,371,414
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	3,175,428	1,806,299
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	243,000	184,000
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	43,675,255	28,239,087
46	7116	Te ardhura transferimi prones,Legalizimi i ndertime pa leje		
47	**719**	**3.Te tjera te ardhura jo tatimore**		
48	***76***	***IV.TE ARDHURA FINANCIARE***	**0**	**0**
53	***72***	***V.GRANTE KORENTE***	**2,175,781,770**	**2,600,455,936**
54	**720**	**1.Grant korent I Brendshem**	**2,175,556,935**	**2,600,455,936**
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	1,354,386,075	1,552,437,491
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)		40,108,291
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	54,534,630	
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshem nga buxheti	763,937,770	997,520,020
62	7207	Sponsorizime te brendshme (nga te trete)	2,698,460	10,390,134
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	**721**	**2.Grant korent I Huaj**	**224,835**	**0**
65		Nga Qeveri te Huaja		

66		Nga Organizata Nderkombetare	224,835	
67		***VI.TE ARDHURA TE TJERA***	0	0
73	***73***	***VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE***		
74	**B**	**SHPENZIMET**	**1,844,673,937**	**2,173,534,105**
75	**600**	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**320,654,672**	**311,457,933**
76	6001	Paga, personel I perhershem	320,654,672	311,457,933
77	6002	Paga personel I Perkohshem		
78	6003	Shperblime		
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	**601**	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**52,918,369**	**53,993,939**
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	47,523,693	48,695,720
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	5,394,676	5,298,219
83	**602**	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**261,949,061**	**178,929,870**
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	3,468,468	2,024,490
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	92,026,796	18,849,919
87	6022	Sherbime nga te trete	69,036,716	56,721,600
88	6023	Shpenzime transporti	20,857,376	14,715,955
89	6024	Shpenzime udhetimi		0
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	7,983,360	0
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	2,134,604	627,878
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	56,547,633	75,863,735
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
94	6029	Shpenzime te tjera operative	9,894,108	10,126,293
95	**603**	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**
101		**V.TRANSFERIME KORENTE**	**822,029,639**	**1,461,868,190**
102	**604**	**1.Transferime korente te brendshme**	**120,468,772**	**614,038,299**
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	120,468,772	596,038,689
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		1,000,000
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		16,999,610
107	**605**	**2.Transferime korente me jashte**	**0**	**0**
112	**606**	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**701,560,867**	**847,829,891**
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	2,285,000	843,471,668
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	699,275,867	4,358,223
115		**VI.SHPENZIME FINANCIARE**	**0**	**0**
125		**VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA**	**0**	**0**
130	***63***	***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**9,668,535**	**1,602,575**
131		***IX.SHPENZIME TE TJERA***	**377,453,661**	**165,681,598**
132	***85***	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES** ***(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)***	**583,924,703**	**680,290,552**

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT